

INFORMATIZIMI I PROCESIT TË CERTIFIKIMIT TË EDUKIMIT PROFESIONAL

Kastriot Haxhiu

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkencat ekonomike, me profil Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit,
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Adriana Gjonaj

Numri i fjalëve: 60.074

Tiranë, Janar 2021

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se punimi im se doktorial publikohet për herë të parë pran Univeristetit European të Tiranës dhe është kryesisht punë origjinale.

Ai përputhet plotësisht me parimet dhe me kërkesat e udhëzimeve të instituconit, për etikën në hulumtim.

Autori

ABSTRAKTI

Punimi studimor analizon gjendjen faktike të aftësisë profesionale në Kosovë, si dhe nevojën imediate të ndryshimit të këtij arsimit bazuar në kërkesat e tregut. Qëllimi primar i kësaj teze është gërshetimi i sistemeve të arsimit dhe të trajnimit të përshtatshëm profesional me kontekstin ekonomik dhe institucional në vend duke u mbështetur në përvojat europiane. Ideja, për hulumtimin e problematikës së informatizimit të procesit të certifikimit të edukimit profesional, lindi nga koncepti i punës në shoqëri ku në një vend me ekonomi në zhvillim, e sidomos një ndër vendet e fundit në rajon me të ardhura e burime të pakta dhe nivel të lartë varfërie, puna shihet si mjet mbijetese, atëherë kualifikimi profesional ofron shanse më të mëdha për punësim. Kualifikimi nënkupton integrim në tregun të punës. Krijimi i një platforme nga palët e interesit me mbështetje juridike nga qeverisja lokale dhe ajo qendrore duhet të jetë hap esencial zhvillimor ekonomik në drejtim të përmisimit të standardeve të shkollimit profesional. Objektivi i përgjithshëm i këtij punimi është që të kontribuojë në fushën e procesit të ndërtimit të strukturës organizative të aftësimeve profesionale si dhe në informatizimit e procesit të certifikimit të tyre, duke modifikuar aplikacionin aktual elektronik të Komunes së Gjakovës. Bashkangjitja e biznesit në këtë proces është faktor kyç për punësimin e të rinjve të kualifikuar dhe ndikimit direkt në zbutjen e papunësisë. Ky faktor do të ndikonte dukshëm në marketingun e aftësisë profesionale në publikun e gjërë dhe popullimin e shkollave profesionale. Kërkesa për një shkollim profesional do të ndikonte në ngritje të cilësisë mësimore dhe përkujdesje institucionale më lartë. Menaxhimi i sistemit të informacionit përmes modifikimit të aplikacionit do të jetë një rivitalizim transparencës ndaj qytetarit dhe një motivim shtesë kualifikim profesional.

Fjalët kyçe: aftësimi profesional, arsimiti, trajnimi, biznesi, aplikacioni i modifikuar, komuna, tregu i punës.

ABSTRACT

The study paper analyzes the factual state of the vocational education in Kosovo, as well as the immediate need to change this training based on the market requirements. The primary objective of this thesis is the intertwining of education systems and adequate vocational training with economical and institutional context in the country by relying on the European experiences. The idea of researching the concern of digitalizing the process of certifying the vocational education rose by the concept of the work in a society whereby in a country with a developing economy especially in a country that is ranked last in the region on income and resources and high poverty rate, work is considered as a survival device, therefore the professional qualification offers higher chances for employment. Qualifications mean integration in the labour market. Creation of a platform with all the stakeholders with a juridical support from the local and central government should be an essential economical development step towards improving the vocational education standards. The main objective of this paper is to contribute in the field of organizational structure building process for the vocational education as well as the digitalization of the process of their certification, by modifying the current digital and electronic platform of the Gjakova Municipality. One key factor in this process is the engagement of the businesses in order to increase the employment of the qualified youth and the direct influence in diminishing unemployment. This factor would evidently influence in marketing the vocational education towards the general public as well as populate widely the vocational schools. The demand for a vocational education would influence in increasing the teaching/learning quality and higher institutional attendance. The information system management by modifying the application would be a transparency renewal towards the citizens and an added value for professional qualification.

Key words: vocational training, education, training, business, modified application, Municipality, labour market.

Për mundin dhe sakrificën ndër vite,

prindëre të mi

Avniut dhe Nadies

FALENDERIME

Faleminderimi i parë i takon Zotit, që më dha mundësin, shëndetin forcën dhe vullnetin që të arrijë deri këtu ku jam sot.

Mirënjohje dhe respekt specifik për udhëheqësen time shkencore Prof.Dr. Adriana Gjonaj, e cila më ka mbështetur, udhëzuar dhe këshilluar gjatë gjithë procesit të punimit doktorial.

Një faleminderim edhe për mentorën time të parë profesoreshën Tamara Luaras, po ashtu edhe profesoreshën Mimoza Durrësi e cila dha kontribut me sygjerimet e saja gjatë studimit tim.

Shoqëri faleminderit për përkrahje dhe kontributin që jepni për mua. Miqë dhe familjar tjerë faleminderit.

Falemindrim edhe për koleget e shkollës dhe studimeve të mija të deri tanishme.

Faleminderimi që buron nga brendia e shpirtit i takon familjes, bashkëshotes Artës, për gjithë përkrahjen në secilin aspekt gjatë punës sime shkencore e më gjëre dhe për të gjitha sfidat e jetës që kemi kaluar. Faleminderim dhe mirënjohje e pafund për dy gëzimet e më të çmuarat në jetë time, fëmijëve, djalit Oriku dhe vajzës Arba, faleminderit shumë që më motivoni për çdo hap të jetës. Faleminderim i veçantë edhe vllëzerve të mi .

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I – KONTEKSTI I KËRKIMIT DHE MOTIVIMI.....	1
1.1. Hyrje	1
1.2. Përshkrimi i sfondit të problemit	2
1.3. Qëllimi i punimit.....	3
1.4. Objektivat e punimit	4
1.5. Hipotezat e punimit.....	6
1.6. Pyetjet kërkimore të punimit.....	6
1.7. Metodologjia e punimit.....	7
1.8. Rëndësia e punimit.....	7
1.9. Kufizimet e hasura	8
1.10. Struktura e punimit.....	9
KAPITULLI II – ARSIMI, ARSIMI PROFESIONAL DHE ICT	14
2.5 Analiza statistikore e AAP-ve në vendet e BE-së.....	25
2.6 Tregu i punës në vendet e BE-së.....	33
2.7 Invenstimet e vendeve europiane në arsim	40
2.8 AAP në disa nga vendet e BE	42
KAPITULLI 3 – ARSIMI PROFESIONAL NË KOSOVË DHE MOTIVIMI I TË RINJVE QË TË NDJEKIN AAP	63
3.1 Hyrje	63
3.2 Nivelet e sistemit të arsimit në Kosovë.....	64
3.3 Shënime statistikore mbi arsimin në Kosovë	71
3.3.1 Numri i nxënësve në nivele e arsimimit në Kosovë	71
3.3.2 Numri i personelit arsimor dhe i klasëve në nivelet e arsimimit në Kosovë	77
3.3.3 Nxënës në arsimin privat.....	82
3.4 Arsimi i mesëm i lartë profesional	83
3.5 Shkollimi i mesëm i përgjithshëm - gjimnazi	92
3.6 Raporti në mes gjimnazeve dhe shkollave profesionale	93
3.6.1 Kosova dhe vendet e rajonit.....	98
3.7 Raporte përmblledhëse financiare.....	100

3.8	Qendrat e Aftësimit Profesional në Kosovë.....	108
3.8.1	<i>Qendrat Regionale të Punësimit</i>	108
3.9	Masat prandaluese për braktisjen e shkollimit	113
3.10	Sfidat e shkollave profesionale në Kosovë	123
3.11	Ndryshimi i strategjisë në shkollat e mesme të larta profesionale në Kosovë	127
3.12	Inkuadrimi i biznesit si partner në praktikat shkollore.....	134
KAPITULLI IV – KOMUNA E GJAKOVËS SI RAJON GJEOGRAFIK STUDIMOR PËR RINDËRTIMIN E APLIKACIONIT PËR SHËRBIMIN E QYTETARËVE.....		141
4.1	Hyrje	141
4.2	Komuna e Gjakovës – si rast studimor për ndërtimin e moduleve të reja të aplikacionit.....	143
4.2.1	<i>Gjeografia e Gjakovës dhe hapësirat e arsimit dhe aftësimit profesional të saj</i>	143
4.2.2	<i>Rindërtimi i aplikacionit dhe qëllimi tij</i>	149
4.2.3	<i>Involvimi i biznesit në sistemin informativ menaxherial – roli dhe rëndësia e tij</i> 151	
4.2.4	<i>Komuna si bartës i projektit</i>	154
4.2.5	<i>Funksionet e sistemit informativ menaxherial</i>	156
4.3	Aplikacioni ekzistues elektronik i KK Gjakovë.....	159
4.3.1	<i>Aplikacioni ekzistues për shërbimet elektronike të qytetarëve të Gjakovës</i>	159
4.3.2	<i>Çasja në aplikacion aktual (ekzistues)</i>	161
	<i>Certifikatat online</i>	164
	<i>Skema logjike</i>	166
	<i>Raportimi i problemeve - Sistemi Online për menaxhimin e aseteve të Komunës së Gjakovës</i>	169
4.4	Aplikacioni i rindërtuar elektronik komunal për shërbime të qytetarit.....	174
4.4.1	<i>Përshkrimi i procesit të punës _Arsyeja e rindërtimit_Roli</i>	174
4.4.2	<i>Vështrimi mbi projektin dhe fusha e përkufizimit</i>	176
	<i>Kërkesat funksionale:</i>	185
	<i>Kërkesat jofunksionale:</i>	186
4.4.5	<i>Pamja e aplikacionit të ridizajnuar</i>	215
4.4.2	<i>Grupi i shfrytëzuesve qytetarët</i>	223
4.4.6	<i>Grupi i shfrytëzuesve shkollat profesionale</i>	225
4.4.7	<i>Grupi i shfrytëzuesve qendra për aftësim profesional</i>	234
4.4.8	<i>Grupi i shfrytëzuesve punëdhënësitë</i>	240

4.4.9 Roli dhe rëndësia e raporteve të aplikacioni të rindërtuar elektronik komunal	243
KAPITULLI V – METODOLOGJIA DHE METODAT E KËRKIMIT	247
KAPITULLI VI – KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	250
REFERNCAT	265

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Arritjet arsimore për moshën 15-34 vjeç në vendet e BE-27 +, 2009.....	26
Figura 2. Shpërndarja e diplomimit në nivelin e mesëm sipas orientimit arsimor, 15-34 vjeçarëve, 2009.....	27
Figura 3. Të diplomuarit AAP sipas llojit të programit, grup moshë e 15-34 vjeçarëve, 2009.....	29
Figura 4. Punësimi i grup moshës 15-24 vjeç në tre çerekun e tretë të vitit 2014.....	35
Figura 5. Statusi i punësimit sipas nivelit të shkollimit, grup moshë 25-34 vjeç, BE+27,2009.....	36
Figura 6. Statusi i punësimit sipas nivelit të shkollimit, grup moshë të ndryshme, BE+27,2009.....	37
Figura 7. Punësimi sipas nivelit arsimor, niveli i mesëm, jo terciar, grupmosha 25-64 vjeç shprehur %, 2018.....	38
Figura 8. Të diplomuar në shkollat e mesme sipas drejtimit dhe profesionit.....	39
Figura 9. Të dhënat e të punësuarve të diplomuar sipas profesionit në vendet BE në vitin 2009.....	40
Figura 10. Pasqyra e buxheteve të vendeve europiane në mes të viteve 2014 dhe 2015.....	41
Figura 11. Pjesëmarrja e nxënësve në vitin e dhjetë sipas programeve arsimore, viti shkollor 2007/08 (në%).....	49
Figura 12. Nxënësit që hyjnë në nivelin e mesimit të mesëm të lartë.....	59
Figura 13. Struktura organizative e shkollimit në Zvicër.....	60
Figura 14. Shpenzimet publike për AAP/ETP në Zvicër 2011.....	62
Figura 15. Të dhënat e arsimit në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë në dekadën e fundit.....	72
Figura 16. Numri total i nxënësve nëpër shkolla 2013/2014.....	73
Figura 17. Numri total i nxënësve nëpër shkolla 2019/2020.....	74
Figura 18. Numri total i nxënësve nëpër shkolla i shprehur grafikisht 2019/2020.....	75
Figura 19. Numri total i nxënësve nëpër shkolla i shprehur në përqindje.....	75
Figura 20. Numri total dhe sipas gjinisë i nxënësve nëpër qendra burimore/ shkolla speciale i shprehur në përqindje për vitin shkollor 2019/2020.....	81
Figura 21. Figura sipas drejtimeve në shkollat profesionale shprehur në përqindje.....	86
Figura 22. Paraqitja e profileve në përqindje.....	89
Figura 23. Drejtimit në gjimnaze shprehur në përqindje.....	92
Figura 24. Raporti mes shkollave profesionale dhe gjimnazeve 2012/2013.....	93
Figura 25. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë sipas gjinisë e shprehur në %.....	94
Figura 26. Nxënësit në shkollat e mesme të larta.....	96
Figura 27. Nxënësit në shkollat e mesme të larta për vitin shkollor 2019/2020.....	96
Figura 1. Grafiku për gjimnaz dhe shkollat profesionale për vendet e Ballkanit Error! Bookmark not defined.	
Figura 2. Shpenzimet qeveritare të rajonit për edukim (% BVP).....	100
Figura 28. Burimet njerëzore dhe finaciare - diagram.....	103
Figura 29. Shpenzimet e arsimit si % e BVP-së nga viti 2013-2018.....	106
Figura 30. Shkalla e papunësisë në rajon 2000-2011.....	126
Figura 31. Nxënësit në shkollat e mesme të larta shprehur në përqindje.....	132
Figura 32. Aplikacioni aktual – faqja e parë.....	162
Figura 33. Regjistrimi tek Komuna ime elektronike.....	163
Figura 34. Kyçja në modulën elektronike të Komunës së Gjakovës.....	164
Figura 35. Modulet e aplikimit në zyren e ofiqarisë.....	166
Figura 36. Skema logjike e aplikimit elektronik.....	168
Figura 37. Modulet e aplikimit të ri për certifikata të ndryshme.....	169
Figura 38. Raportimi i objektit të dëmtuar.....	170
Figura 39. Paraqitja e aplikimit kur bëhet kyçja si shfrytëzues në web aplikacion.....	171
Figura 40. Menaxhimi elektronik i aseteve komunale.....	172
Figura 41. Tabelat e aplikacionit aktual.....	173

Figura 42. Diagrami i ndërlidhjes së aplikacionit	179
Figura 43. Diagrami për grupin 3 – Drejtoria e Zhvillimit ekonomik dhe Drejtoria e Arsimit	180
Figura 44. Diagrami për grupin 6 - Shkolla	181
Figura 45. Diagrami për grupin - Bizneset.....	181
Figura 46. Diagrami për grupin - Nxënësit	182
Figura 47. Diagrami për grupin - Qendrat trajnuese	182
Figura 48. Faqja hyrëse e aplikacionit online të modifikuar	216
Figura 49. Kontrolli i profilit i modifikuar nga ana e nxënësit apo qytetarit	218
Figura 50. Modifikimi i grupit 1_ Qyterarët	223
Figura 51. Lista e shkollave	227
Figura 52. Editimi i shkollave	228
Figura 53. Lista e nxënëve të kualifikuar	231
Figura 54. Editimi i qendrave trajnuese	234
Figura 55. Editimi i nxënësve në qendrat trajnuese.....	237
Figura 56. Editimi i nxënësve dhe trajnimeve	238
Figura 57. Editimi i trajnimeve	240
Figura 58. Vende të lira pune _ oferta pune	241
Figura 59. Oferta pune nga kompanitë e ndryshme.....	243
Figura 60. Raport për një kandidat	244
Figura 61. Raport në përpilim e sipër.....	245

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Ndarja e llojeve AAP sipas gjinisë 15-34 vjeç, EU27 +, 2009.....	30
Tabela 2. Të dhënat e kualifikimeve sipas gjinisë.....	32
Tabela 3. Shkalla e punësimit sipas grup moshave dhe arritja më e lartë arsimore (në %)	47
Tabela 4. Të diplomuarit në nivelet ISCED 3 dhe 4, sipas programit arsimor (të shprehur në përqindje)	49
Tabela 5.Përshkrimi i niveleve të sistemit të arsimit në Kosovë	66
Tabela 6.Përshkrimi i niveleve të sistemit të arsimit në Kosovë sipas shkalles kurrikulare.....	67
Tabela 7.Të dhënat e arsimit në gjashtë	72
Tabela 8. Numri i nxënësve në nivelet e arsimit në Kosovë	76
Tabela 9. Numri i fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në arsimin publik dhe privat për vitet 2018/2019 sipas gjinive.....	76
Tabela 10.Numri i institucioneve edukativo- arsimore në Kosovë	77
Tabela 11. Shkollat, nxënësit, paralelet dhe mësimdhënësit në arsimin e mesëm 2008/2009 deri 2018/2019	78
Tabela 12.Raporti nxënës për mësimdhënës dhe nxënës për paralele (krahasim).....	79
Tabela 13. Numri i nxënësve në nivelet e arsimit private në Kosovë 2019/2020	82
Tabela 14. Numri i nxënësve nëpër shkolla private në nivelin arsimor të lartë (krahasim)	83
Tabela 15. Numri i nxënësve në shkolla profesionale.....	85
Tabela 16. Numri i nxënësve nëpër vite në përqindje në shkollat profesionale	87
Tabela 17. Lëmitë profesionale në Kosovë për vitin shkollor 2019/2020	88
Tabela 18. Numri i nxënësve në gjimnaze sipas drejtimeve	92
Tabela 19. Raporti gjinor në nivelin 3 të shkollimit 2019/2020	95
Tabela 20. Raporti gjimnaz dhe shkollat profesionale për vendet e Ballkanit	98
Tabela 21.Burimet njerëzore dhe financiare.....	101
Tabela 22. Shpenzimet publike në arsim në Kosovë.....	106
Tabela 23. Punësimi sipas nivelit arsimor	111
Tabela 24.Indikatorët kryesorë të tregut të punës.....	116
Tabela 25. Use Cases Tabela.....	189
Tabela 26. Tabela e grupeve të shfrytëzuesëve	222

LISTA E SHKURTIMEVE

MASHT - Ministria Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës

AKS - Agjencia Kosovare e Statistikave

BPV - Bruto Prodhimit Vendor

QAAP - Qendrat për Aftësim dhe Arsimim Profesional

SNKA - Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit 97

FOSS – Free and open-source software

DASH - Departamentit të Arsimit dhe Shkencës

SAK - Statistikat e Arsimit në Kosovë

BE – Bashkimi European

TIK – Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit

KKK - Kornizës së re të Kurrikulumit të Kosovës

AAP - Arsimi dhe Aftësimi Profesional

PSAK - Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016

KAMSH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2012-2014

MPMS - Ministria se Punës dhe Mirëqenies Social

QRP - Qendrat Regjionale të Punësimit

NVM - Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

PATP - Programet Aktive të Tregut të Punës

QRAPGJ - Qendra Regjionale për Aftësime Profesionale në Gjakovë

ICT – Information an Communication Technology

ISCED – International Standard Classification of Education

ERASMUS - European Community Action Scheme for the Mobility of University Students

AHM - Ad hoc module

OECD - Organisation for Economic Co-operation and Development

ETP – Education Training Program

CHF – frangu zvicrran

DAP - Divizionin e Arsimit Profesional

PSAK - Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë

MFK - Ministria e Financave të Kosovës

NEET - Not in Education, Employment or Training

MZHE - Ministria për Zhvillim Ekonomik

MF - Ministria e Financave

BB – Banka Botërore

OEK - Oda Ekonomike e Kosovës

DKA - Drejtoria Komunale e Arsimit

JIC - Jakova Inovative Center

QRGJ - Qendra Rinore në Gjakovë

MySQL - Structured Query Language

PHP - Personal Home Page

LAN - Lokal Area Network

KK – Kuvendi Komunal

WAN – Wide Area Network

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

DZHE - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

DMS - Drejtoria e Mirëqenies Sociale

KAPITULLI I – KONTEKSTI I KËRKIMIT DHE MOTIVIMI

1.1. Hyrje

Zhvillimi arsimor i një vendi varet nga niveli i shkollimit që ka, struktura e personeli arsimor që disponon, metodologjia e mësimdhënies që aplikon, infrastruktura hapësinore ku zhvillohen ligjeratat dhe mjetet e konkretizimit apo kabinetet ku aplikohen praktikat profesionale si dhe nga shkathtësitë e punëtorëve tjerë respektivisht kuadrove të tij përcjellëse. Aftësimi profesional është edukim që përgatit njerëzit për profesionet specifike jetësore me destinacion final tregun e punës. Në këtë kontekst shumica e vendeve të Bashkimit Europian aftësimet profesionale i kanë konsideruar si një hap zhvillimor ekonomik dhe profesional të vendeve të tyre. Popullata e këtyre vendeve është aftësuar bazuar në kërkesat e tregut të vendit dhe atij botëror që kanë ndikuar drejtpërdrejt në gjenerimin e vendeve të reja të punës, krahas saj uljen e dukshme të papunësisë, rritjen e produktiviteti ekonomik, përmisimin e dukshëm të cilësisë së arsimit në nivelet kombëtare dhe në stabilitetin financiar të shtetit.

Sistemi arsimor në Kosovë nuk plotëson nevojat pedagogjike dhe nevojat për aftësim profesional të popullsisë më të re në Evropë dhe njëkohësisht shtetit më të ri në Europë, gjë që rezulton në numër të lartë të të rinjve të papunë, pa aftësi apo kualifikime të cilat kërkohen nga ekonomia globale në rritje.

Ndërveprimet, proceset e vendimmarrjes disa dimensionale mbi rrugëtimin e arsimit në përgjithësi dhe përgatitjen e profesionistit në veçanti duhet të janë të kanalizuar mirë

në dobi të kërkesave të tregut në raport të bashkpunimit me biznesin dhe orientim kah zhvillimi ekonomik.

Ka ardhur koha të përballemi teorikisht dhe praktikisht me rrugën që do të duhet të ndjekim edhe në këtë fushë pavarësisht sfidave që mund të na dalim përpara. Ka ardhur koha të adaptojmë një koncept të ri bashkëkohor dhe pikërisht edukimin profesional e përmes saj edhe edukimin e vazhdueshëm të të rinjve në shkollime të ndryshme formale dhe joformale, që të jenë sa më konkurent për tregun e punës sipas kërkesave të biznesit.

1.2. Përshkrimi i sfondit të problemit

Gjatë një dekade e gjysmë e më shumë, shoqëria kosovare ka nisur rrugën e pluralizmit dhe ndryshimet me të kaluarën janë të theksuara dhe të prekshme. Kosova ka shënuar progres të dukshëm në fushat e ndërtimit të institucioneve dhe në përforcimin e qeverisjes demokratike, krijimin e themeleve të shëndosha për rritjen e ekonomisë dhe në institucionalizimin e sistemit të decentralizuar e modern të arsimit sidomos atij fillor me mësimnxënie të bazuar në vlerësim dhe me fokusim tek nxënësit. Në sektor të caktuar, ajo e ka kapërcyer fazën e tranzicionit mjaftueshëm. Megjithatë në të gjitha këto sfera mbetin dobësi të theksuara të cilat duhet të adresohen me urgjencë nëse populli i Kosovës dëshiron të shfrytëzojë potencialin e vet të plotë individual si dhe qeverisja e saj si shtet. Në fushën e trajnimit profesional ende vazhdojmë të përballemi me një realitet që normalisht do të duhej të ishte tejkaluar tani më. Trajnimet për përdorimin e teknologjisë dhe se çka na ofron teknologjia dhe llojet e pasijeve nuk mjaftojnë sot, teknologjia ka evluar shpejtë dhe duhet një përshpejtim në lëvizje në këtë drejtim. Ende vazhdon vija tradicionale e të nxënës dhe sistemit të trajnimit –

kualifikimit në punë. Sistem ky që edhe tek disa vendet e rajonit ka ngel histori. Dinamika e kërkesave të tregut sot ndryshon dhe së bashku me të me ritëm të njejtë duhet ndryshuar edhe strategjia në sektorët e aftësimit profesional, struktura organizative e saj dhe kyçja e biznesit si nevojë imediate në këtë strukturë. Planifikimet afatmesme dhe afatgjate të aftësimeve profesionale duhet orinetuar në përputhje me zhvillimin e teknologjisë dhe duke shfrytëzuar infrastrukturën e bizneseve të cilat veq kanë kapur ritmin e kohës dhe janë të gatshme të ndihmojnë në formimin e një të riu profesionist për një vend të caktuar pune.

1.3. Qëllimi i punimit

Ideja, për hulumtimin e problematikës së informatizimit të procesit të certifikimit të edukimit profesional, lindi nga koncepti i punës në shoqëri ku në një vend me ekonomi në zhvillim, e sidomos një ndër vendet e fundit në rajon me të ardhura e burime të pakta dhe nivel të lartë varfërie, puna shihet si mjet mbijetese, atëherë kualifikimi profesional ofron shanse më të mëdha për punësim.

Ndryshimet e profileve në disa shkolla profesionale si nevojë e kohës dhe adaptimi i aftësimit dhe arsimimit profesionale bazuar kërkesave të tregut janë qëllimet tjera të punimit si dhe një parakusht për të arritur standartet të shkollimit profesional. Qëllimi tjetër i kësaj teze doktriale është sensibilizimi i opinionit për arsimim pran shkollave profesionale dhe benifitet ekonomike që sjell një individ profesionist në sferën e biznesit. Ky qëllim mund të arrihet përmes mbindertimit të aplikacionit komunal të Gjakovës me module të reja mbi shkollimin profesional që ato të shërbejnë si informator për të rinjt e këtij rajoni veçanarisht, pse jo edhe më gjerë.

Qëndrimet mbi lëvizjen apo largimin nga vendi i origjinës respektivisht shteti amë janë një element shumë i rëndësishëm në vendimmarrjen e individëve. Është e kuptueshme që gjendja socio-ekonomike e shtetit apo komunitetit është një faktor themelor që ndikon në marrjen e vendimit të riut. Në fakt, historia ka treguar se shoqëritë më të suksesshme janë ato që pranojnë dhe përqafojnë më shpejt ndryshimin. Bazuar në kohëzgjatjen e edukimit profesional, mundësinë për të marrë kualifikimin dhe aftësitë e duhura, mbi të gjitha përcakton zgjedhjen e punës, kjo rritë dukshëm mundësitë që të rinjt nga shtresa të varfra e të mesme të tentojnë të hyjnë menjëherë në tregun e punës. Të gjitha këto mund të janë argumente të fuqishme për ndalimin e emigrimit të moshës së re drejtë vendeve përendimore, që është qëllim shtesë social i kësaj teze doktorate. Moshë kjo që ndikon dukshëm në zhvillimin ekonomik të shtetit dhe stabilitetin e qëndrueshëm financiar të tij.

1.4. Objektivat e punimit

Qëllimi i këtij punimi doctoral është studimi i mundësive për identifikimin, analizimin dhe ndryshimin e sistemit të aftësimin dhe arsimit profesional si dhe ndërlikohen e biznesit në këtë proces integrues përmes rindërtimit të aplikacionit elektronik ekzistues të Kuvendit Komunal në Gjakovë për shërbimet elektronike të qytetarit.

Ky punim ka pasur si synim përmbushjen e disa objektivave, ca nga të cilat po i përmendim më poshtë :

- ✓ Objektivi i parë i këtij punimi është që të kontribojë në fushën e procesit të ndërtimit të strukturës organizative të aftësimeve profesionale si dhe në informatizimit e procesit të certifikimit të tyre. Fokusi është përqëndruar tek identifikimi i faktorëve që mund të motivojnë të rinjt të preferojnë trajnimet për

aftësime profesionale dhe shkollat e mesme profesionale. Të rinjt duhet të mësojnë një profesion pastaj të integrohen në tregun e punës sipas profesionalizimit të tyre. Kjo si pasojë do kishte zbutjen në masë të ndjeshme të papunësisë, që njëherit është objektiv shtesë i këtij hulumtimi.

- ✓ Objketivi i dytë i punimit është modifikimi respektivisht rindërtimi i aplikacionit ekzistues elektronik komunal ëshë bërë si arsye për të ndërlidhur të gjitha Qendrat për Aftësim dhe Arsimim Profesional të licencuara, shkollat e mesme të larta profesionale mes veti dhe komunën si bartëse të këtij projekti. Ky projekt do të jetë vazhdimësi dhe një vlerë e shtuar e projektit aktual të aplikacionit elektronik të komunës së Gjakovës për shërbimin elektronik të qytetarit. Me ndryshimin e këtij aplikacioni munëdojmë lehtësimin e bashkëpunimit mes grupeve të intersit të përfshira në projektet për të mirën e qytetarit. Ky projekt përdor teknologjinë Free and open-source software (FOSS). Teknologji e cila është pa pagesë. Sistemi do të jetë i mbyllur, pra do të kanë çasje vetëm grupet e caktuar, të cilat do të i përshkruaj më poshtë. Bashkangjitja e biznesit në këtë proces është faktor kyç i rindërtimit të aplikacionit, si dhe në vet procesin e trajnimeve profesionale e po ashtu në bashkëpunim marrjen e orientimeve në arsimin e aftësimin profesional. Biznesi ka vendin e vet në këtë aplikacion të rindërtuar bazuar në rëndësin e tij për punësimin e të rinjve të kualifikuar dhe ndikimit direkt në zbutjen e papunësisë në nivel lokal , në këtë rast.

Realizimi i këtij aplikacioni funksional të rindërtuar do ta finalizonte trajtimin teorik të problemit dhe kalimin në zbatim përfundimtar praktik të tij.

1.5. Hipotezat e punimit

Hipoteza kryesore

Procesi aktual në arsim dhe aftësim profesional nuk është motivues dhe nuk ka teknologjinë, trajnimet as certifikimet që kërkon tregu i punës dhe si tillë nuk i inkurajonë të rinjt për përvetësimin e kapacitetit intelektual dhe specializimin individual.

Hipotezat ndihmëse

- ✓ Ndërtimi i infrastrukturës menaxheriale të informacionit do të ishte shtytës për të siguruar burime të reja financiare që do të ndihmonin përmisimin e arsimit dhe aftësimin profesional, si dhe rritjen e intersimit për shkollat profesionale tek të rinjt.
- ✓ Certifikimet profesionale në bazë të standarteve europiane dhe kërkesave të tregut lokal do të ishin promotor i zhvillimit ekonomik lokal dhe njëkohsisht i hapjes së vendeve të reja të punës.
- ✓ Pjesmarrja e biznesit si faktor ndërtues në procesin aftësues e certifikues të të rinjve dhe prania e tyre në bordet shkollore do të siguronte atij punëtorin profesional për stafin e tij në të ardhmen e afërt.

1.6. Pyetjet kërkimore të punimit

- A mund të supozojmë se nxënësit në nivelet e ndryshme të shkollimit janë të gatshëm për tregun e punës?
- Efekti i aplikimit të edukimit profesional si vazhdimësi e procesit mësimor dhe atij hulumtues, a mund të bëjë diferencën?
- Cilat do të jenë strategjitë e reja të arsimit e aftësimin profesional?

- Kush duhet të integrohet në këtë proces ?
- A do të kenë përfitime kandidatët dhe familjet e tyre me përfshirjen në procesin e edukimit profesional?
- Ndërtimi i aplikacionit mes institucioneve arsimore dhe atyre për aftësimin profesional a do të ishte frytëdhënës për qeverisjen lokale?

1.7. Metodologjia e punimit

Metodologjia shkencore dhe instrumentat e përdorur për kryerjen e këtij punimi doktoral janë bazuar në:

- Studiuar dhe analizuar në mënyrë kritike një literaturë e gjerë lidhur me edukimin dhe arsimin në Kosovë
- Mbledhja e informatave mbi aktivitetet që kryejnë qendrat trajnuese në Komunën e Gjakovës dhe infrastruktura e tyre
- Analizimi i funksionimit të aplikacionit aktual elektronik
- Rindërtimi i aplikacionit mbi menaxhimin e informacioneve elektronike të shërbimeve të qytetarit në Gjakovë
- Konkluzionet dhe rekomandimet për të ardhmen

1.8. Rëndësia e punimit

Ky studim është hulumtim i cili në mënyrë të shtjelluar na pasqyron një pamje të qartë të shkallës të pjesmarrjes së të rinjve në shkollimin profesional. Na njeh me tregues të tjerë të domosdoshëm për ndërmarrjen e një iniciative në lidhje me motivimin e të rinjve për të ndjekur trajnimet profesionale bazuar në kërkesat e tregut.

Ky punim është i rëndësishëm për arsye se është i pari i këtij lloji që realizon një aplikacion on-line duke përfshirë të gjitha qendrat e trajnimeve profesionale dhe ato të

shkollimit të mesëm të lartë në nivelin komunal, si dhe biznesin. Kjo metodologji e pashqyrimin të informacioneve mundëson paraqitjen e të gjitha të dhënave mbi aftësimin profesional me një kohë shumë të shkurtër dhe bën të mundur shfrytëzimin e tyre për raporte të ndryshme të të gjitha drejtorive komunale që janë shumë të përshtatshme dhe të domosdoshme për nevojat e qeverisjes lokale dhe trasim nga ana e tyre të rrugës për prosperitet arsimor, mirëqenjen sociale pse jo edhe më gjërë. Ky punim do të ishte edhe një stimulim më tepër për Qendrat e Aftësimeve Profesionale dhe qendrat tjera trajnuese që të zgjerojnë veprimtarinë e tyre për aftësim profesional dhe përmirsojnë tutje proceset aftësuese certifikuese sipas standarteve europiane dhe në përputhje me kërkesat e ekonomisë lokale, pasi rezultatet e tyre do të pasqyrohen në këtë aplikacion dhe ato përditësohen në vazhdimësi. Ky punim do të ishte një informator shumë i mirë për të rinjtë që të ndjekin shkollim të mesëm të lartë të tyre pran shkollave profesionale. Ky punim është i bazuar edhe në përfshirjen e biznesit si faktor i barabartë në ndërtimin e një sistemi të ri për aftësimet profesionale e po ashtu edhe në hartimin e strategjive zhvillimore ekonomike sipas programeve aftësuese të kohës.

1.9. Kufizimet e hasura

Pasi kemi të bëjmë me realizimin e një aplikacioni on-line të modifikuar funksional si rezultat final ka qenë e vështirë marrja e autorizimeve në disa nga programet ekzistuese të menaxhimit të sistemeve të informacioneve nëpër institucionet edukativo – aftësuese profesionale. Bisedat me drejtorët e shkollave dhe drejtorive komunale dhe menaxherët e ndryshëm si ata për arsimim dhe aftësim profesional dhe biznesit mund të paraqitet si kufizime për shkak të subjektivizimit që kishte në ndonjë rast. Me të gjitha kufizimet që bart studimi ai është i vlefshëm për të kontribuar në fushën e aftësimeve profesionale

duke shfryëzuar edhe aplikacionin e rindërtuar elektronik komunal, si pjesë e marketingut të saj.

1.10. Struktura e punimit

I tërë punimi është i ndarë në 6 kapituj. Më poshtë, në secilin kapitull përshkruhet në formë të përgjithshme përmbajtja e temave.

Kapitulli I: Konteksi i kërkimit dhe motivimi.

Në këtë kapitull përshkruhen konceptet themelore të punimit siç janë qëllimi i punimit, objektivat e punimit, arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme, hipotezat, pyetjet kërkimore, metodologjia e përdorur në të gjithë kapitujtë, rëndësia e punimit të kësaj teze, kufizimet e hasura si dhe përmbajtja e punimit.

Në këtë kapitull përshkruhet rëndësia që arsimit në përgjithësi dhe ai profesional në veçanti kanë në zhvillimin e shoqërive në kushtet e globalizimit dhe zhvillimit marramëndës të teknologjive, sidomos të ICT. Në pjesën e parë të kapitullit tregohet mbështetja e standartet e BE për aftësimin profesional, mënyrat dhe format se si BE financon programet e ndryshme profesionale për të krijuar të kualifikuarin. Më pas janë treguar instrumentet për të rritur cilësinë dhe transparencën e sistemeve të aftësimin profesional nga ana e BE për shtetet anëtare të saj. Në vazhdim është elaboruar një literaturë e gjërë përfshirë këtu edhe raporte të ndryshme të publikuara në internet dhe rezultatet janë prezentuar përmes tabelave, grafikëve dhe figurave. Analiza të shumëta statistikore të krahasueshme ndërmjet vendeve të BE në procesin e arttijeve arsimore profesionale në Europë. Trajnimet e shpejta dhe kategoritë e shkollimit profesional janë paraqitur përmes përqindjeve dhe prezentuar me grafikët përkatës. Me tutje është shtjelluar pjesmarrja, diplomim i të rinjve të grup moshave të ndryshme në trajnimet dhe shkollimet profesionale në BE, sidomos atyre të grup moshave 15-34 vjet. Kjo grup

moshë është më e pa kualifikuara në Kosovë. Analizë e veçantë në vazhdim të kapitullit i është bërë tregut të punës dhe shkallës së papunësisë në vendet europiane, të prezentuara edhe sipas përkatësisë gjinore. Investimet që bëjnë këto shtete në arsim dhe edukim profesional.

Në pjesën e fundit të këtij kapitulli janë analizuar sistemet e shkollimit profesional dhe rëndësia e pjesëmarrjes së të rinjve në to, në vendet europiane si Gjermania, Austria dhe Zvicra. Në këtë pjesë tregohet mbi rëndësin, kujdesin dhe mbështetjen që bëjnë qeveritë e këtyre shteteve për shkollimin e arsimit profesional. Benificionet si dhe përfitimet që kanë qytetarët e moshës rinore të këtyre vendeve në këtë lloj orientimi shkollor. Investimet që bëjnë këto vende për të përkrahur shkollat e tilla, si dhe ndarja e buxheteve për arsim. Po ashtu është analizuar edhe struktura organizateve e AAP në këto shtete.

Kapitulli III : Arsimi profesional në Kosovë dhe motivimi i të rinjve që të ndjekin AAP

Në këtë kapitull analizohet rëndësia e shkollimit në Kosovë. Temat kryesore që trajtohen në këtë kapitull janë të shumta dhe kryesisht kanë të bëjnë me gjendjen ekzistuese të arsimit në Kosovë. Në fillim pasqyrohen të gjitha nivelet e sistemit arsimor, nga mirret një informacion i plotë mbi numrin e nxënësve që ndjekin shkollimin në të gjitha nivelet në vend. Këto të dhëna na japin një pamje të qartë mbi procesin arsimor kosovar të paraqitura edhe në baza gjinore dhe prezentuara përmes tabelave dhe grafikëve. Po ashtu bëhet edhe krahasimi i të dhënave në shkollat e mesme të larta mes gjimnaze dhe shkollave profesionale në vend. Nga këto të dhënat statistikore mbi arsimin kosovar na tregohen tendencat e rënjës së interesimit për aftësimin profesional në disa profile. Të gjitha këto të paraqitura përmes tabelave dhe grafikëve. Rëndësinë e ndryshimit të profileve pran shkollave tona profesionale. Në

mënyrë analoge janë prezentuar edhe shifrat mbi numrin e nxënësve nëpër klasa, numri i mësimdhënësve për nxënës. Në vazhdimësi raportet financiare tregojnë se sa qeveria kosovare ndan mjete për arsimimin e të rinjve bazuar në buxhetin që ka dhe sa është përqindja e saj në bazë të BPV. Në pjesën e fundit të këtij kapitulli trajtohen po ashtu qendrat e aftësimin profesional në Kosovë, numri i tyre në vend dhe aktivitet trajnuese dhe profesionale që kryhen në to. Krahasim i Kosovës me vendet e regjionit si raport mes drejtimeve shkollore dhe investimeve në arsim. Proceset e certifikimit dhe kohëzgjatja e trajnimeve. Kapacitetet dhe mundësitë që ato posedojnë. Ndryshimet që duhet të përshtaten ekonomisë afatgjate.

Kapitulli IV: Komuna e Gjakovës si rajon gjeografik studimor për rindërtimin e aplikacionit për shërbimin e qytetarit

Ky kapitull është i ndarë në seksione, ku secila nga seksionet do të përmbajnë nënseksionet përkatëse. Në pjesën fillestare të seksionit të Komunës së Gjakovës janë prezentuar të dhënat gjeografike të qytetit të Gjakovës. Krahas demografisë janë treguar edhe arsyet përse Komuna e Gjakovës është zgjedhur si rast studimor duke i shtjelluar arsyet. Numri i shkollave të mesme të larta profesionale me profilet e tyre, numri i nxënësve që ndjekin mësimin në këto shkolla përbëjnë vazhdimin e seksionit të parë. Në brendi të këtij seksioni është prezentuar Qendra Regjionale për Aftësime Profesionale në Gjakovë me aktivitetet e saja, si dhe shkalla e aktivizimit të të rinjve gjakovar në trajnimet profesionale. Hapësirat respektivisht qendrat tjera që merren me trajnime, edukime dhe trajnime profesionale në këtë komunë së bashku me infrastrukturën që ato posedojnë, llojet e trajnimeve, projektet dhe numrin e kandidatëve që kanë, përmbyllin nën seksionin e parë të kapitullit katërt. Në nënseksionin e dytë të njëjtë kapitull tregohet arsyeja pse është zgjedhur Komuna e Gjakovës si rast

studimor për rindërtimin të këtij aplikacioni të menaxhimit të informacioneve komunale që është në shërbim elektronik të qytetarëve. Këtu argumentohet në mënyrë të detajuar arsyeja. Në nënseksionin e vijues tregohet roli dhe rëndësia e involvimit të biznesit në këtë sistem elektronik menaxherial. Në nënseksionin e katërtë tregohen dhe argumentohen arsyet pse komuna duhet të jetë bartëse e këtij projekti informativ dhe aplikativ. Në nënseksionin përfundimtar respektivisht të pestin të këtij seksionit të këtij kapitulli të katërtë, tregohen të tri funksionet kryesore që do të arrihen me rindërtimi e këtij aplikacioni mbi sensibilizimin e aftësimet profesionale dhe shkollimit profesional të përkrahur nga biznesi e qeverisja lokale. Pjesa e në vazhdim e kapitullit i takon tërësisht aplikacionit. Arsyeja pse duhet të rindërtohet aplikacioni. Kapitulli në vazhdim elaboron, qasjen në aplikacionin elektronik përshkrimin e punës konkretisht ë shërbime që ofron aplikacioni aktual i KKGj. Vështrimi mbi projektin dhe kërkesat e që e përshkruajnë sistemin së bashku me diagramet përcjellëse janë pjesë e këtij seksioni si inxhinieri softuerike. Përshkrimi i Use case është bërë me formen tabelare për secilin modul që është rindertuar në aplikacion. Skema funksionale e punës së aplikacionit përmes diagramit dhe raportimet e problemeve përmes sistemi on-line dhë mundësitë që ofrojnë këto raporte. Si seksion i veçantë i kapitullit është përshkruar aplikacioni i rindërtuar elektronik komunal për lehtësimet e reja në dobi të shërbimeve të qytetarit dhe marrjes së informacioneve të doboshime për mirëqenjen e tyre sociale dhe arsimimin personal të tij. Përmes nënseksioneve është bërë edhe : përshkrimi i procesit të punës, grupi i shfrytëzuesve qytetarët, grupi i shfrytëzuesve për shkollat profesionale dhe grupi i shfrytëzuesve për punëdhënësitë. Seksion i veçantë i është lënë edhe rolit dhe rëndësisë së raporteve të aplikacioni të rindërtuar elektronik komunal.

Kapitulli V – Metodologjia dhe metodat e kërkimit

Në këtë kapitull janë përshkruar të gjitha mënyrat e grumbullimit të të dhënave për të krijuar një pashqyrë të qartë për të arritur deri përfundimi i studimit . Hapi i parë i hulumtit shkencor ka nisur me përcaktimin e temës dhe qëllimet e saj në aspektin shkencor. Kam vendosur hipotezat, si kryesoren dhe ato ndihmese duke bërë parashtrimin e pyetjeve kërkimore. Bazuar në pyetjet kërkimore janë përcaktuar objektivat e tezës doktoriale dhe rëndësia e saj duke i paraparë edhe pengesat gjatë punës. Duke u përcaktuar në këto hapa është hartuar struktura bazike e punimit shkencor si dhe është përpiluar metodologjia e saj. Për realizimin e këtij studimi u përdor një metodologji që kombinoi të dhënat sasiore, empirike dhe ato krahasuese.

Kapitulli VI – Konkluzionet dhe rekomnadamet

Në këtë kapitull janë konkluzionet e përgjithëshme të nxjerrura nga dezertacioni, në të cilin janë përmbledhur të gjitha shqyrtimet e parashtruar me të arriturat dhe rezultatet të bazuara në hipotezat e punimit dhe janë dhënë përgjegje për të gjitha pyetjet kërkimore. Të bashkangjitur me konkluzionet e dhëna mbi ndryshimin e procesit të aftësimin.

Po ashtu është edhe konkluzioni final i punimit studimor - Pavarësisht afateve procedurale dhe faktit se ka vështërsi tjera ekzistuese që dalin nga terreni dhe analiza e tij, duhet të vazhdohet në insistimn e ndryshimit të procesit të arsimit profesional. Brenda kornizës së aftësimin është mundësia për t`u indentifikuar edhe të metat që janë në shkollim dhe të gjendet zgjidhje e pranueshme për progres ekonomik. Aplikacioni i rindërtuar një mundësi më shumë për marketingun e aftësimeve profesionale.

Në fund të punimit doktorial janë dhënë referencat.

KAPITULLI II – ARSIMI, ARSIMI PROFESIONAL DHE ICT

Në këtë kapitull përshkruhet rëndësia që arsimit në përgjithësi dhe ai profesional në veçanti kanë në zhvillimin e shoqërive në kushtet e globalizimit dhe zhvillimit marramëndës të teknologjive, sidomos atyre ICT. Në brendi të kapitullit tregohet mbështetja e standarteve të BE për aftësimin profesional si pasqyrohen përmes tabelave dhe grafikëve bazuar në analizat statistikore, tregu i punës, investimet në arsim që bëjnë vendet e BE-së, të burimeve të ndryshme ndërkombëtare dhe atyre vendore. Në pjesën e fundit të kapitullit bëhet një përshkrim i hollësishëm i AAP-ve në disa nga shtetet e BE-së sikurse Gjermania, Austria dhe Zvicra.

2.1 Arsimit – rëndësia dhe roli

Arsimi është metodë e edukimit dhe ngritje e kulturës që për bazë ka dituritë e marra nga shkrimet e ndryshme shkencore (MASHT, 2014). Sipas Kantit (1803/1960:6) : “Njeriu mund të bëhet njeri vetem nga edukimi. Në kuptimin e saj teknik, edukimi është proces me të cilin shoqëria me qëllim transmeton njohuritë e veta të akumuluar, aftësitë dhe vlerat nga një brez në tjetrin.”

Bazuar në këtë thënie të Kantit, shoqëria kosovare duhet të ndërtojë një bazament fundamental të mirëfillët që integron të rinjtë në proceset e arsimit gjegjësisht të ndikon në nxitjen e edukimit të tyre, në përvetsimin e njohurive dhe shkathtësive që të hyjnë direkt në tregun e punës, ku rezultati i punës së tyre do të ishte garanci për zhvillim ekonomik të cilin do ta trashigonin e avansonin edhe brezat që vijnë pas.

Arsimi është një proces i ndryshimit të personalitetit në drejtimin e dëshiruar duke miratuar përmbajtje të ndryshme në varësi të moshës dhe nevojave të individëve (Wikipedia, 2014).

Në leksionet e tij mbi arsimin, Lonergan thotë:

“Filozofia është një reflektim mbi gjendjen e njeriut në një nivel përfundimtar. Kjo është themelore duke menduar për gjendjen e njeriut. Arsimi është mjete më i madh për transformimin e gjendjes së njeriut. Ajo ndryshon mendjet dhe vullnetet e njerëzve. Si pasojë, filozofia dhe edukimi janë të ndërvarura (Lonergan, 1997:4).”

Arsimi, nuk është vetëm mjet i rëndësishëm së ngritjes kulturore-arsimore e morale të popullit, por ai ka edhe rëndësi të veçantë në rritjen e vlerave materiale e ekonomike të vendit, sepse një kapital i këtillë i diturive që do të përvetësojë njeriu do të shëndërrohej në një kapital frytdhënës ekonomik dhe social për gjithë rrethin. Arsimi mbështet zhvillimin moral dhe etik të njeriut. Edukata i jep kuptim vlerave njerëzore duke e vënë në pah humanizmin dhe duke mundësuar lundrim të qetë nëpër sfidat jetësore.

Lidhur me pikëpamjet mbi vlerën dhe rëndësinë e arsimit do të përmendim edhe porosinë e rilindases së madhe shqiptare Sevasti Qiriazit e cila thotë: “lum ai njeri që zbraz qesen e tij për dituri, sepse ajo nuk mund të mirret as të vidhet prej askujt“. Nga kjo mund të konkludojmë se rinia jonë duhet të përvetësojë sa më shumë aftësi dhe dije pasi është pasuri e vetme që nuk mund ta marr askush. Prandaj edhe investimi në dituri është investim në sukses, investim në prosperitet më të sigurt. Shteti duhet ti paraprijë këtij investimi si në fushën e krijimit të kushteve të përshtatshme për arsimim e po ashtu edhe në aspektin e përkrahjes financiare të nevojshme edhe në aspektin e përkrahjes financiare të nevojshme.

Ndikimi arsimit dhe edukimit në jetën e njerëzve studiohet në aspekte e nga këndvështrime të ndryshme. Në çdo shoqëri njerëzit për të mbijetuar e realizuar synimet e tyre kanë nevojë për njohuri, shprehje dhe aftësi. Në shoqëritë e pazhvilluara njerëzit kryenin procese të thjeshta pune, ndërsa në shoqëritë bashkëkohore njerëzit kanë nevojë për dituri të thella, të gjëra, sepse kryejnë procese pune të ndërlikuar dhe me teknologji të lartë e ca dita ditës evoluon drejt prefektes. Prandaj roli i shkollës dhe arsimit, si transmetues të njohurive dhe aftësive sa vjen e rritet, së bashku me të duhet rritur edhe kujdesi dhe përkrahja nga ana organizmave shtetëror.

Një thënie persiane thotë : “Arsimi është fytyra e mendjes” prandaj për të ruajtur fytyrën neve duhet të ndërtojmë një arsimim të bazuar në kualifikim adekuat dhe konform kërkesave të tregut me qëllim e vetëm të punësimit të riut në mënyrë që ai ta jetojë jetën në vendin e vet dhe jo të eksportojmë fuqin rinore në vendet e europiane. Detyra me rëndësishme e nivelit lokal është të aftësojë qytetarin e saj dhe në bashkpunim me sektorin privat të krijojë kushte për sistemim në punë, bazuar në kompetencat që kanë.

2.2 Institucionet arsimore dhe roli i tyre

Institucioni shkollor përbën një nga kushtet më thelbësore të marrëdhënieve të drejtpërdrejta mësues-nxënës dhe si e tillë ekziston në gjirin e një komuniteti, të cilin e lidhin elemente të atillë që ndikojnë në jetën administrative, pedagogjike e shoqërore, shkaqe këto që si pasojë kanë zhvillimin ekonomik dhe social të shtetit.

Në librin e tij “Pedagogjia Familjare” Dr.Riza Brada ka trajtuar edhe qeshtjen mbi insticionet shkolloresi vijon:

“Zhvillimi i bazës materiale të shoqërisë, i formave të ndryshme të superstrukturës shoqërore, të filozofisë, të shkencës, të teknikës e të teknologjisë cilësore dhe më cilësore, e kulturës bashkëhore dhe më bashkëkohore, shumëfishimi i përhershëm i njohurive brenda një kohe

tejet të shkurtër nga të gjitha fushëveprimet njerëzore, domosdoja e aftësisimit intenziv të njeriut në zotërimin e këtyre njohurive si parakusht për zhvillimin e aftësive dhe të shprehive në jetë dhe në punë të sukseshme në këtë dinamik marramendëse, ka bërë të zhvillohet dhe të degëzohet shumë sistemi i arsimit përkatësisht sistemi shkollor. Me zhvillimin e shoqërisë demokratizohet jeta dhe puna. Krijon kushte për herë e më shumë për punësimin e prinderëve dhe të rinjve.”(Riza Brada, Pedagogjia familjare, Biblioteka pedagogjike, Pejë, 1995, faqe 338).

Shkolla është institucioni i edukimit. Thelbi i edukimit është transmetimi prej të rriturve i influencës, parimeve dhe vlerave morale mbi të rinjt për ti përgatitur ata për jetën shoqërore. (Durkheim, 1956). Në këtë perspektivë, detyra e shkollës është të edukojë nxënësit dhe studentët me ndjenjën e komunitetit. Kjo do të thotë se të rinjt duhet të venë interesat e komunitetit dhe të shoqërisë para interesave personale.

Sipas Platoni “egziston vetëm një e mirë, ajo është dituria, dhe një e ligë, ajo është padituria”. Pra, sa më shumë që fitojmë e akumullojmë njohuri, aftësi e shkathtësi aq më larg do të jemi nga tendencat negative sociale, kulturore dhe shoqërore - ekonomike.

Funksionet kryesore të drejtpërdrejta të shkollës janë: socializimi, transmetimi i kulturës, kontrolli shoqëror, vendosja shoqërore, ndryshimi shoqëror dhe shpikjet (Kendal, 2007). Roli shoqërizues i shkollës konkretizohet nëpërmjet njohurive e shprehive që u interpreton nxënësve e studentëve për fusha të caktuara të shkencës, kulturës, artit dhe jetës, shprehitë për gjykime e pjesëmarrje në jetën politike dhe rolin e tyre si nxënës dhe student.

Vëllimi i njohurive dhe natyra e shprehive që fitojnë nxënësit e studentët ndryshojnë në varësi të nivelit të shkollimit. Në shkollën fillore nxënësit mësojnë njohuri elementare dhe gjenerojnë normat e shprehitë e sjelljes në shoqëri e ambiente publike, të ndihmës

për njëri-tjetrin, respektit për të moshuarit, matematikën elementare, përvetësojnë shkrimin e leximin, me një fjalë fillojnë të bëjnë hapat fillestar drejt krijimit të personalitetit.

Në vazhdim të formimit personal, në shkollimin e mesëm të lartë përveç njohurive më të eksploruara arsimore, shkencore e kulturore nxënësit kultivojnë shprehi të punës, profesioneve, ndihmës në komunitet, formave të jetës në shkollë e jashtë saj, ballafaqimin me praktikat e profesionit, e shumë çka tjetër.

Në shkollimin e lartë studentët fitojnë njohuri të plota e të posaçme për profesionin, grumbullojnë e përvetësojnë shprehitë e punës në institucione, kompani prodhimi, pjesëmarrje në jetën dhe aktivitetet shoqërore politike, zhvillojnë pikëpamjet e shijet për familjen, jetën dhe të ardhmen, nëpërmjet kualifikimeve pasuniversitare thellojnë njohuritë shkencore, teknologjike e kulturore dhe aftsitë e shprehitë profesionale, mësojnë nga përvojat në vende e tjera dhe zbatimin e tyre në vendin tonë.

Roli i shkollës si interpretuese e kulturës realizohet nëpërmjet bashkangjites të nxënësëve e studentëve e të vlerave e normave kulturore në një të vetme që është edukimi.

2.3 ICT si shtyllë e edukimit profesional

Trendi i sotëm i zhvillimit drejt ekonomive të bazuara në dije, ka nxjerrë gjithnjë e më shumë në pah rëndësinë e arsimimit e trajnimeve në përgatitjen e kapitalit të vlefshëm njerëzor. Edukimi është një nga shtyllat e zhvillimit ekonomik dhe të rritjes së mirëqënies së shoqërisë. Ashtu sikurse konkurenca ekonomike në nivel global që është duke u rritur me ritme të shpejta, edhe edukimi është duke u kthyer në një burim të

rëndësishëm të avantazheve konkurruese, i lidhur ngushtë me rritjen ekonomike, si një rrugë për vende të ndryshme për të tërhequr investime dhe punë dhe duke u bërë një mjet mjaft i rëndësishëm për përfitimet afat-gjata në shtete të ndryshme, të cilat e shohin edukimin si një rrugë për të reduktuar varfërinë, humbjet ekonomike dhe për të përmirësuar mirëqënien e shtetasve të vet.

Nxitur nga globalizimi i ekonomisë si dhe nga presioni i vazhdueshëm për të mësuar e trajnuar profesionistë të përgatitur, të aftë e konkures, institucionet arsimore në mbarë botën, po përballen sot me sfidat e mëdha të rritjes së aksesit në arsimim e trajnime profesionale e të përmirësimit të cilësisë, në kushtet kur shpesh burimet financiare janë pakësuar. Me zhvillimin e teknologjisë dhe ngritjes së njohurive dhe aftësive të individit, profesionisti është duke shkuar drejt globalizimit dhe për t'u punësuar kudo në botë më nuk do të ketë rëndësi se ku ndodheni apo nga vijim.

Teknologjitë e reja kanë krijuar një epokë të informacionit e cila reflekton mënyrën se si organizatat e ndryshme, përfshirë edhe institucionet arsimore gjenerojnë dhe administrojnë shërbimet e tyre, duke ndryshuar rrugët dhe format e komunikimit dhe të përdorimit të informacioneve. ICT sikurse edhe në çdo veprimtari të jetës edhe në arsim ka sjellë një kthesë rrënjësore në edukimin dhe zhvillimin e kulturës në mësimnxënje dhe mësimdhënie. Teknologjia në mësimdhënie dhe mësimnxënie nuk i bën mësimdhënësit të ndërrojnë rrjedhën e procesit mësimor. Por, ICT mund të ndikoj që mësimdhënësit të ndërrojnë metodologjinë e punës, duke dhënë kushte më të mira për ta. Tani mësimi i kompjuterit dhe përvetësimi i njohurive përmes tij është bërë pjesë e kurrikulave shkollore në tërë botën, si pjesa më e rëndësishme e edukimit modern. Edukimi i bazuar në teknologjinë informative ka bërë një revolucion në dekadën e fundit në tërë fushat e jetës, në këtë aspekt as arsimit nuk ka mbetur prapa.

Sot në gjithë globin tokësor investohet shumë në përdorimin e teknologjisë. Kudo vërehen përparësinë e teknologjisë në implementimin e punëve të tyre të përditshme, qoftë në përpilimin e një programi financiar, kontrollimin dhe diagnostifikim e sëmundjeve të pacientit, shërbimin e klientit, menaxhimi i një apo më shumë pikave të shitjes, servisimet e automjeteve, komunikimin ndërmjet njerëzve nga gjitha vendet e botës, hulumtimet jashtë planetit, prezentimet e punimive të të gjitha niveleve arsimore, mësimin në distancë e deri tek marrja e lajmeve ditore në kohë reale.

Teknologjia është një term i gjërë që merret me zbatimin e njohurive për mjetet e punës dhe profesionet, në shërbim të vazhdueshëm të evidetimit, kontrollimit dhe akomodimit të kushteve për ambientin jetësor në përputhje me kërkesat dhe specifikat e tij. Teknologjia ka ndikuar shoqërinë në mënyra të ndryshme. Në shekullin XXI bota është e fokusuar në shfrytëzimin e përparësive që jep teknologjia. Interneti është adaptuar shumë më shpejtë se teknologjitë e mëparshme. Derisa radios i janë dashur 38 vjet për të arritur shifrën 50 milion përdoruesëve, kompjuterit personal i janë nevojitur 16 vjet, televizionit 13 vjet, kurse vetëm 4 vjet Internetit për të arritur atë shifër” . Intelekti njerëzor ka sjell një kapitalizim të ri përmes zhvillimit të teknologjisë duke rritur tregun e punës profesional, treg ky që ndikon direkt në gjenerimin e ideve të reja krijuese të pasuara me kushte të reja ekonomike që po ndikon dukshëm në rritjen e konkurrencës globale të të mirave materiale. Ekonomia është shëndruar në një objekt dixhital të teknologjisë së lartë dhe gjithçka që po bëhet është për të maksimizuar efikasitetin.

Sipas Luis Daniel Maldonado Fonken “Interneti është një dimension i përvojës së mendjes, shpirtit, trupit dhe energjisë. Nuk ka asgjë që “nuk ekziston”. Është vetëm një dimension i përvojës ku është e mundur të manifestohet.” Ky zhvillim i vrullshëm virtual mundëson qasjen në të gjitha librarit elektronike dhe kjo i paraprinë dhe mundëson

edukim në distancë në kohë reale. Bashkangjitja e teknologjisë në ngritjen e arsimimit dhe formësimit e një shoqërie është faktor esencial zhvillimor i saj.

Integrimi i ICT-së në edukim, ka qenë një nga aspektet kryesore të zhvillimit të edukimit në Europë dhe në vendet e tjera të zhvilluara të botës në këto dy dekadat e fundit. Shumë nga vendet anëtare të organizatës OECD, kanë hartuar plane strategjike ku ICT është konsideruar si një forcë shtytëse në zhvillimin e shoqërive të këtyre vendeve për të ardhmen. Njëkohësisht, mjaft nga vendet në zhvillim, kanë përfshirë përfitimet e përdorimit të ICT në planet kombëtare të edukimit dhe strategjitë për reduktimin e varfërisë dhe të rritjes së mirëqënies së popullsisë. Pra ka një konsensus të gjerë që edukimi, shkenca dhe inovacionet ashtu sikurse edhe përdorimi i ICT janë thelbi i zhvillimit social-ekonomik.

Në Kosovë fatmirësisht, teknologjia ka përdorim të gjerë. Sa më shumë që po zhvillohet teknologjia me të po rritet edhe varësia ndaj saj. Me këtë ritëm të zhvillimit teknologjik pothuajse çdo profesion po ndryshon bashkë me ndryshimin e teknologjisë. Në kuadër të teknologjive globale të cilat kanë depërtuar thellë në ekonomi, komunikim, shkencë, menaxhim, e në fusha tjera të jetës ka ardhur koha e shfrytëzimit të teknologjive të reja edhe në edukimin profesional. Tek ne kjo duhet të reflektohet edhe tek punëdhënësit dhe punëkërkesit, ashtu që ky fenomen duhet të përqendrohet që çdo profil i punëkërkesit të pajiset me të dhënat mbi njohuritë adekuate të profesionit të tij që ka në një bazë të dhënave të përgjithshme në nivelin komunal.

Shteti duhet të sjellë ndryshimet e kurrikulave dhe të programeve të trajnimeve dhe aftësimeve profesionale, të cilat duhet të jenë cilësore dhe të krahasueshme me shtetet europiane që kanë arsim të zhvilluar. Në arsim synohen gjithë herë caqe të reja,

investime të vazhdueshme, prandaj ndryshimi është elementi kyç, pa të cilin arsimit nuk zhvillohet. Benjamin Franklin thoshte: “investimi në arsim sjell kamatat më të mëdha”. Pra, Kosova nuk do të arrijë të zhvillohet si shoqëri dhe as të integrohet në shoqëritë e zhvilluara europiane nëse nuk i bashkangjitet ndryshimeve teknologjike të kohës cilat diktojnë domosdoshmërinë për ndryshime cilësore edhe në arsim e sidomos në arsimin profesional në veçanti. Në vende si Republika e Kosovës që në dekadën e fundit interneti është përdorur më së shumti në Gadishullin Ballkanik, aplikimi i ICT në arsim mungon kur e krahasojmë me faktin që teknologjia përdoret shumë, pa dallim moshe. Realiteti virtual ka ndikim të paparë në evolucionin e shoqërisë. Nuk duhet larguar mendimin se avantazhet në radhë të parë i përkasin teknologjisë, mënyra se si ajo zhvillohet sot në botë, por edhe mënyra se si njerëzit në Kosovë e përdorin atë teknologji. Teknologjia duhet të shfrytëzohet për gjenerimin e vendeve të punës.

Prandaj, shtohet pyetja : a ka ardhur koha të mendojmë se ku me të vërtetë jemi, kah duamë të shkojmë dhe si do ta orientojmë rinin drejt tregut të punës?

Sipas Gustave Flubert i ka dhënë një shprehje mbi librin “ Mos lexoni siç bëjnë fëmijët, për t'u zbavitur apo siç bëjnë ambiciozët për të mësuar. Jo lexoni që të jetoni” , andaj edhe ne nuk duhet të fokusohemi në trajnime të cilat vetëm duhet bërë , por duke analizuar raportet nga tereni duhet të orientojemi kah ajo që neve na mundëson të jetojmë. Ne jetojmë nëse kemi një vend të mirë pune i cili mund të sigurohet nëse kualifikimi ynë është konform kërkesave të tregut.

2.4 Mbështetja e standardet BE-së për aftësimin profesional

Arsimi profesional ka një rol të rëndësishëm në ngritjen e aftësive dhe integrimin e të rinjve në tregun e punës dhe në ofrimin e mundësive me cilësi të lartë teknike.

Harmonizimi i qasjeve të arsimit profesional, shumëllojshmëria e të gjitha sistemeve europiane në edukimet praktike profesionale, metodologjia integruese e tyre me tregun e punës, influenca dhe ndikimi i tyre në zgjidhjen e papunësisë në vendet europiane mund të jenë një udhërrëfyes shumë inkujarues për aplikimin e tyre edhe në vendin tonë.

Kosova është në pikun e saj për të ndërtuar strategjinë e integritit europian, prandaj ka ardhur momenti që të nisë rotacionin arsimor për të përballuar sfidat e kohës në disa fronte njëkohësisht. Këtu nuk mund të bëjë përjashtim as arsimimi në përgjithësi dhe as aftësimi profesional në veçanti, statistikave europiane tregojnë se nëse bazohemi në edukim të mirëfilltë profesional të sponsorizuara nga qeveria si në aspektin reformativ të arsimit, po ashtu në aspektet lobuese për këto nivele edukativo-aftësuese, por edhe në aspektin financiar të qëndrueshëm atëherë rezultatet do të ndikojnë ndjeshëm në barapeshën e sistemit social të vendit, gjegjësisht në zbutjen e papunësisë, që në nivel vendi është më e larta në regjion me mbi 30 % të papunë.

BE përveq financimeve në fushat e zhvillimit ekonomik për vendet brenda dhe jashtë saj ajo gjithashtu financon edhe programet arsimore, programet e ndërtimit të strukturave për aftësimin profesional, të cilat nxisin qytetarët e shteteve europiane për të fituar nga mundësitë e saj, projektet të cilat ajo ofron për të jetuar, studiuar dhe punuar në vendet e tyre, por edhe vendet tjera.

Duke ndarë shembuj të praktikës së mirë, duke marrë pjesë në aktivitetet në mësim të ndërsjellët, shtetet anëtare të BE-së kanë filluar të punojnë së bashku për qëllime specifike në fushën e arsimit. BE ka miratur programin e saj të parë të arsimit në korrik të vitit 1987 – Programi COMEET që është program i projektuar për të nxitur kontaktet dhe shkëmbimet midis universiteteve dhe industrisë. Ky program u pasua shpejt nga

programi ERASMUS (European Community Action Scheme for the Mobility of University Students) - “Të rinjt për Europën”. Këto programe u miratuan dhe u mbështetën nga BE, si dhe me mbështetje të konsiderueshme financiare nga ana e parlamentit europian i cili vuri një pjesë të buxhetit financiar të saj në dispozicion për këto instrumente arsimore.

BE ka dy lloje të ndryshme instrumentesh për të rritur cilësinë dhe transparencën e sistemeve të aftësisimit arsimor për shtetet anëtare të saj :

1. Grupi i instrumenteve të politikave ndërmjet të cilave vendet e BE-së janë të inkurajara që të zhvillojnë sistemet e tyre të mësimit dhe për të mësuar nga sukseset e njëri tjetrit.
2. Programi për të mbështetur shkëmbime, krijimin e rrjetave ndërlidhëse dhe mësimin reciprok midis shkollave, universiteteve apo qendrave të trajnimeve profesionale, si dhe në mes të autoriteteve politike përgjegjëse për këto fusha në shtetet e ndryshme anëtare të BE-së.

Interesi i BE-së në politikën e arsimit, i zhvilluar pas Samitit të Lisbonës në mars të vitit 2000, në ministritë përkatëse ka reflektuar mbi “Objektivat konkrete” të sistemit të arsimit me qëllim të përmirësimit të tyre. Nga kjo kohë komisioni europian për çështjet arsimore ka botuar një seri raportesh dhe rekomandimesh për avansimin e arsimit dhe arritjen e objektivave të përbashkëta.

Programet mbështetëse të BE janë si në vijim :

- ✓ Programi i shkëmbimit të shkollave
 - mbi 2.5 milion nxënës të shkollave gjatë një periudhe programore

- ✓ Programi i shkëmbimit universitar Erasmus
 - 3 milion student pjesëmarrës në veprimet e mobilitetit
 - Kurs i akredituar
 - Kohë zgjatja 3 muaj deri në 1 vit akademik
- ✓ Programi i arsimit dhe formimit profesional - Leonardo Da Vinci program
 - Përfshinë 75.000 të rinj në vit
 - Mësimi ose praktika në një vend tjetër të BE-së
- ✓ Programi arsimor i të rriturëve
 - Fitimi i përvojës ndërkombëtare
- ✓ Nënprogrami – mësimi rreth Europës

Hyri në fuqi me 1/01/2007 vazhdon deri në fund të vitit 2016.

2.5 Analiza statistikore e AAP-ve në vendet e BE-së

Në vitin 2009, Shtetet Anëtare të BE 27 plus Islanda dhe Zvicra apo siç njihet ndryshe si BE 27 + kishin pak më shumë se 130 milionë persona të moshës mes 15 dhe 34 vjet. Rreth një e treta e atyre me arsim të nivelit të ulët (shkollë fillore ose të mesme të ulta), 45.3% me arsim të nivelit të mesëm (larta dhe post-sekondare jo terciare) dhe 20.5% me arsim të nivelit të lartë (arsimi i lartë), siç tregohet më poshtë në figurën 1.

Nivel e shkollimit sipas shteteve anëtare të BE 27+ janë : parashkollor dhe fillor niveli ISCED 0 dhe 1, Mesëm i ulët ISCED 2 dhe 3c, mesëm i lartë e post sekondar ISCED 3 dhe ISCED 4, terciar ISCED 5 dhe 6.




Figura 1. Arritjet arsimore për moshën 15-34 vjeç në vendet e BE-27 +, 2009

Burimi: From education to working life
(The labour market outcomes of vocational education and training) 2012

Duke u bazuar në të dhënat e Cedefop (2010) parashikimet e fundit tregojnë se, pavarësisht se ka një rritje të konsiderueshme në numrin e të rriturve me arsim të lartë (16 milionë) ekziston vetëm një rritje modeste në numrin e atyre me kualifikime të nivelit të mesëm (rreth vetëm 1 milion), kjo e fundit do të vazhdojë të llogaritet si rreth gjysma e fuqisë punëtore Evropiane deri në vitin 2020 (Cedefop, 2012). Kategoria e kualifikimit të nivelit të mesëm ISCED 3 dhe ISCED 4 përmban numrin më të madh të njerëzve me një arsim AAP të orientuar: 35.200.000 njerëz, ose 60.1% të totalit 58.5 milion njerëzve.

AHM (ad hoc module) (trajnimet të shpejta) të vitit 2009, gjithashtu bën dallimin midis kategorive të ndryshme të AAP, dmth kryesisht (ose vetëm) i bazuar në shkollë, një kombinim i shkollës dhe vendit të punës, apo kryesisht bazuar në vendin e punës ose arsim profesional pa dallime të mundshme. Kjo kategori e fundit përbën një të tretën e individëve dhe përfshin gjashtë vende si Estonia, Italia, Holanda, Polonia, Portugalia dhe Sllovakia. Programet kombëtare të disa prej këtyre shteteve nuk bëjnë kurrfarë

dallimi në mes të tri lloje të AAP-ve . Vendet si Finlanda, Estonia, Bullgaria e disa vende tjera europiane sistemin e arsimit profesional e kanë të ndërtuar vetëm me bazë shkollën, ndërsa shtetet si Anglia dhe Franca, duke u bazuar në sistemin e tyre formal arsimor, programet AAP-së i kryhejnë kryesisht në vendin e punës.

Njerëzit me trajnime AAP kryesisht të bazuar në shkollë përbejnë 28.6% të totalit krahasuar me 29.3% të atyre të kombinuara shkollë dhe në vendin e punës. Këto dy lloje korrespondojnë me rreth 10 milionë persona secili. Tre vende që përbëjnë më shumë se gjysmën e kategorisë kryesisht të AAP-ve të bazuar në shkollë janë : Franca 24% e totalit, Rumania 18% dhe Spanja 10%. Nga ana tjetër, kategoria e kombinuar shkollë dhe vendpunimi është e përbërë kryesisht nga Gjermania 67%, Republika Çeke 10% dhe Austrisë 6%. Kategoria e AAP-së kryesisht me bazë vendin e punës është më pak e njohur, përfshin 10% të totalit të BE-së (rreth 3,5 milion njerëz), dhe është i aplikative kryesisht nga dy shtete: Britani e Madhe 55% e kategorisë totale e pasuar nga Franca me 40% .




Figura 2. Shpërndarja e diplomimit në nivelin e mesëm sipas orientimit arsimor, 15-34 vjeçarëve, 2009

Burimi: From education to working life

(The labour market outcomes of vocational education and training) 2012

Figura 2 tregon ndarjen e popullsisë të grup moshës 15-34 vjeçare, me nivelin më të lartë të arsimit të barabartë me një të mesme e lartë apo të një niveli post-sekondar jo terciar me orientim arsimor (e përgjithshme kundrejt AAP). Një grup vendesh ka një përqindje shumë të lartë të personave me arsim profesional AAP, të udhëhequr nga Republika Çeke me rreth 85%, përqindje të njejtë kanë edhe vendet si Sllovakia dhe Austria me 84-85%, të cilat janë të gjitha mbi mesataren e BE-së, që kjo mesatare është 60.3%. Mbi këtë mesatare janë edhe vendet si Gjermania me mbi 70%, Polonia me rreth 68%, Italia dhe Zvicra me 67%, Holonda me rreth 65% dhe Hungaria me 62%. Afër mesatares europiane janë disa vende siç janë Finlanda, Franca, Suedia, Rumania, Danimarka me një përqindje që varon diku afër 60%.

Në anën tjetër, një grup tjetër vendesh ka një pjesë të konsiderueshme më të ulët se mesatarja e popullsisë me arsim e orientuar në AAP, siç janë Irlanda me 22% dhe Portugalia dhe Islanda me rreth 25%. Pra, ndryshimet janë mëse të dukshme në vendet e BE-së.

Ndryshimi midis vendeve mund të varet nga disa faktorë që lidhen për të dy kategoritë, bazuar në ofertën e sistemeve të trajnimit të arsimit. Sistemet arsimore të vendeve në fjalë ofrojnë një gamë të gjerë të llojeve dhe niveleve të trajnimeve të AAP-ve dhe në këtë mënyrë hapen shumë rrugë profesionale të përcjellura nga nivelet e ndryshme dhe llojet e ndryshme të arsimit profesional. Këto dallime të gjitha kanë një ndikim në opsionet arsimore të individëve si dhe në ngritjen e tyre profesionale. Spektri i gjërë i trajnimeve sjell edhe mënyrën e shkollimit të popullatës në këto vende europiane.

Historia gjithashtu luan një rol. Disa vende kanë një traditë të gjatë të AAP (p.sh. Austria, Gjermania dhe Zvicra), të mbështetura nga institucionet dhe kompanitë e profileve të ndryshme për ofrimin e trajnimeve profesionale. Këto vende e konsiderojnë këtë mbështetje si një faktor kyç në përputhje të kërkesës dhe ofertës për aftësi profesionale. Njerëzit në këto vende janë më të prirur për të zgjedhur AAP më shumë se njerëzit në vendet që tradicionalisht i japim rëndësi më të madhe për arsimin e përgjithshëm, si për shembull, Italia. Figura 3 tregon diplomimin e të rriturve sipas llojit të AAP dhe vendit, dhe se si mbizotërojnë sistemet AAP me bazë shkollat apo kombinimin shkollë e vendi i punës në disa vende të Europës.




Figura 3. Të diplomuarit AAP sipas llojit të programit, grup mosha e 15-34 vjeçarëve, 2009

Burimi: From education to working life
(The labour market outcomes of vocational education and training) 2012

Nga figura 3 rezulton se disa vende kanë pjesmarrje më të lartë se mesatarja e BE në llojin e trajnimit të bazuar vetëm në shkolla si Bulgaria me 100%, Finlanda dhe Rumania me mbi 95%, Qipro rreth 90%, Estonia dhe Belgjika mbi 85%, Letonia dhe

Slllovenia me 80%, por ka edhe dukshëm nën atë mesatare si Gjermanime rreth 6-7%, Norvegjia afër 10%, të cilat kanë tendenca në trajnimet e kombinuar shkollë dhe vendi punës që janë dukshëm mbi mesataren europiane. Trajnimet e kombinuara shkollë dhe vendi punës janë mëse evidente dhe shumë mbi mesataren europiane (që është 40%) në vendet siç janë Gjermania, Lituania, Norvegjia. Pra nëse terheqim një krahasim mes Bullgarisë që trajnimet i bazon pothuajse 100% në shkollë, Lituani e Gjermania i kanë afër 100% trajnimet e kombinuar apo sistemin dual të përgatitjes profesionale, që njëherit kanë dhënë rezultate shumë inkurajuese në zhvillimin ekonomik të shteteve përkatëse. Kjo vërehet qartë se edhe standartet e jetës në këto vende janë dukshëm më të larta se në disa nga shtetet tjera të BE-së.

Orientimin edukativo–arsimor profesional në nivelin e mesëm në bazë të gjinive sikurse edhe në rastin e Kosovës edhe në vendet e BE tregojnë një disbalancë gjinie.

Education orientation	Men	Women	Total
General education	33.7%	42.1%	37.8%
VET	64.0%	55.9%	60.1%
of which:			
• school-based;	18.0%	16.4%	17.2%
• workplace-based or combination school/ workplace;	25.0%	22.1%	23.6%
• no distinction possible between types of VET;	21.0%	17.5%	19.3%
• no answer.	2.3%	2.0%	2.2%
Total (%)	100%	100%	100%
Total (in thousands)	30 011	28 518	58 529

Tabela 1. Ndarja e llojeve AAP sipas gjinisë 15-34 vjeç, EU27 +, 2009

Burimi: From education to working life
(The labour market outcomes of vocational education and training) 2012

Të dhënat nga tabela 1 tregojnë një mungesë ekuilibri gjinor për shkollimin e mesëm të orientuar AAP edhe në vendet e BE-së, meshkujt e kanë kryer këtë lloj arsimit më shumë se femrat (në raport 64% M kundrejt 55.9% F me arsim total të mesëm). Nga kjo rezulton se 25% e meshkujve i kanë krye trajnimet e kombinuar apo ato në kompani kundrejt 22.1% të femrave. Ajo që vihet në pah është se femrat kanë tendenca kah edukimi i përgjithshëm 42.1% (kundrejtë 33.7% të meshkujve). Ky rezultat sipas gjinisë ishte edhe në rastin e analizimit të të dhënave në Kosovë.

Këto tendenca janë për shkak të disa faktorëve. Fakti që femrat kanë tendencë për të studiuar më të gjatë (deri në nivel universitar) për të fituar pozicione më të mira në tregun e punës do të thotë ata preferojnë të ndjekin arsimin e mesëm të lartë të përgjithshëm dhe post-sekondar, edukime këto të cilat ju rrisin shanset e regjistrimit në arsimin e lartë. Bazuar në të dhënat e raporteve të ndryshme, preferencat individuale dhe faktorët kulturorë thonë se femrat kanë më shumë gjasa për të zgjedhur më shumë shtigjet e përgjithshme ose akademike të arsimimit. Kjo vërehet në numrim e femrave që kanë diplomuar në nivelin terciar. Tabela 2 tregon se mesatarja europiane po thuajse në të gjitha nivelet e kualifikimit është më e lartë tek femra se sa tek meshkujt.

		EU	BE	BG	CZ	DK	DE	EE	IE	EL	ES	FR	IT	CY	LV	LT	LU	HU
Low	Males	14.1	12.7	21.5	24.1	9.5	18.4	32.3	23.2	10.2	23.8	12.7	8.1	9.2	29.4	39.8	:	24.9
	Females	14.4	14.0	22.0	21.8	7.6	13.3	:	11.3	14.9	26.0	13.2	11.2	4.6	24.1	33.9	:	22.2
	TOTAL	14.2	13.2	21.7	22.7	8.6	15.9	27.7	19.5	11.8	24.7	12.9	9.1	7.2	27.6	37.4	4.1	23.5
Medium	Males	7.6	5.7	8.4	5.1	6.8	7.5	17.8	16.9	9.2	16.0	6.4	5.0	4.3	21.2	22.7	2.7	9.5
	Females	8.1	7.7	8.2	7.6	5.5	6.3	18.2	9.3	17.0	19.2	8.1	7.4	5.7	15.8	17.9	4.7	9.5
	TOTAL	7.8	6.6	8.3	6.2	6.2	6.9	18.0	13.7	12.6	17.4	7.2	6.1	4.9	18.7	20.5	3.6	9.5
High	Males	4.7	4.0	4.5	2.5	5.2	3.0	12.2	7.9	6.6	9.6	4.8	4.4	4.1	10.9	8.1	2.9	4.5
	Females	5.2	4.1	4.2	2.5	4.4	3.3	7.2	5.9	10.9	11.3	5.0	6.6	5.0	9.2	5.9	4.5	3.8
	TOTAL	4.9	4.0	4.3	2.5	4.8	3.1	9.1	6.8	8.7	10.5	4.9	5.6	4.5	9.9	6.8	3.6	4.1
		MT	NL	AT	PL	PT	RO	SI	SK	FI	SE	UK	IS	LI	NO	CH	HR	TR
Low	Males	7.4	5.5	9.7	15.8	10.6	7.5	12.1	42.5	11.6	10.8	11.5	7.8	:	6.7	7.2	11.8	10.0
	Females	8.9	5.8	5.6	16.9	13.2	3.8	10.0	39.2	11.7	12.0	9.0	6.5	:	3.9	7.5	11.3	7.1
	TOTAL	7.8	5.7	7.3	16.3	11.8	5.7	11.2	40.8	11.6	11.3	10.3	7.2	:	5.4	7.4	11.6	9.2
Medium	Males	:	3.3	3.7	8.2	7.6	6.8	6.6	11.4	8.0	5.3	6.7	7.3	:	2.8	4.1	8.7	8.2
	Females	:	3.6	3.3	10.0	11.8	6.5	7.3	13.4	6.9	5.9	5.4	7.0	:	1.9	4.1	11.6	17.9
	TOTAL	:	3.4	3.5	8.9	9.7	6.7	6.9	12.3	7.5	5.6	6.2	7.2	:	2.4	4.1	9.9	10.1
High	Males	:	2.8	2.1	4.0	5.5	4.3	3.9	5.1	4.6	4.7	3.8	:	:	1.7	2.5	7.3	5.5
	Females	:	2.5	2.5	4.4	6.8	3.9	4.2	4.7	4.2	3.9	3.0	:	:	1.8	3.6	6.8	9.9
	TOTAL	:	2.7	2.3	4.2	6.3	4.1	4.1	4.9	4.4	4.3	3.4	3.5	:	1.8	2.9	7	7
		Low (ISCED 0-2)					Medium (ISCED 3-4)					High (ISCED 5-6)						

Tabela 2. Të dhënat e kualifikimeve sipas gjinisë

Burimi: Key Data on Education 2012, page 184

Në vitin 2017, 47.8% e të gjithë nxënësve që ndjekin edukimin e tyre në nivelin e mesëm të lartë në BE ishin regjistruar në programe profesionale. Pjesa e nxënësve të mesëm të lartë që ndërmarrin programe profesionale ndryshon në mënyrë të konsiderueshme midis Shteteve Anëtare të BE-së. Në vitin 2017, Republika Çeke kishin pjesën më të lartë të nxënësve të mesëm të lartë që ndërmarrin programe profesionale në 72.4%. Finlanda, Sllovenia, Kroacia, Sllovakia, Austria dhe Holanda regjistruan më shumë se 65% të nxënësve ndjekin arsimin e mesëm të lartë në rrjedhën e AAP-së. Vendet si Irlanda (10.3%), Qipro (16.7%), Hungaria (23%), Malta (27.1%), Lituania (27.4%) dhe Greqia (28.8%) kishin pjesëmarrjet më të ulëta (më të ulëta se 30% në 2017).

2.6 Tregu i punës në vendet e BE-së

Punësimi i të rinjve dhe punësimit në përgjithësi janë çështje kyçe në Europë, me të cilat ajo po ballafaqohet me vështërsi dhe me tendecë të rritje në disa vende të Europës.

Rezultatet e tregut të punës janë përmirësuar në sfondin e një rimëkëmbje modeste. Shkalla e papunësisë në BE duket jashtëzakonisht reaktive dhe ka një rimëkëmbjen të dobët. Megjithatë, ajo qëndroi mbi nivelet e para krizës, papunësia sillet në rreth 9.5% në vendet BE dhe 11% në vendet e euro zonës në maj 2015. Pabarazitë të tregut të punës kanë filluar të bien në të gjitha vendet e euro zonës dhe BE-së.

Rënia e papunësisë kryesisht është rezultat i ndarjes së punëve, por prapë se prapë normat për gjetjen e një pune edhe pse në shërim e sipër akoma janë më të larta se ato në kohën e parakrizës në vendet e BE-së. Papunësia ka filluar të rritet deri në mes të vitit 2013 dhe kjo ka nxitur një përkeqësim të vazhdueshme për të gjetur punë edhe tek të rinjt në vendet europiane. Gjetja e një vendi pune ka pasur rënje drastike veçanërisht në Greqi, Portugali, Spanjë, Irlandë, Lituania, Polonia, Holanda, Sllovakia dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Pothuajse 6 nga 10, të rinjt e moshës 15-34 vjeçare janë të punësuar, shifër kjo e cila është nën statistikat e përgjithshme të BE-së në raport me totalin e moshës 15-64 vjeçare që është 64.6%. Shkalla e përgjithshme e papunësisë për 15-34 vjeçarët e shprehur në përqindje është 12.8% në vitin 2009 ka qenë mbi mesataren e BE që është 8.9%. Që atëherë papunësia e të rinjve është rritur akoma më tej.

Shkalla e papunësisë të të rinjve është rritur ndjeshëm gjatë krizës europiane si pasojë e drejtëpërdrejt e reflektimeve të luhatjeve ekonomike në mbarë kontinentin e vjetër. Në

vitin 2013, shkalla e papunësisë tek të rinjt ishte mbi 25% në 11 vende e BE-së, kulminacionin në mbi 40% ishte në Spanjë, Greqi dhe në Itali. Në vitin 2014, ajo ka rënë në të gjitha vendet, me përjashtim të Italisë dhe Luksemburgut, por akoma mbetet mbi 25% në shtatë vende europiane. Pas arritjes së niveleve të larta në fazat e hershme të krizës, pjesa e të rinjve të cilët nuk janë të punësuar, nuk marrin pjesë në shkollim ose trajnimi (NEETs) kohët e fundit ka pësuar rënie. Koha që një person i ri mund të kalojnë në arsim është rritur ndjeshëm, sidomos në ato vende më të prekura nga kriza dhe borxhet që ato posedojnë. Papunësia ka rënie të lehtë në vitet e fund në krahasuar me rekordet historike sa ishte në kohën e krizës globale europiane. Që nga fillimi i krizës financiare të vitit 2008, BE-ja ka qenë e goditur nga pasoja të mëdha negative që kanë pasur efekt në papunësi në mënyra të ndryshme midis vendeve të saj.

Kushtet e tregut të punës në përgjithësi janë përmirësuar në vendet e OECD (Organisation for Economic Co-operation and Development), në vitet e fundit, por rimëkëmbja nga kriza e fundit ekonomike mbetet shumë e pabarabartë midis këtyre vendeve. Punësimi ka ende një rritje shumë të ngadalë në zonën e OECD për ta mbyllur hendekun vendeve të punës shkaktuar nga kriza e shkaktuar kohë më parë.




Figura 4. Punësimi i grup moshës 15-24 vjeç në tre çerekun e tretë të vitit 2014

Burimi: <https://data.oecd.org/emp/employment-rate-by-age-group.htm>

Nga seksioni i mëparshëm treguam se shumë njerëz nga grup moshës 25-34 vjeç kanë përfunduar arsimimin e tyre. Duke krahasuar tregun e punës për këtë grup moshës, në të gjitha llojet e arsimit, në bazë të statistikave të Eurostatit del se u diplomuan 33 milionë persona në shkollat e mesme apo edukim post sekondar dhe rreth 22 milion e kanë të kryer fazën e parë të arsimit terciar. Figura 5 tregon se 69.1% janë të punësuar me edukim të përgjithshëm në krahasim me totalin që e kanë të kryer edukimin e përgjithshëm (nivelin 3-4), ndërsa me AAP janë të punësuar 79.2% e njerëzve, ku më së shumti ndër ata që e kanë kryer shkollimin e kombinuar apo atë me bazë në kompani 81.2% e totalit. Ndërkaq sa i përket aryre me nivel ISCED 5 apo edukim terciar del se 84.9 % janë të punësuar personat që kanë kryer programet teorike ISCED 5a (programe të dizajnuara për punë kërkimore të tilla si mjekësi, stomatologji apo arkitekturë) dhe 86.5% me programet profesionale (teknike gjegjësisht praktike të dizajnuara për hyrje të drejtëpërdrejtë në tregun e punës).




Figura 5. Statusi i punësimit sipas nivelit të shkollimit, grup moshë 25-34 vjeç, BE+27,2009

Burimi: From education to working life
(The labour market outcomes of vocational education and training) 2012

Nëse tregojmë raportin e punësimit mes grup moshave të ndryshme (figura 6), do të shihet se të personat e të cilët kanë përfunduar një edukim profesional kanë përqindje më të lartë punësimi. Tek grup moshë 15-19 vjeçarëve, diferenca në punësim është 4.2% më tepër me AAP, tek ata 20-24 vjeç mbi 8% dallim në favor të AAP, tek personat me moshë 25-29 vjeç, të punësuar me shkollim profesional janë 79.3% kundrejtë 75.2 % me arsimim të përgjithshëm. Po ashtu edhe tek grup moshë 30-34 përparësia e njerzëve që janë në punë është në anën e AAP 81.4% kundrejtë 76.8% me arsimim të përgjithshëm.




Figura 6. Statusi i punësimit sipas nivelit të shkollimit, grup moshë të ndryshme, BE+27,2009

Burimi: From education to working life
(The labour market outcomes of vocational education and training) 2012

Punësimi sipas nivelit arsimor, niveli i mesëm, jo terciar, shprehur në përqindje sipas moshave 25-64 vjeç, për vitin 2018 (më i fundit në dispozicion) më i larti është në Sued 86,7%, Portugali 83.71% dhe Republikën Çeke me 83.51% krahasuar me mesataren e OECD-së 76.25, po ashtu punësim të lartë të këtij niveli shkollimi ka edhe Danimarka 83.26%, Gjermani 82.28% Estonia 79.92%, Austria 77.63%.




Figura 7. Punësimi sipas nivelit arsimor, niveli i mesëm, jo terciar, grupmosha 25-64 vjeç shprehur %, 2018

Burimi : Education at a glance: Educational attainment and labour-force status

(<https://data.oecd.org/emp/employment-by-education-level.htm#indicator-chart>)

Duke ju referuar gjetjes, rezulton se tek grup mosha 25-34 vjeçe mund të thuhet se meshkujt të cilët e kanë përfunduar një arsimim profesional janë të punësuar 86.7% të totalit prej 83.9% sa janë të punësuar, ndërsa ata që kanë përfunduar arsimimin e përgjithshëm të punësuar janë 74.9%. Nëse shikohet numri edhe i të papunëve në bazë të kategorive të shkollimi për të gjitha grup moshat nga figura 6 vërehet qartë se shumë më shumë të papunësuar janë ata që kanë një edukim të përgjithshëm në raport me ata që kanë një edukim profesional. Vetëm tek grup mosha 15-19 vjeq numri i të papunëve është më i lartë me edukim AAP e cila mund të jetë si shkak i vazhimit të shkollimit apo mos përmbushja e moshës për punë sipas standarteve të BE-së.

Në anën tjetër nëse shikojmë raportin gjinor, gjinia femrore e po kësaj grup moshe (25-34 vjeq) rezulton se ato që kanë edukim të përgjithshëm të punësuar janë 63.9%, të

totali të të punësuarave prej 68.6%, ndërkaq tek ato me shkollim profesional AAP përbëjnë 70.4% të numrit total të të punësuarëve.

Të dhënat në vijim, na tregojnë pasqyrat e të punësuarve të diplomuar në shkollat e mesme sipas drejtimit dhe profesionit figura 8, ndërsa figura 9 na jep informacionin e të punësuarve të diplomuar sipas profesionit në vendet BE në vitin 2009.




Figura 8. Të diplomuar në shkollat e mesme sipas drejtimit dhe profesionit

Burimi: From education to working life
(The labour market outcomes of vocational education and training) 2012




Figura 9. Të dhënat e të punësuarve të diplomuar sipas profesionit në vendet BE në vitin 2009

Burimi: From education to working life
(The labour market outcomes of vocational education and training) 2012

Totali i të punësuarve të diplomuar në shkollat e mesme në drejtimet e përgjithshme është 10.5 milion persona, ndërkaq të diplomuarit në AAP me të njejtin nivel shkollimi janë 26 milion persona me një dallim prej 15.5 milion personave të diplomuar. Dallimi i madh është edhe tek niveli i shkollimit terciar ku të diplomuar në programet teorike janë 15.8 milion kundrejt 5 milionëve në programet e orientuara në punë.

2.7 Invenstimet e vendeve europiane në arsim

Investimi në arsim është një fushë prioritare në kontekstin e vendeve të Evropës, kjo është një strategji e rritjes e cilësisë edukative në BE për dekadën e tanishëme. Investimi në edukim, trajnime profesionale dhe mësimin gjatë gjithë jetës realizohet për të mbështetur zhvillimin e kapitalit njerëzor, për të rritur punësimin, qytetarinë aktive dhe përfshirjen sociale, dhe në veçanti, trajtuar dhe për të parandaluar marginalizimin e të rinjve dhe papunësinë. Objektivat europine për vitin 2020 janë shumë të mëdha, si zvoglimi i përqindjes së të papunëve dhe ngritja e kapacitetit arsimor tek të rinjt.

Megjithatë, kriza ekonomike dhe rritja e njëpasnjëshme e deficiteve buxhetore të vendeve europiane dhe nivelet e borxhit që ato posedojnë, kërkojnë konsolidim fiskal shumë faktorial për të sjellë anëtarët e këtyre shtetet në përputhje me kërkesat e stabilitetit të BE-së. Sipas Eurostatit, shpenzimet publike në arsim përbëjnë për afër 90% të totalit të investimeve në arsim, ky është vetëm një fakt që është nën presion në këtë proces të konsolidimit.

Evaluimet në buxhetet e arsimit në nivelet kombëtare të vendeve europiane mes viteve 2014 dhe 2015 është paraqitur në figurën 10.




Figura 10. Pasqyra e buxheteve të vendeve europiane në mes të viteve 2014 dhe 2015

Burimi : (<https://webgate.ec.europa.eu/fpfis/mwikis/eurydice/images/8/8f/194EN.pdf>)

Duke e krahasuar këto evaluime të buxheteve të planifikuara të arsimit në vendet europine nga viti 2014 në 2015, del në pah se vlerat janë konstante në rrafsh global,

por është e qartë se më shumë se gjysma e shtetet respektivisht rajoneve (për të cilat të dhënat janë në dispozicion dhe të krahasueshme) kanë rritur buxhetin e tyre të arsimit me më shumë se 1%. Për nëntë shtete si janë Republika Çeke, Estonia, Irlanda, Franca, Kroacia, Luksemburgu, Holanda, Polonia dhe Islanda, rritja është ndërmjet 1% dhe 5%. Ndërsa për shtatë vende si Spanja, Letonia, Hungaria, Malta, Rumania, Sllovakia dhe Suedia është regjistruar një rritje më të lartë se 5% në buxhetin e arsimit. Buxheti i arsimit për vitin 2015 në krahasim me atë të vitit 2014 me vlera konstante ka mbetur stabil, është rritur ose ulur nën 1%, në shtatë shtetet, Bullgaria, Italia, Lituania, Austria, Finlanda dhe Mbretëria e Bashkuar respektivisht Anglia. Në anën tjetër, katër shtetet, për të cilat të dhënat janë në dispozicion dhe të krahasueshme është ulur buxheti i tyre arsimor (me vlera konstante) nga më shumë se 1% në mes të 2014 dhe 2015. Për Belgjikën (me komunitet gjermano folës), buxheti i arsimit ka rënë midis 1% dhe 5%, ndërsa tek popullata e komunitetit freng dhe flaman është rritur për 1%. Në vendet si Greqia, Sllovenia dhe Mbretëria e Bashkuar (aludohet në Irlandën Veriore) buxheti i arsimit ka rënë me më shumë se 5%. Për Gjermaninë, Qipron, Bosnje dhe Hercegovinen, Zvicren, Lihtenshtajnin dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë nuk ka të dhëna, pasi a këto vende nuk morën pjesë në këtë për mbledhje të të dhënave. (<https://webgate.ec.europa.eu/fpfis/mwikis/eurydice/images/8/8f/194EN.pdf>)

2.8 AAP në disa nga vendet e BE

2.8.1 AAP në Gjermani

Normat e larta të arsimit të mesëm të lartë në Gjermani, na pasqyrojnë faktin se për shumicën e gjermanëve shkollimi i përgjithshëm është pasuar me pjesëmarrjen në arsimin e mesëm profesional si një rrugë standarde në tregun e punës.

Kualifikimet profesionale mund të fitohen duke marr pjesë në një nga sistemet e shumta të instuticionalizuara të formimit profesional. Rrugët e ndryshme të disponueshme mund të kategorizohen në tri kategori të cilat ndryshojnë në bazë të aftësive dhe specifikave si:

- ✓ Sistemi i dyfishtë i formimit profesional – i alternuar shkollë dhe trajnimi me bazë të fortë.
- ✓ Arsimimi profesional me kohë të plotë – i bazuar në një program kryesisht aplikativ.
- ✓ Arsimimi i lartë në kolegje, akademi profesionale apo universitete.

Sistemi dual gjerman i formimit profesional jep një kontribut të qenësishëm në fuqinë ekonomike të Gjermanisë. Bashkëpunimi i sipërmarrjeve me institucionet arsimore u përçon studentëve dijet profesionale dhe zbatimin e tyre në praktikë brenda ndërmarrjeve. Sistemi gjerman përcaktohet nga disa karakteristika mjaft unike, që njëherit janë model edhe për shumë vendet të BE-së dhe më gjërë.

Ka rreth 350 programe trajnimi të njohura zyrtarisht në Gjermani, kështu që shanset janë të mira se ndonjë prej tyre do të përshtatet me interesat e të rinjve gjerman, që ata të aftësohen dhe arsimohen e njëkohësisht të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale. Ky kombinim i teorisë dhe praktikës ju jep mundësi të rinjve që jo vetëm të përgatiten në aspektin profesional por edhe të fitojnë përvojë pune në kompani të ndryshme gjermane. Punësimi i kandidatëve që kanë të kryer një trajnim për aftësim profesional është në nivel shumë të lartë, kjo është njëra ndër arsyet së këto lloje të trajnimeve janë shumë të popullarizuara në Gjermani, rreth dy të tretat e të gjithë të rinjve që largohen nga

shkolla, bashkangjiten nëpër këto programe për filluar një trajnim dhe aftësim profesional.

Gjermanët i kanë pesë arsye për të marrë pjesë në aftësimet dhe trajnimet profesionale:

1. Trajnimet profesionale në Gjermani ofrojnë shumë varietete, të cilat janë të kombinuara mes teorisë dhe praktikës që nga zanafilla e tyre programore dmth janë trajnime që fillojnë nga njohuritë bazike. Trajnimet kryhen në vendet e punës në kompani të ndryshme, një ose dy ditë të javës janë të rezervuar për trajnime në objektet shkollore ku mësohen parimet themelore teorike për atë se çfarë nevojitet për punën apo profesionin për të cilin arsimohet i riu dhe pjesa tjera nëpër kompani.
2. Të gjitha kompanitë dhe industritë vazhdimisht i vëzhgojnë praktikantët, prandaj shanset për të siguruar një vend pune përmes një programi të trajnimit profesional janë të shkëlqyera.
3. Kompanitë paguajë rrogë për punën që bën kandidati, si pjesë e kursit profesional. Kur ndiqet një program trajnimi profesional në Gjermani pagesa bëhet në bazë të ditëve të punës deri në përfundim të trajnimit.
4. Trajnimi profesional mund të jetë bileta për një karrierë në tregun gjerman të punës.
Rreth dy të tretat e të gjithë pjesëmarrësve kanë gjetur një punë të përhershme me kompanitë e tyre pas përfundimit të trajnimit profesional si rezultat i punës së sukseshme që kanë bërë respektivisht përvetsimit të mirëfilltë të profesionit për të cilin janë aftësuar.
5. Kërkesa në tregun gjerman të punës është e lartë për profesionistët me një kualifikim të mirëfilltë. Në disa fusha ata janë më të kërkuar sesa ata që kanë

përfunduar studimet terciare. Kjo lidhet me faktin se edhe sot Gjermania kërkon profesionist të lamive të ndryshme edhe jashtë kufijëve të saj.

Vende pune të njoftuara si të lira në sektorë dhe rajone të caktuara vitet e fundit nuk janë zënë plotësisht. Disa firma gjermane kanë nevojë për specialistë të rinj. Formimin përkatës për profesione të kërkuara në Gjermani mund ta nisnin jo vetëm të rinj nga vendet e BE-së, por edhe jashtë saj.

Pas fazës së arsimimit rruga është e hapur për të gjetur një vend pune fiks. I mundshëm është edhe kualifikimi i mëtejshëm si Mjeshtër apo Teknik. Krahas kësaj, titulli Mjeshër të jep të drejtën e aplikimit për një vend studimi në një shkollë të lartë apo universitet gjerman.

Instituti Federal për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (BIBB), ka publikuar një listë të profesioneve dhe pagave përkatëse sesa do të marr personi i cili punon si një praktikant. Udhëzuesi për "Aftësimi profesional në Gjermani", përmban informacione të mëtejshme mbi mbështetjen financiare shtesë që është në dispozicion të të trajnuarve. Pra çdo gjë është e organizuar në mënyrë të atillë për të motivuar të rinjt gjerman për të ndjekur një program në AAP.

Sistemet duale të programeve profesionale zakonisht zgjasin ndërmjet tre dhe pesë vjet. Në shumicën e rasteve, pjesa profesionale është kufizuar në dy vjet për të siguruar se ka kohë të mjaftueshme për pjesën akademike. Këtë lloj shkollimi mund ta marrin vetëm kandidatët që kanë kualifikimin e nevojshëm pranues për universitetet gjermane.

Në Gjermani ekzistojnë shumë zyra kontaktuese, nëpër të cilat të rinjt marrin informacione mbi shkollimet profesionale. Shteti gjerman ka një strategji dhe një

marketing mbi motivimin e të rinjve për pjesmarrje në këto programe të trajnimit profesional.

Këto elemente kanë tendencë për të përforcuar njëra-tjetren. Gjermania bazuar në eksperiencën e saj ka përdorur këto programe të aftësimeve profesionale edhe në vende si Egjipti, Turqia, Meksika, Indi, Tajlandë dhe Vietnami. Elementet kryesore janë krijimi i programeve të trajnimit profesional dhe dispozitat rregullative, mobilizimi i mbështetjes nga qeveritë dhe bizneset e aktorëve kryesore, zhvillimin e shkollave të arsimit profesional dhe qendrave të trajnimit, si dhe trajnimin e trajnerëve. Prototipi i shkollës duale gjermane sot është i përhapur në të gjitha vendet e zhvilluara europiane.

2.8.2 AAP në Austri

Austria është një republikë parlamentare, e bazuar në parimet e demokracisë dhe ndarjes së pushteteve. Ajo përbëhet nga nëntë provinca federale, secila me qeverinë e saj krahinore. Një rol kyç luan partneriteti austriak social, ky është një sistem i bashkëpunimit të politikave ekonomike dhe sociale që përfaqëson interesat e punëdhënësve, punëtorëve dhe përfaqësuesve të Qeverisë. Partneriteti social nuk është i kufizuar për rregullimin e marrëdhënieve të punës (apo atyre industriale) por përfshin të pothuajse të gjitha fushat e politikave ekonomike dhe sociale.

Shkalla e punësimit në Austri është shumë më lart se mesatarja e BE-së, sidomos në grup moshën e 15-24 vjeç (tabela 3).

	ISCED	2003			2006			2012		
		15-24	25-49	50-64	15-24	25-49	50-64	15-24	25-49	50-64
EU-27	0-2	25.1	66.1	41.9	24.6	66.9	43.5	20.6	60.7	43.7
	3-4	47.0	79.1	54.9	48.0	80.3	57.9	43.7	79.3	61.3
	5-6	60.7	88.0	72.4	60.3	88.4	74.1	54.5	86.5	75.7
	n/a	14.9	72.6	39.1	4.8	76.5	5.6	5.6	73.7	65.2
	TOTAL	36.0	77.4	51.5	36.6	79.0	54.4	32.9	77.5	58.6
Austria	0-2	33.9	70.5	33.6	38.1	69.0	39.1	38.0	69.9	40.8
	3-4	67.4	86.1	46.5	68.9	86.1	51.0	69.2	87.5	59.7
	5-6	69.1	91.9	66.3	70.6	91.4	71.5	71.6	91.4	78.0
	TOTAL	50.6	84.5	45.3	54.0	84.3	50.9	54.6	85.9	58.5

Tabela 3. Shkalla e punësimit sipas grup moshave dhe arritja më e lartë arsimore (në %)

Burimi : VET in Europa – Country Report Austria, ReferNet Austria, Cedefop, 2013

Të rinjt me arsim të nivelit ISCED 3-4 në Austri janë të punësuar 69.42% në krahasim me mesataren e të rinjve në vendet e BE 27 që është 43%, për vitin 2012 (Cedefop, 2013). Kjo tregon forcën ekonomike austriake. Nëse shikohen edhe të gjitha kualifikimet e kësaj grup moshe (15-24 vjet) Austria qëndron dukshëm sipër mesatares së vendeve të BE-së , në raport 50.6% kundrejt 36.0%. Sipas një analize të papunësisë bazuar në ndarje sipas grup moshave, të dhënat tregojnë se Austria krenohet me norma më të ulëta të papunësisë në të gjitha kategoritë e moshave, këto janë më të ulta se sa mesatarja e BE-27. Veçanërisht i rëndësishëm është hendeku mes të 15-24 vjeçarëve. Në total në të gjitha nivelet e shkollimit në BE, papunësia është 18.1%, ndërsa në Austri 7.5%. Edhe pse kjo vlerë është përkeqësuar pak në Austri me kalimin e kohës, shkak i krizës globale, ajo është megjithatë qartësisht nën mesataren e BE (VET in Europa – Country Report Austria, ReferNet Austria, Cedefop, 2013).

Sipas Eurostatit, shpenzimet publike në arsim për sektorin e mesëm në Austri në vitin 2005 ishin 5,980.3 milion euro. Matjet me BPV ishin të barabarta me 2.5%, që është

mbi mesataren e BE-25 që rezulton një koficient prej 2.3%. Më shumë fonde janë vënë në dispozicion për arsimin e përgjithshëm se për programet profesionale (1.6% e BPV-së kundrejt 1.0% për AAP-të). Ndërkaq në vitin 2010, këto shpenzime në vendet BE 27 kishin një mesatare prej 5.4% të BPV, ndërsa Austria kishte në shpenzime prej 5.9% të BPV-së për të hyrat në shpenzimet publike dedikuar arsimit.

Numri i 18-24 vjeçarëve të cilët kanë përfunduar vetëm shkollimin e detyrueshëm në Austri është në masën e shprehur në përqindje 7.6% (duke iu referuar vitit 2012), në mënyrë të qartë është nën mesataren e BE që ajo është 12,8%. Kjo do të thotë se Austria ka arritur në pikën e referimi prej maksimum 10% të larguarve të hershme nga shkolla që ishte parashikuar në të gjithë Evropën deri në vitin 2010. Kjo shifër relativisht e ulët i atribuohet gamës së gjerë dhe të diferencuar të programeve të arsimit dhe aftësimit profesional pas arsimimit të detyruar, mbi të gjitha trajnimeve dhe zanateve në sektorin e AAP shkollave.

Në vitin 2011, 85% të të gjithë të diplomuarve të nivelet ISCED 3 dhe 4 në Austri ishin nga programeve të AAP (tabela 4). Prej më shumë se 75% e të diplomuarëve në nivelin ISCED 3, pjesa më e madhe e tyre vjen nga trajnimet e profesionit, nga të cilat 40% e çdo grup moshe në vit dhjetë prej tyre zgjedhin një zanat. Në nivelin ISCED 4, Austria ka 22.6% të diplomuarve në programet e AAP-vë, shifër kjo e cila është tri herë më lartë se mesatarja e vendeve të BE-së që rezulton të jetë 7.3%. Kjo përqindje reflekton për rëndësinë e madhe të shkollave të AAP në nivelin e mesëm të lartë në Austri.

		2005						2011					
		3 GE	3 PPT	3 VET	4 GE	4 PPT	4 VET	3 GE	3 PPT	3 VET	4 GE	4 PPT	4 VET
E	T	38.6	5.5	45.8	0.9	0.0	9.1	42.3	1.2	48.1	1.1	0.0	7.3
A	T	16.0	0.0	54.4	0.0	0.0	29.6	15.0	14.1	48.3	0.0	0.0	22.6

Note: E = EU-24 (2005) respectively EU-26 (2011) (2005: excluding FR, UK and Malta, 2001: excluding UK, as there is no data broken down by education programmes available), A = Austria, T = total, GE = general education, PPT = pre-professional training, VET = vocational education and training 3 = ISCED level 3, 4 = ISCED level 4

Tabela 4. Të diplomuarit në nivelet ISCED 3 dhe 4, sipas programit arsimor (të shprehur në përqindje)

Burimi: Eurostat, retrieved on 5 November 2013

Në mesin e vendeve të OECD Austria ka një nga përmasat më të larta për nxënës në shkollat e mesme në arsimin dhe aftësimin profesional. AAP është jashtëzakonisht i rëndësishëm në Austri. Në përgjithësi rreth 80% e të gjithë nxënësve në vitin e dhjetë (niveli i mesëm i lartë, ISCED 3) marrin pjesë në një program profesional të orientuar (figura 11). Afërsisht 40% përzgjidhin një arsimim respektivisht trajnim të dyfishtë në një kompani dhe me kohë të pjeshme shkollë profesionale, pjesa tjetër zgjedh për një nga shkollat e AAP kolegje (një variant me ose pa kualifikimeve për arsimin e lartë).




Figura 11. Pjesëmarrja e nxënësve në vitin e dhjetë sipas programeve arsimore, viti shkollor 2007/08 (në%)

Burimi : Statistics Austria, ibw calculations

Në Austri, AAP fillon në nivelin e mesëm të lartë dhe është e organizuar si sistem i dyfishtë ose bazuar në shkollë me kohë të plotë. Faktorët arsimor dhe ata relevant kooperojnë bashkërisht që të zhvillojnë një sistem në të cilin kompetenca bazohet në kuptimin e rezultateve të të nxënit dhe ajo mund të përdoret për të rritur transparencën dhe krahasueshmërinë midis sektorëve të ndryshëm. Rezultatet e të mësuarit përfaqësojnë pikënisjen qendrore si për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe sistemin evropian të transferimit të kredive për AAP prej nga merret edhe kualifikimi.

Qeverisja dhe financimi: Sistemi i qeverisjes shkollore austriak konsiderohet joefikase nëse bëhet një krahasim ndërkombëtar. Arsyeja kryesore për këtë pikëpamje është struktura komplekse e shpërndarjes së kompetencave. Reformat e qeverisjes janë vendosur në rrjedhën e zhvillimit të strategjisë që është duke lëvizur drejt debateve progresive në një reforme të përgjithshme administrative. Këto reforma bazuar në modelet që prezantojnë synojnë rritjen e autonomisë së shkollave, kontrollin sistematik të rezultateve, dhe riorganizimin e strukturave administrative.

Përparësitë e sistemit të AAP austriake janë :

- ✓ Sistemi dual ka shumë karakteristika të avansuara, mësimi është mjaft mirë i strukturuar, ku integrohet të mësuarit në shkolla dhe trajnimet kryhen në vendin e punës.
- ✓ Shkalla e papunësisë rinore është e ulët dhe kalimi nga arsimi në punësim e parë është e mbi mesataren e bazuar në standardet ndërkombëtare.

- ✓ Përfshirja e partnerëve social në të gjitha nivelet është fortë mirë e kordinuar, si në hartimin e politikave dhe ofrimin e trajnimeve në AAP, po ashtu edhe mes bashkëpunimit efektiv ndërmjet palëve të ndryshme.
- ✓ Sistemi i AAP-ve plotëson një hapësirë të gjerë të nevojave, duke siguruar rrugë të ndryshme edhe për ata nxënës që me rezultate të dobëta shkollore ose me prejardhje të pafavorizuara, si dhe duke ofruar programe kolegji pesë vjeçare, të cilat ofrojnë trajnime teknike të nivelit të lartë.
- ✓ Sistemi i AAP-ve ofron rrugë të ndryshme të progresit në nivele të ndryshme, duke lidhur këtë shkollim me arsimin e lartë përmes Berufsreifeprüfung (Baccalaureate profesional).
- ✓ Mësimdhënësit dhe fuqia tjetër ndihmëse punëtore në shkollat e AAP duhet të kenë të përgatitje të lartë dhe të kanë përvoja e tyre në industri, një gjë e tillë është e detyrueshme. Shumë shkolla kanë marrëveshje fleksibël, me mësuesit që punojnë me kohë të pjesshme në industri. Reformat e fundit kanë ndryshuar kërkesat për mësimdhënësit e AAP por efektet ende nuk janë të dukshme.
- ✓ Shkalla e përfundimit të arsimit të mesëm në Austri janë të larta krahasuar me standardet ndërkombëtare.

Sa i përket licencimit, kompanitë apo firmat ushtrimore respektivisht trajnuese duhet të marrin një licencë nga Zyra për praktikantë në nivel shtetëror e njohur si Lehrlingsstelle (shqip: zyrë mësimi). Nëse ata nuk mund të përmbushin standarde të caktuara (si për shembull disa nga faktorët mund të janë: ato mund të janë shumë të vogla apo edhe shumë të specializuara për të siguruar praktikantët e tyre me trajnim gjithëpërfshirës), ato mund të formojnë aleanca të trajnimit të njohur si

Ausbildungsverbände (shqip: rrjetet e trajnimeve) për të ndarë praktikantët me kompanitë tjera të licencuara. Në vitin shkollor 2005-06 në Austri ka filluar një iniciativë mbi kontrollimin e cilësisë mësimore (Qualitätsinitiative Berufsbildung, QIBB) me qëllim të nxitjes së menaxhimit më të larë dhe më kualitativ në këto nivel shkollorë.

Një shkollë austriako-shqiptare e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është hapur edhe në Tiranë, pranë Fshatit të Fëmijëve “SOS”, e cila mban emrin e themeluesit të fshatrave SOS, Herman Gmeiner. Kryeministri shqiptar Edi Rama kishte thënë :

“Shkolla që ne përgëzojmë sot është një shkollë, që ofron një diplomë të vlefshme në Shqipëri dhe në Austri. Ne po bëjmë një kthesë të vendosur, edhe pse duhet të rrisim shpejtësinë e marrjes së kësaj kthesë nga sistemi arsimor i ndërtuar vetëm me atë korsinë e rrëmujshme të futjes së të gjithëve në universitet tek sistemi arsimor i ndërtuar me dy korsi, një korsi për arsimin e lartë dhe një korsi për sistemin profesional.” (news, 2014)

Ndërkaq ministri i asaj kohe (tash kryetari i bashkisë Tiranës) z.Erion Velijaj me rastin e inspektimit të kësaj shkolle elitare profesionale kishte thënë :

“Kjo shkollë e re është një përvojë e mirë e bashkëpunimit austriako-shqiptar në çështjet e arsimit profesional. Duke filluar nga data 1 shtator, ftojmë të gjithë ata prindër që duan të regjistrojnë fëmijët e tyre në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Jam shpresëplotë se një Steve Jobs apo Bill Gates shqiptar do mund të lindë këtu një ditë”. (tema, 2014)

2.8.3 AAP në Zvicër

Sot në Zvicër, shkollimi apo edhe investimi për një shkollim sa më adekuat, zë një vend mëse të rëndësishëm në jetën e pothuajse secilit prind, apo edhe nxënës dhe është një ndër prioritetet e qeverisë zvicerriane. Një ndër mundësitë e shumta të shkollimit në Zvicër është edhe shkollimi profesional, apo siç njihet më shumë edhe si shkollimi i zanatit.

Dy të tretat e të rinjve në Zvicër, përcaktohen për një shkollim bazë profesional apo zanat, me të cilin ata aftësohen për një profesion të caktuar. Mundësia për këtë nivle të arsimit ofrohet për rreth 230 profesione të ndryshme.

Mbi 75.000 të rinj në Zvicër e ndjekin çdo vit të ri shkollor shkollimin profesional. Ky shkollim është një punë e përbashkët e institucioneve arsimore shtetërore, kantoneve si dhe kompanive apo organizatave të punës. Arsimi profesional është i dalluar gjithmonë për nga suksesi dhe sjellja nga ana e nxënësëve zvicerian, ata pas mbarimit të shkollimit të obligueshëm e pas konsultave me njerëz të profesioneve të ndryshme, përcaktohen për të ndjekë një zanat, mbi të cilin ata ndërtojnë karrierën e tyre. Të gjitha këto struktura së bashku janë të përkushtuara për një shkollim mjaft kualitativ si dhe për dhënien e mundësive më të mëdha sa i përket zgjedhjes së profesioneve për të rinjt zvicerian apo edhe atyre që jetojnë në këtë shtet të zhvilluar europian.

Shkollimi profesional zakonisht ndiqet për tre vite. Gjatë këtyre viteve, të rinjt pos njohurive më të thella rreth profesionit, pajisen edhe me dituri të përgjithshme që nevojiten të punën e përditshme.

Shkollimi profesional përbëhet nga pjesa teorike dhe ajo praktike, dhe varësisht nga viti i shkollimit dhe profili përkatës, nxënësit kanë 3-4 ditë punë praktike, ndërsa 1-2 ditë shkollë.

Edukimi në shkollën e mesme të lartë në Zvicër nuk është i detyrueshëm dhe është i ndarë në dy grupe: arsimin e përgjithshëm dhe atë profesional. 90% e nxënësve në Zvicër diplomojnë në këtë nivel të edukimit. Një e treta e nxënësve shkojnë në një shkollë të maturës që quhet “Gjimnaz”. Shumica e nxënësve marrin mësim dhe aftësim profesional.

Shkollat e maturës apo gjimnazet janë të rregulluara bashkërisht nga autoritetet kantonale dhe federale, por autoritetet kantonale vendosin shpesh kërkesat e pranimit. Nxënësit me nota të jashtëzakonshme (të larta) nga shkolla e mesme e ulët mund të

pranohen në një shkollë të maturës, pa hyrë në provim pranues në disa raste. Përndryshe një provim pranues është një komponent kyç për të përcaktuar nëse një nxënës mund të studiojë në një shkollë të tillë. Nxënësit duhet të bëjnë një lloj të temës (punë diplome), si dhe të kalojnë një seri të provimeve gjatë shkollimit të tyre dhe nëse i përfundojnë me sukses, si rezultat ata marrin një certifikatë të maturës e cila ju lejon pranimin në universitetet kantonale dhe institutet federale të teknologjisë. Analiza të caktuara aplikohen, për shembull, nëse një nxënës frengjisht-folës dëshiron të studiojë mjekësi në një rajon gjermano-folës.

Shkollat e detyrueshme profesionale bazuar në legjislacionin zvicerian (ndërkantonal apo kombëtar) formojnë bazën për llojin e arsimit në fushën e arsimit të detyrueshëm (niveli i mesëm i lartë dhe të nivelit terciar). Kantonet janë përgjegjëse për zbatimin e këtij legjislacioni dhe janë përgjegjës për organizimin e shkollave. Të vetmet përjashtime janë institutet federale zvicerane të teknologjisë, të cilat janë nën kompetencat e autoriteteve federale. Në Zvicër 90% e të rinjve përfundojnë arsimin e mesëm të lartë në moshën 18 ose 19 vjeçare, moshë kjo e cila u lejon atyre të fillojnë të punojë, apo për të kaluar në një kolegji të trajnimit të lartë profesional ose gjimnaz, për të vazhduar më tutje me arsimin e tyre në një universitet publik ose një universitet të shkencave të aplikuara. Në vijim disa tiparet të veçanta të sistemit arsimor zvicerian:

- ✓ Ka shumë mënyra për të depërtuar respektivisht hyrë ose bërë transferim në një program trajnimi apo në shkollë për të marrë pjesë në një program trajnimi.
- ✓ Ka qasje të hapur për llojet e ndryshme të arsimit: Kushdo që ka kualifikimet e nevojshme në përgjithësi mund të marrë pjesë në kursin e zgjedhjes së profesionit, pjesëmarrja në universitet është sipas dëshirës. Arsimi dhe aftësimi profesional

është subjekt i disa kufizimeve për shkak të numrit të madh të studentëve për fusha të caktuara profesionale.

- ✓ Qasja në shkollat mjekësore është e kufizuar, regjistrimi i nxënësve bëhet në një masë të caktuar.
- ✓ Diplomat janë të njohura në të gjithë Zvicrën, duke lehtësuar lëvizjen kombëtare dhe ndërkombëtare (Gjiganti, 2016)

Në Zvicër shumica e adoleshentëve fillojnë aftësimin profesional pas arsimit të mesëm të ulët. Karaktëritika zviceriane është se shumë kualifikime profesionale mirren në arsimin e mesëm, ndërsa në vende të tjera të njëjtat kualifikimet mirren në nivelin e arsimit terciar. Sistemi zviceran dual i AAP ka programe profesionale që ndryshojnë nga shumica e sistemeve të vendeve tjera europiane të arsimit dhe formimit profesional. AAP është kryesisht i bazuar në një sistem të dyfishtë: të trajnimit praktik në tri apo katër ditë (në varësi nga profili) në një kompani trajnimi dhe që plotësohet nga klasa teorike (profesionale dhe lëndët e përgjithshme mësimore) në një ose dy ditë në shkollë të AAP. Përveç kësaj, nxënësit e AAP marrin pjesë në kurset ndër-kompani, në të cilat ata rrisin aftësitë praktike profesionale. AAP gjithashtu mund të përfundojë me një shkollë profesionale me kohë të plotë. Në pjesët frengo-folëse dhe italiane-folëse të Zvicrës, përqindja e shkollave profesionale me kohë të plotë është më e lartë se në pjesën gjermano-folëse të saj.

Nxënësit që kanë përfunduar arsimin e mesëm të ulët dhe kanë mbushur moshën 14 vjeç mund të aplikojnë për një mësim në një kompani të trajnimit ose të regjistrohen në një shkollë profesionale me kohë të plotë. Kushtet e studimit janë të tilla që në disa raste është e nevojshme që kandidatët të kalojnë provimin pranues. Kompanitë e trajnimeve vendosin për procedurën e përzgjedhjes dhe formën e organizimit të provimit. Në

përgjithësi, kriteret për zgjedhjen e një nxënësi të AAP-së përfshijnë performancën e nxënësit në arsimin e mesëm të ulët, dokumentet e aplikimit dhe një intervistë. Kompani të ndryshme të trajnimit të kërkojnë aplikuesit të kalojnë një test të aftësisë.

Në Zvicër është një procedurë e cila parashikon instruksione për të rinjt për ti këshilluar që ngiten profesionalisht për të hyrë në tregun e punës, (hyrja e të cilëve në botën e punës është rrezikuar në masë të madhe kohëve të fundit për disa arsye si: kriza globale, numri i madh i refurgjatëve, teknologjia e avansuar etj,) që njihet si menaxhimi i rasteve gjegjësisht si zyra për këshillim dhe shoqërim. Menaxhimi i rasteve identifikon të “rinjt e pambrojtur” (adolishentët) në një fazë të hershme, dhe i mbështet ata në një proces të koordinuar dhe mirë të strukturuar. Gjatë kalimit nga arsimi i detyruar në arsimin e mesëm të lartë, ajo i këshillon ata për të zgjedhur karrierën, respektivisht i monitoron gjatë zgjedhjes së profesionit dhe vendit të duhur për kualifikim profesional, pasi që ekzistojnë gjithmon mjaft pikëpyetje, dilema dhe vështirësi të llojeve të ndryshme rreth zgjedhjes së profesionit. Një organ qendror për menaxhimin e rasteve shkon përtej kufijve institucionalë e që ka një qëllim. Qëllimi i arsimit profesional të menaxhimit të rasteve dhe përvetsimit të trajnimeve është për të parandaluar të rinjt të mos largohen nga sistemi arsimor, përkatësisht, për t'i bërë ata të marrin provimin e shkollimit të detyrueshëm dhe për integrimin e tyre në procesin e punës. Këshillim e shoqërim, arsimim dhe ndërmjetësim vlen për të gjithë të rinjt mes 16 dhe 22 vjeç, të cilët nuk gjejnë vend pune për kualifikim, që e kanë ndërprerë kualifikimin e tyre dhe nuk janë lajmëruar si të papunë d.m. th kjo zyrë ofron këtë mundësi. Kantonet e bëjnë zbatimin e menaxhimit të rasteve. Konfederata, organizatat profesionale dhe institucione të tjera i mbështetin në çdo aspekt kantonet. Kantoni përpiqet vazhdimisht që të rinjve t’iu sigurojë pas përfundimit të kohës së arsimit të detyruar mundësi për përgatitje të

mëtejme profesionale. Një përgatitje e suksesshme profesionale është parakusht i domosdoshëm për një fillim të mbarë të jetës profesionale.

Një punëdhënës i një firme ku kryhen trajnimet aftësuese të zanatit mund të përfitojë benificione në së paku tri mënyra nëse ofron kurset e zanatit :

1. Nëse praktikantët punojnë me kohë të pjesshme për një firmë ushtrimore, vlera produktive e kontributit të tyre mund të kompensojë shpenzimet e firmës, si për shembull kostot e materialeve dhe infrastrukturës dhe pagat për nxënësit respektivisht praktikantët dhe instruktorët.
2. Firma mund të shfytëzojë kursin trajnues si një mundësi për të identifikuar praktikantët më të talentuar dhe më të motivuar për punë. Edhe pse kontrata e mësimit aftësues përfundon deri me të përfunduar trajnimi, firma gjithmonë ka mundësi që të ofrojë një kontratë pune për individët më të aftë, gjithmon duke u bazuar në njohuritë superiore dhe aftësive që tregon praktikanti gjatë trajnimit profesional. Kjo është një përparësi shumë e madhe pasi që ky praktikant nuk është në dispozicion për firma të tjera, dhe në këtë mënyrë ajo (kompania) do të shmang mospërputhjet kushtueshme për përgatitjen e një punëtori të ri me mjete vetanake.
3. Së treti, një firmë mund të trajnojë praktikantët në lidhje me kërkesat e saj specifike të aftësive. Një avantazh shumë i rëndësishëm në kohën kur ka mungesa të mëdha të punëtorëve të kualifikuar për një profesion specifik në shumë industri punuese, kjo është një arsye që e bënë më të vështirë për të plotësuar vendet e lira me punëtorët të formuar nga tregu i jashtëm i fuqisë punëtore.

Një punëtor i cili mirret nga tregu aftësues i jashtëm akoma ka nevojë për një period kohe për të fituar aftësi të veçanta dhe për tu përshtatur në një kompani. Në shumë raste, kostot e punësimit nga firmat tjera trajnuese apo nga tregu i jashtëm i punës janë dukshëm më të larta se investimet potenciale neto lidhur me trajnimin e një nxënësi apo praktikanti. Megjithatë, rëndësia relative e tre llojet të përfitimeve nga të afruarit e trajnimit të zanatit ndryshon nëpër firma, sektorë, profesione, dhe madje edhe kantoni në kanton në gjithë Zvicëren.

AAP mundëson të rinjt të hyjnë në tregun e punës dhe siguron shtetin helvetik se ka specialistë të mjaftueshme dhe menaxherët në të ardhmen. AAP është përshtatur për tregun e punës dhe është pjesë e pandashme e sistemit arsimor zvicerian.

Pasqyra kryesore të AAP në Zvicër janë si në vijim :

- ✓ Nxënës në vitin e fundit të shkollimit të mesëm të ulët 88,200
- ✓ Nxënës të rinj që regjistrohen në programet e AAP 82,000
- ✓ Numri i përgjithshëm i nxënësve të AAP 222,600
- ✓ Të diplomuarit në AAP programet 65,600
- ✓ Të diplomuarit në programet Edukimit dhe Trajnimit Profesional ETP 27,500




Figura 12. Nxënësit që hyjnë në nivelin e mësimit të mesëm të lartë

Burimi: Facts and Figuras, Vocational And Professional Education And Training In Switzerland, 2011

Programet ETP janë programe të bazuara në një kurrikul bërthamë nga kolegjet PET. Në përgjithësi, programet e ETP-së janë trajnime me kohë zgjatje për dy vjet (me kohë të plotë) ose tre vjet (me kohë të pjesshme) dhe mundësojnë për të dërguar në një shkollë të njohur federale kolegjet PET në Zvicër.

Struktura organizative e shkollimit në këtë shtet është e paraqitur në figurën 13 në vijim.




Figura 13. Struktura organizative e shkollimit në Zvicër

Burimi: Facts and Figuras, Vocational And Professional Education And Training In Switzerland, 2011

Rreth 30% e kompanive në Zvicër të marrin pjesë në programet e AAP-së. Kompanitë që ofrojnë trajnime profesionale nxjerrin një përfitim të prekshëm nga mësimi dhe nga përgatitja e kandidatëve që ato ofrojnë . Këto kompani kanë një ndikim mjaft të lartë pozitiv në kërkesën e tregut të punës, që në mënyrë horizontale edhe zvoglojnë dukshëm numrin e papunësisë në vend dhe ndihmojnë zhvillimin ekonomik të shtetit.

Zvicra si një ndër shtet më të fuqishme ekonomike edhe pse ka kushte të kufizuara të zhvillimit ekonomik (Alpet zënë pjesën më të madhe të territorit)

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Zvicra>

dhe me një standard të lartë të jetës, ajo ka të ardhurat nacionale të përgjithshme për kokë të banorit, me 44.350 dollarë, është pas Luksemburgut në vendin e dytë në botë. Ky shtet me 7.9 million banor në 2010 është befasuese fakti se si ka arritur një zhvillim të tillë në një ambient jo aq të volitshëm. Pa dyshim, faktorët shoqërorë janë ata më esenciale të cilët kanë ndikuar në transformimin e rrethit gjeografik. Nëpërmjet kuadrit kualifikues të punëtorëve Zvicra ka mundur të zhvilloi industrinë precize që nuk ka pretendime të mëdha në lëndët e para. Me ndërtimin e rrugëve, tuneleve, urave, hoteleve, vendet për pushime rekreacion, çdo pjesë e saj, pa marrë parasysh lartësinë, është ndër vendet më të vizituara në Europë. Ky zhvillim është një pasojë pozitive e një investimi mjaftë të madh në shpenzime publike për shkollim. Vetëm në shkollat AAP në vitin 2011 ka shpenzuar 2.480 milion franga zvicerriane (CHF). Në kurset industriale 118 milion CHF, 235 milion CHF janë shpenzuar për përgatitjen për regjistrim në AAP dhe 106 milion të tjerë për procedurat e kualifikime (figura 14). Pra marketingu për të ndjekur një shkollim profesional ka mbështje të lartë shtetërore dhe bazohet në veprimet konkrete dhe ka një stabilitet të theksuar arsimor profesional.

Public expenditure for VET/PET system in 2011¹⁴




Figura 14. Shpenzimet publike për AAP/ETP në Zvicër 2011

Burimi: Facts and Figuras, Vocational And Professional Education And Training In Switzerland, 2013

KAPITULLI 3 – ARSIMI PROFESIONAL NË KOSOVË DHE MOTIVIMI I TË RINJVE QË TË NDJEKIN AAP

3.1 Hyrje

Ligji për arsimin e lartë thotë se krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane si dhe potencon rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës (MASHT, 2007).

Por këto standarte janë me zbrastësira të paplotësuara nëpër shkollat tona, janë ato obligime apo detyrime të cilat shkolla presupozohet se duhet ti kishte në qendër të fokusit saj por që praktikisht nuk i kryen ato, pra funksionet e munguara ose i kryen në mënyrë të pjesëshme ose janë funksione gjysmake që në esencë vështirë se mund të krijojnë tërësinë. Funksionet e tilla të paplotësuara karakterizojnë shkollat në të gjitha vendet, madje edhe në ato të zhvilluara e të industrializuara. Ndër funksionet më të dallueshme të munguara të shkollave tona mund të përmendim: lidhja e kufizuar e shkollimit me tregun e punës dhe ekonominë, sistemi jo shumë konkurrues i pranimit në shkollimin e lartë, mungesa e sinergjisë midis arsimit dhe formimit profesional, mungesa e unitetit midis pregtitjes së nxënësve dhe studentëve si specialist dhe qytetarë të denjë për ushtrimin e veprimtarive për të cilat marrin diplomatë (Kasapi, 2016). Lidhja e kufizuar me tregun e punës dhe ekonominë është një mangësi e dukshme dhe prekshme e shkollës së sotme në Kosovë.

Misioni i shkollës është pajisja e nxënësve dhe studenteve me njohuri teorike dhe shprehi praktik, sipas MASHT-IT. Nxënësit i përdorin njohuritë e fituara për të vazhduar ciklet e mëtejshme të shkollimit ose për të hyrë në tregun e punës, nëpërmjet

profesionit për të cilin përgatiten. Por shpesh ndodhë që disa të orientohen me vështirësi në profesionin dhe punën e filluar rishtas. Ata ndjejnë se diçka u mungon. Sfidat e punës në mjaft raste u duket e huaj dhe ambientohen me vështirësi në proceset e punës dhe të fshehtat reale të profesionit.

Shpesh ndodh që shkollat tona lënë mangësi mjaft elemente të lidhjes me praktikën, proceset e prodhimit, të administrimit e drejtimit të punës. E njëjta ndodhë edhe me studentët e sapo diplomuar. Ata ngjajnë si nxënës para kolegeve të tyre më të vjetër të cilët janë mjeshtër me përvojë shumëvjeçare në punë e profesion, ndjehen të pakënaqur me punën dhe profesionin, ambientohen me vështirësi me proceset e drejtimit, administrimit të burimeve njerëzore. Kjo zbulon se shkollat ku kanë studiuar nuk kanë mundur të harmonizojnë njohuritë teorike me shprehitë praktike. Për të shmangur këtë kufizim, në shkollat e larta ose në shkollat e mesme tekniko-profesionale duhet sa më shumë të organizohen seanca njohjeje dhe ambientimi me praktikën, kjo d.m.th. që mësimi të jetë dual, gjegjësisht praktik e teorik.

Mungesa e lidhjes midis arsimit dhe formimit profesional është një dobësi e sistemit të arsimit dhe edukimit në Kosovë. Arsimi dhe formimi profesional janë dy aspekte të një procesi: përgatitjes së të rinjve me shprehi teknike, profesionale e praktike. Prandaj duhet ndërmarr një proces reformimi në arsimin e mesëm dhe atë të lartë.

3.2 Nivelet e sistemit të arsimit në Kosovë

Historia e arsimit në Kosovë ndahet në tri periudha: Periudha e parë fillon me hapjen e shkollave fillore anembanë Kosovës para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Arritjen më të madhe në këtë periudhë e paraqet themelimi i Universitetit të Prishtinës dhe hapja

e Bibliotekës Universitare të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe arsimit zhvillohej në tri gjuhë: shqipe, serbokroate dhe turke (Wikipedia, 2014).

Periudha e dytë fillon rreth vitit 1991 dhe paraqet reagim ndaj rrënimit të dhunshëm të sistemit arsimor nga ana e politikës represive serbe. Si rezultat i kësaj, ngrihet një sistem i pavarur arsimor, që realizohej në 452 shkolla të plota fillore, 67 shkolla të mesme, 1 universitet me 14 fakultete dhe 7 shkolla të larta, me afro 400.000 nxënës e studentë dhe me 21.000 punëtorë të arsimit. Financimi i këtij sistemi bëhej nga puna vullnetare dhe ndihmat që i jepnin diaspora dhe popullata shqiptare, të cilët këtë sistem e shihnin si hapin e parë të pavarësisë së Kosovës (Wikipedia, 2014).

Periudha e tretë, që fillon me përfundimin e luftës në vitin 1999 e këndej, karakterizohet me reformat që i bëhen arsimit në të gjitha nivelet: nga arsimit dhe edukimi parashkollor e deri në universitet, të cilat kishin për synim përshtatjen e arsimit në Kosovë standardeve bashkëkohore evropiane e botërore. Gjatë kësaj periudhe fillon të zhvillohet edhe sistemi privat i arsimit. Si hap i parë i këtij sistemi merret themelimi i Departamentit të Arsimit dhe Shkencës (DASH), që përcillet me krijimin e infrastrukturës ligjore dhe profesionale, e cila duhet të letësojë reformimin rrënjësor të arsimit (sistemi 5+4+3-4 në arsimin e përgjithshëm dhe në atë profesional dhe Marrëveshja e Bolonjës në arsimin e lartë), si dhe me themelimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në mars të vitit 2002 (Wikipedia, 2014).

Nivelet e sistemit të arsimit në Kosovë janë të klasifikuara në kategoritë e Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit 97- SNKA apo ISCED 97.

Mësimi fillor në Kosovë zhvillohet në pesë gjuhë: gjuhë shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe kroate dhe është i obligueshëm dhe falas në shkollat publike për të gjithë qytetarët.

Së fundmi, qeveria e Kosovës ka shpaluar planet për ngritjen e shkollim të mesëm në

nivel obligativ, sipas aftësive dhe suksesit të treguar, nxënësit ndjekin shkollimin e mesëm në gjimnaze e përgjithshme dhe të profilizuara po ashtu edhe në shkolla profesionale. Reformimi i sistemit arsimor është prioritet qeveritar, megjithëse mungesa e fondeve, lehtësimeve teknologjike dhe e përgatitjes profesionale të mësimit nxënësve, si dhe numri të madh të nxënësve për klasë, pengojnë arsimin efektiv në Kosovë.

Nivelet sipas SNKA¹	Struktura e arsimit të Kosovës	Moshat
	Arsimimi i të rriturve/Arsimimi gjatë tërë jetës në shkallë të gjerë (formal dhe joformal)	23/24+
SNKA 6	Arsimi pasuniversitar	23/24+
SNKA 5	Arsimi universitar ²	
SNKA 4	Arsimi passekondar jouniversitar	18 +
SNKA 3	Arsimi i mesëm i lartë Klasat X-XII	15-17
SNKA 2	Arsimi i mesëm i ulët Klasat VI-IX	11-14
SNKA 1	Arsimi fillor Klasat I-V	6-10
SNKA 0	Klasa parafillore	5-6
	Arsimi parashkollor	lindje-5

Tabela 5.Përshkrimi i niveleve të sistemit të arsimit në Kosovë

Burimi: http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Statistikat_e_Arsimit_ne_Kosove

Gjatë niveleve formale të shkollimit, nxënësit në mënyrë koherente përgatiten për mësim gjatë tërë jetës dhe për botën e punës në epokën e dijes të bazuar në digjitalizim.

Krahasuar me Kornizën e Kualifikimeve, Korniza e Kurrikulës u referohet vetëm 4 niveleve formale të arsimit dhe 5 niveleve të kualifikimeve. Me këtë ofrohet një bazë e mirë, një platformë e cila në të njëjtën kohë është dritare e hapur drejt arsimimit gjatë tërë jetës dhe arsimimit të të rriturve. Prandaj, në të gjitha shkallët e Kurrikulës dhe në të gjitha fushat e Kurrikulës do të theksohen mundësitë që u ofrohen nxënësve për të

arritur kualifikimet kombëtare të bazuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve. (fq 27)

Sistemi Ndër. i Klasifikimit	Nivelet e sistemit formal të arsimit	Shkallët e Kurrikulës
SNKA 3	Arsimi i mesëm i lartë Klasa XII	Shkalla e Kurrikulës 6: Konsolidim dhe specializim
	Arsimi i mesëm i lartë Klasat X-XI	Shkalla e Kurrikulës 5: Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional
SNKA 2	Arsimi i mesëm i ulët Klasat VIII-IX	Shkalla e Kurrikulës 4: Përforsim dhe orientim
	Arsimi i mesëm i ulët Klasat VI-VII	Shkalla e Kurrikulës 3: Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim
SNKA 1	Arsimi fillor, Klasat III-V	Shkalla e Kurrikulës 2: Përforsim dhe zhvillim
	Arsimi fillor, Klasat I-II	
SNKA 0	Klasa parafilllore	Shkalla e Kurrikulës 1: Përvetësim themelor
	Mosha 0-5	
		Shkalla përgatitore e Kurrikulës: Edukimi në fëmijërinë e hershme

Tabela 6.Përshkrimi i niveleve të sistemit të arsimit në Kosovë sipas shkallës kurrikulare

Burimi : <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/korniza-e-kurrikules11.pdf>

Korniza e Kurrikulës është e strukturuar sipas gjashtë shkallëve të Kurrikulës, të cilat paraqesin periudha me karakteristika të përbashkëta për sa i përket zhvillimit të fëmijëve dhe kërkesave të Kurrikulës. Ato paraqesin pikën referuese për përcaktimin e kompetencave kryesore që duhen zotëruar, kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e përvojave mësimore, qasjen dhe kriteret e vlerësimit si dhe institucionin përgjegjës për arritjen e tyre. Shkalla e 5-të e Kurrikulës ka të bëjë me zhvillimin themelor dhe profesional të nxënësit , ndërsa shkalla e 6-të nënkupton konsolidim dhe specializim . Këto dy shkallët i takojnë sistemit SNKA 3 të kualifikimit përkatësisht nivelit të mesëm të lartë të arsimit nga klasat e dhjeta deri tek dymbëdhjetat.

3.2.1 Arsimi parashkollor/parafillor

Niveli i arsimit parashkollor/parafillor paraqet nivelin zero sipas SNKA-së, të cilin e ndjekin fëmijët e grupmoshave prej 0 deri në 6 vjeç, të ndarë në grupe, varësisht nga mosha.

Grupmoshat prej 0 deri në 5 vjeç i takojnë edukimit parashkollor, ndërsa grupmoshat 5-6 vjeç i takojnë edukimit parafillor. Edukimi parafillor organizohet në institucionet e edukimit parashkollor, në çerdhe dhe në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta. Ky edukimit funksionon me institucione publike dhe jopublike (të licencuara).

3.2.2 Arsimi i detyruar

Arsimi i detyruar paraqet nivelet një dhe dy sipas SNKA-së. Arsimi fillor klasifikohet si niveli 1 (klasat 1-5) dhe niveli 2 është arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9), duke përfshirë grupmoshat prej 6-15 vjeç. Arsimi i detyruar në nivel vendi funksionon në shkolla publike dhe jopublike (të licencuara).

3.2.2.1 Niveli i arsimit fillor

Niveli i arsimit fillor zgjat 5 vjet, duke filluar nga klasa e parë deri në klasën e pestë (1-5). Në këtë nivel regjistrohen fëmijët që mbushin moshën 6 vjeçare. Grupmosha e nxënësve në këtë nivel është nga 6 deri në 10 vjeç, duke përjashtuar ata që e përsërisin klasën dhe nxënësit me aftësi të kufizuara. Vlerësimi i nxënësve bëhet me nota, të cilat evidencohen në regjistër të klasës apo paraleles, respektivisht ditari i klasës. Sistemi i notave shkon nga një (1) deri në pesë (5), ndërsa nota më e ulët kaluese është mjaftueshëm (2). Sipas Ligjit të arsimit parauniversitar nxënësit e këtij niveli kalojnë nivelin pa mbetje prej klasës në klasë (nuk përsërisin klasën), duke mos llogaritur rastet

kur prindi shpreh vullnetin që fëmija ta përsërisë klasën edhe një vit, për shkak të ngeçjes. Procesi mësimor zhvillohet sipas planit mësimor. Plani mësimor përmban lëndët dhe ngarkesën e orëve për secilën lëndë, e që janë të njëjta në gjithë vendin. Me këtë plan nuk punon minoriteti serb në veri të Kosovës, as ai goran në Gorë/Dragash. Lënda “Gjuhë e huaj” fillon në klasën e tretë dhe si gjuhë e huaj mësohet gjuha angleze. Përveç vlerësimit për përparimin në mësim, bëhet edhe vlerësimi në sjelljen e nxënësit. Vlerësimi i plotë i nxënësit evidencohet në regjistër, në amzën e shkollës dhe në dëftesë. Dëftesa përbën dokumentin përfundimtar të mbarimit të ciklit dhe është dokumenti që mundëson regjistrimin në klasën pasardhëse, gjegjësisht në nivelin e dytë të arsimit të detyruar.

3.2.2.2 *Niveli i arsimit të mesëm të ulët*

Niveli i mesëm i ulët shtrihet nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë (6-9). Grup moshë e nxënësve në këtë nivel është nga 11 deri në 14 vjeç, duke mos llogaritur ata që përsërisin klasën dhe nxënësit me aftësi të kufizuara. Edhe këtu vlerësimi i nxënësve bëhet sikurse në nivelin fillor me sistem të notimit. Në këtë nivel nxënësit mund të vlerësohen edhe me nota të pamjaftueshme (1), çka nënkupton se nëse nxënësit në fund të gjysmëvjetorit të dytë i mbesin katër nota të pamjaftueshme, ai e përsërit vitin shkollor. Ndërsa, nëse mbetet me një deri tri nota të pamjaftueshme i nënshtrohet riprovimit, i cili organizohet në dy afate: në afatin e qershorit dhe në atë të gushtit. Edhe pas nënshtimit në provime, nëse nxënësi nuk ka treguar sukses pozitiv, ai mund ta përsëritë klasën, qoftë edhe me një notë të pamjaftueshme. Në fund të klasës së nëntë (9) nxënësit, pasi t'i nënshtrohen testit të arritshmërisë, pajisen me dëftesë, e që është dokumenti përfundimtar i mbarimit të arsimit të detyruar dhe që mundëson regjistrimin në arsimin e mesëm të lartë. Testi i arritshmërisë ka kuotizim por jo kriter për rezultat

kalues. Vlerësimi i plotë i nxënësit evidencohet në regjistër, në librin e amzës të shkollës dhe në dëftesë. Procesi mësimor zhvillohet sipas planit mësimor të paraparë nga MASHT-i. Plani mësimor përmban lëndët dhe ngarkesën e orëve për secilën lëndë, e që janë të njëjta në gjithë vendin. Edhe në këtë nivel komuniteti serb dhe ai goran nuk i përmbahen planeve mësimore të MASHT-it. Edhe këtu lënda “Gjuhë e huaj” nënkupton gjuhën angleze.

3.2.3 *Niveli i arsimit të mesëm të lartë*

Arsimi i mesëm i lartë paraqet nivelin tre (3) sipas SNKA-së dhe funksionon në shkolla të mesme publike dhe jopublike (të licencuara). Në bazë të synimeve dhe përmbajtjes këto shkolla janë të organizuara në gjimnaze dhe në shkolla profesionale. Shkollat e mesme të larta (gjimnazet dhe shkollat profesionale) janë shkolla të profilizuara. Gjimnazet ndahen sipas drejtimeve në: shoqërore, të përgjithshme, të shkencave natyrore, matematikë-informatikë dhe të gjuhëve. Afati i studimit në këto shkolla zgjat 3 vjet. Edhe shkollat e mesme profesionale ndahen sipas drejtimeve në: teknike, bujqësore, ekonomike, të mjekësisë, të muzikës, të tregtisë, teologjike, të artit dhe në qendra të kompetencës. Afati i studimit në këto shkolla zgjat 3 vjet. Në të gjitha shkollat e mesme, gjimnaze apo profesionale, zhvillohen disa lëndë të përgjithshme, me synim formimin e përgjithshëm të nxënësit, si: gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, histori, gjeografi, matematikë, fizikë, kimi, biologji, edukatë fizike etj . Shkalla e përfitimit të njohurive ose vlerësimi të nxënësve edhe këtu bëhet me sistem të notimit nga 1 deri në 5. Edhe këtu nxënësit mund të vlerësohen edhe me nota të pamjaftueshme (1), çka nënkupton se nëse nxënësit në fund të gjysmëvjetorit të dytë i mbesin tri nota të pamjaftueshme, ai e përsërit vitin shkollor. Ndërsa, nëse mbetet me një deri dy nota të pamjaftueshme i nënshtrohet provimit klasor, i cili organizohet në dy afate: në afatin e qershorit dhe në

atë të gushtit. Edhe pas nënshtrimit në provime, nëse nxënësi nuk ka treguar sukses pozitiv, ai mund ta përsëritë klasën, qoftë edhe me një notë të pamjaftueshme. Në mbarim të vitit të fundit nxënësit i nënshtrohen provimit shtetëror të maturës. Edhe ky vlerësim evidencohet në regjistër dhe në librin e amzës të shkollës. Për të kaluar provimin shtetëror të maturës duhet arritshmëri 50% e pikëve, gjegjësisht 100 pikë nga 200 sa është formati sot. Provimi mbahet në dy ditë. Dita e parë lëndët si gjuha shqipe, gjuha angleze dhe matematika, ndërsa në ditën e dytë janë lëndët e profesionit. Pas kësaj nxënësit fitojnë të drejtën të konkurojnë në studimet universitare, të cilat janë publike dhe private (të licencuara). Prej 116 shkollave, mësimi në gjuhën shqipe zhvillohet në 101 ose 87.0 % , në gjuhën boshnjake 1 ose 0.9 % , në gjuhën turke 1 ose 0.9 % , ndërsa në 13 ose 11.2 % të shkollave mësimi zhvillohet në më shumë se një gjuhë.

3.3 Shënime statistike mbi arsimin në Kosovë

3.3.1 Numri i nxënësve në nivele e arsimimit në Kosovë

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare, nëse këto të dhëna të viti shkollor 2013/2014 i krahasojme me ato të viti shkollor 2018/2019 ka ndryshime në të gjitha nivelet e arsimimit. Tek niveli i mesëm i lartë, nivel ky që është edhe cak i punimit shkencor, shihet ka dukshëm fluks më të vogël të nxënësve dhe si pasojë e rënjes së vazhdueshme në të natalitetit ndër vite apo edhe si shkak i faktorëve tjerë social. Ky ndryshim është rreth 15 % më pak nxënës në këtë nivel shkollimi në teritorin e Republikës së Kosovës.

Niveli	Arsimi	2013/2014	2014/2015	2015/2016	2016/2017	2017/2018	2018/2019
0	Parashkollor	26.768	25.928	27.508	29.473	31.068	32.526
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët	280.823	273.649	263.779	255.093	247.614	243.177
3	I Mesëm i lartë	100.437	83.743	87.847	90.941	91.345	85.789
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët special	635	307	254	203	197	186
3	I Mesëm i lartë special	147	138	103	68	101	118
5+6	Universitar	52.159	69.220	120.429	123.988	110.137	104.579
Gjithsej		460.969	452.985	499.920	499.766	480.462	466.375

Tabela 7. Të dhënat e arsimit në gjashtë

Burimi : Të dhënat e arsimit për vitin vitin 2015/2016 dhe 2018/2019 janë ASK në bashkëpunim me MASHT – Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA)

Në vijim përmes grafikut tregohet ndryshimi i numrit të nxënësve në nivelet e shkollimit në Kosovë në dekadën e fundit.




Figura 15. Të dhënat e arsimit në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë në dekadën e fundit

Burimi : <https://ask.rks-gov.net/media/5359/vjetari-2019.pdf>

Ku vertetohet ajo që u tha më lartë se ka rënie të numrit të nxënësve në vitin e fundit shkollor tek arsimi i mesëm i lartë.

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare, gjithsej numri i nxënësve që vijojnë mësimin në vitin shkollor 2013/2014 në Republikën e Kosovës është 408.146 nxënës, nga këta 213.419 janë meshkuj apo 52% të totalit, kundrejt 48% femra apo shprehur në numra 194.724 nxënëse. Kur këto të dhëna krahason me ato të viti shkollor 2019/2020 do shohim se kemi rënje të numrit të nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit 329.387 gjithsejt ku 160.202 janë femra dhe 169.387 meshkuj, në raport 51% meshkuj kundrejt 49% femra.




Figura 16. Numri total i nxënësve nëpër shkolla 2013/2014

Burimi : Autori

Për vitin shkollor 2019/2020 janë këto dhëna :




Figura 17. Numri total i nxënësve nëpër shkolla 2019/2020

Burimi : Autori

Të dhëna e vitit shkollor 2019/2020 tregoj se në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë ka rënje të numrit të nxënësve në përgjithësi, si shkak i natalitetit të ulët dhe braktisjes së shtetit. Nëse tërheqim një linjë krahasuese të të dhënave mes viteve shkollore 2013/2014 dhe atij 2019/2020 atëhere shohim se kemi trend negativ të pjsëmarrjes në shkollim për 62.606 fëmijëve në të gjitha nivelet e shkollimit apo shprehu në përqindje 13%.




Figura 18. Numri total i nxënësve nëpër shkolla i shprehur grafikisht 2019/2020

Burimi : Autori

Numri total i fëmijëve në nivelet e arsimit parashkollor/parafillor është 33.043 fëmijë, ndërsa gjithësej në nivelet 2 dhe 3 të arsimit ka 234.590 nxënës. (meshkuj 129.979 apo 53% dhe 113.611 vajza respektivisht 47%) apo 68% të totalit të nxënësve në Republikën e Kosovës (Figura 19).




Figura 19. Numri total i nxënësve nëpër shkolla i shprehur në përqindje

Burimi : Autori

Të dytë për nga numri vijnë shkollat e mesme, me 22% të totalit të nxënësve (nga të cilët 54% janë meshkuj kundrejt 46% femra). Të dhënat e kompletuara janë paraqitur në vijim në tabelën 8.

Niveli i arsimit	Gjithsejt	Meshkuj	Femra
Parashkollor	9393	4924	4469
Parafillor	23650	12304	11340
Filllore/mesem e ulët	234590	12979	113611
Mesme e lartë	77907	39747	38160
Gjithsejt	345540	69954	167580

Tabela 8. Numri i nxënësve në nivelet e arsimit në Kosovë

Burimi : Autori

Niveli	Arsimi	Gjithsej	Femra	Meshkuj
0	Parashkollor	32.526	15.548	16.978
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët	243.177	117.909	125.268
3	I Mesëm i lartë	85.789	42.013	43.776
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët special	186	77	109
3	I Mesëm i lartë special	118	49	69
5+6	Universitar	104.579	59.378	45.201
Gjithsej		466.375	234.974	231.401

Tabela 9. Numri i fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në arsimin publik dhe privat për vitet 2018/2019 sipas gjinive

Burimi : Të dhënat e arsimit për vitin vitin 2015/2016 dhe 2018/2019 janë ASK në bashkëpunim me MASHT – Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA)

Duke e tërheq një paalele krahasuese në mes të dhënave të vitit shkollor 2013/2014 dhe atyre të viti 2018/2019 keni ndryshim të përqindjes në raport gjinor tek nxënësit e shkolloave të mesme në dobi të gjinisë femrore të cilat në masë 49 % apo atë numerik 42.013 nxënës ndjekin shkollimin e mesëm të lartë në krahasim me 51% meshkuj (apo 43.776). Pra, ka rritje të nxënësve femra në shkollimin e mesem për 3% që në kuaton totale kjo diference gjinore zvoglohet për 8% sa ishte në vitin shkollor 2013/2014 në vetëm 2 % në vitin shkollor 2018/2019.

Po ashtu edhe në numrin e përgjithshëm të femrave në të gjitha nivelet e arsimit ka rritje të pjesëmarrjes së femrave në arsimim nga 194.727 sa ishte në vitin shkollor 2013/2014 për vitin shkollor 2018/2019 ky numër shkon në 231.401 nga totali i përfshirjes

466.375, ku po thuhet është numër i barabartë me gjinin mashkullore sa i përket përfshirjes në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. (Tabela.9)

3.3.2 Numri i personelit arsimor dhe i klasëve në nivelet e arsimit në Kosovë

Raporti mbi personelin arsimor në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë, është sa vijon:

- Gjithsej personel.... ... 28.13.914 (M. 13.914 & F. 14.029)
- Mësimdhënës.....23.234 (M.10.69 & F. 13.165)
- Personeli administrativ.....1.566 (M. 1.048 & F. 518)
- Personeli ndihmës.....3.350 (M. 2.824 & F. 526)

Nga ky numër 553 mësimdhënës apo siç quhen edukator janë të përfshirë në procesin e arsimit parashkollor e parafillor apo 2% nga totali i mësimdhënësve në Kosovë. Vlen të ceket se vetëm një janë edukator meshkull. Në arsimin fillor janë 17.426 arsimtar (7.080 meshkuj dhe 10.346 femra) dhe atë të lartë 5.255 mësimdhënës (ndarja sipas gjinisë M. 2.988 & F. 2.267). Sa i përket strukturës gjinore në shkollat e Kosovës mbajnë mësim 57% mësimdhënës të gjinisë femrore.

Numri i institucioneve edukativo –arsimore në Kosovë është sa vijon:

Nivelet	Gjithsej	Amë	Të ndara
Parashkollore	44	37	7
Shkolla fillore	921	635	286
Shkolla të mesme	123	107	16
Shkolla speciale	6	6	0
Totali	1154	758	396

Tabela 10.Numri i institucioneve edukativo- arsimore në Kosovë

Burimi : Autori

Nga tabela 10 konkludojmë se numri më i madh i institucioneve shkollore është në shkollat fillore 921 objekte gjithsej, ndërsa institucionet parashkolle kanë numrin më të vogël të objekteve me gjithsej 44 sosh.

Nëse e tërheqim një paralele mes numrit të nxënësve, personelit arsimor dhe numrit të institucioneve edukativo-arsimore dhe krijojmë një raport tabelar sa vijon :

Viti shkollor	Shkolla	Paralele	Nxënës			Mësimdhënës			Numri i nxënësve për një arsimtar
			Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	
2008-2009	121	3.130	96.765	43.327	53.438	5.157	1.717	3.440	19
2009-2010	125	3.308	104.806	47.242	57.564	5.519	1.923	3.596	19
2010-2011	137	3.483	108.503	49.788	58.715	5.957	2.134	3.823	18
2011-2012	142	3.874	109.513	50.290	59.223	6.095	2.237	3.858	18
2012-2013	140	3.608	107.303	49.518	57.785	6.142	2.316	3.826	17
2013-2014	131	3.472	103.038	47.865	55.173	6.374	2.494	3.880	16
2014-2015	120	:	83.743	39.358	44.385	5.358	2.081	3.277	16
2015-2016	119	:	85.377	40.667	44.710	5.275	2.211	3.413	16
2016-2017	119	:	87.996	42.383	45.613	5.687	2.287	3.400	15
2017-2018	122	:	91.345	179.048	190.977	5.724	2.324	3.400	16
2018-2019	125	:	85,789	42,013	43,776	5,787	2,394	3,393	15

Tabela 11. Shkollat, nxënësit, paralelet dhe mësimdhënësit në arsimin e mesëm 2008/2009 deri 2018/2019

Burimi : Të dhënat e arsimit për vitin vitin 2015/2016 dhe 2018/2019 janë ASK në bashkëpunim me MASHT – Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA)

Nga të dhënat e fundit zyrtare shiq shihen edhe nga tabela e sipërm për vitin shkollor 2018/2019 ka një përmisim të vogël sa i përket numrit të i nxënësve për një arsimtar që është 15 ndërsa në vitin shkollor 2008/20019 ka qenë 19 ndërkaq në vitin 2013/2014 ai raport ishte 1 mësimdhënës 16 nxënës . Ndërsa tek objketete mësimnxënjes respektivisht shkolla kemi dukshëm ma pak 5 sish si shkak edhe i numrit më të vogël të nxënësve, nga 131 në vitin shkollor 2013/2014 në 125 të tilla në vitin shkollor 2018/2019 apo 17 më pak se në raport me vitin shkollor 2011/2012.

Përshkrimi	Niveli fillor dhe i mesëm i ulët		Niveli i mesëm i lartë	
	2013/2014	2019/2020	2013/2014	2019/2020
Raporti nxënës për mësimdhënës	19.6	14	18.3	14.2
Raporti nxënës për paralele	21	18.4	28.4	23.2

Tabela 12. Raporti nxënës për mësimdhënës dhe nxënës për paralele (krahasim)

Burimi : Autori

Duke krahasuar vitin e fundit shkollor 2019/2020 me një vit reference si viti 2013/2014 kemi tek të gjitha nivelet përmisim të raporteve si ai nxënës për mësimdhënës nga 19.6 në 2013/2014 në 14 tek niveli 2 dhe 3, e po ashtu edhe tek niveli i mesëm i lartë ky raport ka një përmisim të dukshëm. Trend pozitiv ka edhe tek raport nxënës për paralele tek dy vitet shkollore krahasuese nga 21 në 18.4 tek niveli fillor dhe ai i mesem i ulët respektivisht nga 28.4 në 23.2 nxënës për paralele

Duhet të ceket edhe një fakt se numëri i nxënësve sipas niveleve ISCED 97 për 1000 banor, sipas statistikave të arsimit, ka një rënjë të vazhdueshme nga viti shkollor 2010/2011 që ishte 231.2 nxënës në vitin shkollor 2018/2019 ka qenë 201.2 nxënës. (ASK, Statistikat e Arsimit, 2019)

Parashtrohet një pyetje shumë e thjeshtë: A mjaftojnë këto objekte shkollore dhe ky numër i mësimdhënësve? Përgjegjja do të ishte e shkurtër jo. Aryetimi është se tek arsimit i mesëm i lartë vazhdon të jetë numri i lartë i nxënësve nëpër paralele 23.2 nxënës, që d.m.th. se kualiteti i mësimimit nuk mund të jetë ai që aspirojmë të jetë dhe lirisht mund të thuhet larg standardeve europiane. Angazhimet e nxënësve nëpër puntoritë e shkollave (aty ku ekzistojnë) për të aplikuar praktikën profesionale nuk

mund të mbahet për të gjithë njëkohësisht, prandaj ndarja në grupe është e pashmagshme. Kjo ndikon edhe në zvoglimin e kohës të qëndrimit të nxënësve nëpër puntoritë e shkollave profesionale. Nuk duhet harruar se mësim e mban vetëm një arsimtar i kësaj lënde. Pra mungesa e buxhetit sanksionon që mbrenda puntorive ta udhëheqin mësim pos profesorit edhe ndonjë teknik profesional. Duke i parë këto rrethana themi se ky numër mbetet akoma shumë i lartë kur sidomos kur flitet për shkollat profesionale, gjegjësisht tek ato shkolla që praktika profesionale kryhet mbrenda objekteve shkollore, e kur hapësira në kabinete apo laboratore nuk është e mjaftueshme e po ashtu edhe numri i vogël i pasjeve dhe mjeteve punuese të cilës do profil që i takojnë .

Këtu ka nevojë imediate të ndërhyhet në politikat arsimore në rritjen e numrit të objekteve shkollore, e jo zvoglimin e tyre, e sidomos atyre të nivelit të mesëm të lartë apo në ndërtim e shkollave të reja të mesme dhe ato konform standerteve të BE me të gjitha paisjet dhe materialet e nevojshme. Mungesa e objekteve për zhvillimin e praktikave profesionale në shkolla është më se evidente, përkundër që ka të tilla, por paisjet dhe materialet e punës tashmë mund të thuhet se janë të vjetruara apo ka edhe të tilla që janë jashtë funksionit. Duhet të rritet numri i personelit që mbajnë praktikën profesionale, si për të rritur kualitetin e mësimin, e gjithashtu për të rritur sigurinë e punës tek nxënësit. Kjo e dyta kur dihet që në shkollat teknike kemi të bëjnë me paisje elektrike të tensioneve të larta, të cilat kërkojnë kujdesin dhe syqelësin maksimale në punë.

Kjo do të ishte shtytje që në aspektin horizontal të programohen investime pos në kurrlikuat e reja konform kërkesës së tregut edhe në përmisimin e infrastrukturës

shkollor, e sidomos të paisjeve të kabineteve me mjetet themelore për të zhvilluar praktikën profesionale.

Krahas këtyre, në Kosovë ka nxënës në shkolla speciale respektivisht qendra burimore, për personat me aftësi të kufizuara, klasë të bashkangjitura dhe të mbështetura. Gjithsej nxënës 349 (M.206 & F.143), ku në atë parashkollor/parafillor vijnë mësim 68 nxënës me nevoja të veçanta (M.45 & F.23), në atë fillor dhe të mesëm të ulët 170 nxënës (M. 103 & F. 67 respektivisht shprehur në përqindje 60.6% M. dhe 39.4% F.), ndërsa në ato të mesme të larta ka 1110 (M. 58 apo 52.3% & F. 61 gjegjesisht 47.7%) nxënës. Nëse e shikojmë pjesmarrjen e këtyre fëmijëve në tri vitet e fundit del se ka varacione nga viti në vit, por gjithsesi mbetet brengosëse përqindja e lartë e tyre. Qeveria e Kosovës konkretisht MASHT, e kanë obligim kushtetues që këtyre fëmijëve t`ju mundësohet integrimi në shoqëri si edhe të gjenden forma të posaçme të afësimit profesional të përshtatshme që edhe këta të jenë e tregun të punës, dhe kontribues të zhvillimit të vendit, dhe njëkohësisht të ndjehen të barabartë me moshatarët e tyre që gëzojnë shëndet të plotë.




Figura 20. Numri total dhe sipas gjinisë i nxënësve nëpër qendra burimore/ shkolla speciale i shprehur në përqindje për vitin shkollor 2019/2020

Burimi: Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/2020

3.3.3 Nxënës në arsimin privat

Pas luftës në Kosovë janë hapur edhe shkollat jopublike apo private të cilat janë të licencuara pran MASHT-it. Numri i nxënësve që ndjekin mësim në këto institucione edukativo-arsimore është paraqitur në tabelën sa vijon :

Niveli	Totali	Meshkuj	Femra
Parashkollor/ Parafillor	7219	3778	3441
Fillor /i mesëm i ulët	5252	2894	2358
I mesëm i lartë	3480	1895	1585
Gjithsej	15951	8567	7384

Tabela 13. Numri i nxënësve në nivelet e arsimit private në Kosovë 2019/2020

Burimi : Autori

Edhe nga kjo statistikë e dhënë në formë tabelare shihet se numri i nxënësve më i madh është në shkollimin e mesëm të lartë me gjithsej 15951 nxënës ku 5252 nxënës ndjekin mësim në këto institucione private arsiore në nivelin fillor respektivisht të mesëm të ulët dhe po ashtu një numër mjaft i madh edukimin e tyre e në nivelin e mesëm të lartë 3480 nxënës e vazhdojnë nëpër këto institucione edukativo-arsimore.

Nëse e shikojmë përqindjen e nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit në arsim privat ndaj atij publik në tri vitet e fundit del se tendencat në rritje të vazhdueshme për të ndjekur arsimin jopublik. Kjo si pasojë e kushteve më të mira të punës sidomos në nivelin e mesëm të lartë, ku edhe fitohet baza e përgatitjes për profesionin e karrierës. Nga tabela e mëpshtme shihet, në nivelin arsimor të mesëm të lartë ka rritje vazhdueshme , po thuajse për 200 nxënës nga viti shkollor në vitin tjetër pasues, tri vitet e fundit shkollore. Kjo rritje vërehet dhe është e matshme edhe tek nivelet tjera arsimore, në numër edhe më të lartë.

Viti shkollor	Gjithsejt	Meshkuj	Femra
2017/2018	2901	1590	1311
2018/2019	3208	1767	1441
2019/2020	3480	1895	1585

Tabela 14. Numri nxënësve nëpër shkolla private në nivelin arsimor të lartë (krahasim)

Burimi: Autori

3.4 Arsimi i mesëm i lartë profesional

Arsimi dhe aftësimi profesional, nënkupton aftësimin dhe arsimin, që ka për qëllim pajisjen e njerëzve të gjitha moshave me shkathtësi të punësimit.

Arsimi profesional është pjesë e sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional që iu mundëson nxënësve, të cilët e kanë kryer shkollimin e obliguar 9 (5+4) vjeçar ose atyre që kanë mbushur 15 vjeç dhe më të mëdhenj, arritjen e shkathtësive për punësim brenda institucioneve të arsimit profesional. Arsimi i mesëm profesional, që nënkupton shkollat profesionale, si qëllim parësor ka përgatitjen e kuadrove për treg të punës, por ofron edhe mundësi të aplikimit në studime më të larta post sekondare dhe universitare. Arsimi dhe aftësimi profesional pajisë nxënësit me njohuri shkathtësi profesioni, vlera dhe qëndrime që ju mundësojnë atyre ti plotësojnë nevojat e të sotmes dhe sfidat e së nesërme .

Ky lloj arsimit në Kosovë është organizuar në tetë tipe të shkollave, ku mësimi zhvillohet në disa profile, që janë: Arti, Bujqësia, Ekonomia dhe juridiku, Mjekësi, Muzika, Teknike, Teologjike, Tregtia.

Ka edhe dy profile si ajo mikse dhe qendrat e kompetencës. Misioni i Qendrës së Kompetencës është të ofrojë Arsim dhe Aftësim Profesional me cilësi të lartë, për nxënës të rregulltë dhe për të rriturit, me planprograme të familjarizuara me nevojat e tregut të punës në fushën e ekonomisë, tregëtisë, hotelerisë, administratës dhe TIK-ut. Në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, i pajisë nxënësit me aftësi, shkathtësi dhe kompetenca profesionale, duke i bërë të gatshëm ata që të veprojnë të pavarur, qoftë në vendin e punës apo edhe gjatë vazhdimit të arsimimit të lartë.

Kohëzgjatja e shkollimit të mesëm të lartë profesional, pjesë e shkollimit parauniversitar në Kosovë, është e ndarë në 3 nivele. Nivelet e arsimit në Kosovë janë të definuara sipas standardit ndërkombëtar për kualifikim SNKA në përputhje me ligjet në fuqi.

- ✓ Niveli i parë përfshinë klasën e 10-të dhe të 11-të. Kjo shkallë ofron kualifikimin bazik dhe mundëson punësimin në treg të punës si punëtor i gjysmë kualifikuar.
- ✓ Niveli i dytë, është vazhdimësi e nivelit të parë, përfshinë klasën 12-të, dhe ofron punësim në treg të punës si punëtor i kualifikuar.

Nxënësit e shkollave profesionale kanë të drejtën e studimeve universitare. Struktura e organizimit të MASHT-it përfshin Divizionin e Arsimit Profesional (DAP). Qëllimi kryesor i këtij divizioni është të udhëheqë të gjitha punët administrative, si: planifikim dhe përgatitje të propozim rregulloreve për funksionimin e shkollave profesionale dhe propozimin e masave të ndryshme për avancimin e arsimit profesional. Gjithashtu, zhvillon planprogramet mësimore në përputhje me rrjetin e profileve të ndryshme të arsimit profesional si dhe bashkëpunon edhe me institucione të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, për të hulumtuar nevojat e ekonomisë së tregut.

Arsimi profesional organizohet në 61 shkolla dy prej të cilave janë Qendra të Kompetencës, ndërsa mësimi zhvillohet në disa profile, që përfshin 56.9 % e numrit të përgjithshëm të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë.

Nr.	Tipi i shkollës	Numri i shkollave	Nxënësit				
			10	11	12	13	Gjithsej
1	Artit (AM)	2	163	147	160	153	623
2	Bujqësore (AG)	3	583	677	498	530	2288
3	Ekonomike (ECO)	10	3649	3349	3110	4140	14248
4	M. mjekësisë (ME)	7	1953	2013	1951	2127	8044
5	Muzikës (AM)	7	163	161	160	145	629
6	Teknike (TE)	19	6594	5804	5632	5377	23407
7	Teologjike (TH)	1	234	201	167	145	747
8	Tregti (TR)	1	104	77	39	66	286
9	Mikste	9	2141	1897	1854	1948	7840
10	Qendra e Kompetencës	2	560	444	300	0	1304
Gjithsej		61	16144	14770	13871	14631	59416

Tabela 15. Numri i nxënësve në shkolla profesionale

Burimi: Statistikat e MASHT-it

Nga tabela 15 shihet tipet e shkollave janë të profileve të ndryshme ku vend dominues zënë shkollat profesionale teknike me numër total në të gjitha vitet e shkollimit 23.407 nxënës respektivisht 35.8% (Figura 21) të numrit të gjithëmbarshtëm të nxënësve që ndjekin shkollimin në shkollat profesionale, si edhe me numrin më të madh të objekteve 19 sish apo 31% të totali të objekteve shkollore në vend që nënkupton interesim të theksuar të të rinjve për këtë profil arsimor. Sipas statistikave të MASHT-it të viti shkollor 2012/2013, të cilat si të dhëna refernce, shkolla ekonomike është e dyta për nga renditja me 21.8%, e pasuar nga ajo e mjekësisë me 13.3% të numrit të gjithëmbarshtëm të nxënësve të nivelit 3 të shkollimit. Muzika është njëra ndër profilet që ka interesimin më të ulët me 1.0% dhe në fund vie profili i tregëtisë. Si arsyetim mund të jetë se tek muzika duhet talenti për vijimin e

këtij profesioni të rëndësishëm, ndërkaq sa i përket atij të tregëtisë në Kosovë kushdo që ka kapital vetanak apo plotëson kushtet e huasë nga bankat mund të hap një dyqan e të mirret me këtë veprimtari dhe ti plotësojë nevojat familjare, pra nuk është parakusht licenca për të ushtruar këtë profesion.




Figura 21. Figura sipas drejtimeve në shkollat profesionale shprehur në përqindje

Burimi : Autori

Ajo që vlen të ceket se profil i shkollës teknike ka rënje të intersimit nga të rinjt për ta ndjekur në krahasim në vitin 2009/2010 ku përbënte 41.5% të numrit total në shkollat profesionale e në vitin 2012/2013 ka vetëm 35.8%, rritje të madhe ka profili i artit nga 0.8% sa kishte në vitin 2009/2010 tani ka 9.9% nga totali i nxënësve që ndjekin mësim në shkollat profesionale të nivelit të arsimit të mesëm të lartë.

	2009/2010	20010/2011	2011/2012	2012/13
Art	0.8	0.7	1.4	9.9
Bujqësore	4.8	4.5	4.1	3.5
Ekonomike	23.9	23.8	23.9	21.5
Mjekësisë	12.6	13.1	13.6	13.1
Muzikës	0.9	1	0.9	1
Teknike	41.5	40.8	39.9	35.8
Teologjisë	1.1	1.1	1.7	1.1
Tregti	0.7	0.6	0.5	0.4
Mikëse	13.7	13.4	13.3	11.7
Qendrat e kompetencës		1.1	1.6	2

Tabela 16. Numri i nxënësve nëpër vite në përqindje në shkollat profesionale

Burimi : Autori

Sipas të të dhënave të arsimit të Kosovës del se në të gjitha këto tipe të shkollës në tri vitet e fundit ka rënje të intersimit për regjistrim.

Duke u bazuar në të dhënat e fundit të MASHT-it, nga faqja zyrtare 2020, tek arsimi profesional vegëza profilet dhe shkollat, kemi shpërndarje të profileve të ndryshme gjithë andej teritoritë të Kosovës . Fatkeqësisht, arsimi profesional shihet si alternativë vetëm kur nxënësit nuk arrijnë suksesin që kërkohet për t'u regjistruar në gjimnaze. Sipas MASHT-it, numri i nxënësve të regjistruar në shkollat profesionale ka rënë nga numri i përgjithshëm të nxënësve në nivelin e mesëm të lartë.

Të dhënat po i paraqesim në formën tabelare në vijim:

Lëmitë	Nr. Nxënësve
Lëmi i kultures, i artit dhe i informimit publik	904
Lëmi i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	6048
Lëmi natyror – matematikor	93
Lëmi i ekonomi – juridik	12375
Lëmi i tregëtisë, i hotelierisë dhe i turizmit	2863
Lëmi i kimisë, i jometaleve dhe e grafikës	1432
Lëmi i tekstilit dhe lëkuratrisë	637
Lëmi i trafikut	4250
Lëmi i gjeodezisë dhe ndërtimtarisë	2010
Lëmi i elektroteknikes	6510
Lëmi i makinerisë dhe përpunim i metaleve	5607
Lëmi i xehetarisë, metalurgjisë dhe gjeologjisë	1076
Lëmi i pylltarisë dhe përpunimit të drurit	411
Gjithsej	44216

Tabela 17. Lëmitë profesionale në Kosovë për vitin shkollor 2019/2020

Burimi : <https://masht.rks-gov.net/shkollat-profilet>

Pra, edhe këtu shihet se drejtimet të cilat janë në kuadër të shkollave teknike, njësoj si edhe vitet paraprake shkollore janë më atraktive për nxënësitë, pa lënë anash as profilin ekonomik dhe juridik si preferencë e të rinjëve të cilët kanë qëllim vazhdimin e studimeve.




Figura 22. Paraqitja e profileve në përqindje

Burimi : Autorit

Shihet se qartë se profilet ekonomia dhe juridiku kanë 28% të numrit të nxënësve të të gjithë shkollave të mesme të larta , pasur nga drejtimet teknike siç është elektroteknika 15%, makineria 13%. Edhe këtë vit shkollor si edhe të tjerët më parë lëmitë si matematika, tekstili apo edhe kultura e arti me 2% se bashku me kiminë e profilet si motra të saj me 3%

të numrit të gjithë mbarshëm të nxënësve, mbesin shumë pak të dëshiruara për të rinjët. Nuk duhet harruar se profilet mjekësore janë mjaftë atraktive 14%, ku të rinjët shpresojnë të gjejnë vende pune në shtet perendimore, pasi kërkesa për profesionist të këtyre lëmive në vendet e BE-së është mjaftë e madhe. Pra, këtu duhet orientuar edhe marketingu i zyrtarëve të MASHT-it së bashku edhe me përfaqësuesit arsimor në nivelet lokale që të orientohen të rinjt tek këto lëmi se mund të janë shumë më afër tregut të punës si profesionist të këtyre lëmive përkatëse.

Sipas Kornizës së re të Kurrikulumit të Kosovës (KKK), programet e praktikës profesionale janë pjesë e kurrikulumit të shkollave të mesme AAP (Arsimi dhe Aftësimi Profesional), që janë të bazuara në rezultate të arsimit dhe nxënies së bazuar në kompetenca dhe paraqesin kornizën si vijon:

- ✓ klasa 10: teori 60% kundrejt praktikë 40%,
- ✓ klasa 11: teori 50% kundrejt praktikë 50% dhe
- ✓ klasa 12: teori 40% kundrejt praktikë 60%.

Këto programe iu mundësojnë nxënësve të kalojnë një periudhë të planifikuar kohore nëpër ndërmarrje apo punëtori, ku do të fitojnë përvojë, duke i ardhur kështu në ndihmë zgjedhjeve të tyre për karrierën e mëtejme dhe duke ngritur shkathtësitë e tyre në industri.

Shkollat e mesme AAP në Kosovë ofrojnë dy lloje kryesore të programeve të nxënies të bazuara në punë – nxënia e bazuar në punë në shkollat AAP që kanë punishtet e tyre dhe praktikë profesionale nëpër ndërmarrje. Nxënësit e AAP në përgjithësi dërgohen në ndërmarrjet që zgjedhin vet, ku do të pasqyrohet lloji i punës që ata planifikojnë të bëjnë

pas përfundimit të studimeve. Për shumicën e nxënësve të AAP praktika profesionale është përvoja e parë e punës.

Koncepti i praktikës profesionale mbështetet në gjashtë dimensione që janë kryesore sa i përket asaj se si individët mësojnë përmes punës:

1. Qëllimi i praktikës profesionale
2. Supozimet lidhur me të nxënit dhe zhvillimin
3. Përmbajtja e praktikës profesionale
4. Menaxhimi i praktikës profesionale
5. Rolet e mësimdhënësve të AAP dhe tutorët në ndërmarrjet pranuese
6. Rezultati i praktikës profesionale (MASHT, 2014)

Praktika profesionale nëpër ndërmarrje është një trambolin suksesi dhe me cilësi të lartë të të nxënit ku nxënësit kanë mundësi të përfitojnë shkathtësi praktike me pajisje moderne dhe nën kujdesin e ekspertëve të fushës përkatëse që njohin shumicën e metodave dhe teknologjive më të fundit të punës.

Kështu, përkrahja e zhvillimit të një relacioni të bashkëpunimit mes shkollave AAP dhe bizneseve, metodë prej të cilit përfitojnë dhe gjejnë përkrahje të dy këto struktura, me qëllim të përmirësimit dhe përforcimit të shkathtësive të nxënësve dhe për të plotësuar kurikulat në shkollë me përvoja përkatëse të të nxënit, sistem ky që duhet të jetë një shtyllë kryesore e reformës së AAP-së në Kosovë.

3.5 Shkollimi i mesëm i përgjithshëm - gjimnazi

Gjimnazi është emërtimi i shkollës së mesme të përgjithshme në disa vende. Gjithsej numri i nxënësve në gjimnaze është 47.196 dhe përbën 44.2 % e numrit të përgjithshëm të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë. Gjimnazi ka 5 profile. (Tabela 18)

Nr	Profili	Klasët				Gjithsej
		10	11	12	13	
1	Shoqërore	5229	4854	4468	0	14551
2	I përgjithshëm	1022	977	867	1238	4104
3	Natyror	6457	6289	6360	0	19106
4	Matematikë-Informatikë	1368	1291	1266	0	3925
5	I gjuhëve	1137	1035	1094	0	3266
Gjithsej		15213	14446	14055	1238	44952

Tabela 18. Numri i nxënësve në gjimnaze sipas drejtimeve

Burimi : Autori

Nga kjo rezulton se drejtimi më i preferuar i kësaj grup moshe është ai shkencave natyrore 42% të numrit të përgjithshëm të gjimnazit pasur nga drejtim/profili natyror me 33%. (Figura 23).




Figura 23. Drejtimet në gjimnaze shprehur në përqindje

Burimi : Autori

Vlen të ceket se numri i gjinisë femrore që ndjekin këto profile është më i lartë se sa i meshkujve (24.456 F kundrejt 20.230 M) respektivisht 55% femra ndaj 45% meshkuj. Ky indeks tregon se femrat kanë prirje më të madhe për shkollim më të gjatë, kur dihet se këto profile profesionalizmin e tyre e kanë në studimet universitare dhe më gjerë. Ky ndryshim gjinor vërehet edhe në trendet në vitin shkollor 2009/2010 raporti gjinor ishte 48.08 meshkuj me 51.94 femra. Pra, ndryshimi është i theksuar, d.mth. se në vitin 2009/2010 diferenca ishte rreth 4%, në vitin shkollor 2012/2013 kjo diferencë shkon në 10% .Ndërsa në vitin shkollor 2019/2020 raporti gjinor është 57.7 % F & 42.3 % M.

3.6 Raporti në mes gjimnazeve dhe shkollave profesionale

Bazuar në të dhënat e viti shkollor 2012/2013 del se raporti mes vijimit të procesit mësimor në shkollat profesionale është 57% kundrejt 43% në gjimnaze.




Figura 24. Raporti mes shkollave profesionale dhe gjimnazeve 2012/2013

Burimi : Autori

Po për këtë vit shkollor, po paraqesim krahasimin gjinor tabelar në këto tipe të shkollimit të nivelit të mesëm të lart ku konludojmë se shkollimi profesional është më i preferuar për gjinin mashkullore 60.1% të të regjistruarëve gjithsejt në nivelin 3. Ajo që vlen të përmendet është edhe raporti femër / mashkull në gjimnaze ka parametrat 1.21, ndërsa në shkollat profesionale 0.66, për vitin shkollor 2012/2013.

Numri i nxënësve që kanë ndjekur shkollimin e mesëm të lartë në Kosovë gjatë vitit shkollor 2019/2020 ka qenë gjithsej 74.427 nxënës , ku nga ky numër 37.585 i përkasin gjinisë mashkullore apo 51%. Raporti gjinor mes dy tipeve të shkollave, sipas statistikave të arsimit në Kosovë, është se në gjimnaz mësimin e kanë vijuar 34.869 nxënës në tërësi ku 20.133 janë femra dhe 14.736 meshkuj. Shprehur në përqindje 42.3% femra dhe 57.7% meshkuj. Ndërsa në shkollat profesionale numri i nxënësve është në po atë vit shkollor 39.558, nga këta 23.116 janë të gjinisë mashkullore apo 58.4%, femra janë 41.6% apo shprehur në numra 14.747 nxënëse.




Figura 25. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë sipas gjinisë e shprehur në %

Burim : Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/20

Raporti gjinor ndryshon në vitin shkollor 2019/2020 për gjimnaze është 1.36 në dominim të gjinisë femrore, ndërsa kjo gjini është më pak prezente në shkollat profesionale në raport me meshkujt në shifrat 0.71. Kemi një trend pozitiv të rritjes të interesimit të gjinisë femrore për drejtimet profesionale edhe pse i vogël në krahasim me vitet e kaluara por jep sinjali interesimi nga gjinia femërore për shkollim profesional sidomos medicina dhe tekstili.

	Meshkuj	Femra	Raporti F/M
Gjimnaze	42.3	57.7	1.36
Shkolla profesionale	58.4	41.6	0.71

Tabela 19. Raporti gjinor në nivelin 3 të shkollimit 2019/2020

Burimi : Autori

Nëse e shikojmë raportin e numrit të nxënësve të në mes gjimnazeve dhe shkollave profesionale prej viteve shkollore 2009/2010 e deri në vitin shkollor 2012/2013 del se numri i nxënësve apo më mirë të themi interesimi i tyre për fitimin e një profesioni që lidhet direkt me tregun ka trend negativ nga 56.69% sa ishte në vitin shkollor 2009/2010 ka zbritur shifrat 53.9%. Raporti mes këtyre dy tipeve të shkollimit për vitin shkollor 2019/2020 është 47% në gjimnaze dhe 53% në shkollat profesionale. Pra trendi i rënjes së interesimit të nxënësve vazhdon në mënyrë periodike, për 10 vite shkollore interesimi ka rënë për afër 4%. Ky është edhe një tregues tjetër për cilësinë e mësimin në profilet e shkollave profesionale si dhe për kurlikulat e saj të cilat nuk janë në përputhshmëri me nevojat e ekonomisë së tregut.




Figura 26. Nxënësit në shkollat e mesme të larta

Burimi : Autori

Raporti i numrit të nxënësve për vitin shkollor 2019/2020 mes shkollave ka po ashtu trend rritje në favor të gjimnazit. Në shkollat profesionale kanë ndjekur mësim 53% apo 39.558 nxënës ku të numrit të gjithmbarëshëm të nxënësve të Kosovës në raport me gjimnazin që është 47% respektivisht 34.869 nxënës.




Figura 27. Nxënësit në shkollat e mesme të larta për vitin shkollor 2019/2020

Burimi : Statistika e Arsimit Kosovë 2019/2020

Duke i elaboruar këto të dhëna, del në pah se Kosovës i duhet një sistem më efektiv dhe më efikas i arsimit. Për të arritur këtë, MASHT duhet bërë ndryshime në strukturën e vet menaxheriale duke reformuar edhe sistemin e vet të llogaridhënies. Pos këtyre, kërkohet edhe forcimi i menaxhmentit në nivel qendror, regjional dhe komunal dhe përmirësimi i kapaciteteve për integrimin e aspekteve të barazisë në strukturat dhe praktikat menaxhuese. Strategjia e re do të mundësojë vlerësime dhe parashikime gjithëpërfshirëse të kërkesave të sektorit të arsimit, një qasje më të baraspeshuar në zhvillimin sektorial, si dhe do të shërbejë për hartimin e një programi të fokusuar dhe më të koordinuar të asistencës zhvillimore. Gjatë periudhës së mbuluar me këtë plan që do të përfshinte ristrukturimin e arsimit të mesëm dhe afirmimin e arsimit e aftësimin të mesëm profesional, zhvillimin e Qendrave të Kompetencës, përshtatjen më të mirë të arsimit dhe punësimit, përfshirë edhe zhvillimin e arsimit dhe aftësimin të lartë profesional si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës.

Përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë duke siguruar kontrollin e cilësisë, aplikimin e standardeve evropiane dhe shqyrtimin e organizimit të strukturave akademike si dhe zhvillimin e Teknologjisë së Informimit e të Komunikimit (TIK) në të gjitha nivelet, zhvillimi profesional i mësimitdhënësve si dhe segmentet e arsimit të bënin përcaktimin e zhvillimit të resurseve njerëzore si një prioritet kombëtar dhe krijimin e një kulture të mësimit gjatë gjithë jetës dhe të gjitha këto të derivonin një garanci profesionale dhe një impuls goditës për zhvillimin ekonomik të vendit, gjenerimin e vendeve të reja punës që rrjedhimisht do të ndikonte në uljen e papunësisë dhe përmisimin e mirëqenjes sociale të popullatës kosovare.

3.6.1 Kosova dhe vendet e rajonit

Më lartë cekem se Kosova ka raport 47 % të nxënësve që ndjekin gjimnazet dhe 53 % që vijojnë mësimin në shkollat profesionale të profileve të ndryshme. Republika e Shqipërisë sipas Instatit gjatë viti shkollor 2017/2018 kishte të regjistrua 91451 nxënës në gjimnaz, 3908 në programin social kulturor dhe 21287 nxënës në shkollat profesionale. Qarku që më së shumti kishte nxënës të regjistruar atë vit shkollor ishte ai Durrësit me 3224 nxënës. Mali i Zi gjatë viti shkollor 2019/2020 kishte 27446 nxënës të regjistruar në shkollat e mesme nga ata 48.7 % janë femra apo 13362 nxënëse. Nga ky numër 8595 vijojnë mësimin në gjimnaz. Sa i përket Serbisë nga 249855 nxënës në shkollat e mesme, 49.4% e tyre janë femra apo 123553. Nga këta pjesa më e madhe vijojnë mësimin në shkollat profesionale. Ndër më të ndjekurat janë profili i ekonomisë, drejtësisë e administratës si dhe ai i elektroteknikë .Maqedonia e Veriut gjatë viti shkollor 2017/2018 kishte gjithsej 71944 nxënës, nga keta të gjinisë mashkullore në shkollat e mesme ishin 37 818 dhe 34126 femra .Bosnja dhe Hercegovina në vitin shkollor 2017/2018 kishte gjithsej 117764 nxënës nga të cilat 58789 ishin femra. Raporti mes shkollave profesionale dhe gjimnaze është sa vijon :

Shteti	Shkollat e mesme	
	Gjimnaz	Profesionale
Kosova	47	53
Shqiperi	78	22
Serbi	26	74
Mali i Zi	32	68
Maqedoni	44	56
BH	31	69

Tabela 20. Raporti gjimnaz dhe shkollat profesionale për vendet e Ballkanit

Burimi : Autori

Nga tabela shihet numri më i madh nxënësve në këto vende balkanike e ndjekin mësim në shkollat profesionale ku përjashtim bënë Shqipëria ku pjesa dërmuese e nxënësve vijojnë arsimimin e tyre në gjimnaz.




Figura 28. Grafiku për gjimnaz dhe shkollat profesionale për vendet e Ballkanit

Burimi : Autori

Duhet të theksohet në të gjitha vendet e ballkanit ka rënje të numrit të nxënësve në rreth 5 deri në 10 % gjatë vit shkollor. Arsyejt janë të natyra të ndryshme si nataliteti, emigracioni, kushtet sociale etj. Shumica nga këto vende ka buxhet më të vogël për arsimim se mesatarja e BPV në vendet BE që është 4.6%.




Figura 29. Shpenzimet qeveritare të rajonit për edukim (% BVP)

Burimi : https://www.thebalkanforum.org/file/repository/Education_Briefing_ENG_FINAL.pdf

3.7 Raporte përmbledhëse financiare

Arsimi është një e mirë shoqërore respektivisht kombëtare dhe si i tillë ofrimi i arsimit duhet të financohet nga buxheti publik.

Sistemi arsimor në Kosovë financohet kryesisht nga paraja e Buxhetit Qendror, i cili transferohet tek komunat përmes një granti të quajtur "Granti Specifik për Arsim". Sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, shuma e grantit përcaktohet duke përdorur një formulë që llogarit numrin e mësimitdhënësve dhe regjistrimin efektiv. Kjo gjithashtu merr parasysh kurrikulën kombëtare, normat e madhësisë së klasës, arsimin me nevoja të veçanta, vendndodhjen dhe shpenzimet operative për paga. Formula e financimit për financim për kokë banori, nga komuna në shkollë, ka hyrë në fuqi në vitin 2009, me qëllim që të ofrojë më shumë autonomi për shkollat në menaxhimin e financave, një hap që supozohet të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në alokimin e burimeve. Kjo formulë bazohet në numrin e nxënësve në të gjitha nivelet dhe në karakteristikat e tjera të shkollave.

(Kosovo, 2018). Kosova ka gjithsej 1116 institucione shkollore publike parauniversitare, nga këto 122 janë shkolla të mesme të larta.

Treguesit arsimor që paraqiten në këtë pjesë e prezantojnë më së miri rëndësinë që i jepet sistemit të arsimit me rastin e ndarjes së buxhetit. Konkretisht, sa përqind e BPV ndahet për arsim, cila është përqindja e arsimit në shpenzimet e përgjithshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe sa nga BPV ndahet për kokë nxënësi.

Tabela e mëposhtme tregon investimet e bëra në arsim për një period tre vjeqare si destinimi i tyre, vitet nga 2009/2010 deri në 2011/2012.

	Parauniversitar			Gjithsej		
	2009/10	2010/11	2011/12	2009/10	2010/11	2011/12
Pagat e mësimdhënësve si përqindje e shpenzimeve publike rrjedhëse	64.87	58.89	67.92	77.88	73.11	79.45
Shpenzimet publike në arsim si përqindje e BPV	2.94	3.04	3.39	5.06	4.76	4.88
Shpenzimet publike në arsim si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë	11.1	9.94	9.07	14.89	15.26	15.47
Shpenzimet rrjedhëse publike për një nxënësi si përqindje e BPV për kokë banori	9.01	8.55	9.53	14.49	15.48	13.79

Tabela 21. Burimet njerëzore dhe financiare

Burimi : Treguesit e arsimit në Kosovë

Arsimi parauniversitar përfshin: arsimin me nevoja të veçanta, edukimin parashkollor dhe parafillor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë.

Sipas treguesit të arsimit në Kosovë, statistikave tregojnë se sa është përfshirë komplet buxheti i ndarë për sektorin e arsimit, duke përfshirë: buxhetin e ndarë nga MASHT për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë, si dhe buxhetin e Universitetit të Prishtinës (përfshirë të gjitha financimet nga granti qeveritar, të hyrat vetanake dhe donatorët në bazë të gjendjes së ribalancit në Ministrinë e Financave të Kosovës (MFK), (MASHT, Treguesit e arsimit në Kosovë, 2018).

Pjesa më e madhe e mjeteve të planifikuara të buxhetit të Republikës së Kosovës të destinuar për MASHT-in nëpër të gjitha vitet e cekuara (tabela 21), si ato për arsimin parauniversitar (me mesatare për tri vitet 63.89%) edhe po ashtu edhe ato gjithsej (me mesatare për tri vitet 76.81%) shkojnë për paga të mësimdhënësve. Nga këto mjete, sipas Eurostat-it, shpenzimet mesatare publike në arsim si përqindje e BPV për këto tri vite tek arsimi parauniversitar është 3.12% kundrejt 4.9% tek ai gjithsej, shumë kjo më e ulët në krahasim me vendet e BE-se ku shpenzimet publike në arsim (SNKA 0-6) në vitin 2009 ishte e barabartë me 5.4% të BPV-së. ([Eurostat \(kodi dhënat online: educ_figdp\)](#))

Sa i përket shpenzimeve publike në arsim si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë konkludojmë se ka rënje të investimeve tek arsimi parauniversitar krahasuar me komplet buxhetin e ndarë për sektorin e arsimit në përgjithësi i cili nga viti në vit ka një rritje të theksuar. Kjo ndodh për shkak se ka stagnuar ndërtimi i objekteve të reja shkollore

në arsimin parauniversitar. Edhe pse akoma kemi shkolla që mësimi mbahetë në tri turne gjithandej Kosovës.




Figura 30. Burimet njerëzore dhe financiare - diagram

Burimi : Autori

Sipas PSAK (Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016) i cili bazohet tek kostoja zhvillimore dhe operative rrjedh se gjatë kësaj periode vjetore në AAP do të investohet një shumë e përgjithshme prej 34,341,310 € nga e cila 20,140,950 € janë si kosto zhvillimore apo 59% e investimeve 14,200,360 € si kosto pasuese operative apo e shprehur në përqindje 41% e totalit.

Në përgjithësi, objektet shkollore nuk janë në gjendje të mirë, kjo më së miri verifikohet kur kemi sasi të mëdha të të reshurave të shiut dhe borës. Duket se shpenzimet operative

nuk janë të shpërndara në mënyrë efikase duke rezultuar me alokime të paparashikuara buxhetore dhe në mirëmbajtje jo të mirë të objekteve shkollore. Kjo kërkon hartimin e një procesi të mirëfilltë për planifikimin e menaxhimin e objekteve dhe zhvillimin e planeve të mirëmbajtjes për të gjitha ndërtesat e shkollave në Kosovë. Pos kësaj, duhet të përdoren më mirë shkollat ekzistuese në fshatra dhe në qytetet e vogla, duke u nisur nga ideja për zhvillimin e arsimit në fshatra sipas modelit të përdorimit të shkollave si qendra komunitare të të nxënit.

Sa i përket zhvillimit profesional të mësimit PSK 2011-2016 ka paraparë 10,684,240 € si kosto të përgjithshme, nga këto janë 7,777,900 € kosto operative, ndërsa për ndërtimin e kapaciteve të MASHT-it 1,497,233 € nga të cilat vetëm 20,000 € si kosto operative dhe shuma prej 1,477, 233 € si kosto zhvillimore.

MASHT që nga viti 2009 ka filluar me realizimin e trajnimit të personelit arsimor për programin e ECDL-së (përdorim të kompjuterit). Por, sivjet ky kurs ECDL (Patenta Evropiane për Përdorimin e Kompjuterit) për mësimit nuk është zbatuar. “Trajtime për ECDL nuk ka pasur sivjet (mendohet për vitin 2015). Është konsideruar se nuk ka mjete...” sipas Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut (intervistë e dhënë në mediave publike në Kosovë). (Telegrafi, Ska trajtime kompjutersh per mesimdhenes, 2016)

Por, KAMSH-i (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve) 2012-2014 tregon hapësirën e limituar fiskale në Kosovë. Buxheti total i të ardhurave në fund të vitit 2014 pritet të arrijë një total prej 1.444 milionë €, ose të jetë rreth 27% më i lartë se në vitin 2010. Shpenzimet totale gjatë periudhës 2012-2013 pritet të rriten vazhdimisht, duke arritur një vlerë prej 1.487

milionë € gjatë vitit 2013, ose një rritje prej 4% në krahasim me vitin 2011. Në anën tjetër, parashikimet sugjerojnë se gjatë vitit 2014 buxheti i përgjithshëm i shpenzimeve pritet të shënojë një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2013, për t'u kthyer sërish në nivel të ngjashëm me shpenzimet e projektuara në vitin 2011. Ndaj, kjo sugjeron se hapësira fiskale për shpenzime të reja si nxitje fiskale apo financiare për praktikë profesionale nëpër ndërmarrje pranuese është e kufizuar, të paktën në afat të shkurtër apo të mesëm. (MASHT, Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale 2013-2020, 2014)

Shpenzimet publike në arsim si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV) në vitin 2017 arrijnë 4.1%, që krahasuar me vitin paraprak është për 0.5 pikë të përqindjes më e ultë, kurse shpenzimet publike për arsim si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë përbëjnë 14.9% të shpenzimeve, që krahasuar me vitin paraprak është për 1.0 pikë të përqindjes më e ultë. (MASHT, Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë 2017/18, 2018).

Financimi në sektorin e arsimit është rritur ndër vite. Edhe pse është e vështirë të vlerësohet sasia optimale e burimeve të nevojshme për përgatitjen e secilit nxënës për jetë dhe punë në shoqërinë moderne, krahasimet ndërkombëtare të shpenzimeve për arsim për nxënës mund të ofrojnë pika referimi të dobishme. Shpenzimet publike për arsimin, të shprehura në përqindje të shpenzimeve qeveritare vjetore, dhe krahasuar me BPV-në, janë të krahasueshme me praktikat rajonale dhe BE-në. Shpenzimet nominale janë rritur dukshëm në krahasim me vitin 2011. Niveli i shpenzimeve publike në arsim në vitin 2018 ishte 4.22% e BPV-së ose 13.7% e shpenzimeve qeveritare. (Kosovo, 2018)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
BPV	€ 5,326.6	€ 5,567.5	€ 5,807.0	€ 6,070.1	€ 6,413.9	€ 6,761
Shpenzimet qeveritare	€ 1,515.9	€ 1,513.1	€ 1,615.7	€ 1,766.5	€ 1,837.2	€ 2,378
Shpenzimet në arsim	€ 203.1	€ 230.6	€ 261.9	€ 280.2	€ 265.7	€ 285.9
<i>% e BPV-së</i>	3.8%	4.1%	4.5%	4.6%	4.1%	4.22%
<i>% e shpenzimeve qeveritare</i>	13.4%	15.2%	16.2%	15.9%	14.9%	13.7%

Tabela 22. Shpenzimet publike në arsim në Kosovë

Burimi: Menaxhimi i arsimit parauniversitar në Kosovë

Nëse këto të dhëna paraqiten në formë grafike do të fitohet grafikoni i poshtëm.




Figura 31. Shpenzimet e arsimit si % e BVP-së nga viti 2013-2018

Burimi: Menaxhimi i arsimit parauniversitar në Kosovë

Duke u bazuar në këto të dhëna shihet se shpenzimet janë në rritje të vazhdueshme. Vetëm në vitin 2018 si BVP ka 96% ndërsa në arsim 4%. Akoma investimet në arsim janë të vogëla për rezultate të mëdha, kjo dëshmon edhe rezultati i testit PISA.

Shpenzimet qeveriare në arsim në vitin 2017/2018 në nivelin e arsimit të mesëm të lartë kanë qenë 52.778.844 € nga 266.722.462 € sa janë shpenzuar në tërësi për arsimin parauniversitar. Për çdo nxënës po në të njejtin vit shkollor është shpenzuar 607 € . Ndërsa si përqindje e BVP për çdo kokë banori në po të njejtin vit shpenzimet qeveritare kanë qenë 17%, mesatarja e shpenzimeve në tërë arsimin parauniversitar ka qenë 17.1%, ku shpenzimet më të mësha kanë ndodhur tek niveli i arsimit parafillor me 43.5%.

Duke i krahasuar të gjitha të dhënat e prezentuara nëpër tabela si ato nga viti shkollor 2009/2010 deri tek ato 2017/2018 vihet në pah se pjesa dërmuese e kapitalit për arsim shkon në paga të mësimdhënësve, për vitin 2017, 88.5% tek arsimi parauniversitar.(Nëse përqindja e pagave të mësimdhënësve llogaritet në shpenzimet rrjedhëse të përgjithshme të arsimit parauniversitar).

Për të siguruar një arsim cilësor për një numër relativisht të madh të të rinjve të Republikës së Kosovës, sfida më e madhe në financimin e arsimit është dhe mbetet menaxhimi i efikas i mjeteve financiare. Shpenzimet në arsim përqendrohen kryesisht në dy kategori, paga dhe mëditje dhe shpenzime kapitale, të dhënat për shpenzime tregojnë se komunat ndajnë rreth 80% të buxhetit të përgjithshëm për paga dhe pagesa të tjera, edhe pse kërkesat dhe nevojat më të larta për të alokuar më shumë para në fusha të tjera që kanë të bëjnë me cilësinë e ofrimit të arsimit dhe performacën e mësimdhënësve.

3.8 Qendrat e Aftësimit Profesional në Kosovë

Në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Social (MPMS) veprojnë shtatë qendra Regjionale të Punësimit (QRP) dhe tetë Qendra të Aftësimit Profesional (QAP), në qytetet kryesore të Kosovës.

Këshilltarët pranë Qendrave Regjionale të Punësimit përkrahin punëkërkuessit të cilët dëshirojnë të kalojnë nëpër aftësime profesionale. Rreth 3,500 punëkërkuess në vit vijnë kurse të aftësimit profesional në QAP, të cilat ofrojnë trajnime pa pagesë me kohëzgjatje prej një deri në gjashtë muaj. Këshilltarët mund t'iu ndihmojnë punëkërkuessve edhe në vijimin e trajnimeve në kompani.

Në kuadër të MPMS ka disa projekte të cilat dëshirojnë të rrisin kapacitetet e QAP-ve për të ofruar aftësime profesionale. Këto projekte mbështesin qasjen e barabartë në aftësime profesionale kualitative për punëkërkuessit, sidomos për të rinjt të cilët dëshirojnë të ngrisin aftësitë dhe shkathhtësitë e tyre për të qenë më konkurrues në tregun e punës. Objektivat kryesore janë rritja e kapaciteteve të trajnimeve nga sektorët publikë dhe privatë dhe promovimi i masave aktive të tregut të punës në zonat urbane dhe rurale, pa lënë anash edhe mbështetjen në infrastrukturë (ndërtimin e objekteve të reja) dhe paisjen e tyre me teknologji të kohës.

3.8.1 Qendrat Regjionale të Punësimit

QRP-të ofrojnë shërbime të shumta, të tilla si :

- ✓ Regjistrimi (evidentimi) i punëkërkuessve

- ✓ Informimi mbi kushtet dhe mundësit e punësimit
- ✓ Hulumtimi i tregut të punës
- ✓ Ndërmjetësim për punësim
- ✓ Këshillimi për orientim profesional dhe për punësim
- ✓ Këshillim për aftësim dhe riaftësim
- ✓ Përkrahja për vetëpunësim etj.

Mirëpo, Kosova po përballet me gjendje të vështirë ekonomike që ndikon në tregun e punës dhe që ngrit sfida të mëdha për ngritje të cilësisë së fuqisë punëtore.

Raporti mbi AFP-në (Anketa e fuqisë punëtore), në tremujorin e parë të vitit 2019 përmban të dhëna mbi punësimin dhe papunësinë sipas moshës, gjinisë, gjendjen e punësimit, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe fushave të tjera të tregut të punës. Në tremujorin e parë të 2019, shkalla e punësimit është 28.2 %, shkalla e papunësisë është 26.9 % ndërsa shkalla e jo aktivitetit është 61.3 %. (ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore, Qershor, 2019)

Sa i përket pjesëmarrjes në fuqinë punëtore që është 38.7 % në këtë periudhë, numri i femrave që i përkasin fuqisë punëtore ishte 19.5 % ndërsa meshkuj ishte 57.6 %. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë është 50.6 %. Papunësia afatgjate e të rinjve (15-19 vjeç), që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj për këtë tremujor është 39.8 %. Përqindja e të rinjve që nuk janë të punësuar, as në shkollim, as në trajnim – NEET (të intervistuarit e moshës 15-24 vjeç), është 29.0 %.

Në kontekstin afatshkurtër dhe afatmesëm, me përmirësimin e perspektivave për zhvillim ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës, mund të ndërmerren disa veprime për zbutjen e

shkallës së papunësisë. Në sferën e arsimit dhe aftësisë duhet të bëhen ndryshime në mënyrë që të reflektohen më saktësisht nevojat e tregut të punës.

Në bazë të të dhënave, nga rapoertet Puna dhe punësimi:

- ✓ 45.4% e të regjistruarëve të papunë paraqesin një shkallë të regjistrimit të papunësisë mesatarisht rreth 37-41% nga popullata ekonomikisht aktive.
- ✓ Shkalla e ulët e punësimit dhe punësimit të të rinjve janë në gjendje alarmuese.
- ✓ Afro 60% e të regjistruarëve si të papunë i referohen nivelit të kualifikimeve për nga arsimimi si të “pa kualifikuar”.
- ✓ Funksionimi i lidhjeve ndërmjet arsimit/aftësisë dhe tregut të punës është i dobët.

Baza e shkathtësive është faktor me rëndësi që investitori i huaj e merr parasysh kur vendos se ku të investojë apo jo. Pa marrë parasysh përmirësimet e ndjeshme që janë bërë, ende ka sfida për të arritur relevancën dhe efektivitetin në arsim dhe trajnim, si dhe në vlerësimin e rezultateve të të mësuarit. Mungesa e shkathtësive relevante e kufizon edhe aftësinë e shumë njerëzve për të gjetur vend pune produktive dhe për të kryer mirë detyrat që kërkohen nga punëdhënësit. Arsimi dhe aftësimi cilësor që i përgjigjet kërkesave të tregut të punës janë shumë konsistente me përmirësimin e produktivitetit dhe konkurrencës.

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI (NË MUËRA)			
Pa shkollë	0.3	0.6	0.9
Fillor	33.2	9.8	43.1
Arsim i mesëm profesional	132.2	22.0	154.1
Shkollë e mesme gjimnazi	29.5	8.1	37.7
Terciar	65.9	39.3	105.3
Gjithsej	261.2	79.8	341.0
SHKALLA E PUNËSIMIT (%)			
Pa shkollë	4.0	3.4	3.6
Fillor	21.1	3.5	9.8
Arsim i mesëm profesional	47.4	13.4	34.8
Shkollë e mesme gjimnazi	42.1	13.2	28.5
Terciar	70.5	53.1	62.8
Gjithsej	43.0	13.3	28.2

Tabela 23. Punësimi sipas nivelit arsimor

Burimi : Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 2019

Tabela 23 tregon që sa më i lartë të jetë shkollimi aq më e lartë do të jetë mundësia për të u punësuar (62.8%), prandaj duhet ndryshimi i strategjisë së punësimit përmes arsimit të mesëm profesional të kalohet direkt në tregun e punës.

Në Kosovë, ofrimi i trajnimit profesional nga sektori privat, sektori joprofitabil dhe sektori publik ende nuk është sistemuar. Certifikimi tani ofrohet nga institucionet e trajnimit në bazë të organizimeve të testimit dhe provimeve të cilat janë shumë variabile. Këta faktorë momentalisht përbëjnë një pengesë si për ngritjen e standardit të cilësisë në sistemin e trajnimit në Kosovë dhe në njohjen e shkathtësive, njohurive dhe kompetencave të fituara jashtë programeve formale mësimore.

Trajnimi për të papunët ende mbetet i kufizuar. Programet e trajnimit për tregun e punës kryhen dhe përcaktohen përmes një rrjeti të tetë qendrave të trajnimit profesional dhe një

numër të institucioneve të trajnimit në partneritet me MPMS. Përkundër që këto këto programe janë përmirësuar në cilësi dhe sasi, ato ende u shërbejnë vetëm një numri të kufizuar të kërkuesve (më pak se një për qind të të papunëve të regjistruar) dhe fleksibiliteti dhe relevanca e tyre nuk e mbajnë hapin me kërkesat e tregut të punës që ndryshojnë vazhdimisht¹. Nuk ka as sistem të vendosur për të matur se sa janë relevante dhe ekonomike trajnimet e tilla. Duke u bazuar edhe në të metat e politikave të punësimit nga MPMS të cilat i ka raportuar edhe Zyra Kombëtare e Auditimit, del numri i vendeve të lira të punës gjatë viteve 2016-2018 ka qenë shumë i ulët në krahasim me kërkesën për punë. Gjatë këtyre viteve kanë qenë në dispozicion vende të lira të punës për vetëm mesatarisht 14% të të papunëve të regjistruar. Planifikimi i buxhetit i MPMS për realizimin e MATP (Masat Aktive të Tregut të Punës) ka qenë i mangët për shkak se buxheti i planifikuar nuk i përgjigjet kërkesave të numrit të lartë të papunëve aktiv. Rregullorja për MATP e përpiluar nga MPMS për disa prej masave aktive siç janë subvencionimi në pagë, trajnimi në punë dhe puna publike, e rregullon prioritizimin e të papunëve afatgjatë. Por këto nuk janë zbatuar me sipas normative rregulluese, pasi alokimi i tyre ka shkuar në distancione tjera të kësaj ministrie.

Ndryshimet në procesin e certifikimeve, mënyrën dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së tyre, evidentim më të saktë të kërkesave të tregut të punës, politika të reja strategjike nëpër sektore të ndryshme sidomos për ato në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), përkrahje më e madhe nga financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës (ku në vitin

¹ Sipas një studimi përcjellës të kryer nga OBP në vitin 2007, vetëm 27% të të diplomuarve nga shkollat ATP në vitin 2006 kanë gjetur punë gjatë atij viti.

2007/2008 është vetëm 0.1% të buxhetit të përgjithshëm është ndarë nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës për përkrahje për Programet Aktive të Tregut të Punës (PATP) mund të krijojnë mundësi të reja punësimi të cilat do të ndikonin në uljen e papunësisë. Kërkohej fuqizimi i mëtejshëm i kapacitetit të institucioneve të tregut të punës për të programuar, menaxhuar, implementuar, monitoruar dhe vlerësuar këto programe. Për më tepër, programet e tashme aktive të tregut të punës që ofrohen nga institucionet e tregut të punës fokusohen kryesisht në programe aftësimi dhe zhvillimi të shkathëtisë.

3.9 Masat prandaluese për braktisjen e shkollimit

Çasja në vazhdim të arsimit pas shkollimit të lartë të mesëm në shekullin XXI është e vetmja alternativ drejt sigurimit të një vendi pune sot, fenomen ky që në mbarë globin tokësor paraqet ndër problemet parësore krahas dukurive ekzistuese natyrore.

Mund ti parashtrijmë dy pyetje :

1. Me dinamikën e ritmit e ndryshimeve për vendet e punës sot mijëra të rinj konkurojnë në tregun e punës, por sa janë ata individ profesionist?
2. Sa këta individ i plotësojnë nevojat e tregut?

Sipas raporteve të nxjerruara më lartë mund të aludojmë në një përgjegje jo fort të kënaqme. Kështu, për një vend si Kosova kjo gjithësesi paraqet një shqetësim të madh, jo lehtë i tejkalueshëm. Andaj marrja e disa masave efektive janë më së të nevojshme. Prandaj, zhvillimi teknologjik dhe mënyrat e reja të aftësime profesionale mund të jenë çelës i suksesit drej destinacionit të të rinjve kosovar, që është punësimi.

Zgjedhja e ngritjes profesionale dhe përvetësimi i dijes për profesion, efikasiteti i cilësisë dhe orientimet drejt gjetjes së zgjidhjeve praktike, të cilat nuk do të kërkonin burime të konsiderueshme, mund të jenë indikator të cilët duhet të zbehin dukshëm përqindjen e lartë të papunësisë në vend, motivimin e të rinjve për të përvetsuar një zanat dhe njëherit të jenë promotor drejt zhvillimit ekonomik, stabilitetit financiar, qetësisë sociale dhe ndërtimit të shtetit që ec drejt integritit europian.

Sistemi aktual arsimor në Kosovë nuk plotëson nevojat për aftësim profesional të popullsisë më të re në Evropë, gjë që rezulton në numër të lartë të të rinjve të papunë, pa aftësi apo kualifikime të cilat kërkohen nga ekonomia globale në rritje.

Arsimi i lartë në përgjithësi dhe ai profesional në veçanti kanë mbetur prapa zhvillimit të biznesit dhe kërkesave të tregut të punës. Në këtë situatë kanë ndikuar një sërë faktorësh si infrastruktura jo adekuate shkollore, mungesa e punëtorive brenda shkollave në shumicën e rajoneve kosovare, strukturat e vjetra në shkollat e formimit profesional, struktura këto të cilat nuk i përgjigjen zhvillimit të sotëm të teknologjisë dhe kërkesave të ekonomisë. Fakti që ka mungesë të mjeteve për zhvillimin e praktikave profesionale në shkollat e Kosovës është evident dhe i qëndrueshëm. Mungesa e një marketigu të fuqishëm qeveritar për të treguar rëndësinë shoqërore të kësaj kategori edukativo-formuese është evidente. Një faktor tjetër është familja, që nuk i nxit të rinjët të ndjekin shkollat profesionale. Mos motivimi nga familja vjen si arsye se numri më i madh i fabrikave prodhuese nuk funksionojnë, pasi ato janë privatizuar dhe në të shumtën e rasteve e kanë zvogluar numrin e punëtorëve duke u shëndruar në ekonomi familjare, por ka edhe mjaftë raste kur ato kanë ndyshuar destinacion. Fakti që një pjesë bukur e madhe familjeve kosovare jetojnë me një buxhet

ekzistencial (numri i familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës sociale në vitin 2014 ka qenë 29.538 familje), pastaj mungesa e arsimit familjar (përqindja e popullsisë pa arsimim formal (nuk e kanë përfunduar nivelin e arsimimit të të mësuarit të shkrim-leximit) është 5,7% (sipas REKOS 2011)), janë disa faktor dëshmuar pse familja nuk është motivuese. Pra, kushtet bazë socialo-ekonomike të familjeve tona bëjnë që ato të mos janë aq kontribut dhënëse për motivimin e të rinjve për vazhdimin e shkollimit.

Të rinjtë duhet të fitojnë vetëbesimin dhe fuqinë e tyre kreative si dhe të shohin e po ashtu të shfrytëzojnë resurset lokale si bazë për zhvillimin e aftësive personale profesionale e cila është shtyllë dhe mundësi konstruktive për punësim dhe zhvillimin e karrierës. Kosova ka nevojë për qytetarë të formuar dhe edukuar më mirë, si edhe për një forcë pune më të aftë, me qëllim që të ndërtojë një shoqëri të së ardhmesë, bazuar në dije dhe profesionalizëm. Profesionalizmi sjell zhvillim ekonomik. Zhvillimi ekonomik i vendit në përgjithësi dhe atij lokal në veçanti mund të arrihet vetëm nëpërmjet formimit të një force pune të kualifikuar që si rrjedhojë do të përmbushë aspiratat e brezit të ri për zhvillim.

Grupi i moshës 15-24 vjeç ka shkallë të lartë të papunësisë nga totali i popullsisë prej 55.9%, ku breng e madh është përqindja e lartë e gjinisë femrore me 68.4% kundrejt 50.4% asaj mashkullore (tabela 24). Po ashtu e lartë dhe madje mjaftë shqetësuese është përqindja e të rinjve që nuk janë të punësuar, as nuk vijojnë shkollimin dhe as nuk ndjekin ndonjë trajnim (NEET) (Not in Education, Employment or Training) shifër kjo shprehur në përqindje është 35.3% e numrit të gjithmbarshëm të popullsisë ekonomisht aktive për punë në Kosovë, në proporcionin gjinor 40.9% femra ndaj 30.0% meshkuj. (Tregu i punës dhe papunësia në Kosovë, Raport Hulumtues, Riinvest, Janar 2003, Prishtinë.)

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)	Meshkuj	Femra	Totali
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	60.2	21.1	40.5
Shkalla e joaktivitetit	39.8	78.9	59.5
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	44.0	12.9	28.4
Përqindja e punësimit të cenusshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	25.0	18.9	23.6
Shkalla e papunësisë	26.9	38.8	30.0
Shkalla e papunësisë te të rinjtë (15-24 vjeç)	50.4	68.4	55.9
Përqindja e të rinjve NEET në popullsinë e të rinjve(15-24 vjeç)	30.0	40.9	35.3

Tabela 24. Indikatorët kryesorë të tregut të punës

Burimi : Rezultatet e Anketës së fuqisë punëtore 2013 në Kosovë, Nëntor 2014, Prishtinë

Bazuar në të dhënat statistikore europiane të vitit 2011, vendet e BE-së kishin një përqindje 21.4% për kategorinë NEET, ku disa nga shtetet si Gjermania, Danimarka, Austria e Holanda e kanë nga 6-8%, Republika Çeke mbi 15% që ndër vendet me përqindje shqetësuese për Europën së bashku me Spanjën rreth 20% (Eurofound 2012, NEETs – Young people not in employment, education or training: Characteristics, costs and policy responses in Europe, Publications Office of the European Union, Luxembourg.), rrjedh se intervenimet emergjente duhet të bëhen për këtë kategori të shoqërisë në Kosovë.

Më shumë se një e treta (35.3%) e personave të moshës 15 deri 24 vjeçare në Kosovë nuk janë në shkollim, nuk janë të punësuar apo nuk ndjekin ndonjë trajnim profesional. Papunësia tek të rinjtë është një problem i madh jo vetëm i shoqërisë kosovare, por edhe më gjerë. Ky është një problem i papërbalueshëm social për një vend në tranzicion, siç është Kosova. Ky fenomen mund të quhet lirisht si një kancer shoqëror pasi shuan ëndërrat e shumë të rinjve për prosperitet. Prandaj duhet ndërmarr disa masa parandaluese si shoqëri. Masa këto që duhet ta godasin problemin që në rrënjët e saj. Nëse shikojmë vendet e BE, si

shoqëri elitare e kohës, ato kanë mbri aty ku janë vetëm duke u mbështetur në edukim të mirëfiltë dhe me profesionalizim nacional të kërkesa të shteteve përkatëse. Andaj, si masa të tilla që mund të ndikojnë në zbutjen e kësaj dukurie aktuale të shoqërisë mund të jenë :

- ✓ Masat për parandalimin e braktisjes së shkollës parakohe nga të rinjt kosovar
- ✓ Masat për riintegrimin e tyre në arsimim
- ✓ Ndërtimi i politikave të tranzicionit shkollë-punë bazuar në sistemet arsimore të vendeve të BE
- ✓ Masat për të nxitur punësimin dhe masat për largimin e barrierave administrative në punësim

Masat për parandalimin e braktisjes së shkollës parakohe nga të rinjt kosovar – Në esencë hapi apo lëvizja fillestar që duhet të ndërmerret është të intervenohet para se këta të rinj ta lëshojnë shkollën. Të hulumtohet për arsyet e braktisjes së shkollimit nga kjo grup moshë, të bisedohet me prindërit dhe rrethin ku jetojnë. Në këtë proces mbështetës dhe social rol integrues duhet të luajnë edhe mësimdhënësit, pasi ata mund të dinë aryet e largimit të fëmijëve nga shkolla. Biseda duhet të zhvillohet hapur me anëtarët e familjes apo personat që janë përgjegjes për ta. Sipas reformatorit amerikan të edukimit Horche Mann, që njihet si krikues i shkollave publike dhe problemeve të saj, (themeloi e redaktoi edhe një revistë Journal Common Shool) citoi: “ Një mësimdhënës që synon të jap mësim pa frymëzuar nxënësit me dëshirën për të mësuar , i ngjan atij që rreh me çekan një hekur të ftohtë ”. (Mann, 2017). Mann ka përpiluar edhe gjashtë parimet që kryesisht kanë shënjestër që fëmijët të mos injorohen në shkollë, arsimi duhet të kontrollohet e paguhet nga njerëz që

janë të intersuarta avansojnë atë, populli nuk duhet të mbetet injorant, parimet e edukimit të një shoqërie të lirë, mësimdhësit të janë trajner profesional. Pra, të gjitha këto janë aktuale për shkollën tonë në mënyrë që nga mësimdhënësit si të parët që kanë kontakt me nxënësit deri tek strukturat ushëheqëse, dukepërfshirë edhe familjen duhet të fokusohemi në luftën që fëmijët në asnjë variant mos ta braktisin shkollim e tyre.

Të mësohet shkaku dhe arsyeja dhe pastaj si vijim të ndërtohet strategjia parandaluese, gjithmon duke pasur oferta motivuese për aftësim profesional. Të mbështet më shumë ambienti shkollor, si në planprograme, infrastrukturë dhe trajnim të personelit mësimor (nëse është shkak). Të ju mundësohet këtyre nxënësve edhe një shans i dytë për të qëndruar në shkollë apo t`ju mundësohet ndonjë alternativ tjetër ekuivalentuese që shpie drejt ndonjë trajnimit profesional përkatës në mënyrë që kjo pjesë e rinisë të ketë vullnet dhe ti rikthet aftësimin dhe ndërtimit të zhvillimit personal.

Masat për riintegrimin e tyre në arsimim – të analizohet dhe të shikohet mundësia e mbështetjes në kohë për të rinjtë të cilët sapo kanë vendosur të largohen nga shkolla apo nga trajnimet profesionale. Të hartohet një rregullore ku t`iu mundësohet këtyre nxënësve bashkangjitja në procesin mësimor me një program shtesë apo t`ju afrohet një trajnim alternativ që ata e dëshirojnë, respektivisht ku ata mund ta gjejnë vetveten dhe të jetë në përputhshmëri me kërkesat e tregut. Të ju sigurohet mjete të mjaftueshme financiare (pagesa transportit, ushqimit gjatë kohës së zgjatë trajnimit, mjetet e punës, siguria në punë,...) që këta nxënës apo kandidat të mos bëhen barrë e ekonomisë edhe ashtu të renduar financiare.

“Arsimimi e bënë një popull të lehtë për t’u udhëhequr , por vështirë për tu sunduar, të lehtë për t’u qeverisur por të pamundur për tu skllavëruar” (Brougham, 2017). Bazuar në këtë thënia të Henry Brugham, reformator politik anglez i shekullit XIX, mbi edukimin, edhe shoqëria udhëheqëse kosovare duhet ta bëjë të pamundurën që të parandalojë braktisjen parakohe nga shkolla, pavarësisht shkaqeve që ato ndodhin, në mënyrë që të gjithë të arsimohen dhe të bëhen pjesë e qeverisjes së lehtë.

Ndërtimi i politikave të tranzicionit shkollë-punë bazuar në sistemet arsimore të vendeve të BE – të krijohen masa për të lehtësuar kalimin në punësim. Në një fazë të më vonshme të aplikohet një strategji e ndërhyrjes me qëllim primar për të kaluar “nga të mësuarit në të punësuar me qëllim për të fituar”. Kjo gjithmon duke u siguruar se investimet publike në arsimim dhe trajnime profesionale janë duke shkuar rreth maksimalizimit të suksesit dhe qëllimit fundamental të saj që duhet të jetë zbutja e papunësisë dhe aftësimin profesional të rinjëve, pra rreth arritjes së objektivave arsimore–ekonomike të vendit, gjithmon duke respektuar paratë publike. Kjo mund të realizohet duke ngritur “pika koordinative lokale” apo qendrat për këshillim në karrier, bazuar në legjislacionin arsimor zvicerian (ndërkantonal apo kombëtar), e këto të formojnë një bazament esencial në tërë territorin e Kosovës. Këto pika koordinative këshilluese për orientim në karrier duhet ti motivojnë të rinjtë të paisjen me kualifikimin e duhur profesional, të vazhdojnë arsimin në shkollat profesionale si parakusht për tu përgatitur me një aftësi teknike dhe profesionale për karrier dhe si rrjedhojë të janë kandidatë serioz për tregun e punës. Kjo nënkupton që të gjitha institucionet në nivele komunale/lokale duhet biseduar me parterët e biznesit privat që të marrin të rinjtë në punë, dhe bizneset komunës t’ia paraqesin kërkesat e veta të interesit.

Këto pika koordinative nga na tjetër duhet t`iu garantojnë biznesit standardet e kërkuar në bazë të tregut të punës dhe seriozitetin profesional të personave të certifikuar. Komunitet të janë përgjegjëse për zbatimin e këtij legjislacioni dhe po ashtu përgjegjëse për organizimin e shkollave, sidomos të atyre profesionale mbështetur në kërkesat e tregut lokal. Por të gjitha palët duhet të kenë një akt juridik obligues. Në këtë mënyrë në gjithë vendin mund të ndërtohet një trekëndësh i partneritetit mes të rinjve të papunë - Komunitet – biznesit lokal. Nga ky kënd vështrim përfitues do të ishin të gjithë. Përfituesi më i madh do të ishte komuniteti pasi edhe do të rritej në mënyrë të vazhdueshme kërkesa për trajnime profesionale ose kërkesa për vazhdim të shkollimit, por në vijën horizontale do të ishte një sinjal i mirë që të rinjt mos ta braktisin shkollimin. Ky do të ishte një element shtesë për zhvillim ekonomik dhe menaxhim të mirë të jetës sociale në Komunitet. Por edhe biznesi do të përfitonte nga lehtësirat komunale si dhe stafi i tij i punës do të kishte më shumë punëtor të rinj, pse jo edhe më profesional. Por kontribut i tyre madhor do të ishte edhe investimi në të ardhmen ekonomike zhvillimore të vendit.

Masat për të nxitur punësimin dhe masat për largimin e barrierave administrative në punësim – këto masa duhet të kenë qëllim të vetëm arritjen e punësimit të të rinjve, masa këto për t`iu ndihmuar ndërmarrjet me disavantazhe specifike në tregun e punës. Ndërhyrjet politike-ekonomike që ndikojnë në aspektin e zvoglimit të barrierave praktike apo logjistike në punësim. Burokracia duhet zvogluar në minimum apo zhduket fare kur bëhet fjalë programet punëformuese dhe ato iniciativa që kanë një platformë mirë të organizuar në kuadër të certifikimit të qytetarit me licenca valide për tregun e punës. Qeveria mund ti lejoj autoritet lokale për të ushtruar ndikimin e tyre në qendrat profesionale apo t`iu jepet

autonomi e plotë mbi “pikat koordinative lokale” dhe zyrave këshilluese për përzgjedhjen e profesionit. Themelimi i këtyre zyrave këshilluese për profesion duhet bëhet me iniciativ komuale dhe mbështetur nga të gjitha strukturat e shoqërisë civile dhe profesionistëve të lëmive përkatëse. Në aspektin funksional, si të tilla këto zyra duhet të hartojnë strategji për zgjedhjen e trajnimeve prioritare komunale për të cilat ka treg pune dhe në caktimin e afateve kohore, si dhe ajo që është kryesorja të ketë kompetenca në licencimin konform standarteve europiane, me shkallë niveluese me vendet e BE-së. Krahas saj kjo duhet përkrahet me një buxhet përmbushës nga Qeveria përkatësisht Ministria e Financave (MF), Ministria për Zhvillim Ekonomik (MZHE), MPMS, pse jo edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), si strategji e ngritjes së kapaciteteve të arsim në vend sidomos atij profesional, pra të janë shtytje për vet MASHT-in. Por edhe organet komunale duhet përpiluar projekte për të fituar donacione apo grante të cilat mund të përkraheshin nga fondacionet ndërkombëtare. Kjo duhet të ndodhë patjetër pasi komuna (në këtë platformë) po paraqitet si organ ndërmjetësues mes biznesit lokal dhe organeve vendimmarrëse shtetërore të nivelit ekzekutiv dhe juridik dhe partnerëve tjerë të kualifikimit të qytetarit. Biznesi lokal kërkon staf profesionist apo gjysmëprofesionist varësisht nga vendi i punës. Të rinjtë kërkojnë punë, komuna prosperitet dhe zhvillim ekonomik. Pse të mos ketë koordinim mes tyre me shtetin si garantues dhe hartues i një platforme juridikisht obligative mes palëve..

Çdo zyrë këshilluese e përzgjedhjes së profesionit, e cila duhet patjetër të themelohet nën ombrellën e pushtetit lokal, duhet të zhvillojë një partneritet aktiv me shkollat e mesme të larta (si gjimnazet dhe shkollat profesionale por edhe me qendrat e kompetencës), me

punëdhënësit lokal dhe të bëjë koordinimin mirë të menduar, bazuar në analiza të mirëfillta, mes sektorëve për hartimin e strategjive për ti këshilluar të rinjt, për ti ndihmuar ata, për të hulumtuar aftësitë e tyre dhe të sigurojë trajnime profesionale adekuate bazuar në kërkesat e tregut të punës që në këtë mënyrë të mundësohet punësimi eventual i tyre.

Profesor Qemajl Buçinca në librin e tij “Menaxhimi i prodhimit” ka elaboru orientimin dhe seleksionin profesional si vijon:

Orientimi profesional ka të bëjë me hulumtimin e kërkesave të cilat parashtrohen nga vendet e punës dhe zgjedhja e punëtorëve të cilët më së miri i plotësojnë kërkesat e vendeve të punës, nga aspekti profesional dhe aftësitë psikofiziologjike të vendeve të punës, përkatësisht profesionit. Seleksionimi profesional studion aftësitë profesionale me veti të caktuara psikofiziologjike, të cilat i plotësojnë kërkesat e vendit të caktuar të punës, përkatësisht të profesionit të caktuar. Me seleksionim kërkohen punëtorët më të aftë, që në kushte të caktuara të vendeve të punës të japin prodhimësinë më të madhe, me pasoja sa më të vogla psikofiziologjike për organizmin e tyre. Sepse një njeri mund të jetë i paaftë për një punë, por mund të jetë shumë i aftë për punën tjetër. Orientimi profesional dhe seleksionimi profesional plotësohen reciprocikisht dhe duhet të bëhen mbi baza shkencore. (Qemajl Buçinca, Menaxhimi i prodhimit, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2008, fq 270-271).

Për këtë qëllim dhe me këto punë duhet të mirret zyra këshilluese si një organ institucional profesional i ndërtuar nga ekspert të fushave të ndryshme dhe me një eksperiencë të madhe. Inovacionet bazuar në analiza të mirëfillta nga terreni, thirrja e bizneseve për të investuar në aftësim profesional, strategji në nivel të eksperteëve të fusave përkatëse duhet të jenë ca nga detyrat e kësaj zyreje të karrierës profesionale.

Autonomia më lartë në nivelet e pushtetit lokal nga Qeveria për AAP-të, si përkrahja më e madhe financiare e këtyre të fundit do të ishte faktor kyç për zhvillimin e rajoneve në veçanti. Po ashtu ana tjetër e medaljes në aspektin pozitiv do të ishte se edhe do të forcohej kriteri i përgatitjeve profesionale tek të rinjt, do të shtohej motivi tek ata, do fitohej besimi i tyre në strukturat udhëheqëse shtetërore, do parandalohet emigracioni ilegal në mesin e

tyre. Kjo në veçanti do të arrihej me programet zhvillimore që si pasojë pozitive do ta redukonte numrin e të rinjve NEET në listat e veta në nivelin lokal, gjegjësisht në vend. Me ndërmarrjen e këtyre hapave parimor pasiguria ekonomike duhej të zvoglohej dukshëm dhe nuk o të kishte konfuzione të pafundme rreth të ardhmës në vend.

3.10 Sfidat e shkollave profesionale në Kosovë

Argumentete e shumëta që dalin nga hulumtimet e ndryshme të kryera në Kosovë sjellin deri tek një përgjegje negative se mbi 18% e shkollave profesionale nuk ofrojnë nxënie të bazuar në praktikë për shkak të mungesës së infrastrukturës respektivisht punëtorive brenda objektit shkollor dhe mungesës së mekanizmave për të arritur bashkëpunimin me ndërmarrjet që mund të akomodojnë një numër të caktuar të nxënësve si pjesë e orëve të praktikës. (Instituti Pedagogjik i Kosovës në vitin 2011). Përqindja e nxënësve që nuk kalojnë nëpër asnjë lloj praktike gjatë procesit mësimor është relativisht e lartë dhe është raportuar se kjo është rreth 40% e të gjithë nxënësve të shkollave të mesme profesionale. Si rezultat i drejtëpërdrejtë i kësaj, këta nxënës do të hyjnë në tregun e punës si të paftësuar ose pak të aftësuar, duke pasur kështu perspektivë shumë të ulët për të gjetur punësim, dhe për rrjedhojë, do të bien në kurthin e varfërisë. Varfëria sjell demotivim, demotivimi sjell emigrimin e cilit do lloj, e si pasojë shteti humb forcën rinore punuese. Shteti privohet nga arma e saj më e fortë për të ndërtuar një shtet me stabilitet të qëndrueshëm ekonomik.

Mungesa e punëtorive brenda objekteve shkollore është penalizimi më i madh që kanë shkollat profesionale sot në Kosovë. Mungesa e literaturës është një ndër pengesat më serioze që sot ballafaqohet shkolla profesionale kosovare. Përdorimi i literaturave të pakëta

ekzistuese nuk sinkronizohet fare me realitetin e kohës, gjë që pamundëson të mësuarit efikas. Përkundër asaj që një pjesë e mirë e shkollave janë të paisuara me kompjuter, kanë qasje në internet, por përdorimi i tyre zakonisht ju mundësohet vetëm profilit të teknologjisë informative apo kur mbahen orët e TIK-ut. Kjo është shumë larg asaj që pretendon qeveria – shkollë digjitale. Literatura pothuajse mungon tërësisht tek shkollat profesionale teknike dhe aty përdoren dispencat e krijuara nga vet mësime të bazuar nga materialet e internetit apo librat tjerë. Në të mirën e rasteve përdoret literatura e adaptuar e fakulteteve adekuate të profileve përkatëse të sinkronizuar me vulnetin e mësimeve. Por një gjë e tillë është e pamjaftueshme për ngritje të cilësisë, kur kësaj i shtohet se akoma ligjeratat diktohen në disa lëndë të caktuara!

Mungesa e politikave strategjike ndërtimin e kurrikulave adekuate të shkollave profesionale, tjetër faktor që brengos. Disa nga shkollat akoma nuk kanë kurrikula mësimore.

Financimi i dobët i shkollave profesionale dhe mungesa e autonomisë së plot buxhetore, kur dihen specifikat e këtyre shkollave për mirëmbajtje janë pasojë e buxheti të vogël në nivel qendror. Kufizimet janë se buxheti i Kosovës në vitet e fundit ka rritje shumë të vogël nga 1.316 miliard euro në vitin 2013, në vitin 2015 ka arritur në 1.76 miliard euro, ndërsa në vitin 2016 pritet të jetë rreth 1.6 miliard euro, që nënkupton rritje jo aq premtuese për ndryshime rrënjësore në afat të shpejtë. Duke ditur se shpenzimet publike në arsim në nga viti 2011 kanë qenë 4.06 % e BPV, ndërsa në vitin 2019 4.1% atëherë realizimi i synimeve për një shkollë europiane duket jo i afërt. Sektori i arsimit në Kosovë për vite me radhë është përballur me probleme të mëdha dhe pa përmirësim të duhur në fusha të caktuara. Institucionet e vendit ishin kritikuar për mosndarje të mjaftueshme të

mjeteve financiare për arsimin. Nga 2.3 miliardë euro të buxhetit të Kosovës në vitin 2019, për shpenzimet në arsim ishin ndarë jo më shumë se rreth 300 milionë euro. Dihet mirë se shkollat profesionale teknike dhe kërkesat e tyre jnaë dukshëm më të shumëta në krahsim me vet shkollat tjera profesionale, e financimi i tyre është potuajse më vogël.

Për më tepër, shkollat profesionale kanë edhe një mori të problemeve tjera me buxhet. Për shkak të karakterit të tyre praktik, ku për shembull nxënësit duhet të mësojnë të qepin apo të përdorin makineri, shkollat profesionale kanë nevojë për një buxhet më të lartë për t'i blerë dhe për t'i mirëmbajtur këto pajisje. Momentalisht, një diferencim i tillë në buxhet ndërmjet shkollave deri më tani nuk ndodh. Si rezultat, përkundër nevojave më të mëdha, shkollat profesionale marrin të njëjtat fonde si shkollat tjera. Për më shumë, ashtu si të gjithë shkollat tjera ato kanë pak autonomi për fondet e tyre. E meqë shkollat profesionale kanë nevoja më të ndryshme, mungesa e autonomisë në buxhet kufizon mjaft punën e tyre. Gjithashtu, njëjtë si shkollat tjera, edhe shkollat profesionale ballafaqohen me shumë procedura të prokurimit. Duke pasur parasysh nevojat praktike të këtyre shkollave, këto procedura shpesh vështirësojnë punën e shkollave profesionale dhe rezultojnë në vonesa apo mungesë të mjeteve të punës. (Pozhegu, 2016)

Kosova vazhdon të vuaj nga një sistem arsimor i cili në të gjitha nivelet çalon në fokusimin e nevojave pedagogjike dhe të aftësimin të nxënësve për treg, respektivisht nevojave të ekonomisë. Kosova mbetet ekonomia më e varfër në rajon dhe përballet me nivele të larta të varfërisë, papunësi masive që në mesatare llogaritet të jetë 45%, për dallim për shembull nga Maqedonia me 33%, Bosnja dhe Hercegovina 23%, Serbia afër 20%, Mali i Zi dhe

Shqipëria me 14%), varësia e rëndë nga importet dhe me sektor shumë të vogël të eksportit, dhe me mungesë të strategjisë të aftësimeve profesionale bazuar në standartet europiane.




Figura 32. Shkalla e papunësisë në rajon 2000-2011

Problem kyç është infrastruktura shkollore dhe paisjet përcjellëse, numri i madh i ekonomisë informale dhe mungesa e autonomisë së mjaftueshme të menaxhmetit të shkollave në kuadër të qeverisjes së mjeteve financiare. BHV (Bruto të hyrat kombëtare) për kokë banori llogariten në 2885 euro, dhe kështu Kosova radhitet në vendin e 93-të në botë, prapa Maqedonisë, Shqipërisë, Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës (Banka Botërore, Treguesit e Zhvillimit Botëror 2012).

Papunësia e të rinjve sillet rreth 70%, që mund të jetë potencial për trazira, në veçanti duke ditur se më shumë se gjysma e popullsisë është nën moshën 25 vjeçare dhe rreth 21% e tyre janë të moshës prej 15 gjerë 25 vjeçare. Banka Botërore llogaritet se 34% e popullsisë së

Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë me të hyra 45€ apo 60\$ në muaj (Banka Botërore, Treguesit e Zhvillimit Botëror 2012). Duke u përballur me këtë realitet të papunësisë dhe të varfërisë, nuk do t'ia tepronim po të themi se stabiliteti dhe perspektiva zhvillimore e Kosovës varen kryesisht nga krijimi i vendeve të punës dhe ndryshimet sasiore të shkollimit profesional.

Marrja e vendimit për zgjedhjen e investimit prioritar, atëherë kur duhet vendosur me mjetet e caktuara se çka dhe kur të investohet, ka rëndësi vitale, sepse marrja e vendimeve të gabueshme ka pasoja afatgjate në organizimin e strategjive arsimore. Investimi në AAP, në objektet shkollore, mjetet e punës dhe paisjeve tjera shkollore, përgatitja e kuadrove të reja sipas kërkesave të vendeve të reja të punës do të ishte një program investiv për të ardhmen dhe një projekt i realizueshëm me qëllim kryesor zbutjen e ndjeshme të papunësisë përmes krijimit të të riut profesionist për tregun e punës.

3.11 Ndryshimi i strategjisë në shkollat e mesme të larta profesionale në Kosovë

Ka ardhur koha të përballemi teorikisht dhe praktikisht me rrugën që do të duhet të ndjekim edhe në këtë fushë. Ka ardhur koha të adaptojmë një koncept të ri bashkëkohor dhe pikërisht edukimin profesional.

Kërkesat e tregut sot ndryshojnë dhe së bashku me to me trend të njëjtë duhet ndryshuar edhe strategjia e në shkollat e mesme të larta profesionale gjegjësisht kurrikulat mësimore në përgjithësi, mënyra e organizimit të praktikës profesionale në veçanti. Inkuadrimi dhe përkrahja e biznesit privat do të mundësonte mbajtjen e praktikave aftësuese me një metodologji e teknologji të kohës.

Strategjitë e arsimit duhet të ndyshojnë për të mirë dhe ky ndryshim duhet të jetë shumëdimensional. Asimetria mes teorisë dhe praktikës, duhet të ndryshojë në disfavor të teorisë, pra duhet bazuar në sistemin dual gjerman të aftësimeve profesionale. Me ritjen e fleksibilitetit të sistemit arsimor drejtë përmbushjes së kërkesave të tregut të punës dhe me përmisimin e cilësisë arsimore, duhet të krijohet një zingjir i strategjive për një aftësim dinjitoz të të rinjëve në mënyrë që të kanë një të ardhme të sigurtë në vend.

Bazat e një sistemi modern dhe me cilësi të lartë të AAP në përputhje me standarteve europiane mund të arrihen vetëm nëse kombinohen qendrat e trajnimeve profesionale dhe shkollave të larta të mesme profesionale për të ofruar shërbime kualitative që mundësojnë punësim. Strategji e re do të jetë përfshirja masive dhe aktive e sektorit privat për të punuar në një qasje të përbashkët, respektivisht në partneritet me strukturat shtetërore. Bashkëpunimi intenziv me kompanitë prodhuese apo shërbyese mund të sjell vullkan mendimesh në të ndërtuarit e planprogrameve të reja të veçanta për shkollat profesionale që si destinacion final kanë tregun. Të gjithë duhet të kontribuojmë për të mirën e edukimit dhe ekonomisë kosovare. Vuajtja e integritetit arsimor të Kosovës karshi vendeve të BE-së është shpërfilja që i bëhet në vepër AAP, mungesa e financimit autonom nga shkollat profesionale si rezultat i mungesës së ideve dhe shumë çka tjetër. Mozaiku i këtij sistemi shkollor nuk mund të plotësohet pa përfshirjen e biznesit në qendër të saj. Argumenti i mungesave në investime të mirëfillta në punëtoritë e shkollave të mesme profesionale vërehet qartë nga buxheti që ato posedojnë. “Presioni” pozitiv ndaj ligjëvënësve shtetëror dhe ndarësve të buxhetit duhet të jetë vet raporti i rezultateve të maturës që nxënësit e shkollave profesionale tregojnë, që mjerisht është minimal kundrejtë moshatarëve të tyre në gjimnaze,

sidomos në shkollat teknike. Por ky debalancim i rezultateve vjen edhe si pasojë e testit jo adekuat për shkollat profesionale. Pra, kompanitë biznesore mund të ofrojnë participim dhe ta zbusin ngarkesën financiare karshi sistemit shkollor profesional. Plani afatgjatë për të garantuar sukses drejt europianizimit të sistemit shkollor në Kosovë është integrimi i biznesit në thelbin e saj. Ky do të ishte një mesazh për gjithë shoqërinë. Eksperiencat e vendeve të BE lehtësisht mund të jenë të zbatueshme edhe tek ne. Një pako e re legislative me lehtësira tatimore apo një formë tjetër ekonomike duke suportuar kompanitë e përfshira në trajnime, do të ishte një injeksion motivues për bizneset që të investojnë në shkollimin e të rinjve respektivisht përgatitjes së tyre për treg të punës.

Logjika investuese, ndarja e buxhetit, legjislacioni, dhe zbatimi i fakteve në teren janë interes i përgjithshëm shtetëror i institucioneve vendimmarrëse të të gjitha niveleve në vend, nëse dëshirojmë të kemi arsim cilësor dhe zhvillim ekonomik. Grumbullimi i problemeve në arsimin kosovar pothuajse është në pikën maksimale të saj (duke mos harruar edhe problemet në edukimin terciar e akademik). Deklarimet se do të investohet, AAP janë prioritet shtetëror apo diçka të tilla nuk zgjedhin problemet e AAP-ve, aq më shumë problemet për aftësimin e të rinjve sot.

Shteti duhet të garantojë një sistem arsimor funksional dhe modern, i cili u përgjigjet nevojave shoqërore dhe ekonomike. Shkollimi me bazament profesionist rrjedhimisht si rezultat do të kishte prespektiv ekonomike dhe si pasojë pozitive e saj do të kishim ulje të papunësisë që horizontalisht do ta ndalonte edhe migrimin e rinisë drejt perëndimit, dukuri e shprehur shumë kohët e fundit në Kosovë. Qeveria e Kosovës dhe menaxhmenti lokal qeverisës duhet ta kanë kuptuar se arsimimi dhe aftësimi profesional si faktor që ndikon në

ekonomin e tregut duhet të konsiderohet element bazik në politikat zhvillimore dhe duhet përpiluar strategji me programe tipike të tregut të punës.

Në këtë aspekt shteti duhet të rrisë bashkëpunimin me sektorin privat, pasi ky sektor është faktor kyç i zhvillimit ekonomik të vendit. Shteti në objektet shkollore duhet ndërtojë kushtet e nevojshme për pjesën praktike brenda shkollës, përgatitjen e kurikulave të reja në raport me tregun e punës, ndërsa sektori privat apo biznesi duhet të marrë përgjegjësi për lidhjen përmbajtësore dhe praktike me trendet e punës. Me fjalë tjera duhet të bëhet një menaxhim konform standardeve europiane i praktikave profesionale. Ndarja e aseteve me biznesin mund të tërheq edhe investitor të llojeve të ndryshme. Detyra bazë shtetërore në sektorin arsimor është orientimi sa më i saktë i të gjitha mjeteve dhe instrumenteve që disponon në autoritet publike drejt realizimit të disa objektivave themelore, në dobi të gjithë komunitetit, në këtë rast drejt aftësisë të rinjve për punë dhe rritjen e nivelit të punësimit që njëheritë do ta stimulonte rritjen ekonomike në vend. Përparësitë dhe interesi do të jetë i shumanshëm. Ekspertet arsimor duhet të vendosin politika të progresit edukativo-arsimor dhe teknologjik për të mundësuar një transformim në programet aftësuese profesionale, që ato parim esencial të ndihmojnë procesin e prosperitetit ekonomik dhe ndikojnë në zbutjen e papunësisë në vend.

Përvojat europiane tregojnë se shkollimi profesional nuk shpërndan spontanisht progres dhe mirëqenje sociale, por ato duhet kërkuar ndërmjet ndërtimit të strategjive dhe politikave progresive në çdo vend bazuar në specifikat e tij.

Duke marrë parasysh botën profesionale e cila ka një dimension global në ndryshim të vazhdueshëm dhe rritjen shpërthyesë të informacionit, thjeshtë nuk mjafton një hapje e një profili profesional në shkollat e mesme por fokusimi në përvetësimin e fakteve që familjet ti udhëzojnë fëmijët e tyre drejtë regjistrimit në këtë lloj edukimi. Faktet tani për tani mungojnë

Në këtë proces duhet të kyçen të gjithë menaxhmenti i shkollave profesionale, Zyra për Bashkpunim Ekonomik në Arsimin e Aftësimin Profesional (OECVET), Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), bizneset, DKA-të, kryetarët komunal, Këshillet prindore të shkollave që ti informojnë prindërit për të mirat që sjell ky nivel shkollimi d.m.th. se fëmijët e tyre do të fitojnë përvojën elementare praktike në lidhje me profilin profesional. Ky duhet të jetë hapi imediat pasi statistikave tregojnë tendenca rënje të shkollave profesionale kundrejt gjimnazeve në vitet e fundit. Informacioni duhet ketë përmbajtje thelbësor të detajuar pasi si fëmijët ashtu edhe prindërit duhet të njëftohen me përparësitë që sjell shkollimi profesional. Të gjitha këto atyre duhet t`iu argumentohen me gjuhën e statistikave dhe raporteve si për zhvillimin profesional të nxënësve ashtu edhe për kërkesat e tregut dhe reformat e mundëshme arsimore në dobi të këtij shkollimi.




Figura 33. Nxënësit në shkollat e mesme të larta shprehur në përqindje

Burimi : Autori

Të informohen prindërit se me këtë shkollim mundësohet zbutja e hendekut mes qytetit dhe fshatit (nga statistikat e vitit 2011 në fshatëra jetojnë 61.7% e popullësisë së Kosovës)(Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2014,Maj 2014,Prishtinë) pasi që oferta edukativo-arsimore ka qenë minimale në zonat rurale dhe njëkohësisht degraduese për bizneset në ato zona, që si pasojë ka ardhur edhe tek mbi popullimi i qyteteve, që mbërthen një problem tjetër të veçant në vete. Kjo fushat sensibilizuese duhet të bëhet në shkollat 9-vjeqare. Ndhma e qendrave për këshillim dhe orientim në karrierr duhet të jep maksimumin e vet në këtë aspekt për mes sensibilizimit të argumentuar mbi profesionin.

Sfidat apo kufizimet nga ana e prindërve dhe fëmijëve mund të jenë të tilla se mjedisi ku zhvillohen praktikat profesionale nuk janë të sigurta për fëmijët e tyre, shqetësimet së ata mund t'iu nënshtrohen abuzimeve fizike nga bizneset. Por shoqëria jonë tashmë është rrugës së vendosjes së konturave të shtetit përmes legjislativit dhe mbrojtja ligjore është

obligim nacional, kjo duhet t`iu bëhet e qartë të gjithëve. Profesori amerikan në Universitetin e Bostonit, SHBA thotë “ është e mundur dituria të krijoj probleme, por ato nuk mund ti zgjidhim ndërmjet paditurive. (Asimov, 2017). Sa do që mund të lindin probleme për ngritjen profesionale tek të rinjët në fazat e para të saj, ato përmisohen gjatë rrugës dhe nuk përbëjnë ndonjë rrezik shqetësues sa kur i riu mbetet pa shkollim , pa profesion dhe gjithmon është jo kandidat për treg pune. Ligjet e punës mbrojnë të gjithë.

Doracakut informues mbi të mirat e edukimit elementar profesional dhe vemendja e mediave elektronike do të kishin rol pozitiv në sensibilizimin e interesimit të prindërve që fëmijët e tyre ti orientojnë në shkollat profesionale, pasi Kosova është duke e ndërtuar strategjinë e zhvillimit të saj ekonomik mbi aftësitë dhe shkathtësi profesionale. Fëmijëve të familjeve me asistencë sociale duhet që t`iu sigurohet transporti, shujta ditore gjatë kohës së praktikave profesionale dhe mbrenda mundësive edhe bursa solide për shkollim. Fëmijëve me aftësi të kufizuara duhet ofruar ambiente të veçanta për trajnime dhe aftësi profesionale në kuadër të shkollave profesionale dhe paragrafe speciale në kontrata me bizneset respektivisht ndërmarrjet që ofrojnë praktikën profesionale. Kjo kategori e shoqërisë fatëkeqësisht nuk është e pakët.

Shfrytëzimi i të gjitha mundësive financiare për të ndërtuar sa më shpejtë strukturën zhvillimore në shkollimet profesionale, mbështetja e bizneseve që përkrahinë dhe zbatojnë praktikat profesionale, informacioni sensibilizues kombëtar dhe infrastruktura shkollore do të ishin komponim drejt ngritjes së vazhdueshme të procesit të aftësimit profesional. Në të gjitha këto sfera qeverisja kosovare duhet të adresohet me urgjencë nëse populli i

Kosovës dëshiron të shfrytëzojë potencialin e vet të plotë si individ dhe qeverisja e saj si shtet.

Identifikimi dhe ribërja në kushte moderne e profesioneve, kurikulat e orientura në praktikë, kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë mësimore, certifikimi profesional, autonomia financiare e shkollave të mesme profesionale , kooperimi me botën e biznesit janë strategji europiane për një shtet të ri european siç është Kosova.

3.12 Inkuadrimi i biznesit si partner në praktikat shkollore

Sistemi gjerman përcaktohet nga disa karakteristika mjaft unike. Së pari, trajnimi me bazë firmën respektivisht kompanitë i nënshtrohet standardeve të përcaktuara në nivel kombëtar lidhur me përmbajtjen dhe cilësinë e aftësive. Së dyti, një gamë të gjerë e kompanive marrin pjesë në formimin e aftësive profesionale dhe, së fundi shteti ofron mbështetje por bazohet në stimulim të sektorit privat për të sponsorizuar trajnimet federale. E ardhmja e Kosovës është integrimi në familjen europiane, si hap i parësor duhet të jetë edhe përvetsimi i praktikave të tyre të sukseshme në ngritjen e kapaciteteve profesionale tek të rinjve gjegjësisht arsimit profesional i tyre.

Objektivi kryesor i programeve profesionale është zhvillimi i kapaciteteve të të rinjve për të miratuar dhe zbatuar mendime suksesi, të vlefshme dhe të pavarura në lidhje me zgjedhjen e shkollave dhe profesioneve, dhe për të planifikuar karrierë dhe të bashkohen me botën e punës.

Mësimi praktikë, shërben për të rritur njohuritë dhe shkathtësitë dhe është pikë kyçe në mes të shkollës dhe ekonomisë, si dhe kontribon direkt në ngritjen nxënjes profesionale tek të rinjt. Praktika është edukim në karrier dhe po ashtu ngrit dukshëm marketingun e

shkollave profesionale gjë që ndikon në imazhin pozitiv të tyre, si pasoj mund të ketë motivimin e gjeneratave që vijin për të ndjekur këtë lloj shkollimi. Zgjedhjet e profesionit janë vendimet të cilat na orientojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e jetës. Të rinjt në vitet e adoleshencës janë një periudhë kur në para tyre janë kryqëzimeve të jetës dhe numrit më të madh të ndryshimeve. Intensiteti dhe domosdoshmëria e zgjedhjes dhe dilemat me të cilat ata përballen nuk ndodhin aq shumë në çdo periudhë tjetër të jetës së tyre. Kjo është periudha kur me vendime dhe ndryshime ata mësojnë shumë dhe për këtë arsye është e nevojshme për krijimin e kushteve për të sjellë vendimin më të mirë për veten dhe për zgjedhjen e profesionit. Zgjedhja e profesionit është një nga vendimet më të rëndësishme në jetë dhe ndikon në cilësinë e jetës dhe punës në të ardhmen. Prandaj marketingu duhet të jetë sensibilizues dhe shumë i kurtarë në mënyrë që të rinjve t`iu lehtësojë zgjedhjen e dilemës që ndodhet para tyre. Puna profesionale dhe teknologjia sot jo vetëm që kanë bërë ndryshime në kërkesat e kualifikimit por ato kanë ndryshuar tashmë dhe kërkesat për orientim profesional, prandaj çdo këshillë mbi zgjedhjen e profesionit do të ishte një mendim pozitive për të rinjt. Këshillimi dhe orientimi profesional duhet të meret thjeshtë nevoj e kohës për ngritjen e vetdijesimit tek të rinjt mbi të ardhmen profesionale të tyre.

Kjo strategji mund të jetë faktor esencial për gjetjen dhe rritjen e mundësive për partneritetet mes bizneseve lokale dhe regjionale me shkollat profesionale në favor të profesionalizmit sa më të madh të nxënësve. Kjo metodologji arsimore mund të realizohet me anën e mbajtjes së ligjëratave dhe organizimin e mësimit në punëtoritë përkatëse nga ana e bizneseve, si edhe inkuadrimi i tyre në hartimin e planeve shkollore sidomos të orëve të praktikave profesionale. Biznesi duhet të jetë prezent edhe në bordet e shkollave. Bordet e

ndërtuara nga bizneset, personeli arsimor, prindi dhe përfaqësuesi komunal, do ti menaxhonin shkollat profesionale në bazë të kërkesave të tregut të punës dhe sipas standarteve europiane. Përfitmi dhe interesi do të jetë i dyanshëm. Biznesi duhet ti inkuarajoj nxënësit me informacione mbi shërbimet e punësimit, informacione për vendet e lira të punës, ndërmjetësimi për punësim dhe orientim profesional, module këto do të shtjelloheshin në të gjitha takimet e përbashkëta të bordeve shkollore. Politikat në arsim duhet të kërkojnë me ngulm integrimin sa më të mirë të shkathtësive kyçe në sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional, duke kujtuar që rritja e produktivitet vendor rritë punësimin, e rritja e punësimi ndikon në rritjen e zhvillimin ekonomik, dhe në këtë aspekt inkuadrimi i biznesit si faktor kontributdhënës është i pashmangshëm. Këto elemente kanë tendencë për të përforcuar njëra-tjetren. Memorandumi i bashkpunimit, do ti mundësonte sipërmarrësve ti bashkë menaxhonin shkollat respektivisht praktikat profesionale, do të ngushtonte edhe hapësirën mes të nxenit praktik dhe atij teorik, por edhe do të shkurtonin kostot e shkollave, por esenca kryesore e saj do të ishte se do ti ndihmonte të rinjt të bëjnë zgjedhje të zgjeruar për karrierën e tyre, që njëkohësisht do të hapte një rrugë vetëpunësimi dhe zotërimin e një biznesi si një alternativ e duhur për jetën e tyre. Praktikrat profesionale të cilësisë së lartë, që mundësojnë bizneset për shkollat rrisin mundësinë e vetëpunësimit të nxënësve, por edhe mundësin për punësim në vet bizneset që ata i trajnojnë apo aftësojnë praktikisht

Në anën tjetër ekonomia private, bizneset në kohën e nevojës së pranimit të stafit të ri, menjëherë ballafaqohen me nevojën për trajnimin e tyre për shkak të mungesës së përgatitjes së tyre dhe nivelit të ulët të arritjes së kompetencës gjatë shkollimit. Ndërlidhja e

biznesit me shkollat profesionale nënkupton për ta sigurimin e së ardhmës së tyre. Hapja e dyerëve të punëtorive të tyre për të rinjt dhe vullnet për ti përkrahur ata për të përvetësuar një zanat është një orientim i sigurtë edhe për prespektiven e sektorit privat. Ky është sektori ku duhet të jetë fokusi më i madh i të gjithë neve që duhet të shihet dhe trajtohet me kujdes për të përmirësuar nivelin e lartë të papunësisë. Sektor ky që ndikon në stabilitetin ekonomik në vend dhe mirëqenjen sociale të popullatës. Etika e biznesit është është përgjithësisht një disiplinë normative, kur standardet morale fillimisht përkrahen dhe më pas zbatohen. Ajo bën vlerësime specifike për atë çka është e drejtë apo e gabuar, duke pretenduar më tej edhe për atë çka duhet bërë dhe atë çka nuk duhet bërë. (Sopjani, 2009)

Nga bizneset varen si shoqëria ashtu edhe shteti, prandaj ai duhet të investoi në rini nëse dëshiron një punëtor të kualifikuar. Biznesi ka për synim realizimin e profitit duke kryer të gjitha punët për sigurimin e të mirave respektivisht produkteve (materiale dhe shërbimeve), këtë mund të realizon vetëm nëse në stafin e tij ka profesionist të mirëfillt. Partneriteti institucional mes shkollave dhe biznesit në shumë vende të zhvilluara europiane është çelësi suksesit, pse mos të jetë edhe për ne.

Strukturat qeverisëse të nivelit lokal por edhe të shtetit duhet të bëjnë analiza të mirëfillta mbi punën e kompanive të marra në shqyrtim gjegjësisht në bashkpunim me sektorin e arsimit dhe të për aftësim profesional. Dosja e punës së ndërmarrjeve duhet në përputhje me ligjet ekonomike dhe administrative. Ky do të ishte një hap konkret i lidhjes së botës së biznesit me edukimin. Shteti si bartës i ekonomisë dhe legjislacionit duhet të ndërtoi lehtësira të llojeve të ndryshme qofshin ato doganore, të taksave, fonde të posaqme për kreditim me kushte të volitshme apo beneficione tjera për biznesin i cili merr pjesë në

trajnimin edhe edukimin profesional të të rinjeve jo vetëm në shkolla por edhe në qendrat e aftësimeve profesionale. Biznesi me përvojën dhe kapacitetin finaciar që ka mund të ndikoj dukshëm në përmisimin e kushteve të punës nëpër puntoritë e shkollave, QAP-ve (Qendra e Aftësime profesionale) si dhe në strukturën programore. Por jo vetëm kaq ata kanë njohuri dhe mundësi që të rrisin edhe kapacitetin trajnues të mësimitdhënësve, si dhe të jenë gjerator i progresit edukativo – arsimor. Shteti duhet ta nxisë biznesin që të investoi në arsim profesional, por legjilativi duhet edhe të krijoj mundësitë që ai të mos ngurroi në investim dhe privilegje për to. Shembuj të këtyre bashkpunimve janë shtetet si Austria, Gjermania, Zvicra e gjetiu. Qeveria e Republikës së Kosovës është duke munduar ta gjejë rrugën e prosperitetit dhe duhet patjetër të ndërmarr masa për të mbrojtur interesin publik në përgjithësi e të arsimit të të rinjve në veçanti, por njëkohsisht ai duhet të krijojë mundësi të reale lehtësuese, atyre bizneseve apo ndërmarrjeve serioze që duan të hyjnë në rrugën e përbashkët për krijimin e të riut profesionist, që në mënyrë të drejtpërdrejt kjo si pasojë ka zhvillimin ekonomik të vendit dhe zbutjen e ndjeshme të papunësisë. Nuk jemi të mjerë pasi si shtet kemi mundësi të kufizuara buxhetore dhe ato janë të vogla për ndryshime të mëdha, por ne kemi arsenalin më të fort për krahasim, moshën e re, dhe ato mundësi duhet rreshtuar drejt profesionalizimit të rinisë sonë. “ Në një vend të qeverisjes së mirë, varfëria është diçka prej të cilës duhet pasur turp. Në një vend të qeverisur keq, pasuria është diçka prej të cilës duhet pasur turp. (Confucius, 2017)

Partneritetit mes biznesit dhe shtetit nënkupton edhe thellimin e reformave duke bërë një çiftim të shkollave profesionale me biznesin dhe ndërmarrjet. Kyçja e biznesit në bashkmenaxhimin e shkollave e ofron më afër biznesin me problematikën e këtij shkollim,

e bën më të përgjegjëm për të gjetur zgjidhje konkrete. E nga tërë kjo përfiton nxënësi duke iu përmisuar kushtet e shkollimit dhe duke ngritur shkathtësit profesionale.

Kosova duhet ndërmarr reforma shtesë në politikat arsimore, të studioi karakteristikat e tregut të punës në raport me kërkesat e biznesit. AAP është një shkollim mjaftë i shtrejtë prandaj investimi i biznesit në këtë arsimim duhet të jetë mëse i domosdoshëm si për shoqërinë ashtu edhe për shtetin dhe për vet ekonominë e vendit.

Qeveria duhet të ketë bashkëpunim simetrik me bizneset, pasi që atyre ju nevojitet përkrahje dhe njohje e kontributit të tyre për ngritjen e profesonalizmit të gjeneratave të reja dhe kjo mund të arrihet përmes beneficioneve që ju mundëson shteti në aspektin administrativ, fiskal apo edhe financiar. Qeveria e Kosovës, përmes Ligjit për AAP-të në bazë të nenit 33, paragrafi 3 sygjeron uljen e taksave për ndërmarrjet që pranojnë që të kryhet praktika profesionale në kompanitë e tyre. Ky është një hap i mirë fillestar drejt bashkpunimit.

Kufizimet mund të paraqiten të shumta në këtë aspekt pasi Kosova duhet të ndryshojë ligje të tëra se cilat biznese dhe në cilat sfera mund të gëzojnë beneficinet shtetërore, pregatiten kontratat reciproke, të sigurohen kushtet e punës dhe kujdesit për nxënësit pjesmarrës në ato praktika. Duhet të sigurohen edhe mjetet transportuese për transportin e nxënësve nëse ato ndërmarrje që ndodhen larg shkollave, siguria fizike e nxënësve gjatë aktiviteteve të praktikës profesionale.

Ndër atributet njerëzore padyshim se janë vlerat. Ato tregojnë arritjet dhe veçanërisht karakterizojnë dhe përcjellin individin gjatë jetës së tij. Prandaj përkundër barrierave që

dalim rrugës shteti duhet krijoj kushtet drejt lehtësira ndaj biznesit në favor të ngritjes së vlerave dhe aftësive profesionale rinore.

Nuk duhet ndalur përpjekjet e mëtutjeshme nga të gjitha niveleve dhe palët për të aftësuar të riun por edhe kualifikuar të pakualifikuarin drejt tregut të punës. Modelimi i strategjisë mbi simbolin e edukimit profesional do të ishte një arritje si për shtetin si organ legjislativ dhe për ndërmarrjet private si alternativa për punësim, në kohën kur kërkesa për punë jo vetëm tek ne por edhe regjion, është në rritje e sipër. Veprimet koordinuese mes shtetit dhe biznesit për zhdukjen sa më të madhe të barrierave ekzistuese në dobi të uljes së papunësisë, duhet të jenë veprime të hapura dhe konstruktive për shkollat profesionale, qendrat e trajnimit dhe qeverisjet lokale në të mirë të zhvillimit ekonomik. Bashkpunimi mes shumë faktorëve të ndryshëm ligjbërës dhe botës ekonomike mund të nxjerrin ligje të ndryshme favorizuese ekonomike që janë të vlefshme për fushen e administrativ, biznesit, arsimit tatimeve dhe ligje tjera staistikore që kanë destinim ngritjen profesionale me standarte të BE. Ky do të ishte një makro marketing për biznesi bërjen dhe aftësimin profesional me garntues shtetin legjislativ si promotor i zhvillimit ekonomik dhe zbutjes së papunësisë.

KAPITULLI IV – KOMUNA E GJAKOVËS SI RAJON GJEOGRAFIK STUDIMOR PËR RINDËRTIMIN E APLIKACIONIT PËR SHËRBIMIN E QYTETARËVE

4.1 Hyrje

Ky kapitull është i ndarë në seksione, ku secila nga seksionet do të përmbajnë nënseksionet përkatëse. Në pjesën fillestare të seksionit të Komunës së Gjakovës janë prezentuar të dhënat gjeografike të qytetit të Gjakovës. Krahas demografisë janë treguar edhe arsyet përse Komuna e Gjakovës është zgjedhur si rast studimor duke i shtjelluar arsyet. Numri i shkollave të mesme të larta profesionale me profilet e tyre, numri i nxënësve që ndjekin mësimin në këto shkolla përbëjnë vazhdimin e seksionit të parë. Në brendi të këtij seksioni është prezentuar Qendra Regjionale për Aftësi Profesionale në Gjakovë QRAPGJ me aktivitetet e saja, si dhe shkalla e aktivizimit të të rinjve gjakovar në trajnimet profesionale. Hapësirat respektivisht qendrat tjera që merren me trajnime, edukime dhe trajnime profesionale në këtë komunë së bashku me infrastrukturën që ato posedojnë, llojet e trajnimeve, projektet dhe numrin e kandidatëve që kanë, përmyllin nën seksionin e parë të kapitullit katërt. Në nënseksionin e dytë të të njejtit kapitull tregohet arsyeja pse është zgjedhur Komuna e Gjakovës si rast studimor për rindërtimin të këtij aplikacioni të menaxhimit të informacioneve komunale që është në shërbim elektronik të qytetarëve. Këtu argumentohet në mënyrë të detajuar arsyeja. Në nënseksionin e vijues tregohet roli dhe rëndësia e involvimit të biznesit në këtë sistem elektronik menaxherial. Në nënseksionin e katërtë tregohen dhe argumentohen arsyet pse komuna duhet të jetë bartëse e këtij projekti informativ dhe aplikativ. Në nënseksionin përfundimtarë respektivisht të pestin të këtij

seksionit të parë të këtij kapitulli tregohen të tri funksionet kryesore që do të arrihen me rindërtimi e këtij aplikacioni mbi sensibilizimin e aftësimet profesionale dhe shkollimit profesional të përkrahur nga biznesi e qeverisja lokale.

Pjesa e në vazhdim e kapitullit i takon tërësisht aplikacionit. Arsyeja pse duhet të rindërtohet aplikacioni. Kapitulli në vazhdim elaboron, qasjen në aplikacionin elektronik përshkrimin e punës konkretisht të shërbimeve që ofron aplikacioni aktual i KKGj. Skema funksionale dhe raportimet e problemeve përmes sistemit on-line. Si seksion i veçantë i kapitullit është përshkruar aplikacioni i rindërtuar elektronik komunal për lehtësimet e reja në dobi të shërbimeve të qytetarit dhe marrjes së informacioneve të bollshme për mirëqenjen e tyre sociale dhe arsimimin personal të tij. Përmes nënseksioneve është bërë edhe : përshkrimi i procesit të punës, grupi i shfrytëzuesve qytetarët, grupi i shfrytëzuesve për shkollat profesionale dhe grupi i shfrytëzuesve për punëdhënësitë. Seksion i veçantë i është lënë edhe rolit dhe rëndësisë së raporteve të aplikacioni të rindërtuar elektronik komunal.

Filozofia e aplikacionit të modifikuar qëndron tek reflektimi i pashqyrimit të informacionit dhe mënyrave të veprimit të biznesit në raport me Qendrat për Aftësim Profesional dhe shkollave profesionale në veçanti tek menaxhimi i të dhënave esenciale, cilësia e shërbimit në kontributin teorik dhe atë praktik të ngritjes së intersimit për aftësim profesional dhe hartimin e strategjisë adekuate për formimin e punëtorit të kualifikuar.

4.2 Komuna e Gjakovës – si rast studimor për ndërtimin e moduleve të reja të aplikacionit

Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi është arsyetimi pse duhet të ndërtohen module të reja një të sistemet informativ menaxherial komunal mbi të gjitha aktivitetetve që mbahen në Komunën e Gjakovës në sektorin e arsimimit dhe aftësimin profesional të të rinjve që kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe ato module ti bashkangjiten aplikacionit ekzistues komunal.

4.2.1 Gjeografia e Gjakovës dhe hapësirat e arsimit dhe aftësimin profesional të saj

Gjakova është qytet në pjesën perëndimore të Kosovës. Po ashtu Gjakova është qendër e Komunës dhe rajonit me të njëjtin emër. Sipërfaqja e qytetit është 24.81 km² ndërsa e Komunës 586.91 km² me një popullësi prej 94.556 banorëve sipas regjistrimit të viti 2011, ndërsa popullësi e vlerësuar me 31.12.2013 96.162 banorë, me gjithsej 88 vendbanime, me dendësi 3600 banorë/km brenda qytetit ndërsa si Komunë ka dendësi 160.5 banorë/km (Wikipedia, 2013) Të rinjt të grup moshës 20-24 vjeq janë 8.946 banorë, ndërsa të asaj 15-19 vjeq janë 10.453 banorë që në total është diçka mbi 20% e popullësisë së saj të gjithmbarëshme. Ndhma sociale në vitin 2014 kanë kërkuar 2.603 familje me 11.007 (respektivisht 11.7% e popullësisë komunale) nga 27.389 familje sa ka Komuna në tërësi. Nëse shikohet tregu i punës në vitin 2014 ka pasur 14.956 persona të cilët kanë kërkuar punë nga këta shumica dërmuese më gjysmëkualifikim apo pa kualifikim fare, por ka edhe të tillë që kanë arsimim terciar. Po këtë vit janë hapur 451 ndërmarrje të reja (shumica tregëti me pakicë - biznes i vogël familjar 113), ndërkaq janë mbyllur 135 sish. Shumica e

të punësuarëve janë sektorin publik ku të ardhurat mesatare neto mujore në nivel të Kosovës janë 429 € (Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2015).

Shkollat e mesme të larta të Gjakovës

Komuna e Gjakovës ka gjashtë shkolla të mesme të larta, një nga këto është gjimnazi i profilizuar (me tri degë të ndara në zonat rurale Ponashec, Bishtazin dhe Skivijan). Shkollat e mesme profesionale janë këto :

- ✓ Teknike “Nexhmedin Nixha” – në përbërjen e saj ka profilet si: elektroteknika, makineria, arkitektura, tekstili dhe arti pamor.
- ✓ Mjekësisë “ Hysni Zajmi” – stomatologji, pediatri, infermeri, farmaci, fizoterapi, laborant mjekësor
- ✓ Ekonomike “Kadri Kusari” – ekonomi, juridik, administrat dhe bujqësi
- ✓ Muzikës “Prenk Jakova” – kryesisht për instrumentet muzikore.
- ✓ Mikse “ Gjon Nikollë Kazazi” – ekonomi, elektroteknike, bujqësi, gjimnaz i përgjithshëm.
- ✓ Gjimnazi “Hajdar Dushi” në qytet dhe ka tri paralele të ndara në Ponashec, cermjan dhe Bistazhin - shkencat natyrore dhe shkencat shoqrore-gjuhësore
- ✓ Gjimnazi “Asllan Berisha” në Rugovë – shkencat natyrore dhe shkencat shoqrore-gjuhësore

Gjimnazi “Hajdar Dushi” së bashku me tri paralelet e ndara punojnë sipas Kornizës së Kurrikulit të Kosovës (klasët e x-ta), si shkolla e mesme e lartë ekonomike.

Në të gjitha këto shkolla vijojnë mësimi 5241 nxënës në raport 2358 femra (45%) kundrejt 2883 meshkujve në gjithsejt 173 paralele. Nga ky numër 3128 nxënës (1316 F, 1812 M apo 57.9%) mësimin e vijojnë në shkollat profesionale. Nxënës të komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë 122 nxënës, respektivisht nga këta 52 femra shprehur në përqindje 45% Drejtoria Komunale e Arsimit Gjakovë (DKAGJ).

Gjakova ka disa qendra ku zhvillohen aftësimet profesionale të grupmoshave të ndryshme ku përvetsohen zanete të ndryshme.

Qendrat për trajnime dhe aftësime profesionale të Gjakovës

Qendra e Aftësimit Profesional (QAP) është përfshirë në sistemin e Ministrisë Punës Mirqenjes Sociale (MPMS) në vitin 2001 dhe ka një njësi mobile në komunën e Deçanit, me programe të ndryshme aftësuese si :

- ✓ Asistent administrativ
- ✓ Kontabilitet
- ✓ Instalues elektrik në banesat civile
- ✓ Asistent në administrim biznesi
- ✓ Saldim
- ✓ Ndërmarrësi

Në këtë qendër kryhen aftësime profesionale sipas kualifikime që kanë kandidatët duke filluar nga niveli 0 – 2 që është nivel për personat e pakualifikuar deri tek ata me kualifikim 5a+ sipas Standatit Ndërkombëtar për Kualifikimin e Arsimimit ISCED-se. Po ashtu aftësimet kryhen edhe sipas moshës (në nivel vendi mosha 15-24 vjeq krahasuar me të

dhënat e 2011 tani ka rënë për 17%) (www.mpms.rks-gov.net). Trajnimet kryhen edhe sipas etniteteve dhe sipas gjinisë. Duke iu referuar kapaciteteve të Aftësisit Profesional në shifra absolute me mesataren e mbledhur të të regjistruarëve të pa punë në rajonet e ndryshme të Kosovës, shkalla më e lartë e aktivizimit është arritur në rajonin e Gjakovës me rreth 3.28% (Puna dhe Punësimi, Raporti i Performancës, Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, Prill 2013, Prishtinë.)

Qendra ka një staf të kualifikuar dhe punëtori ku realizohen trajnimet profesionale. Por mungesa e një infrastrukture moderne në raport me kohë është mëse e evidente, përkundër asaj që është në ndërtim e sipër godina e re. Në këtë qendër ndihet nevoja edhe e paisjes me mjete të reja konfor përparimit të teknologjisë në tërësi, për të realizuar trajnimet sipas standarteve europiane.

Hapësira punuese BONEVET është një qendër jo-fitim prurëse e komunitetit ku njerëzit mbledhen për të ndarë burimet dhe njohuritë, të punojnë në projekte, rrjeta kompjuterike dhe ndërtuar programe dhe modele të ndryshme. Ajo është një kombinim joformal i një laboratorit, një dyqan dhe një sallë konferencash e cila inkurajon "duart-në", eksplorimin, duke siguruar burimet që janë zakonisht në dispozicion të individëve që punojnë vetëm (<http://www.bonevet.org/about-us/>).

Qendra ka një strukturë plotësisht të pajisur dhe mirëmbajtur në mënyrë profesionale me sipërfaqe prej 700m² e huazuar nga Komuna për 10 vjet, ku organizohen trajnime/aftësime me pagesë simbolike (rreth 30-45 euro për një trajnim 6 javor me 6 orë pune në javë) nga instruktorët profesional në lamitë elektronikës, automatikë, robotizim, printim 3D,

komputer-Aided Design, programim, Arduino, LittleBits etj. Këtu zhvillohet një arsimim kreativ, ku ka risi, kuriozitet, shkëmbim idesh dhe motivim për punë. Ka mbi 35 anëtar dhe mbi 220 anëtar. Motoja e saj është : *“Nëse mund ta imagjinosh, mund ta krijosh”* që flet qartë për përkushtimin dhe punën që bëhet në këtë qendër trajnuese, e apra e këtij lloji në Ballkan. Kjo qendër trajnimesh është duke funksionuar me suksese të plota edhe për grup moshat e reja dhe ka një interior të paisjeve kryesisht sipas standarteve europinae. Numri i të rinjëve që ndjekin kurset, konform pagesës, ka rritje.

Qendra inovative (Jakova Inovative Center JIC) e hapur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) së Kosovës e cila është një mbështese të ndërmarrësisë dhe zhvillimit komercial të biznesit (<http://www.mti-ks.org/sq/Aktivitetet-e-MTI-se/>). Kjo qendër moderne inovative është fokusuar në ofrimin e shërbimeve të inkubatorit të biznesit, trajnimeve, mentorimit dhe këshillë-dhënies. Ka një objekt me sipërfaqe prej rreth 300m², e mbështetur nga komuna. Këtu zhvillohen trajnime cilësore në ambiente moderne dhe profesionale. Për dallim prej qendrave tjera, JIC dëshiron të pozicionohet në një formë të tillë në treg që shfrytëzon idetë, njerëzit dhe resurset për të ndikuar në ekonominë e vendit dhe për të zbuluar potencialin e vërtetë tek ndërmarrësit e rinj në Gjakovë e Kosovë. Kjo qendër është pajisur me bazën e nevojshme për zhvillimin e kapitalit intelektual dhe njerëzor. Në këtë qendër kanë ligjeruar edhe një sërë figurash të profesioneve të ndryshme me tituj të lartë shkencor, të cilët janë pjesë e arritjeve shkencore në përmasa ndërkombëtare. Qendra ka mbajtur edhe Crowd Sourcing Summit In Gjakova ku kanë ligjeruar ekspert europian të teknologjisë informative. Të gjithë pjesëmarrësit e komunitetit në këtë qendër trajnuese dhe informuese përkrahen me materiale përpunuese dhe ndihmën

logjistike. Mban kontakte të rregullta dhe është në koordinimi me Komunën , në veçanti me Drejtorinë për Zhvillimit Ekonomik.

Në Komunën e Gjakovës e zhvillojnë aktivitetin e vet edhe disa qendra trajnuese për gjuhë të huaja të licencuara që ofrojnë certifikim sipas standarteve europiane të certifikimit. Po ashtu është edhe kompania e licencuar për trajnimin e mësimitdhënësve ATI-KOS, e cila ofron trajnime profesionale për programin e MS Office për shkollat e Komunës të nivelit ECDL sipas sistemit të Microsoft. Trajnimeve të tilla nga paketa e programeve të aplikative iu janë nënshtruar edhe një numër i madh i profesorëve të komunës sonë. Programe këto të sponsorizuara nga donacionet e jashtme në bashkpunim me MASHT-in. Efektet e tyre vërhen edhe në proceset mësimore në ato shkolla ku ka kompjuter dhe paisje tjera elektronike konkretizuese si projektor, printer, plotera, aparate digjitale dhe kanë qasje në rrjetet e gjërë lokal, dmth në Internet. Mungesa e paisjeve të teknologjisë informtive është e evidente në shkollat tona, akoma.

Qendra Rinore në Gjakovë (QRGJ), qendra e komuniteteve Rom Egjiptian Ashkali (REA), janë vendet ku zhvillohen aktivitet tjera trajnuese në fushat e biznesit, menaxhimit, muzikës, mësimi i gjuhëve të huaja ku frekuentojnë sidomos në të dytë pjestarët e minoritetve që jetojnë në këtë komunë. Kryesisht këto qendra funksinojnë në bazë të donacioneve të huaja dhe kanë karakter integruar për edhe aftësues. Aftësimet këtu janë joformale në të shumtën e rasteve.

Marketingu mbi veprimtaritë dhe punën e tyre do të kishin një mbështetje më të fuqishme, qofshin ato vendore apo ndërkombëtare, nëse rezultatet e punës së tyre prezentohen në

raportet e përditësuara nga strukturat komunale dhe së rezultat mund të rritjes dukshëm flukshmëria e pjesëmërrjes së të rinjëve për të mësuar një profesion.

4.2.2 Rindërtimi i aplikacionit dhe qëllimi tij

Të gjitha këto trajnime profesionale të cilat ofrohen në Komunën e Gjakovës nuk kanë një bazë të të dhënave të përbashkët përmes një softueri të cilat mund të menaxhohen nga Kuvendi Komunal, të dhëna këto të cilat mund të shërbejnë për statistika të ndryshme, vështrimin apo kontrollimin e trajnimeve që kryhen, pse jo edhe të niveleve të certifikimit të kandidatëve. Qendra Informative pranë Komunës, si mekanizëm kryesor i komunikimit dhe ndërlidhjes me Qytetarët e Komunës së Gjakovës ekziston dhe është funksional, prandaj ndërlidhja e saj me këtë sistem të menaxhimit të informacionit do ta bëjë atë më funksionale dhe kuptimplote. Prandaj, këto të dhëna si prioritet do të ishin për Kuvendin Komunal dhe drejtoritë përkatëse të saj edhe ofrimin e stafit të kualifikuar donatorëve të ndryshëm ndërkombëtar dhe po ashtu edhe bizneseve vendore. Këto do ta lehtësonin punën dhe ndihmonin shumë qytetarin. Krijimi i qasjeve funksionale nga ana e ekspertëve të teknologjisë informative për ta vitalizuar aplikacionin e rindërtuar elektronik komunal do të kishte efekte pozitive dhe shumë dobi prurëse për gjithë qytetarët e Gjakovës në rend të parë dhe qevirsjes lokale në tërësin e saj.

Krijimi i një ure lidhëse mes institucioneve të arsimimit dhe aftësimin profesional dhe biznesit, me komunën si bartës të projektit të rigjeneruar, do të ishte një gjenerator i zhvillimit të kapaciteteve dhe cilësisë të trajnimeve profesionale në komunë konform tregut. Ndërtimi i infrastrukturës elektronike të informacionit do të ishte shtytës për të

siguruar burime të reja financiare që do të ndihmonin përmisimin e arsimimit dhe aftësimin profesional.

Idea e rindërtimit të këtij sistemi informativ menaxherial është që të ndihmohet në procesin e bashkëveprimit mes shkollave të mesme të larta, qendrave aftësuese, biznesit në nivel komunal, si dhe vet bartësin kryesor të projektit Kuvendin Komunal të Gjakovës. Këto module shtesë të aplikacionit ekzistues do ta funksionalizojnë edhe më tepër atë dhe do të jetë një stërmullar i madh i informacioneve mbi aftësimet dhe shkollat profesionale të komunës dhe lidhjen e tyre me biznesin dhe më gjërë.

Bartja e të dhënave prej shkollave të mesme të larta për të gjithë nxënësit të cilët e kryejnë shkollimin e mesëm të lartë në komunë në sistemin e informimit të qendrave që merren me arsimim dhe aftësim profesional do të krijonte hapin e parë për masovizimin dhe njëkohësisht ngritjen e interesimit tek të rinjt për të përvetsuar një profesion karriere. Kjo do të vijon me një marketing të mirëfillt nga QAP-ët nëpër shkollat e mesme si nëpër mediat informative lokale përmes emisioneve të ndryshme propaganduese-informuese, përfshirë këtu edhe vizitat e rregullta që do t'iu bëheshin maturantëve gjatë viti të fundit në bankat shkollore, duke iu ofruar fletushka mbi llojet trajnimit profesionale me dokumentacion përcjellës. Kjo të krijonte një rrjet zigjiror të informacioneve për të rinjt e Komunës së Gjakovës dhe orientimin e tyre në karrier.

Bazuar në intervistat e realizuara me të rinjt del në sipërfaqe se ata nuk kanë njohuri për të gjitha qendrat aftësuese profesionale në rajonin gjegjësisht komunën ku jetojnë aq më pak se cilat trajnime zhvillohen aty apo kohëzgjatjen e tyre si dhe mënyrën e organizimit. Ata

nuk kanë njohuri mbi certifikimin dhe titullin që fitojnë gjatë atyre trajnimeve profesionale. Prandaj një marketing institucional i ndërlidhur edhe me të dhënat e tyre (kuptohet së pari nga ata duhet të merret e drejta për t'iu transmetuar të dhënat personale secilit individ/nxënës) mund ta përmbush këtë vakum informacioni. Pasurimi i sistemit informativ të QAP me të dhënat e maturanëve, nuk do të shërbej vetëm si dekor informacioni, por do ti obligonte menaxherët e këtyre institucioneve që të përmissojnë dhe avancojnë më tutje mënyrën e trajnimit duke e bazuar në ato europiane dhe duke vazhduar rrugëtimin e tyre për përfitimin e fondeve të reja. Dihet se këto të dhëna do të rivitalizohen në secilin përfundim të viti shkollor, pse jo edhe me shpeshë. Në të njëjtën kohë do t'iu mundësonte edhe bashkpunimin me biznesin ku nga këta të fundit do të kërkohej përkrahje qoftë në sektorin e infrastrukturës apo edhe me ekspert të fushave përkatëse si dhe në avansimin e mëtutjeshëm të programeve aftësuese profesionale. Ekspertet e fushave përkatëse do të vazhdonin bashkpunimin me shkollat duke i afruar maturanët drejtë qendrave aftësuese profesionale, me qëllim të vetëm që të rinjt ta zotrojnë një profesion gjegjësisht zanat dhe me të konkurojnë në tregun e punës në mënyrë sa më denjë dhe sa më të aftë profesionalisht.

4.2.3 Involvimi i biznesit në sistemin informativ menaxherial – roli dhe rëndësia e tij

Edhe biznesi në planet e veta, në vazhdimisi mendon për stafin, për punonjësit e kualifikuar dhe profesionistë, si t'i formon ata dhe si të përmirëson performancën e atyre që ka në staf. Biznesi mendon si të gjen, specializon dhe mban punonjësit e talentuar pasi kjo shihet si mënyra e vetme për të siguruar suksesin e tanishëm dhe të ardhshëm të tij. Prandaj kyçja e

tij si faktor funksional në këtë sistem të rindërtuar për informata shitesë apo aplikacion të modifikuar do të ishte edhe një rast i mirë drejt stabilitetit ekonomik për ta.

Nga ana tjetër, të rinjve me aftësim profesional gjegjësisht me përvetsimin e një zanati ju hapet një portë drejt tregut të punës, e cila mund të jetë emblem drejt arritjes së objektivave personale por edhe rrugë e zhvillimit ekonomik të vendit. Shkollat respektivisht qendrat e zanatit nuk i përkasin së kaluarës, ato thjesht janë modernizuar, veprojnë në mënyrë aktive në kohët e sotme dhe madje ka prirje për rritje pothuajse në të gjitha vendet e Bashkimit Europian, pse mos të jetë edhe tek ne ashtu, ku papunësia në nivel vendi kap shifrën mbi 30% me tendecë rritje të përditshme. Emigrimi për arsye ekonomike ka trend të rritjes së vazhdueshme.

Kyçja në vazhdim të arsimimit apo zotërimit të një profesioni pas shkollimit të mesëm ditët e sotme është alternativ e vetme për të fituar një edukim real jetësor profesional dhe një mundësi më shumë për punësim. Ngritja potencialit profesionist është një mundësi më shumë për inkuadrim në tregun ekonomik të punës.

Studentit respektivisht kandidatit pjesmarrës në programet aftësuese do ti lejohet që të kryejë më shumë se një trajnim njëkohësisht edhe atë mund ta bëjë nëpër qendra të ndryshme, edhe në punëtorit private e evidentimi i të gjitha trajnimeve do të bëhej njëkohësisht poshtu ai do të kishte mundësi certifikim në të gjitha ato programe aftësuese. Të gjitha këto informacione do të barten parimisht në sistemin e riformatuar. Roli dhe rëndësia e biznesit në këtë fushë duhet të jetë epiqendra e ndërtimit të kësaj infrastrukture, pasi ata posedojnë edhe mjetet financiare, punësojnë të rinjt, jetojnë me tregun e punës dhe kanë

eksperiencë menaxheriale. Të gjitha këto do të ishin epërsi për studentin fillestar për ta trasuar rrugën e tij drejt gjetjes prespektivës individuale. Kjo do ti afronte bizneset që zhvillojnë aktivitet prodhues dhe riparuese (si automekanikët, autoelektricitët, këpuctarët, instaluesit elektrik, zdukthtarët, farkatarët, artizanatet etj) që të ofrohen më shumë drejt shkollave profesionale, të janë pjesë e bordeve të tyre që në fund nënkupton më shumë praktikë nëpër shkolla. Të gjitha këto zanate apo profile pune nuk i takonjë vetëm të kaluarës por janë edhe shumë kërkuese për tregun si punëtor i kualifikuar. Si rezultat edhe intersimi i të rinjve për shkollat profesionale do të rritej, pasi tani për tani trendi ka rënë të theksuar të interesit. Nga intervistat me menaxherët e bizneseve të ndryshme në komunë ata nuk shprehen të gatshëm ti bashkangjiten këtij karavani të dijës sot, pasi nuk e ndihen pjesë vendimmarrëse apo këshilluese nëpër institucionet përkatëse. Ata nuk kanë benifitime të mjaftueshme nëse marrin nxënës për të mësuar profesion në punëtorit e tyre prandaj edhe hezitojnë në bashkpunim. Atyre duhet t'iu ofron benifite taksash apo t'iu garantohet me ligj pagesat mbi numrin e kandidatëve që ata aftësojnë për tregun e punës konform standarteve që nevoiten me ligjin e punës. Qeverisja lokale ka drejt të benificoi bizneset sipas prioriteteve.

Prandaj, biznesi duhet të jetë edhe faktor kyç në përpilimin e kornizave dhe programeve aftësuese pasi përvoja e tyre është më se e domosdoshme dhe i dhurojnë origjinalitet projektit. Biznesi duhet të ketë mundësin të thotë fjalën e parë por edhe të fundit në kërkesat për degë, profile, cilësi dhe për paketën e aftësive që duhet të ketë nxënësi pas çdo niveli. Shkurt ai duhet të mbajë timon e arsimit dhe aftësimit profesional, sepse është në dobi të tij. Si rrjedhim edhe biznesi duhet të ndërjegjësohet për koston fillestare që duhet

të paguaj, në këmbim të një produkti cilësorë do të dal nga duart e tij, pasi ky produkt më shumë se të gjithëve i sjell përfitime vet atij. Inkuadrimi i biznesit në procesin e shkollimit dhe fitimit të profesionit do ti largonte arsyetimet e këtyre të fundit se nuk marrin pjesë sa duhet në funksionimin e institucioneve lokale. Pra biznesi mund të shëndrohet në investitorin më të madh të shkollimit dhe aftësimit profesional, pasi aftësimi profesional është shumë i shtrejtë dhe i vetmi që mund ta përballoj dhe të njëkosisht të nxjerr përfitime prej tij është vet biznesi. Buxheti komunal shumë shpesh nuk ka mjete për mbështjen me mjete financiare shkollat profesionale bazuar në kërkesat që kanë ato, si mungesë të fondeve të pamjaftueshme. Këtë vakum financiar mund ta mbulojnë ndërmarrjet e sektorit privat përmes formave të ndryshme në qasje të projekteve që kërkohen nga shkollat profesionale.

Nga sistemi informativ biznesi do të kishte përfitim se ai në çdo kohë do të kishte njohuri me llojet, mënyrat dhe numrin e kandidatëve të certifikuar si mbi kualifikim e arritur. Kjo do t'iu mundësonte bizneseve si dhe investitorëve të kenë më të lehtë qasjen në informata dhe njoftime rreth klimës biznesore në komunë, si për gjetjen më të lehtë të punëtorëve eventual profesional adekuat për veprimtarinë e tyre, por njëkohsisht ata do të ishin pjesëmarrës aktiv në këtë proces jetik për të rinjt sot.

4.2.4 Komuna si bartës i projektit

Parashtrohet pyetja pse Kuvendi Komunal duhet të jetë bartës i këtij projekti?

Arsyeja kryesore është se komuna posedon të gjitha Drejtoritë Komunale të cilët kanë qasje në punët, aktivitetet dhe statistikat e jetës që zhvillohet në atë rajon, prandaj edhe një informacion më shumë do të ishte edhe një resurs më shumë.

Çdo lloj donacioni apo investimi biznesor i cilit do lloj qoftë ai, që vjen nga jashtë Kosovës apo edhe nga komunat tjera si motra, vjen së pari tek niveli lartë komunal përkatësisht në Drejtorinë Komunale përkatëse. Atëherë qasja në këto informacione për personat e kualifikuar dhe mënyra e kontaktit me ta do të ishte shumë më e lehtë. Aty hartohen strategjitë e zhvillimit ekonomik lokal, ndahet buxheti komunal sipas sektorëve dhe prioriteve që ka vet komuna, merren vendime mbi investimet kapitale komunale e investime tjera të peshave të ndryshme, me një fjalë ajo është promotor i së ardhmës për njerëzit që punojnë dhe veprojnë në atë rajon.

Po ashtu këto të dhëna ajo mund ti shfrytëzojë për përpilimin e statistikave dhe raporteve të ndryshme që nevoiten për pashqyrat komunale. Informacionet të panumërta mund të mirren nga kombinimet e ndryshme të disa fushave si nga i njejti modul po ashtu edhe nga relacionet ndërmodulare. Krejt këto mund të pashqyrohen edhe përmes grafikëve të lloje të ndryshme që mund të formohen me qasjen e programeve tjera aplikative statistikore. Në aspektin e sigurisë, kuptohet personat përgjegjes do të ishin të autorizuar si të vetëm për mirëmbajtjen e tyre dhe ata do ti ishin të vetmitë që do të kishte qasje në këto shënime, të cilat duhet të ishin plotësisht konfidenciale për të tjerët. Por si pasqyrë statsitkore informative, do të kishte mjaftë informacione publike p.sh sa qytetar kanë kualifikime dhe të cilit lloj dhe cilin nivel janë të kualifikuar mund të bëhen publike përmes web faqes komunale apo faqes zyrtare të saj në rrjetet sociale, si dhe shumë informacione tjera që kanë qasje të lirë si nga aplikacioni ekzistuese edhe nga modifikimi i tij. Edhe për biznesin mendohet që ti jepet një qasje e autortizuar vetem për leximin e të dhënave, ofrimin e vendeve të lira të punës, por vetëm atyre biznese që janë të regjistruara pran komunës, me

një fjalë atyre që zhvillojnë veprimtarin e rregulltë dhe janë janë parapagues të rregulltë të taksave komunale dhe shtetërore. Kjo ofron edhe një mundësi më shumë që të zvoglohet ekonomia informale. Informaliteti ekonomik mbulon një përqindje brenda biznese apo aktiviteteve afariste.

Arsyeja e rradhës është aspekti financiar pasi që Web sistemi informativ menaxherial i ndërtuar do të vendoset në serverët e komunës dhe të ndërlidhet me web faqen e saj – në mënyrë që të mos investohet në Hosting dhe Domain. Mirëmbajta dhe qasja e vetme i takon asaj, dhe për çdo parregullësi përgjegjësia i takon asaj gjegjësisht administratorit të përcaktuar nga Asambleja Komunale.

Komana në strukturën e saj ka edhe ekipin IT të cilët do të janë në dispozicion që ta impletojnë, funksionalizojnë dhe mirëmbajnë aplikacionin e rindërtuar elektronik përshërbime elektronike për qytetarët.

4.2.5 Funksionet e sistemit informativ menaxherial

Sistemi informativ menaxherial i modifikuar duhet ti kishte disa funksione shtesë si në vijim:

Funksioni i parë - do të jenë listat e nxënësve nga të gjitha shkollat e mesme të larta të Komunës së Gjakovës. Secila shkollë do ta ketë *log in* dhe *password*-in e vet i cili do të administrohet nga një administrues të cilin do ta caktoi shkolla (preferohet sekretari i shkollës).

Me nxënësit paraprakisht lidhet një kontratë nga të cilët kërkohet e drejta e shfytëzimit të të dhënave të tyre personale - normalisht atyre ju tregohet qëllimi.

Tabela e nxënësve (formulari) do të përmbaj të gjitha të dhënat e duhura personale për secilin nxënës.

Të gjitha këto të dhëna pastaj mund të shihen nga Qendrat për Aftësim dhe Arsimim Profesional të licencuara të tilla si Qendra Regjionale për Aftësim Profesional Gjakovë, BoneVet, Jakova Innovation Center, qendrat për mësimin e gjuhëve të huaja dhe të tjera biznese të cilët mbajnë trajnime të ndryshme profesionale të licencuara dhe të certifikuara. Këto qendra do të regjistrohen paraprakisht nga ana e administratorëve të aplikacionit dhe atyre do të ju ipet çasja e autorizuar në sektor dhe të drejtat në aplikacion paraprakisht.

Funksioni i dytë - Tabela e trajnimeve do të përmbajë të gjitha llojet e kurseve që organizohen në këto qendra trajnimi si dhe datat e fillimit të trajnimeve, datat e mbarimit të trajnimeve, licenca që fitohen gjatë trajnimeve etj. Të gjitha këto do të ndërlidhen mes veti për qëllime të ndryshme që janë në interesë si të komunës por shkollave profesionale dhe QAP-vë. Drejtoritë komunale do të kanë qasje në këto të dhëna për të përpiluar raporte të ndryshme dhe nxjerrjen e të dhënave që iu nevoiten për prezentime të ndryshme pran donatorëve apo punën e tyre institucionale të zakonshme.

Tabela e regjistrimeve - Këtu regjistrohen nxënësit por edhe qytetarët dhe trajnimet që ata i kanë mbajtur në ato qendra trajnuese, dhe mbahet evidentimi që kryhet gjatë procesit të certifikimit. Ata do të kenë një databazë personale për çdo aktivitet aftësues që ta kryejnë si brenda shkollës apo edhe jashta saj. Të gjitha këto informacione mund të shohin edhe biznestet nëse kanë interesa për ndonjë individ të caktuar të kualifikuar për një profesion përkatës.

Funksioni i tretë – kërkimi. Bizneset që kërkojnë punëtor të kualifikuar do t'iu lihet vetëm mundësia të shohin se sa dhe cilat lëmi janë kandidatet e kualifikuar, ndërsa bizneset investuese do të kanë çasje edhe në dokumentacionet tjera. Për të dhënat tjera ata duhet të regjistrohen përmes një formulari për regjistrim online me emrin e firmës dhe numrin e regjistrimit të biznesit. Biznesit do ti lejohet çasje edhe në paraqitjen e ofertave të punës. Ato mund të bëjnë këtë përmes administratorëve lokal.

Bizneset apo kandidatët do ta kenë obligim që për punësimin e tyre ta lajmërojnë Qendrën Për Punë Sociale ose Komunën e Gjakovës pasi që evidentimi i tyre nevojitet për statistika dhe analiza.

I gjithë softueri do të mirëmbahet nga Administratori të cilën do caktojë komuna dhe do të mirëmbajë tërë sistemin e postës elektronike, menaxhimin e fajllave si dhe bazën e shënimeve.

Administruesit e shkollave dhe të qendrave për aftësi profesionale do të kenë të drejtë t'i fusin shënimet e nxënësve/kandidatëve dhe ti përmisojnë ato vetëm në rast se iu ipet e drejta nga administratori qendror. Shrytëzuesit e thjeshtë kanë mundësi vetëm të lexojnë shënimet. Në fund do të përpilohet një udhëzues i përdorimit për secilin nivel të shfrytëzuesëve.

Informacionet e grumbulluara nga ky aplikacion i modifikuar kanë një lidhje të drejtpërdrejtë edhe disa faktorëve tjerë brenda komunës, dhe jashtë saj përmes shkollave dhe qendrave për aftësim profesional. Këtu mund të prezentohet edhe të arriturat e qendrave orientuese për karrier që funksion në kuadër të shkollës apo edhe aktivitet tjera trajnuese e

këshilluese të saj. Informacionet që vijnë nga biznesi mund të prodhojnë të dhëna menaxhuese efektive nga tereni edhe për vet shkollat lidhur me ekonominë e tregut apo të ndërtojnë koncepte mbi nevojë e kualifikimeve që ka tregu për QAP. Fluks të informatave mund të ketë edhe qendrat për aftësim dhe arsimin profesional pasi aty kualifikohen numri më i madh i qytetarëve nga trajnimet e ndryshme profesionale. Lincencimi i punëtorit të kualifikuar fitohet aty. Paisja me cetifikime valide dhe procedurat e e licencimit janë pjesë e të dhënave që paraqiten për raportim nga QAP.

4.3 Aplikacioni ekzistues elektronik i KK Gjakovë

4.3.1 Aplikacioni ekzistues për shërbimet elektronike të qytetarëve të Gjakovës

Komuna e Gjakovës disponon me sistemin për shërbimet online për qytetarët e saj.

Aplikacioni softuerik është i bazuar në Web teknologji është i ndërtuar në teknologjinë Free and open-source software (FOSS) (me kod burimor i hapur), dhe është i ndërtuar në databazat (baza e të dhënave) në MySQL (Structured Query Language), ndërsa Interface (ndërfaqja) në PHP. Ky projekt përdor teknologjinë Free and open-source software (FOSS). Teknologji e cila është pa pagesë Pra, gjuhë programues është përdorur gjuha PHP (Personal Home Page). Kjo teknologji ofron fleksibilitet për t'iu qasur të dhënave nga lokacione të ndryshme përmes rrjetit LAN (Local Area Network), WAN (Wide Area Network) dhe Internetit.

Interfejsi (ndërfaqja) i realizuar është i afërt me shfrytëzuesin dhe lehtë manipulohet me të, në mënyrë që edhe punëtorët me dije fillestare të njohurive kompjuterike të çasen në të , respektivisht mund ta përdorinë atë aplikacion.

Aplikacioni është i instaluar në serverin e dedikuar vetëm për këtë aplikacion. Qasja në aplikacion është e vazhdueshme qoftë nga objekti kryesor, qoftë nga objekti në largësi.

Ky aplikacion softuerik online ka ca nivele të përdoruesve në varësi nga detyrat të cilat i kryejnë punëtorët komunal të autorizuar respektivisht përdoruesit e tij. Niveli më i lartë është ai i administratorit të sistemit. Administratori, si staf i grupit IT komunal, ka qasje në të gjitha modulet e integruara në sistem dhe njëheritë është përgjegjës për të gjitha autorizimet e dhëna. Nivelet tjera janë të përcaktuara në bashkëpunim mes KK (Kuvendi Komunal) të Gjakovës dhe stafit udhëheqës të kompanisë që ka ndërtuar aplikacionin. Janë të caktuara grupet për zyrën pritëse, servisin dhe financat.

Aplikacioni është modular, që mundëson integrim të moduleve të reja. Këtë të drejtë e ka vetëm administratori i caktuar nga ana e KK. Kjo mundëson dhe lejon që administratori të mund të heqë apo shtojë modulet e caktuara në varësi nga interesat komunale.

Në aspektin e sigurisë të gjithë përdoruesit e sistemit do të mund t'i qasen aplikacionit përmes rrjetit kompjuterik lokal LAN (Local Area Network) ose përmes lidhjes VPN (Virtual Private Network) edhe nëpërmjet rrjetit kompjuterik të gjerë.

Qasja në aplikacion i lejohet pas autentikimit (emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi). Gjatë qasjes përmes rrjetit WAN të dhënat enkriptohen për të arritur siguri të lartë të funksionimit të sistemit.

Ky aplikacion ka një mirëmbajtje nga ana e kompanisë lokale e cila përfshin: kontrollimin e backup-ave (kopjeve rezervë), intervenimin në rast nevojë brenda ditës si dhe kontrollimin e vazhdueshëm të serverit për një periudë kohore, në këtë rast një vjeqare.

4.3.2 *Çasja në aplikacion aktual (ekzistues)*

Portali i Komunës është zhvilluar me qëllim të rritjes së transparencës dhe komunikimit në mes të institucionit të Komunës dhe banorëve të saj. Ky portal përbën një hap para drejtë digjitalizimit komunal dhe njihet me emrin Komuna ime elektronike.

Për menaxhimin e projekteve tek llojet e kërkesat të projektit, nevojiten kërkesat funksionale të cila përshkruajnë sjelljen e sistemit: çfarë duhet të punojë sistemi, cilat shërbime ofrohen, çfarë është formati i të dhënave hyrëse dhe dalëse, si reagon sistemi në ndonjë të dhënë hyrëse, si ndërrohet sjellja gjatë kohës etj. Në vijim po analizojmë punën e aplikacionit ekzistues .

Aplikacioni për qasjen online të qytetarëve në shërbimet komunale, mundëson që Komuna dhe qytetarët të jenë gjithë kohën në kontakt të drejtpërdrejt edhe pa prezencën fizike të qytetarit në objektin e komunës. Qasja në këto shërbime bëhet në mënyrë të sigurt, duke shfrytëzuar lidhjen e Internetit. Ky aplikacion është krijuar në kuadër të dixhitalizimit të shërbimeve komunale dhe ngritjes së transparencës ndaj popullatës. Si e mirë tjetër e saj është se redukohen dukshëm pritjet e qytetarëve për tu paisur me certifiakta të llojeve të ndryshme apo për të nxjerr dokumente tjera komunale.

Shërbimet janë produkte të cilat komuna u ofron qytetarëve të saj në bazë të nevojave dhe kërkesave të vlerësuara dhe të sanksionuara me akte administrative dhe ligjore.

Në bazë të vlerësimit të nevojave që kanë qytetarët, grupet e ndryshme të interesit dhe komunitetet, MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) nëpërmjet kornizës ligjore dhe dokumenteve tjera administrative i ka sanksionuar fushat kryesore në të cilat

komunat ofrojnë shërbime për qytetarët dhe grupet e interesit. Shërbimet komunale ndahen në tri kategori:

- ✓ Shërbimet themelore
- ✓ Shërbimet e transferuara dhe
- ✓ Shërbimet e specializuara.

Shumë shtete evropiane kanë kaluar në ofrimin e shërbimeve të integruara. (MAPL, 2013)

Disa nga këto shërbime komuna e Gjakovës i ka të digjitalizuara nëpërmjet të aplikacioneve online. Faqja e parë në aplikacionin e Kuvendit Komunal të Gjakovës (figura 34), bëhet fjalë për aplikacionin ekzistues, përbehet nga regjistrimi i qytetarit si përdorues i këtij aplikacioni elektronik dhe kyçja në llogarinë personale, si dhe ka dy module për certifikatat online respektivisht ofiqarinë komunale dhe atë për menaxhimin e aseteve të Komunës së Gjakovës.




Figura 34. Aplikacioni aktual – faqja e parë

Burimi : <https://gjakova.e-komuna.com/>

Për tu regjistruar si anëtar i ri i sistemit elektronik online të KK Gjakovë duhet të klikohet tek regjistrohuni dhe nga këtu hapet dritarja Regjistrimi (figura 35) e cila përmban të dhënat personale të individit që dëshiron të regjistrohet si: numrin e kartes së indentifikimit, e-mail adresën, emrin, mbiemrin, adrsën e vendbanimit, numrin e telefonit, shtetin ku jeton, kodin postal të Komunës dhe në anën e djathtë na paraqitet harta dhe vendbanimi. Në kutin verifikuese duhet të pajtohesh me kushtet e dhëna. Disa nga fushat janë obligative për tu plotësuar, pa plotësimin e plot të tyre nuk mund të kemi qasje në llogarin personale të portalit elektronik komunal.

Republika e Kosovës

Komuna Ime Elektronike

Komuna e Gjakovës

FILLIMI KONTAKTI

Regjistrimi

Numri i letërnjoftimit *

Password *

Përsërit fjalëkalimin *

Email *

Emri *

Mbiemri *

Adresa Numri *

Qyteti * Gjakova

Kodi postar * 50000

Shteti ku jeton * KOSOVA

Telefoni *

Pajtohem me **termat dhe kushtet!**

* Fusha te obligueshme

Adresa

Nena Tereza pr,
Gjakova, 50000
Kosova

Telefoni

(0) 800 60000
(0) 800 60001

Map showing location in Gjakova, Kosovo.

Figura 35. Regjistrimi tek Komuna ime elektronike

Burimi : <http://gjakova.e-komuna.com>

Qytetarët të cilët aplikojnë respektivisht dëshirojnë ti kryejnë ndonjërin nga këto shërbime që ofron Komuna e Gjakovës online, duhet së pari të regjistrohen, duke marrë emrin për përdorim (username) dhe një fjalëkalimin (password). Palës i ipet mundësia e rikthimit të

fjalëkalimit nëse është shkruar gabimisht. Kjo mundëson që në të ardhmen qytetarët të mund të kenë qasje edhe në shërbimet tjera që do të ofrohen nga Komuna.

Certifikatat online

Aplikacioni për qasjen Online të qytetarëve në shërbimet e Komunës, mundëson që kryerjen e shumë shërbimeve komunale pa qenë qytetari fizikisht në Komunë. Qasja në këto shërbime duhet të bëhet në mënyrë të sigurt, pasi që çdo qytatar ka autentifikimin personal. Një baner me titullin “Kyçuni në llogarinë tuaj” mundëson hapjen e aplikacionit për komunikim online pasi të ketë shënuar kodin e sigurisë i cili paraqitet në mënyrë automatike, si në figurën e poshtme.

Kyçuni në llogarinë tuaj

Nr. Personal
<input type="text"/>
Fjalëkalimi
<input type="text"/>
Fute kodin e sigurisë
8421
<input type="text"/>
KYCU

■ **Regjistrohuni këtu**

■ **Rikthe fjalëkalimin**

Figura 36. Kyçja në modulën elektronike të Komunës së Gjakovës

Burimi: <http://gjakovaportal.com/al/>

Qasja në aplikacionin për online shërbime bëhet nga web faqja zyrtare e Komunës si dhe direkt nga portali i cili caktohet në bashkëpunim me Komunën, siç shihet edhe nga burimi i të dhënave. Kjo mundëson që në të ardhmen qytetarët të mund të kenë qasje edhe në shërbimet tjera që do të ofrohen nga Komuna.

Qytetari do të ketë mundësi që të aplikojë për ndonjërin prej tetë certifikatave, e-certikatat, të cilat ipen nga zyra për regjistrim civil, siç janë:

- ✓ Ekstratet e lindjes (janë me numër personal)
- ✓ Certifikatën e lindjes
- ✓ Certifikatën e martesës
- ✓ Certifikatën e vdekjes
- ✓ Certifikatën e bashkësisë familjare
- ✓ Certifikatën e shtetësisë
- ✓ Certifikatën e vendbanimit
- ✓ Certifikatën e statusit martesor

Komuna Ime Elektronike

Republika e Kosovës Komuna e Gjakovës

APLIKIMET **CERTIFIKATA** **ASETET E KOMUNES** **PROFILI JUAJ** **KONTAKTI** **DALJA**

CERTIFIKATAT

- [Aplikimet e mia](#)
- [Ekstrakt i Lindjes](#)
- [E Lindjes](#)
- [E Martesës](#)
- [E Vdekjes](#)
- [E Bashkesise Familj.](#)
- [E Statusit Martesore](#)
- [E Shtetësisë](#)
- [E Vendbanimit](#)

RAPORTIMET

- [Raportimet e mia](#)
- [Shtyllat e ndriqimit](#)
- [Pusetat](#)
- [Karriget e parkut](#)
- [Semaforet](#)

APLIKIMET E HAPURA

Përshkrimi	Aplikuar per	Statusi	Data e regjistrimit	Përgjegjur	Shikuar
Nuk ka shënime					

APLIKIMET E ZGJIDHURA

Përshkrimi	Aplikuar per	Statusi	Data e regjistrimit	Përgjegjur	Shikuar
▪ Ekstrakt i lindjes	Arbër Ferizi	Zgjidhur	26-05-2016 09:34:16	0	0
▪ Ekstrakt i lindjes	Mehdi Ferizi	Zgjidhur	26-05-2016 09:31:40	0	0
▪ Ekstrakt i lindjes	Zana Ferizi	Zgjidhur	26-05-2016 09:28:33	0	0
▪ Ekstrakt i lindjes	Jeta Ferizi	Zgjidhur	26-05-2016 09:26:32	0	0
▪ Ekstrakt i lindjes	Yli Ferizi	Zgjidhur	26-05-2016 09:21:08	0	0
▪ Certificate e bashkesise familjare	Mehdi Ferizi	Zgjidhur	20-10-2015 10:36:23	0	0
▪ Certificate e vdekjes	Burbuqe Ferizi - Puka	Zgjidhur	20-10-2015 10:34:03	0	0
▪ Ekstrakt i lindjes	Mehdi ferizi	Zgjidhur	20-10-2015 10:30:01	0	0
▪ Ekstrakt i lindjes	Arbër Ferizi	Zgjidhur	23-12-2014 14:13:46	0	1

Figura 37. Modulet e aplikimit në zyren e ofiqarisë

Burimi : <http://gjakova.e-komuna.com>

Pas aplikimit, qytetari do të lajmërohet nga Komuna nëpërmjet e-mailit pasi të i kryhet shërbimi si dhe për kohën kur mund ta tërheqë atë.

Skema logjike

Për ta studiuar më mirë aplikacionin ekzistues është analizuar dhe rishikuar i dokumentacioni si: udhëzimet për punë, procedurat e dokumentuara, skema logjike e ndërimit të sistemit. Përmes kësaj na është mundësuar një rishikim më i mirë rishikimi i sistemit në tërësi dhe aktivitetet të cilat kryhen realisht. Kjo na ka mundësuar ta analizojmë edhe mësimin e punës konkrete nga shfrytëzuesi. Të gjitha këto procedura janë shfrytëzuar si teknika të mbledhjes të informacioneve të bollshme mbi sistemin ekzistues.

Skema logjike e aplikimit të qytetarit në web faqen komunale është paraqitur përmes diagramit algoritmik.

Përshkrimi	Sistemi mundëson modifikimin e profilit të nxënësve
Aktori kryesor	QAP
Parakushtet	Log in
Trigger	Nevoja për modifikimin e përdoruesve

Skenari bazik	Hapet programi, bëhet log in-ni me autentikim, shtypet butoni "Lista QAP ", zgjedhet profili i qendrave të trajnimeve profesionale që duhet modifikuar, ndyshohen të dhënat në fushat përkatëse, shtypet butoni Modifiko, shfaqet mesazhi "a jeni te sigurtë për ruajtjen e ndryshimeve "shtypim butonin ok , sistemi njofton për sukses apo mosukses , mbyllet sistemi.
----------------------	--

Use Case Elementi	Përshkrimi
Numri i use case	42
Aplikacioni	Aplikacioni e-Komuna Gjakovë
Emri i use case	Modifikimi i profilit
Përshkrimi	Sistemi mundëson modifikimin e profilit
Aktori kryesor	QAP
Parakushtet	Log in
Trigger	Nevoja për modifikimin e përdoruesve
Skenari bazik	Hapet programi, bëhet log in-ni me autentikim, shtypet butoni "Menaxho profilin ", zgjedhet profili që duhet modifikuar, ndyshohen të dhënat në fushat përkatëse, shtypet butoni Modifiko, shfaqet mesazhi "a jeni të sigurtë për ruajtjen e ndryshimeve "shtypim butonin ok , sistemi njofton për sukses apo mosukses , mbyllet sistemi.
Use Case Elementi	Përshkrimi
Numri i use case	43
Aplikacioni	Aplikacioni e-Komuna Gjakovë
Emri i use case	Listimi/Kërkimi i shkollave
Përshkrimi	Sistemi mundëson listimin dhe kërkimin e të dhënave të shkollave

Aktori kryesor	QAP
Parakushtet	Log in
Trigger	Nevoja për modifikimin e përdoruesve
Skenari bazik	Hapet programi, bëhet log in-ni me autentikim, shtypet butoni "Lista e shkollave", zgjedhet shkolla që dëshiron të lexohen të dhënat apo analizohen fushat përkatëse, krijon raport e klikon butonin Dalje dhe mbyllet sistemi.

Use Case Elementi	Përshkrimi
Numri i use case	44
Aplikacioni	Aplikacioni e-Komuna Gjakovë
Emri i use case	Listimi/Kërkimi i nxënësve
Përshkrimi	Sistemi mundëson listimin dhe kërkimin e të dhënave
Aktori kryesor	QAP
Parakushtet	Log in
Trigger	Nevoja për modifikimin e përdoruesve
Skenari bazik	Hapet programi, bëhet log in-ni me autentikim, shtypet butoni "Lista e nxënësve", zgjedhet nxënësi që dëshiron të lexohen të dhënat apo analizohen fushat përkatëse, krijon raport e klikon butonin Dalje dhe mbyllet sistemi.

Use Case Elementi	Përshkrimi
Numri i use case	45
Aplikacioni	Aplikacioni e-Komuna Gjakovë
Emri i use case	Listimi/Kërkimi i të trajnuarëve
Përshkrimi	Sistemi mundëson listimin dhe kërkimin e të dhënave
Aktori kryesor	QAP
Parakushtet	Log in
Trigger	Nevoja për modifikimin e përdoruesve
Skenari bazik	Hapet programi, bëhet log in-ni me autentikim, shtypet butoni "Lista e Të TRAJNUARËVE", zgjedhet kandidati i trajnuar që dëshiron të lexohen të dhënat apo analizohen fushat përkatëse, krijon raport e klikon butonin Dalje dhe mbyllet sistemi.

Use Case Elementi	Përshkrimi
Numri i use case	46
Aplikacioni	Aplikacioni e-Komuna Gjakovë
Emri i use case	Dalja /Exit
Përshkrimi	Sistemi mundëson daljen nga aplikacioni
Aktori kryesor	QAP
Parakushtet	Log in
Trigger	Nevoja për mbylljen e aplikacionit
Skenari bazik	Shtypet butoni "Dalje" dhe mbyllet aplikacioni

4.4.5 Pamja e aplikacionit të ridizajnuar

Faqja e parë e aplikacionit të modifikuar do të ketë katër module apo funksione shtesë, siç janë :

- ✓ Shkollat profesionale
- ✓ Qendrat për aftësim profesional
- ✓ Punëdhënësit
- ✓ Komuna e Gjakovës

Krahas këtyre funksioneve shtesë funksionojnë edhe modulet ekzistuese të ofiçarisë komunale respektivisht ofiqaria online dhe menaxhimi i asteve komunale.

Pra, në total gjashtë funksione apo grupe të shfrytëzuesve do të ketë aplikacioni i modifikuar online i Komunës së Gjakovës.




Figura 50. Faqja hyrëse e aplikacionit online të modifikuar

Burimi : Autori

Procedura e regjistrimit të nxënësve do të jetë e njëjtë sikurse edhe për qytetarët. Nxënësi mund të jetë i regjistruar edhe si qytetar më parë, nëse ka pasur nevojë për ndonjërin nga dokumentacionet të cilat i ka tërhequr online nga aplikacioni ekzistues. Ai mund të vazhdojë ta përdor të njëjtën çasje .

Atyre do t'iu kërkohen këto të dhëna tek informacionet kyçe:

- ✓ Numri personal
- ✓ E-mail adresa
- ✓ Fjalëkalimi

- ✓ Përseritja e fjalëkalimit

Tek profili fushat të cilat duhet të plotësohen janë:

- ✓ Emri nxënësit/qytetarit
- ✓ Adresa e venbanimit
- ✓ Kodi postar
- ✓ Shteti ku jeton
- ✓ Telefoni

Listimi është paketa shtesë e fushave të cilat iu është shtuar aplikacionit aktual d.m.th është pjesë e aplikacionit të modifikuar. Përmbajtja e listimit është krijuar në formë të pyetjeve sa vijojnë :

- ✓ A dëshironi të listoheni në listen e bizneseve?
- ✓ A jeni punësuar?
- ✓ A dëshironi të pranoni njoftime me email për shërbime të reja?

Të tria pyetjeve nxënësi apo edhe qytetari do t'iu përgjigjet duke klikuar në kutinë vertetuese nëse përgjegjja është po, e lenë të zbrazët nëse është jo, pastaj azhurohet. Këto pyetje që do ti parashtrihen nxënësit gjegjësisht qytetarit do të kenë efekt shumë të lartë në përpilimin e raporteve të ndryshme për të cilat kanë nevojë administrata komunale, bizneset, shkollat, qendrat e trajnimit profesional apo edhe tjerë persona të autorizuar. Të këto institucione kanë nevojë të marrjes së informacioneve për qeshtje të ndryshme si numrin e nxënësve nëpër shkolla, përkatësin, trajnimet që kryejnë, vendet e lira të punës që ofrojnë bizneset dhe shume kërkime tjera që mund të raporten edhe në forma ndërmodulare.

Këto raporte gjenerojnë statistika të ndryshme të përcjelluara me diagrame, të cilat do ti shqyrtojmë më detalisht në pjesët e moduleve të reja të aplikacionit të rikonstruktuar komunal.

The screenshot shows the 'E-Komuna v.2 Demo' interface. The top navigation bar includes 'FILLIMI', 'PROFILI JUJAJ', 'KONTAKTI', and 'DALJA'. The main content area is divided into a left sidebar with various menu items and a main profile form. The profile form is titled 'Profili juaj' and contains the following sections:

- Informacionet per kyçje:**
 - Nr. Personal: 1111111111
 - E-mail: 1@gjakovaportal.com
 - Fjalëkalimi: [input field]
 - Përsërit fjalëkalimin: [input field]
- Profili juaj:**
 - Emri: [input field]
 - Qytetari x: [input field]
 - Adresa e vendbanimit: [input field]
 - Qyteti: [input field]
 - Kodi postar: 50000
 - Shteti ku jeton: KOSOVA (highlighted with a red circle)
 - Telefoni: 0 [input field]
- Listimet:**
 - A dëshironi të listoheni ne listen e bizneseve?
 - A jeni i punësuar?
 - A dëshironi të pranoni njoftime me email per sherbimet e reja?

An 'AZHURO' button is located at the bottom right of the form.

Figura 51. Kontrolli i profilit i modifikuar nga ana e nxënësit apo qytetarit

Burimi : Autori

Funksioni i parë do të jenë listat e nxënësve nga të gjitha shkollat e mesme të larta të Komunës së Gjakovës (5 janë profesionale + 1 gjimnaz me tri degë nëpër fshatërat për rreth).

Shkollat profesionale të komunës së Gjakovës janë :

- ✓ Shkolla e muzikës “Prenk Jakova”
- ✓ Shkolla Mesme e Lartë Teknike “Nexhmedin Nixha”
- ✓ Shkolla Mesme e Lartë Mjekësisë “Hysni Zajmi”

- ✓ Shkolla Mesme e Lartë Ekonomike “Kadri Kusari”
- ✓ Shkolla Mesme e Lartë Mikse “Gjon Nikollë Kazazi”

Gjakova ka gjimnazin “Hajdar Dushi” i cili ka edhe numërin më të madh të nxënësve brenda kësaj komune. Gjimnazi i ka edhe tri paralele të ndara në fshatërat : Cermjan, Ponashec dhe Bishtazhin. Klasët e X-të janë sipas Kornizës Kurrikulare të Kosovës. Në kudër të kounës është edhe gjimnazi “Asllan berisha” në Rugovë.

Secila shkollë do ta ketë *log in (qasjen)* dhe *password-in (fjalëkalimin)* e vet e cila do të administrohet nga një administrues të cilin do ta caktoi shkolla (preferohet sekretari i shkollës nëse ka trajnim përkatës).

Me nxënësit paraprakisht lidhet një kontratë nga të cilët kërkohet e drejta e shfytëzimit të të dhënave të tyre personale - normalisht atyre ju tregohet qëllimi i këtij aplikacioni dhe dobit që ka shkolla lidhur me shfytëzimin e këtij aplikacioni elektronik, si dhe benefitet personale që kanë vet nxënësit kur të shfytëzojnë aplikacionin online për ndërtimin e karrieres së tyre në të ardhmen e afërt. Këtë kontratë do ta nënshkruaj edhe prindi njëkosisht apo personat të cilat kujdesen për ta duke ju treguar me transparencë të plot të gjitha vetit pozitive që sjell ky aplikacion për të gjitha palët që janë të përfshira. Progresi ekonomik dhe ai arsimor që sjell ky aplikacion shkon përtej interesave personale dhe nivelit komunal.

Gjatë ndërtimit të tabelave, ID grupet janë të shoqëruara me emërin përkatës dhe janë të bashkngjituara përshkrimet . Grupet e shfrytëzuesve janë sa vijojnë:

- ✓ Grup id 1 ka emrin Qytetari dhe iu dedikohet qytetarëve të cilët kanë aktivizuar llogarinë online të aplikacionit elektronik komunal.
- ✓ Grup id 2 Drejtoria e Administratës – grup i cili i dedikohet Drejtorisë së Administratës komunale të Gjakovës, pasi merren dhe arkivon të gjitha të dhënat e banorëve të komunës.
- ✓ Grup id 3 Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Arsimit – i dedikuar për këto dy drejtori komunale së bashku. Këto drejtori do të fokus grupi i në të cilën mbështet edhe i tërë aplikacioni, me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të ekonomisë lokale përmes trajnimeve profesionale për aftësimin e të rinjëve.
- ✓ Grup id 4 është grupi i cili i dedikohet për Drejtorin e Shërbimeve Publike, pasi këtu kryhen një pjesë shumë e madhe e aktiviteteve që i nevojitet interesit të përgjithshëm të qytetarëve.
- ✓ Grupi 5 Zyrja e Informacionit – ky grup i dedikuar për zyrën e informatave për qytetarin. Këtu qytetari njoftohet për të gjitha shërbimet që kryen Komuna e Gjakovës.
- ✓ Grup id 6 Shkollat – Grup i dedikuar për shkollat e mesme të larta të Komunës së Gjakovës. Këtu përfshihen administratat shkollore me shërbimet që ato kryejnë në rrafshin e trajnimeve profesionale, praktikat shkollore dhe kabinetet, duke përfshirë edhe infrastrukturën e objektit shkollor.
- ✓ Grup id 7 Bizneset – Grup i dedikuar për bizneset e Komunës së Gjakovës të cilat marrin pjesë në edukimin profesional të nxënësve të komunës së Gjakovës në forma të ndryshme arsimore apo edhe atyre bizneseve të cilat ndihmojnë arsimimin në këtë Komunë.

- ✓ Grup id 8 Nxënësit – Grup i dedikuar për nxënësit e shkollave të mesme të larta të Komunës së Gjakovës. Në këtë grup të shfrytëzuesve përfshihen të gjithë nxënësit e regjistruar nëpër shkollat e mesme të larta të Gjakovës ku si qëllim është njoftimi i tyre mbi trajnimet profesionale që mbahen në Gjakovë dhe të arriturat.
- ✓ Grup id 9 Qendrat trajnuese – Grup i dedikuar për qendrat trajnuese të Komunës së Gjakovës. Ky grup do të bënë lidhjen mes shkollave të mesme të larta dhe bizneseve mbi trajnimet që mbahen dhe do të mbahen pran këtyre qendrave me të gjitha karakteristikat tjera përcjellëse.
- ✓ Grup id 10 Admin – Grup i dedikuar për administruesit e shkollave. Këtu qasje do të ken vetëm personat e autorizuar nga shkollat e mesme të larta.
- ✓ Grup 20 Power user – Grup i dedikuar për administruesit e web aplikacionit. IT ekspertet komunal që mirëmbajnë tërë sistemin e këtij aplikacioni të modifikuar.
- ✓ Grup 50 i bllokuar – Grup i dedikuar kur qytetari është i bllokuar apo i pa aktivizuar. Shërben për të ndihmuar qytetaraët në një apo në mënyrë tjetër nuk kanë qasje në shërbimet elektronike të Komunës.

group_id	group_name	description
1	Qytetari	Qytetari i cili e ka aktivizuar logarine
2	d_Administrates	Grupi i dedikuar per drejtorine e administrates
3	d_ZhEkonomik_Ar	Grupi i dedikuar per drejt. e zh. ekonomik dhe d. e arsimit
4	d_ShPublike	Grupi i dedikuar per drejt. Sherbimeve Publike
5	z_Informacionit	Grupi i dedikuar per zyren e informacionit per qytetare
6	shkollat	Grupi i dedikuar per shkollat e komunes
7	bizneset	Grupi i dedikuar per bizneset e komunes
8	nxenesit	Grup i dedikuar per nxenesit qe e kane perfunduar shk. e mesme
9	qendrat_trajnuese	Grupi i dedikuar per qendrat trajnuese te komunes
10	admin	Administratoret
20	power user	Super user
50	blocked	Qytetari i bllokuar ose i pa aktivizuar

Tabela 26. Tabela e grupeve të shfrytëzuesëve

Burimi : Autori

Ndryshimet e grupeve të përdoruesve nga aplikacioni ekzistues janë relavante, pasi tek kanë funksionuar vetëm këto grupe :

- ✓ Grupi_id1 me emrin qytetari
- ✓ Grupi_id 4 me emrin grupi 4
- ✓ Grupi_id 5 me emrin info
- ✓ Grupi_id10 me emrin admin
- ✓ Grupi_id 50 me emrin blocked

Numri shumë më i madh i grupeve të shfytëzuesve në ridizajnimin e aplikacionit mundëson edhe funksionimin më të mirë të tij si dhe marrjen e më shumë informacioneve nga grupe të ndryshmetë interesit të kyçura në aplikacion. Kjo nënkupton se sasia e menaxhimit të informacionit rritet dukshëm nga burimet tjera shtesë të kyçura në aplikacionin e modifikuar. Do të ketë më shumë propozime, komente, raporte, tabela e të dhëna tjera në interes të qytetarit dhe vet drejtorive komuale e të tjerëve.

4.4.2 Grupi i shfrytëzuesve qytetarët

Ky grup është i dedikuar qytetarëve dhe figuron edhe në aplikacionin aktual por që modifikuar për të rritur funksionalitetin e tij edhe për qëllimet tjera. Në këtë fokus grup edhe nxënësit e shkollave mund të regjistrohen si qytetar. Kjo është edhe njëra ndër arsyet e modifikimit të këtij moduli ekzistues.

Tek sektori i aplikimeve janë shtuar modulet sa vijojnë:

- ✓ Lista e nxënësve të trajnuar
- ✓ Lista e bizneseve
- ✓ Aplikimet e mia

Në këto fusha mund të merren të gjitha informacionet mbi trajnimet e kryera nga ana e nxënësve, vendet e aplikimit të tyre dhe a janë këto aplikacione të hapura në procedurë apo kanë marr përgjegjeje d.m.th janë zgjidhur. Po ashtu është edhe lista e bizneseve që kërkojnë praktikant apo punëtor në varësi të interesave të tyre.

Mire se erdhe : 1111111111 <input type="checkbox"/>	APLIKIMET E HAPURA					
TE DHENAT	Përshkrimi	Aplikuar per	Statusi	Data e regjistrimit	Përgjegjur	Shikuar
Vende te lira pune	Nuk ka shënime					
APLIKIMET	APLIKIMET E ZGJIDHURA					
Lista Nxenesve te trajnuar	Përshkrimi	Aplikuar per	Statusi	Data e regjistrimit	Përgjegjur	Shikuar
Lista Bizneseve	Nuk ka shënime					
Aplikimet e mia						

Figura 52. Modifikimi i grupit 1_ Qyterarët

Burimi : Autori

Benifiti i administratës komunale tek ky modifikim qendron edhe tek raportet. Nga të dhënat mbi nxënësit e trajnuar, lista e bizneseve, vendet e lira të punës dhe aplikimet për

punësim mund të nxjerren statistika të ndryshme të interesit komunal për të gjitha drejtoritë komunale dhe me gjerë.

Përpilimi i raporteve mund të bëhet nga një, dy apo më shumë fusha njëkohësisht varësisht nga dedikimi që ka raporti. Nëse ka nevojë këtyre raporteve mund të ju shtohen edhe pashqyrimet përmes diagrameve të ndryshme të cilat mund të lidhen edhe me programet tjera aplikative.

Të gjitha këto raportime lehtësojnë tej mase punën e punëtorëve të autorizuar administrativ komunal dhe njëherit koordinojnë në mënyrë automatike punën e drejtorive të ndryshme mes veti pa pas nevojë të komunikimit vetanak.

Raportet e këtij moduli mund të ndërlidhen edhe me modulet tjera, me anë të autorizimit pasi është zone e rezervuar.

Kërkimi i avansuar në këtë modul na mundëson qasjen shumë të lehtë në të gjitha të dhënat nga tabelat e krijuara me fushat përkatëse. Këtu iu është lënë hapësirë edhe rikonsultimit të mëtutjeshëm të modulit respektivisht aplikacionit me qasje tjera të nevojshme të kohës me arsyen e avansimit të mëtutjeshëm të tij.

Sa i përket qasjeve të nxënësve në të njetin modul është berë për arsyen se ata që kanë të kryer trajnime profesionale apo kanë ndonjë aftësi profesioanle tek vendet e lira të punës mund të gjejnë ndonjë punë, edhe nëse ajo është sezonale. Ligji i punës i lejon të rinjtë mbi moshën 15 vjeqare të punojnëme orë të shkurtuar dhe punë pa rrezik për shëndetin e tyre.

Marrëdhënia e punës mund të themelohet edhe me personat në mes të moshës pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, të cilët mund të punësohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor. (Ligji Nr 03/L-212 i punës , Dhjetor 2010). Në këtë mënyrë ata mund të gjenerojnë të ardhura për shkollim e tyre të mëtujueshëm dhe lehtësojnë barrën finaciare të financimit nga familja.

4.4.6 Grupi i shfrytëzuesve shkollat profesionale

Ky grup është i dedikuar për Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorin e Arsimit, si grup id 3. Ky është grup që bënë pjesë në modulën e modifikuar të aplikacionit elektronik komunal me emrin shkollat profesionale. Këtu janë potencuar dy drejtori komunale së bashku, jo rastësisht. Këto dy drejtori janë përzgjedhur që të janë në të njëjtin grup të shfrytëzuesve për disa arsye. Duke ditur se arsimit është motori i zhvillimit ekonomik të një vendi dhe ndikon në rritjen e standartit të jetës atëherë edhe të dhënat e këtyre dy drejtorive në fjalë duhet të gjenden në të njëjtin vend për të pasur një pasqyrë shumë më të qartë në kohë reale kur të të dhënave kur nevojiten ato dhe jo vetëm atëherë por në tërësi. Prezentimet janë të tilla se këto drejtori duhet të janë në koleracion të rregulltë mes veti për të ndërtuar legjitimitet më të lehtë të punësimit brenda kompetencave që i kanë normalisht dhe mundësive që posedojnë ato. Këto dy drejtori duhen të jenë fleksibël dhe t'u përshtaten kërkesave të një tregu dinamik dhe të ndryshimeve shumta që po ndodhin me zhvillimet teknologjike prandaj janë parë si të pandara mes veti në këtë aplikacion në mënyrë që të përcjellat ky trend i ndryshimeve sado që mundet për të mirën e qytetarit.

Shkëmbim i të dhënave të dy drejtorive në një grup të përbashkët të shfrytëzuesve rrit edhe efikasitetin e punës për të dyja palët, pasi për këto të dhëna kanë nevojë edhe drejtoritë tjera dhe sidomos biznesi lokal dhe investitorët eventual nga do qofshin ata. Njëkohësisht rritet edhe trasparenca ndaj të gjitha palëve, të intersuara.

Të drejtën për editimin e të dhënave e kanë vetëm personat e autorizuar nga dy drejtoritë përkatëse. Mund të kyqen edhe drejtorit tjera me autorizim përkatës nga administratori i sistemit të menaxhimit të informacionit, i cili është kuadër i kuvendit komunal të Gjakovës.

Ky modul përmban :

- ✓ Lista e shkollave
- ✓ Lista e biznesit
- ✓ Lista e trajnimeve
- ✓ Raportet
- ✓ Lista e nxënësve
- ✓ Lista e qendrave trajnuese
- ✓ Vendet e lira të punës
- ✓ Aplikimet
- ✓ Raportimet

Tek moduli lista e shkollave janë mbledhur të dhënat e detajuar për të gjitha shkollat e mesme të larta të Gjakovës të tilla si : emri i shkollës, drejtori i shkollës, telefoni zyrtar dhe ai mobil i shkollës, emaili, kodi komunal, adresa e plotë e shkollës, po ashtu është paraqitur edhe lokacioni i shkollës përmes pamje përmes adresës elektronike

www.openstreetmap.org si dhe mund të editohen të gjitha këto të dhëna . Grup id 6. Të dhëna këto që janë edhe të domosdoshme edhe për DZHE përpos asaj të arsimit.

Mire se erdhe : 3333333333

TE DHENAT

[Lista Shkollave](#)

[Lista Bizneseve](#)

[Lista e Trajtimeve](#)

[Raportet](#)

[Lista e Nxenesve](#)

[Lista Q. Trajnuese](#)

[Vende te lira pune](#)

APLIKIMET

Nuk ka shënime

RAPORTIMET

Nuk ka shënime

Pastro **KERKO**

Shkollat profesionale


Emri i shkolles	Drejtori	Telefoni	Email	Komuna	Adresa	Lokacioni	Shto
Sh.m.teknike "Nexhmedin Nxha"	n. Kepuska		nnxha@hotmail.com	17	B. Kastrati	https://www.openstreetmap.org/#map=18/42.384381/20.4324860	Edito
Gjimnazi: "Hajdar Dushi"	Bedri Cahani			17	"Beqir Kastrati" p.n.	https://www.openstreetmap.org/#map=18/42.3851565/20.4335431	Edito
Sh.m. mjekësië "Hysni Zajmi"	Isuf Aslani			17	"Normaja e Gjakovës"	https://www.openstreetmap.org/#map=18/42.3828064/20.4353045	Edito
Sh.m.ekonomike "Kadri Kusari"	Sinan Hajdari			17	"Normaja e Gjakovës"	https://www.openstreetmap.org/#map=18/42.3831828/20.4361038	Edito

Figura 53. Lista e shkollave

Burimi : Autori

Po ashtu në funksion të kësaj është edhe makina e kërkimit për të dhëna shtesë nëse ka nevojë pala e intersuar si mund të bëhet pastrimi i tyre nëse është bërë ndonjë gabim gjatë shënimit të të dhënave nga vet përdoruesi. Nga këto të dhënave ne do të marrim informacione shtesë mbi shkollën në fjalë. Këtu secili mund të njoftohet më detalisht mbi gjendjen faktike dhe fizike të shkollës siç janë: numri total i nxënësve, numri sipas gjinive, numri i klasëve mësimore, kabineteve për mbajtjen e praktikës profesionale, numri i punëtorëve, numri i arsimtarëve, numri i personelit administrativ, numri i tualeteve dhe mund të modifikohet edhe për të dhëna tjera në varësi të specifikave të shkollës.

Mire se erdhe : 3333333333 
TE DHENAT
Lista Shkollave
Lista Bizneseve
Lista e Trajnimeve
Raportet
Lista e Nxenesve
Lista Q. Trajnuese
Vende te lira pune
APLIKIMET
Nuk ka shënime
RAPORTIMET
Nuk ka shënime

Shto/Edito Shkollat	
Emri i shkolles	SHMLT "Nexhmedin Nixha"
Drejtori	Neshet Kepuska
Telefoni	<input type="text"/>
Faxi	0390-322-099
Email	nnixha@hotmail.com
Komuna	GJAKOVË 
Adresa	B. Kastrati
Lokacioni	https://www.openstreetmap.org/#map=18/42.384-
Nr Klaseve	<input type="text" value="0"/>
Nr Nxenesve	<input type="text" value="0"/>
Nr Nx Meshkuj	<input type="text" value="0"/>
Nr Nx Femra	<input type="text" value="0"/>
Laboraret	<input type="text" value="0"/>
Nr Dh Arsimitareve	<input type="text" value="0"/>
Nr Dh Administrative	<input type="text" value="0"/>
Nr Toaleteve	<input type="text" value="0"/>
Nr Dh Tjera	<input type="text" value="0"/>

AZHURO

Figura 54. Editimi i shkollave

Burimi : Autori

Si modul tjetër i shtuar në aplikacion aktual është edhe lista e bizneseve. Bizneset i takojnë grupit id shtatë të shfytëzuesëve që në kuadër të skedarit të shkollave profesionale . Fokusimi i arsimit tek biznesit duhet jetë me prioritet pasi nxënësit duhet të orientohen drejtë profesioneve të caktuara që kërkon biznesi. Bashkëpunimi ndërmjet shkollave profesionale dhe bizneseve është shumë i varfër dhe kryesisht i nxitur nga projektet e donatorëve ndërkombëtar të cilat janë tani më në përfundim e sipër dita e ditës. Duke

bazuar edhe në vet orientimin e MASHT-it për lidhjen midis arsimit cilësor dhe punësimit atëherë biznesi duhet ta ketë vendin në këtë aplikacion të modifikuar me modulën e saj vetanak. Përmes trajnimeve nga bizneset fitohet eksperiencia profesionale për tregun e punë. Eksperiencë kjo që ndikon në ngritjen e edukatës së punës profesionale. Me vet punësimin e kandidatit nga ana e biznesit bëhet ndikim direkt në zbutjen e lartë të papunësisë që ekziston në komunën tonë. Këtu duhet të zbatuar një masë kushtëzuese e rëndësishme së veçantë, që është ruajtja e standarteve të punës, serioziteti reciprok i palëve dhe zbatimi i etikës profesionale si garanci për marrëdhënien profesionale afatgjatë ndërmjet shkollave si ente të arsimit dhe biznesit si destinacion i punësimit dhe aftësimin profesional të të rinjëve bazuar në kërkesat e saj. Bizneset duhet të aplikojnë pran administratorëve komunal përkatës për të marr qasjen në aplikacion.

Tek lista e bizneseve, janë përfshirë fushat emri dhe mbiemri i pronarit të kompanisë, emri i kompanisë, numrat e telefonit, llojet e trajnimeve që ofron ajo kompani. Edhe ky modul përmban makinën e kërkimit. E veçanta është se brenda këtij moduli është krijuar një relacion me të dhënat e trajnimeve dhe vlerat e tyre. Kjo ndërlidhje është bërë përmes butonit kërkim i avansuar. Kërkimi i avansuar nënkupton qasje edhe në modulet tjera me autorizim shtesë, përditësim i informacioneve nga bizneset për oferta të reja pune, verifikim i kandidatëve të kualifikuar në bazë të profesioneve përkatëse. Kërkimi i avansuar është digjitalizim efikas për hulumtimin e të dhënave. Ky direktorium i biznesit nënkupton se mund të bëhet edhe kategorizimi i bizneseve në bazë të aktiviteteve që ata kryejnë apo veprimtarive që ata ushtrojnë. Të gjitha këto mund paraqiten në formë të raporteve përmes modulit të raportit që po ashtu është pjesë e skendarit të shkollave profesionale .

Pas shtypjes së butonit kërkim i avansuar neve na paraqitet tabela e kërkos, me të dhënat për nxënësitë e cila përmban fusha:

- ✓ Emri i nxënësit
- ✓ Emri i prindit
- ✓ Mbiemri i nxënësit
- ✓ Gjinia – ka listë rënëse zgjedhore për dy gjinitë
- ✓ Ditëlindja – përfshihet data e plot e lindjes
- ✓ Telefoni personal
- ✓ Adresa dhe numri i hyrjes
- ✓ Komuna – me listë rënëse për të gjitha komunat e Kosovës sipas rradhitje së rretheve në dokumentet zyrtare të Kosovës
- ✓ Email adresa e nxënësit
- ✓ Shkolla nga vjen nxënësi si listë rënëse për të gjitha shkollat e mesme të larta të Gjakovës
- ✓ Departamenti apo drejtimi i trajnimit, edhe kjo si listë rënëse me disa drejtime aktuale e cila shumë lehtë mund të modifikohet nga administruesit e shkollave dhe të adaptohet enkas për ta.
- ✓ Titulli që fiton pas trajnimit
- ✓ Grupi i modulit
- ✓ Fotoja e kandidatit të trajnuar
- ✓ Data e përfundimit të trajnimit

Edhe këtu funksionon makina e kërkimit për gjetjen e ndonjë të dhëne të posaçme mbi kandidatët apo edhe ndonjë kandidat tjerë mirëpo që ai është i edituar më parë.

Tek moduli lista e nxënësve ne i gjejmë të gjitha të dhënat për nxënësit e kualifikuar, telefonin dhe llojin e trajnimit të cilat mund të shtohen për aq sa trajnime kryen nxënësi, si në figurën e mëposhtme. Nxënësit janë pjesë e grupit të tetë të shfytëzuesve (id 8) që funksion tek skedari i shkollave profesionale.

Emri	Emri i prindit	Mbiemri	Gjinia	Drejtimi	Titulli	Telefoni	Shto trajnim	
Filan	Filani	Fisteku	M	Departamenti Elektroteknikë		044111111		

Nr. rreshtave: 1 /

Figura 55. Lista e nxënëve të kualifikuar

Burimi : Autori

Nga figura vërehet qartë se edhe këtu ekziston mundësia që të qasemi në kërkim të avancuar mbi të dhënat e nxënësve.

Tek moduli lista e qendrave trajnuese do të përfshihen të gjitha qendrat e trajnimit të cilat janë të regjistruara në komunën e Gjakovës dhe që janë taksa paguese. Qendrat trajnuese do të obligohen që në bashkëpunim me Kuvendin Komunal ti paraqesin të gjitha llojet e trajnime që mbajnë, kohën e fillimit, kohën e mbarimit dhe shënimet tjera që kërkon aplikacioni i modifikuar elektronik. Në këtë mënyrë shtohet transparenca e trajnimeve të

mbajtura dhe duhej të rritet intersimi i të rinjëve për pjesëmarrje në mënyrë që të aftësohen profesionalisht për një profesion të caktuar, që përmes tij të potencial për tregun e lirë të punës.

Kjo listë përmban emrin e qendrës së trajnimit, adresën, email adresën, web faqen e qendrës trajnuese e cila mund të jetë udhëzues shumë i mirë mbi trajnimet që mbahen aty, numrin e telefonit ku mund të kontaktohen pesonat përgjegjes pran atyre qendrave.

Qëllimi i qendrave aftësuese profesionale është që aplikantët apo edhe punëkërkuesit përtej pajisjes me kualifikimin e duhur profesional, duhet të jenë dhe të përgatitur me aftësi të teknike dhe të karrierës, si një domosdoshmëri për të krijuar një profil kandidature funksionale të kërkuar nga punëdhënsi respektivisht biznesi. Prandaj aplikacioni elektronik i riformatuar i ka dhënë një peshë specifike vet qendrave trajnuese dhe biznesit në mënyrë që ngritet vetdija qytatare për podesimin e një zanati punëdhënës. Raportet e krijuar nga fushat e kombinuara nga qendrat e trajnimeve profesionale dhe biznesve në këtë rast dhe duke shfrytëzuar lista e shkollave apo edhe të nxënësve të kualifikuar është një gamë e madhe e informacioneve për vet DZHE, DA, DMS dhe drejtoritë tjera të komunës së Gjakovës.

Kjo mundëson qasje të përshpejtuar në informacion edhe në rastet e donacioneve të jashtme që nevoiten për arsye të ndryshme nga komuna apo edhe biznesi pse jo. Këtu mund të përfshihen edhe qendrat për orientim në karrier pasi ato tani duhet të janë të domosdoshme, por të cilat si të vetme nuk mjaftojnë në ngritje rapide të vetdijes së të rinjëve për të ndjekur shkollat profesionale, por bazuar në shfytëzimin e raporteve dhe koordinimin me biznesin

rruga suksesit arrihet më lehtë. Qendra për Këshillim në Karrierë do të luajë rol të posaçëm në përforcimin e lidhjeve në mes të sektorit privat dhe shkollave për arsimi dhe aftësim profesionale . Qendra do t'u ofrojë nxënësve të shkollave për arsimi dhe aftësim profesionale mundësitë për të fituar njohuri, aftësi dhe përvojën e duhur për të identifikuar opsionet, për të shqyrtuar alternativat në tregun e punës dhe për të pasur sukses në shoqëri., prandaj edhe qasja e tyre në raportet e detajuara të aplikacionit nga drejtoritë e ndryshme është me benefit për to. Këto qendra duhet të kenë leje qasje nga administratori, përmes një shfytëzuesi. Në këtë mënyrë rritet funksionalizimi i qendrave për orientim në karrier si një udhëzuese profesioni tek të rinjt.

Ky aplikacion i sistemit të informacionit është një mundësi e mirë për marketing të tillë dhe menaxhimin e të dhënave për orientim e të rinjëve drejt shkollave profesionale. E veçanta e modulit është që shërbimi që ofrohet është i plotë dhe shumëdimensional.

Tek regjistri edito na paraqitet tabela e mëposhtme mbi atë qendër trajnuese, duke përfshirë edhe kontaktet elektronike si emaili dhe web faqja mes të dhënave tjera.

Shto/Edito Qendrat trajnuese



Q. Trajnuese	BONEVET
Address	Gjakove
Telefoni	0
Email	9@gjakovaportal.com
Web faqja	http://www.bonevet.org
Çasja	9999999999
Fjalëkalimi
Regjistruar nga :	-
Midifikuar nga:	- 14/01/2018 20:14:27
 	

Figura 56. Editimi i qendrave trajnuese

Burimi : Autori

Pra vërehet se secila qendër ka qelsin e qasjes dhe fjalëkalimin vetanak dhe dihet se kush i ka regjistruar ato të dhëna dhe koha e modikimit me datë dhe orë të plot.

4.4.7 Grupi i shfrytëzuesve qendra për aftësim profesional

Kjo hapësirë në aplikacion online është e dedikuar për qendrat për aftësim profesional dhe ato trajnuese të komunës së Gjakovës. Në këtë modul bëhet përshkrimi i tyre.

Në këtë grup janë të ndër lidhura tabelat :

- ✓ Të trajnuarit
- ✓ Editimi i nxënësve

- ✓ Trajnimet
- ✓ Lista e trajnimeve
- ✓ Editimi i trajnimeve
- ✓ Raportimet
- ✓ Aplikimet

Tabela të trajnuarit përmban këto të dhëna si në vijim :

- ✓ Emrin e kandidatit që të trajnohet
- ✓ Emrin e prindit të kandidatit
- ✓ Mbiemri i kandidatit
- ✓ Titulli i trajnimit respektivisht lloji i trajnimit që do të ndjek kandidati
- ✓ Statuti ku i shënohet arritjet gjatë trajnimit profesional
- ✓ Vëretje do të ceket se cilit lloj të vlerësimit iu është nënshtruar kandidati
- ✓ Data e fillimit të trajnimit
- ✓ Data e mbarimit të trajnimit

Nga kjo tabelë po ashtu mund të bëhet kërkimi i avansuar i të dhënave dhe editimi i të dhënave . Çdo aftësim profesional i në të riu përmes qendrave për aftësim evidentohet ë dhe mund të raportohet sipas nevojës në cilën do nga modulet e modifikuara të kësaj platforme elektronike.

Editimi i nxënësve bëhet përmes tabelës e cila është e ndërlidhur me tabelën të trajnuarit.

Editimi apo shtimi i nxënësve përmban këto fusha tabelare si vijojnë :

- ✓ Emri i nxënësit

- ✓ Emri i prindit
- ✓ Mbiemri i nxënësit
- ✓ Emri i plotë si masë sigurie
- ✓ Gjinia
- ✓ Ditëlindja
- ✓ Telefoni
- ✓ Adresa
- ✓ Komuna nga vjen nxënësi
- ✓ Kodi postar i komunsë nga vjen nxënësi
- ✓ Email adresa e nxënësit
- ✓ Shkolla ku është duke vijuar mësimet nxënësi apo ku i ka vijuar
- ✓ Departamenti apo drejtimi që ndjek nxënësi në shkollë
- ✓ Titulli i trajnimit që merr nxënësi pas përfundimit të trajnimit
- ✓ Data e përfundimit të trajnimit
- ✓ Qasja – i lejohet personit të autorizuar
- ✓ Fjalëkalimi i personit të autorizuar
- ✓ Fotografia e nxënësit

Shumica nga fushat kanë lista rënëse ku mund të zgjidhen vlerat drejtëpërdrejtë pa pasur nevojë që të shkruhet të dhënat. Këto vlera zgjedhëse mund të ndryshojnë në varësi nga llojet e trajnimeve apo kërkesave që kanë qendrat e trajnimeve profesioanle. Por proceduara e menaxhimit të të dhënave mbetet e njejtë dhe lehtësisht e përdorshme për secilin administrues të qendrave trajnuese apo edhe personave tjerë të aurtorizuar që të kenë qasje.

Mire se erdhe : 6666666666 ✖
TE DHENAT
Lista Nxenesve
Te trajnuarit
Lista Trajnimeve
Lista Q. Trajnuese
Lista Shkollave
Vende te lira pune
APLIKIMET
Nuk ka shënime
RAPORTIMET
Nuk ka shënime

Shto/Edito Nxenesit	
Emri	Fillan
Emri i prindit	Fillani
Mbiemri	Fisteku
Emri i plote	Fillan Fisteku
Gjinia	M <input type="checkbox"/>
Datelindja	01/07/2000 <input type="text"/>
Kontakti:	
Telefoni	044111111
Adresa Numri	Nena Tereza
Komuna	GJAKOVË <input type="text"/>
Kodi postar	50000
Email	8@gjakovaportal.com
Shkola	SH.M.TEKNIKE "NEXHMEDII NIXHA" <input type="text"/>
Departamenti	DEPARATAMENTI ELEKTROTEKNIKË <input type="text"/>
Titulli	TEKNIK ELEKTRO <input type="text"/>
Data e perfundimit	10/06/2017 <input type="text"/>
Çasja	8888888888
Password	<input type="text"/>
Photo	<input type="text"/>

Figura 57. Editimi i nxënësve në qendrat trajnuese

Burimi : Autori

Tek tabela editimi i nxënësve - trajnimet do të merren të gjitha evidentimet mbi trajnimet e kryera, vrejttjet dhe suksesin e arritur për secilin nxënës që është trajnuar.

Tek fusha i trajnuari, e cila ka vlerë zgjedhëse, pasi që nxënësit parapraktikisht është regjistruar pran qendres trajnuese dhe ato të dhëna kanë databazë unike, i regjistrohet emri, emri i prindit dhe mbiemri. Fusha trajnimi plotësohet me llojin e trajnimit që kryen nxënësi dhe data kur është kryer trajnimi, po ashtu si vlerë e zgjedhur nga tabelat paraprake. Tek fusha statuti mund të zgjidhet vlera, kaloi, dështoi apo e padefinuar nëse kandidati ende nuk

është testuar. Rezultati ipet në formë të pikëve të fituara nga testime apo cila do formë që ai vlerësohet nga trajnerët e aftësisë profesionale pranë qendrave në fjalë. Tek vretet mund të shënohet çdo koment që e shpreh të arsyeshëm personi përgjegjës apo trajnuesi.

Tabela përmban data të përfundimit të trajnimit dhe datën e modifikimit, të dy këto kanë tipin e të dhënave data dhe koha, pra shënohet edhe ora e qasjes përpos datës. Të dhënat azhurohen përmes butonit të azhurimit. Azhurimi i të dhënave mund të caktohet të bëhet edhe në baza ditore apo javore, nëse kërkohet një gjë e tillë nga administratori.

Shto/Edito Nxenesit - Trajnimet	
I Trajnuari *	FILAN FILANI FISTEKU ▼
Trajnimi *	ARBER - TRAJNIM PER Z - 2017-08-15 ▼
Statusi *	KALLOJ ▼
Rezultatet	94
Verejtjet	KANDIDATI KE QENE I RREGULLT GJATE TRAJNIMEVE DHE I FOKUSUAR NE KURS
Data e regjistrimit	- 14/01/2018 19:54:37
Date Modified	- 14/01/2018 19:54:37
AZHURO	

Figura 58. Editimi i nxënësve dhe trajnimeve

Burimi : Autori

Tabela shtimit të trajnimeve e cila editohet nga listave e trajnimeve përmban këto fusha si në vijim :

- ✓ Titulli i trajnimit - ku shënohet titulli i kursi për aftësim profesional që ka ndjek nxënësi
- ✓ Qendra trajnuese ku evidentohet qendra ku e kryer trajnimin nxënësi
- ✓ Instruktorët ku shënohen emrat e gjithë trajnereve të cilët e kanë mbajtur kursin profesional për aftësim që ka marr pjesë nxënësi
- ✓ Data kur ka filluar trajnimi
- ✓ Data e mbarimit të trajnimit
- ✓ Gjithsejt ditë pune - ku evidentohet ditë punës gjatë pjesëmarrjes në trajnim
- ✓ Orë pune - plotësohet me numrin e saktë të orëve sa ka zgjatur trajnimi profesional
- ✓ Lokacioni - ku shënohet vendi se ku është kryer aftësimi profesional
- ✓ Dokumentet - shënohet të gjitha dokumentacionet të cilat i ka dorëzuar kandidati
- ✓ Kryhet azhurim i ë dhënave apo edhe aulimi i tyre me rast nevojë

Pra, tabela përmban ë gjitha të dhënat e nevojshme administrative të cilat nevojiten për evidentimin e certifikimit të një kandidati pas kryerjes së një aftësimi profesional pran një qendre të caktuar trajnuese.

Të gjitha këto të dhëna mund ti shoh edhe biznesi, kuptohet përmes një autentifikimi paraprak, atëherë kjo tregon edhe efikasitetin dhe domosdoshmërin e funksionalizimit të këtij aplikacioni të modifikuar pran komunës, bazuar në rolin që do ta ketë në procesin e

menaxhimi të informacionit dhe rritjes së transparencës komunale në raport me bashkëpunëtorët tjerë.

Shto/Edito Trajnimet	
Titulli i trajnimit	Trajnim per X
Q. trajnuese	ARBER
Instruktoret	Trainer 5, Trainer 6
Data nga	01/08/2017
Data deri	04/08/2017
Gjithsejt dite	4
Gjithsejt ore	0
Lokacioni	Lokacioni x
Dokumentet	
Data e regjistrimit	- 15/08/2017 08:21:04
Date Modified	- 15/08/2017 08:21:04
<input type="button" value="AZHURO"/> <input type="button" value="ANULO"/>	

Figura 59. Editimi i trajnimeve

Burimi : Autori

4.4.8 Grupi i shfrytëzuesve punëdhënësitë

Kjo hapësirë është e rezervuar vetëm për kompanië të cilat kërkojnë punëtorë të kualifikuar. Bizneset nuk kanë qasje tjetër në aplikacion direkt pos në këtë modul, pasi për modulet tjera siç është cekur më lartë duhet leje nga administruesi i aplikacionit. Nga regjistri vende të lira pune shfaqet tabela oferta pune nga mund të editohen të dhënat për punësim.

Tek tabela oferta pune përmban të gjitha të dhënat të cilat duhet ti kërkohen një kandidati i cili ka nevojë për një punë të caktuar bazuar në kualifikimin që ka.

Mire se erdhe : 6666666666 ✖

TE DHENAT

[Lista Nxenesve](#)

[Te trajnuarit](#)

[Lista Trajnimeve](#)

[Lista Q. Trajnuese](#)

[Lista Shkollave](#)

[Vende te lira pune](#)

APLIKIMET

[Nuk ka shënime](#)

RAPORTIMET

[Nuk ka shënime](#)

Pastro

KERKO

Kerkimi i avansuar

Oferta pune

Gjithsej shenime: 1

Emri i kompanise	Titulli i punes	Pershkrimi	Data nga	Data deri	Dokumentet	Data e regjistrimit	Shto
ATI-KOS	Praktikan - Teknik i IT - 2 persona	Kerkohen 2 persona te interesuar per praktike gjat muajve shkurt-mars 2018	16/01/2018	15/02/2018			Edito

Aktivata Windows

Figura 60. Vende të lira pune _ oferta pune

Burimi : Autori

Ofrimi elektronik i një vendi pune përmes portalit komunal nga bizneset lokale apo më gjërë, me qëllim të rritjes së nivelit të punësimit tek të rinjtë e kualifikuar, sidomos i atyre të diplomuar në shkollat profesionale dhe që kanë marr një aftësim shtesë përmes qendrave trajnuese, është komunikim interaktiv elektronik mes palëve, që tregon se jemi në hap me zhvillimin teknologjik të kohës konkretisht botës digjitale. Rrjetizimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit të katërkëndëshit komuna, shkolla, qendra aftësuese profesionale dhe biznesit si meritore i zbutjes së papunësisë, përmes informacioneve elektronike të azhuruara, tregon kulturën e punës për mirëqenjen sociale të të gjithë akterëve të përfshirë. Ky është një progres komunal drejt ngritjes së mirëqenjes së banorëve të saj, një hap i ri kah zhvillimi ekonomik dhe ndikimin në parandalimin e migrimit të rinjëve për qeshtje punësimi.

Tabela editimi i ofertave të punës është dizajnuar nga këto fusha që duhet të plotësohen prej personave zyrtar të autorizuar të kompanive përkatëse që kërkojnë punëtor të kualifikuar në mënyrë elektronike nga aplikacioni i modifikuar i komunës së Gjakovës :

- ✓ Emri i kompanisë
- ✓ Tiulli i punës - që kërkohet nga kompania në fjalë
- ✓ Përshkrimi i vendit të punës dhe specifikat tjera për atë pozitë, si dhe numri i punëtorëve që kërkohet
- ✓ Data kur fillon punën kandidati
- ✓ Data deri kur përfundon kontrata e punës
- ✓ Dokumentet, fusha ku evidentohet të gjitha dokumentet të cilat i dorëzon kandidati pran kompanisë në të cilën aplikon për punësim
- ✓ Data e regjistrimit ku shënohet data e aplikimit dhe dorëzimit të dokumenteve të kërkuara
- ✓ Editimi i të dhënave

Edhe kjo tabelë ka makinën e kërkimit për ndonjë informacion shtesë, si për përmban lidhjen e kërkimeve të avansuara. Figura e mëposhtme tregon pamjen e tabelës së përshkruar.

Shto/Edito Oferta pune

Titulli i punes	Praktikan - Teknik i IT - 2 persona
Emri i kompanise	ATI-KOS ▼
Pershkrimi	KERKOHEN 2 PERSONA TE INTERESUAR PER PRAKTIKE GJAT MUAJVE SHKURT-MARS 2018
<u>Konkursi i hapur:</u>	
Data nga	16/01/2018
Data deri	15/02/2018
Dokumentet	
Data e regjistrimit	-
Date Modified	Filan Fisteku - 16/01/2018
<input type="button" value="AZHURO"/> <input type="button" value="FSHIJE"/> <input type="button" value="ANULO"/>	

Figura 61. Oferta pune nga kompanitë e ndryshme

Burimi : Autori

Siç shihet edhe nga figura tabela përmban data e regjistrimit të të dhënave dhe modifikimit të tyre, si dhe butonat për azhurim, fshirje apo anulim të të dhënave të evidentuara.

Ky komunikim elektronik përmes një aplikacioni të tillë të moderuar me një qasje të re produktive edhe në aspektin e kohës dhe në aspektin profesional të të gjitha palëve të involvuara na tregon se Gjakova nuk rastësisht është një qytet digjital kosovar .

4.4.9 Roli dhe rëndësia e raporteve të aplikacioni të rindërtuar elektronik komunal

Për informimin e drejtë të qytetarit është e rëndësishme të bëhet një përmbledhje e të gjitha veprimtarive për të parë mbarëvatjen e saj. Raportet shërbejnë edhe që të diskutohet për ta, hidhen hipoteza ose të jepen ide të reja. Propozimet dhe komentet vetëm sa e ngrisin transparencë në cilin do nivel që është ajo.

Panorama e cila mund të shfaqet me përpilimin të raporteve është një diapazoni të gjërë. Lidhja dhe ndërlidja mes moduleve na mundësohen të përpilojmë raporte të panumërta, vetëm duke përzgjedhur fushat nga tabelat ekzistuese bazuar në destinacionin e informacionit apo menyren se si ai duhet të menaxhohet.


Kerko	
Emri	Idriz
Emri i prindit	Asllan
Mbiemri	idrizi
Q. Trajnuese	QENDRA E TRAJNIMEVE 3 ▼
Titulli i trajnimit	Salldues
Data nga	10/4/2018
Data deri	10/7/2018
Lokacioni	Rruga " Skenderbeu"
Pastro	

Figura 62. Raport për një kandidat

Burimi : Autori

Përdorimi i termave ekonomik gjatë raportimit me përmbajtje të të dhënave sasiore të mbledhura nga tereni, mbi tregun apo çfarëdo informacioni tjetër, konsiderohet e arritur shtesë pune. Këto të dhëna për biznesin, duke i vizituar ato mund ta bëjnë edhe nxënësitë e profile përkatëse të shkollave profesionale në kuadër të praktikës profesionale jashta objektit shkollor. Kjo krijon benifi të dyfishtë dhe forcon komunikimin verbal mes shkollës dhe biznesit.

Raport							
Gjithsej shenime: 2							
Titulli i trajnimit	Emri	Emri i prindit	Mbiemri	Q. Trajnuese	Data nga	Data deri	Lokacioni
Trajnim per X							
	Filan	Filani	Fisteku		01/08/2017	04/08/2017	Lokacioni x
Sub Total	Count1						
Trajnim per Z							
	Filan	Filani	Fisteku		15/08/2017	15/08/2017	Lokacioni z
Sub Total	Count1						
Grand Total	Count2						

Figura 63. Raport në përpilim e sipër

Burimi : Autori

Transmetimi i informacioneve të përfituara nga të dhënat statistikore apo aktivitet që kryejnë si qendrat për aftësime profesionale, oferrat e punës apo informacione tjera, tek personat tjerë, qytetarët, duhet të janë kryesisht profesional, e ky aplikacion elektronik i modifikuar na jep mundësin e krijimit të një raporti të tillë. Objektivi kryesor i aplikacionit të menaxhimit është të informojë duke komunikuar me qytetarin përmes raporteve, aplikacioneve të llojeve të ndryshme, ofertave të punës, e të dhëna tjera që njëherit mundësojnë sensibilizimin e arsimimit profesional.

Detyra kryesore e IT komunal dhe përgjegjësve tjerë(drejtorive, QAP,shkollave,bizensit) është ta implemetojnë strategji të marketingut për të krijuar një politikë të procedurave për të mbledh informacionin, menaxhuar atë si dhe shpërndarë atë në opionion në formë të lehtë të kuptueshme për ta. Duhet të marrin në konsideratë edhe kodin e etikës për ruatjen e privatësisë së të dhënave personale të të gjithë të apostrofuarëve nëpër tabela të aplikacionit, sidomos nxënësve.

Komuniteti e rrit vlerën e këtij aplikacioni me rritjen e numrit të shfytëzuesëve të aplikacionit elektronik on-line komunal. Tendencat e tregut teknologjik janë për ta orientuar opinoin kah informacinet elektronike.

Shkëmbimi i informacionit mes palëve, grupeve të intersit, është aspekti më i rëndësishëm i aplikacionit pasi që lidhja mes tyre tregon edhe potencialin e përdorimit të tij për aktivitetet e ndryshme. Ky komunikim bëhet pa marr parasysh kohën dhe vendin, hapësirën dhe platëformën programore elektronike dhe pa faktorin e presionit.

Aplikacioni elektronik, përmes përpilimit të raporteve, është shumë i rëndësishëm si marketing elektronik për arsimimin profesional, pasi që bazohet në kuptimin e të dhënave faktike të punëtorëve të kualifikuar, ofertës së punës dhe biznesit përmes qasjes në internet, krahas edhe informacioneve tradicionale që mund të merren në zyret përkatëse të institucioneve të cilat janë të shpërndara anë e kënd qytetit. Kjo do të jetë një mënyrë e re për të komunikuar me qytetarin për t`ia ngritur vetëdijen për trajnimet profesionale dhe për t`ia mundësuar atij një kualifikim të certifikuar për tregun dhe marrjen e informacioneve për ofertat që tregu i punës ka për të.

Sipas raporteve të CISCO-s : “Marketingu në internet është shuma e të gjithë aktiviteteve të biznesit të realizuara nëpërmjet internetit me qëllim gjetjen, tërheqjen dhe mbajtjen e konsumatorëve” (CISCO, 2004)

KAPITULLI V – METODOLOGJIA DHE METODAT E KËRKIMIT

Metodologjia shkencore dhe instrumentat e përdorur për kryerjen e këtij punimi doktoral janë bazuar në:

- Studiuar dhe analizuar në mënyrë kritike një literaturë e gjerë lidhur me edukimin dhe arsimin në Kosovë
- Mbledhja e informatave mbi aktivitetet që kryejnë qendrat trajnuese në Komunën e Gjakovës dhe infrastruktura e tyre
- Analzimi i funksionimit të aplikacionit aktual elektronik
- Rindërtimi i aplikacionit mbi menaxhimin e informacioneve elektronike të shërbimeve të qytetarit në Gjakovë
- Konkluzionet dhe rekomandimet për të ardhmen

Hapi i parë i hulumtit shkencor ka nisur me përcaktimin e temës dhe qëllimet e saj në aspektin shkencor. Kam vendosur hipotezat, si kryesoren dhe ato ndihmese duke bërë parashtrimin e pyetjeve kërkimore. Bazuar në pyetjet kërkimore janë përcaktuar objektivat e tezës doktriale dhe rëndësia e saj duke i paraparë edhe pengesat gjatë punës. Duke u përcaktuar në këto hapa është hartuar struktura bazike e punimit shkencor si dhe është përpiluar metodologjia e saj.

Për realizimin e këtij studimi u përdor një metodologji që kombinoi të dhënat sasiore, empirike dhe ato krahasuese. Sipas Sullivan kërkimi sasior zakonisht përdoret për të verifikuar teoritë egzistuese ose për të testuar hipotezat e ndërtuara mbi bazën e kërkimit

aktual. Avantazhi kryesor i kërkimit sasior është mundësia për të përmbushur objektivat dhe për të vlerësuar saktë fenomenet sociale apo sjelljen konsumatore. Studiuesit bashkohen me mendimin se sa do e vështirë të jetë sjellja konsumatore ajo mund të përshkruhet në mënyrë të saktë duke përdorur shifrat. (Sullivan, 2001)

Për mbledhjen e të dhënave një vend të fundamental zë literatura bashkëkohore mbi shkollat profesionale, aftësimin profesional dhe investimet në vendet e zhvilluara për kualifikim të vazhduar në vendet në zhvillim duke përfshirë edhe Kosovën. Kjo literaturë shërbeu për të ndërtuar hipotezat dhe modelin teorik të paraqitur në punim doktorial. Literatura e gjerë lidhur me edukimin dhe arsimin profesional në shtet europiane është studiuar dhe analizuar në mënyrë kritike për të marr informacionet e nevojshme dhe nxjerr konkluzione. Sasia e informacionit është bazuar në të dhënat e Eurostat-it, raporte të ndryshme nga vendet europiane me theks të veçantë Gjermania, Austria e Zvicra. Të dhënat statistikore kanë përfshirë selektimet në bazë të grupmoshave, shkallës së punnësisë, investimeve në arsim profesional , tregu i punës. Këto të dhëna statistikore janë prezentuar edhe përmes grafikëve. Një pjesë e të dhënave sekondare, u siguruan nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve elektronike, si interneti, për raportet e institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare dhe ato vendore.

Ky material i analizuar për avansimin dhe përparimin e AAP-ve në vendet e BE-së ka shërbyer edhe për nxjerrjen e konkluzioneve se si duhet të veprohet edhe në Kosovë për përmisimin e gjendjes aktuale për aftësim të vazhdueshëm profesional të të rinjëve dhe qytetarëve tjerë.

Metodë tjetër për këtë punim doktoral që është përdorur për të analizuar faktorët që ndikojnë në përmisimin e procesit të arsimit dhe aftësisimit profesional në Kosovë, është ajo e kërkimit empirik për grumbullimin e të dhënave.

Të dhënat empirike janë realizuar duke mbledhur shënime bazuar në pyetjet kërkimore të punimit doktoral. Mbledhja e të dhënave është realizuar nga DKA, menaxherët e qendrave aftësuese profesionale dhe qendrave tjera trajnuese, menaxherët IT të KKGj mbi punë e aplikacionit elektronik ekzistues, biseda me bizneset e përzgjedhur sipas veprimtarive të ndryshme, që është realizuar në disa mënyra. Këto të dhëna janë mbledhur edhe bazuar në vëzhgimet dhe eksperiencën personale.

Kërkimet empirike janë bazuar për të marr informacione mbi motivimin e të rinjve për shkollim e vazhdueshëm profesional të tyre që do të ndikonte në kualifikim dhe karrierën e tyre drejtpërdrejtë. Përshkrimi i strukturës organizative të arsimit në Kosovë, bazuar në nivelet e shkollimit, analizat e statistikore të grumbulluara bazuar në grup moshë, gjini dhe drejtimit e shkollimit. Këto të dhëna janë përcjell përmes diagrameve të llojeve të ndryshme të përpunuara me programin aplikativ për llogaritje Microsoft Excel. Këtu është përdoruar edhe metodologjia krahasuese si pësh. në rastin e raporteve mes shkollave profesionale dhe gjimnazit.

Struktura e trajnimeve nëpër qendrat e ndryshme të aftësimve profesionale të Gjakovës janë realizuar me biseda të thjeshta me menaxherët e tyre, ku janë marr edhe të dhënat mbi infrastrukturën që posedojnë dhe trajnimet që realizojnë.

KAPITULLI VI – KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Në këtë tezë doktrature janë shtjelluar disa qeshtje thelbësore që i përkasin arsimit dhe afëtsimit profesinal, Qendrave për Atësim Profesional, shkollave profesionale dhe biznesit. Të gjitha këto janë trajtuar duke u bazuar në të dhënat e literaturës së bazur në kërkime shkencore nga autor të ndryshëm të huaj dhe të vendit. Janë ndërtuar relacionet mes të dhënave, të paraqitura edhe përmes grafikëve.

Tema nuk është përzgjedh ratësisht, ka lindur si ide nga vet profesioni që ushtrojë, pengesat në punën që bëjë për zbatuar praktikën profesionale, që burojnë si pasojë e dobësive në sistemin e arsimimit dhe dëshira për ndryshime pozitive në më të gjitha palëve që janë cekur në këtë punim doktrorial. Krijimi i koleracionit progresiv mes palëve shpresoj se do të shërbej për të mirën e komuniteti dhe gjeneratave që vijnë. Shpresoj se me konkluzionet dhe rekomandimet nga ana ime për fushën e studiuar do të kontribojë sado pak në avancimin qeshtjes arsimore duke ju dhënë mundësi që edhe kontribuesit të tjerëve ta ngrisin funksionalizimin e aplikacionit në varësi nga kërkesat dhe rrethanat e kohës. Ky është një hap i mëtutjeshëm personal në aspektin e kualifikimit shkencor.

Ideja ishte modifikimi i aplikacionit ekzistues me mundësi të reja shfytëzimi për ta ndihmuar qytetarin për të realizuar shërbimet elektronike dhe duke edhe informacione shtesë mbi komunën, aftësimin e vazhdueshëm profesionale dhe punësimi në biznesin lokal. Pse modifikimi i aplikacionit të tillë? Përdorimi i teknologjisë informative dhe sidomos i telefonave të mençur nga të gjitha shtresat e shoqërisë dhe atë në baza të rregullta

ditore, qasja e lehtë në aplikacioni përmes njohurive bazike do të ishte marketingu dhe sensibilizimi ma i mirë për gjithë mirëqenjesn sociale të komunës së Gjakovës.

Bazuar në arsyet përdorim e website-ve nga ana e komunitetit ku pjesa e më e madhe e përdor për të komunikuar mes veti, pra mund të bëhen burim i shpërndarjes së informacionit. Në Kosovë ka për rreth 1.1 milion përdorues të internetit. Kjo shifër është ndër më të lartat në regjion dhe mund të krahasohet gjithashtu edhe me vendet e zhvilluara si Zvicra, Gjermania, Britania e Madhe, etj. Në Kosovë ka mbi 600 mijë përdorues të telefonave të mençur ku 48 % prej tyre janë të papunësuar. 55 % të përdoruesve të pajisjeve mobile, qasen në internet nga telefonat e tyre të mençur. Kur është fjala për studim dhe hulumtim, 60 % të femrave e përdorin internetin për këtë qëllim. Kurse 55 % të femrave e shfletojnë internetin nga kureshtja ne raport me 45 për qind me meshkujt. (Telegrafi, Statistika interesante nga përdorimi i internetit në Kosovë, 2014) . Në botë ka rreth 4.38 miliard përdorues të internetit të cilët përbëjnë 56.8% të gjithë popullsisë botërore. (Stats, 2019) . Impletimin dhe funksionalizim elektronik mbetet punë e IT komunal apo ekspertëve të tjerë të teknologjisë informative.

Në këto vitet e fundit shumë është folur dhe shkruar edhe nëpër media mbi shkollat dhe aftësimet profesionale të lidhuara me biznesin, por faktet dhe rezultatet e në teren tregojnë të arritura të pakëta. Idefernca e më tutjeshme do të ketë pasoja afatgjata, që do të duhej shumë këhë për riparim gjeneral.

Arsimi dhe aftësimi profesional luan një rol qendror për një ekonomi të përgjegjshme dhe stabile në një vend demokratik. Kjo është vertetur edhe praktikisht dhe me të dhëna

statistikore nga vendet e unionit europian dhe më gjërë, dhe disa na këto karakteristika janë prezentuar në pjesën e sipërme të punimit tim doktorial. E ardhmja e një shteti nesër gjendet sot në bankat shkollore tani dhe çfarëdo njohuri që ata do të përvetësojnë sot do të reflektohet në ekonomi nesër. Ky efekt gërshetues duhet të rifreskohet çdo ditë, për çdo gjeneratë shkollore me një bazament të qëndrueshëm me thelb e fokus në ekonominë e tregut dhe duke kontribuar me vizione progresive të zhvillimit dhe duke aftësuar njerëz për profesion të caktuar. Kualifikimi nënkupton dinamikë në grup, ide të qarta për zhvillimin e shoqërisë, përshtatjes së ndryshimeve të shpejta të tregut, fleksibilitet organizativ, qasje në ndryshimet teknologjike por edhe telekomunikacion, strategji dhe azhurim të proceseve intelektuale respektivisht njohurive të fituara nga cilido arsimim e aftësim, apo pavarësisht çfarëdo lloj edukimi që është ai.

Ndryshimit të tregut të punës si rezultat i evluimeve të teknologjisë duhet ti çasen edhe qendrat për aftësim profesional si dhe vet shkollat profesionale, sidomos me fokus të veçantë shkollat teknike. Kjo arrihet duke mbajtur kontakte, komunikim dhe ndërveprim në çdo kohe me faktorët kyç të ekonomisë së tregut gjegjësisht me afaristët dhe bizneset, për të fituar pashqyrën e qartë të ndryshimeve që ndodhin në oazat e punës dhe për të krijuar bashkë me ta kushte të reja për aftësime profesionale në shkollat tona. Ky sistem funksional do të ishte një praktikë shumë mirë e orientuar dhe do të shkonte në dobi të shkollave profesionale që do të ndikonte drejtpërdrejtë në ngritjen e imazhit të tyre. Jo vetëm aq por do të shërbente edhe si rë e lidhjes mes të sotmes dhe të nesërmes në aspektin arsimor. Kjo do të ishte një avantazh i madh për popullimin e shkollave profesionale me nxënës. Ky popullim do të ndikonte pozitivisht edhe në përmisim e cilësisë mësimore pran këtyre

shkollave duke investuar edhe në vet trajnimin mësimdhënësve për t'iu përshtatur kërkesave të kohës, pse jo edhe më shumë. Ky është edhe vet qëllim dhe misioni i shkollave tona profesionale sipas Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Shoqëria njërzore përbëhet nga individ që kanë qëllime dhe mendime të përbashkëta dhe për ato hartojnë strategji efektive për të praktikuar në jetë ato ide. Ideja nuk është hartimi teorik i një plani veprues por zbatimi praktikë i tij.

Partneriteti me biznesin lokal duke organizuar edhe mësim në punëtoritë përkatëse pos praktikës, do të ishte favorizim i madh për komunitetin lokal, që do të bëhej shembull i bashkpunimit treg dhe shkollë, punë dhe teori, dhe në veçanti një hap i madh para për ekonominë lokale. Mirëqenja organizative e llojit të tillë me të gjitha këto lëvizje, suksese, ndryshime kah e ardhmja, trajnime efektive në përputhshmëri me të gjitha parametrat që kërkohen në treg do të evidntoheshin në aplikacionin e modifikuar on-line të komunës dhe do të kishte ndikim pozitiv esencial në vet qeverisjen lokale kundrejtë të gjithë qytetarëve të saj.

Nga kjo platformë, ne duam që një herë e përgjithmonë të qartësojmë raportin mes shkollave profesionale të mesme të larta me qendrat orientuese brenda saj, qendrave për arsim e aftësim profesional, pikave këshilluese të karrierës, dhe biznesit me anë të një marrëveshje ligjrisht obligative, draft rregullore apo statut, me afate kohore të qarta, objektiva precize, garancat dhe mbështetja nga dy nivelet e qeverisjes, si ai qendror po ashtu edhe ai lokal.

Ky përmisim i cilësisë së llogaridhëniesë elektronike përmes raporteve të ndryshme të detajuara të formuluar nga shumë fusha ndërmodulare të aplikacionit të rindërtuar për të menaxhuar sistemin e të dhënave informative, do të ndikonte indirekt në ngritjen e cilësisë së arsimit, përmes garës së dijes nga vet shkollat e komunës. Rrugëtimi i përbashkët i ekonomisë së tregut me aftësimet profesionale si nga shkollimi i mesëm i lartë profesional dhe nga qendrat trajnuese do të rezultonte në uljen e papunësisë, pasi që papunësia më e madhe sipas statistikave në nivel vendi shkon mbi 60% buron nga niveli i ulët i kualifikimeve. Pra, duhet të kujdesimi si shoqëri demokratike edhe për qytetarët e pakualifikuar, pasi moshë 15-24 ka përballjen më të lartë në shoqërinë tonë si të pakualifikuar ndaj një profesioni. Përballja me mungesën e punëtorëve të kualifikuar është një problem në veti që bartë shteti i Kosovës dhe vetëm orientimi kah shkollimi dhe aftësimi profesional i të rinjve, bazuar në kërkesat e tregut duhet të jetë çelësi i zbutjes së kësaj dukurie negative të vendit tonë. Marrja në konsideratë këtyre fenomeneve duhet të bëhet nga lartë me plan integruar për aftësim profesional por edhe nga vet qeverisja lokale, pasi numri i punë kërkuarve është i madh ndërsa ka mungesa të theksuara të kuadrit të kualifikuar në pothuajse të gjitha veprimtaritë që disponon tregu sot.

Komunat ose qeverisja lokale duhet të luajnë një rol esencial kur është fjala për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës brenda teriorit administrativ të saj. Bizneset duan që të operojnë në zonat ku veprimtaria e tyre zhvillohet lirshëm, me minimizim të shpenzimeve administrative, apo edhe në ato rajone kur kanë benifite nga niveli lokal apo qendror. Komuna duhet të zhvilloi politika të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit. Ajo duhet të fokusohet në marrjen e informatave mbi nevojat e bizneseve lokale. Struktura

organizative e zingjirit të krijimit të vendeve të reja të punës ndërtohet mbi aftësimin e punëtorëve të pakualifikuar për punë dhe kjo mund të arrihet përmes qendrat për aftësim dhe pregatitje profesionale. Roli i komunës në këtë strategji zhvillimore është primar dhe mund të arrihet rezultat pozitiv përmes studimit të bizneseve, QAP dhe shkollave profesionale dhe si pikënisje shumë fortë do të ishte aplikacioni i modifikuar i saj.

Si do arrihej kjo përmes aplikacionit elektronik? Përmes këtij aplikacioni ku do të menaxhohen të dhënat nga të gjithë akterët e involvuar mund të arrijë deri tek koordinimi i sukseshëm dhe me kosto efektive modeste. Ekspertët e teknologjisë informative duhen të kanë për bazë të gjitha konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna, kur të implemtentohet dhe vitalizohet aplikacioni në tërësi. Tërë ky aktivitet i marketingut rezulton në një shpërndarje më të madhe të informatave për çështjet e lokacionit të bizneseve, vendet e lira të punës, kualifikimet e kërkuara, nxënësit e trajnuar, profilet e shkollave profesionale dhe shumë raporte tjera që mund të rrjedhin nga konkluzione e informacioneve që do të përmbante aplikacioni i modifikuar on-line i komunës sonë. Kjo është një strategji efektive e cila pastaj e rrit efikasitetin në ndarjen e resurseve dhe përgjegjësi të palëve pjesëmarrëse. Duhet përvetësuar zhvillimi i standarteve digjitale të kohës, përmes këtyre në marrim dhe menaxhojmë informacionin.

Qasja në këto informacione mundëson krijimin e vendeve të punës duke u dhënë bizneseve më shumë informacione për qytetarët e kualifikuar, do të jetë përparësi krahasuese për vet ata. Pasi për këto të dhëna biznesi ndryshe nuk do të kishin dijen mbi të kualifikuarit dhe mundësin e përzgjedhjes së nxënësve që ata vet mund ti aftësojnë për profilin që iu nevoitet. Në komunën tonë operojnë biznese të vogla dhe të mesme në pjesën dërmuese të

saj, kjo e bënë aplikacionin edhe me frytëdhënës nëse të gjithë këto veprimtari biznesore i qasen aplikacionit të modifikuar komunal.

Koncepti i bashkimit të resurëseve poseduese do të ketë ndikim mjaftë të madh në rritjen e pasurisë lokale duke krijuar vende pune, duke hartuar strategji zhvillimore të infrastrukturës në shkollat profesionale, si në objekte, paisje dhe kuadër. Ky koncept do të ketë një protfolio të gjërë për të tërhequr biznesin pran shkollave të tilla që në mënyrë automatike nënkupton rritjen e intersimit të të rinjëve për tu arsimuar në nivelin e mesëm të lartë në shkollat profesionale. Këtu duhet të inkuadrohen edhe qendrat e karrierës së ndihëm në marketing për këto orientime të arsimimit. Këto qendra funksionojnë në kuadër të shkollës, por kanë autonomi veprimi.

Shkollimi, trajnimi dhe zhvillimi ekonomik shkojnë së bashku kur subvencionohen nga komuna përmes partnerit kryesor të vendeve të punës, biznesit. Ky subvencionim komunal për bizneset mund të jetë përmes stimulimeve tatimore. Këto stimulime tatimore mund ta ofrojnë shumë ndërmarrjet biznesore të veprimtarive të ndryshme pran shkollave profesionale dhe njëherit të fuqizojnë këto shkolla në opinionin publik. Nëse vehet në shenjestër kjo strategji edukative, mund të krijohet një planifikim mirë i menduar dhe të bëhet një zonim më efektiv, që të gjitha këto mund të ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve të individit të kualifikuar dhe kjo të përdoret për zhvillim ekonomik përmes uljes së papunësisë. Një punëtor i kualifikuar i plotëson më lehtë kushtet e punës nga oferta e punës që vie nga një biznes i subvencionuar nga komuna.

Sot ekziston një shpërndarje e madhe ndërmjet orientimit të nxënësve në arsimim, ku shumica prej tyre ndjekin gjimnazin e përgjithëshëm rreth 46% edhe pse vetëm një shkollë ekzistuese në krahsim me katër shkolla profesionale që shpërndajnë dije në komunën e Gjakovës. Në këtë drejtim, nëse shikohen dhe analizohen profilet si dhe orientimet e nxënësve brenda komuës vërehen shpërputhje ndërmjet profileve të cilat përcaktohen nxënësitë dhe nevojave bazike të ekonomisë së tregut. Zanatet e vjetra, artizanet, bujqësia, bujqësia mekanike, saldimi dhe ca profesione tjera po thuajse në zhdukje nga mungesa e punëtorve të kualifikuar. Profile këto që nuk gjendet në drejtimet e shkollave profesionale. Ka edhe profile tjera mungesë të nevojave të tregut sot.

Plan programet në shkollat profesionale duhet të rishikohen me emergjencë, për ti trasuar në rrugën e tregut të punës, kjo duhet të ndodh në vazhdimësi pa ndërprerje. Këto ndryshime duhet të funksionalizohen si shërbim i orientimit për një përmbushje të standarteve elementare përball rinisë sonë që t'ia bëjmë më të lehtë përzgjedhjen e profesionit dhe qasjen më të shpejtë në tregun e punës në mënyrë që mos ti bashkangjitet karavanit të largimit drejt vendeve të Bashkimit European për një jetë më solide.

Koordinimi i programeve të aftësimin profesional bazuar në ato kërkesa që ka tregu i punës është shkronja e parë e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal. Qeverisja lokale duhet të ofrojë alternative dobi prurëse mbi komunitetin. Këto alternativa mund të ndërtohen nëse bëhet një studim i mirëfilltë e gjdo gjëje që ka të bëjë me punësimin. Aplikacioni i modifikuar do të ishte pishtari i këtyre informacioneve mbi të clat do të duhej të përpiloheshin raportet e ndryshme, të nxjerren statistika të cilit do lloj apo të arsimimit dhe aktiviteteve të aftësimin nga qendrat e trajnimeve si nga ofertat e biznesit si për vende të lira

pune ashtu për ofrimin e mundësisë së mbajtjes së praktikave profesionale pran tyre në koordinim edhe me qendrat e këshillimit të karrierës.

Përgjegjja në pyetjet kërkimore në formë të konkluzionit

- A mund të supozojmë se nxënësit në nivelet e ndryshme të shkollimit janë të gatshëm për tregun e punës?

Bazuar në të dhënat që vijnë nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës del se shkalla e papunësisë tek të rinjtë është 50.6 %. Papunësia afatgjate e të rinjve (15-19), që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj për këtë tremujor është 39.8 %. Përqindja e të rinjve që nuk janë të punësuar, as në shkollim, as në trajnim – NEET (të intervistuarit e moshës 15-24 vjeç), është 29.0 %. (ASK, Anketa e fuqisë punëtore, 2019) . Nga kjo rezulton se nivelet e ndryshme të shkollimit nuk janë të gatshme për tregun e punës nga aryet e ndryshme, si :

- ✓ Duke filluar nga profilet adekuate që zhvillohen në shkollat tona
- ✓ Cilësia jo nivel që e kërkon biznesi
- ✓ Mungesa e kushteve të infrastrukturës nëpër shkollat tona për të zhvilluar praktikat profesionale – si pasoj buxhetit të pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat themelore
- ✓ Mungesa e literaturës është mëse evidente, sidomos në shkollat teknike
- ✓ Mungesa e bashkpunimit me bizneset nuk është aspak në proporcion
- ✓ Faktorët tjerë legjislativ dhe ekzekutiv

Prandaj, duhet një qasje e re për të përmisuar profesionalizmin e nxënësve në shkollat tona, qasje të cilat u elaboruan gjatë punës së tezes doktoriale.

□ Efekti i aplikimit të edukimit profesional si vazhdimësi e procesit mësimor dhe atij hulumtues, a mund të bëjë diferencën?

Me anë të aftësimin profesional të licencuar nga autoritetet gjegjëse dhe me plan pune të mbështetur nga trajnimet që mbahen në vendet e Bashkimit Europian normalisht që rezultatet do të janë efektive në dobi të punësimit. Mund të bëhet diferenca. Trajnimet profesionale duhet të mbahen në përputhje me kërkesat e tregut dhe zbatuar standartet adekuate që janë në relacion me vet oferrat e punës. Tregu i punës sot kërkon një forcë pune jo vetëm të kualifikuar, por dhe të pajisur me aftësi shumë të mira teknike dhe ndërdisiplinore për të garantuar cilësinë e punës prandaj trajnimet në vazhdimësi bëjnë dallimin kur edhe zyrtarisht tregu respektivisht biznesi haptas thotë se ka mungesë të punëtorëve të kualifikuar në fusha të ndryshme. Kur thuhet të kualifikuar ai duhet të ketë aftësimin profesional të certifikuar. Duke u bazuar në të dhënat Agjensionit të Statistikve të Kosovës, ASK, është nevojshme të merret në konsideratë edhe kategoria e qytetarëve të pakualifikuar, e që në vendin tonë ky numër i të papunësuarve nuk është i vogël por shkon deri në 60 %. Atëherë ky argument e forcon iden se qytetarit duhet afruar kualifikimi për punësim. Për tu arritur kjo duhen individ me qasje strategjike, ekspert të lëmive dhe vizionare për të hartuar strukturën organizative dhe implemtuar atë gjithmon në harmoni me tregun dhe zhvillimin e teknologjisë. Rol kuarcial kanë edhe qeverisja qendrore si njësi administrative dhe ato lokale në veçanti që në bashkpunimin mes vete ti harmonizojnë veprimet dhe procedurat ligjore, por edhe ta involvojnë faktorin ndërkombëtar që me përvojat nga vendet e tyre, sidomos ato të BE, të gjejnë forma efektive zhvillimore edhe

financiare për qendrat AAP dhe trajnimet tjera profesionale që kualifikojnë qytetarin. Ajo se çfarë është përditëshmëri në shkallën europiane është rritja e vijueshmërisë në shkollat që orienetojnë drejt tregut të punës, andaj edhe ne duhet ndjekur rrugën e tillë, por krahas saj duhet ndryshuar edhe qasja në të gjitha aspektet në të mirën e punëtorit të kualifikuar kosovar.

Cilat do të jenë strategjitë e reja të arsimit e aftësimit profesional?

Krijimi i platformës ligjiore, bazuar në analiza objektive, analiza statistikore për bizneset përfaqësuese, trasim i saktë i problemeve dhe vështërsive në teren, ofrim i zgjidhjeve me konkluzione të mirëfillta e rekomandime ekzakta, të të gjithë grupve të interesit në këtë proces zhvillimor për nxënësin dhe qytetarin e kualifikuar, të mbështetura nga ana e ekspertëve të fushëve përkatëse në afat sa më të shkurtë kohor jo më shumë se një vit shkollor, duhet të krijojë një udhëzim administrativ apo statut veprimi. Ky do të jetë një proces kompleks deri në hartimin e këtij akti.

Ky asociacion arsimor-edukativ profesional do të debatonte mbi këto qeshtje :

- ✓ Taksën ndaj bizneseve që ofrojnë trajnime profesionale ta zbrit në varësi nga numri i nxënësve që trajnojnë, në bazë të një kuotizimi të caktuar nga komuna, mbështetur në të ardhurat
- ✓ Rritja e buxhetit dhe autonomisë për shkollat profesionale në varësi të rritjes së buxhetit komunal
- ✓ Rritja e buxhetit dhe autonomisë për QAAP në varësi të rritjes së buxhetit komunal
- ✓ Benificione dhe mbështetje shtesë për qendrat tjera trajnuese të komunës

- ✓ Përkrahja e vazhdueshme për AAP si në plan programet aftësuese dhe në atë të infrastrukturës sipas nevojës së tregut. Ndiurma për integrimin e tyre me qendrat tjera si motra me vendet e BE dhe atyre të regjionit.
- ✓ Raportet nga të gjitha institucionet dhe personat e autorizuar e kompetentë, nga vet palët e përfshira në këtë bashkësi (asociacion), në lidhje me shkollimin dhe aftësimin profesional duhet të janë në përputhje me legjilacionin në fuqi dhe për t'iu prezentuar qytetarit të përditësuar në forma tabelare apo tjera lehtësisht të kuptuara përmes aplikacionit të modifikuar komunal
- ✓ Udhëzimi duhet të parashikon lehtësira tjera sa i takon procedurave të aplikimit për grupet e trajnuese të reja
- Kush duhet të integrohet në këtë proces ?

Në këtë proces duhet të integrohet që të gjithë faktorët që ndikojnë në formimin dhe aftësimin profesional të qytetarit dhe ata që krijojnë normat juridike në mbrojtje të tij dhe në secilin aspekt tjetër. Palët e involvuara janë :

- ✓ Kuvendi komunal si organ legjislativ për procedurat ligjore
- ✓ Drejtoria Komunale e Arsimit – për hartimin e platformave programore brenda shkollave dhe mbikëqyrjen e proceseve zhvillimore të mësimin
- ✓ Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik – për hartimin e strategjive të reja zhvillimore në bashkëpunim me biznesin, shkollat profesionale dhe qendra për aftësim profesional për nevojat e tregut
- ✓ Drejtoria Komunale e Financave – për mbështjen financiare të aktiviteve që do të zhvillohen dhe ndryshime tjera në kuadër të projektit

- ✓ Shkollat profesionale – për prioritet duhet të kanë ndryshimet e profileve ekzistuese konform kërkësive të tregut, në bashkëpunim me biznesin dhe qendrat për orientim në karrier si dhe DKA
- ✓ Qendrat për aftësim profesional, të gjitha që operojnë brenda teritorit katestral të Komunës së Gjakovës – si vendet që do ta kanë barrën kryesore për trajnimin e qytetarit profesionist konform standarteve europiane të pajisur me licence të certifikuar bazuar në kërkesa fleksibile të tregut. Në koperim me drejtoritë përkatëse të komunës dhe ekspertët e fushave
- ✓ Biznesi – të gjitha ndërmarrjet e regjistruara, tatim paguese dhe që janë të interesuara që në veprimtarin e tyre të trajnojnë nxënësin. Biznesi do të përfaqësohet në këtë asociacion me përfaqësues sindikal të veprimtarive përkatëse. Biznesi do të jetë pjesë edhe e bordeve shkollore
- ✓ Komuna e Gjakovës – si bartës i projektit të aplikacionit me përfaqësues e saj
- ✓ Grupet e eksperteve të fushave përkatëse si hartues ligjor të platformës për aftësim profesional
- ✓ Një anëtar i shoqërisë civile
- ✓ Ekspertët e teknologjisë informative si finalizues elektronik të projektit

Struktura pjesëmarëse oragnizative mund të ndryshojë si pasojë e rrethanave të kohës apo mendimit të shumicës së anëtarëve të saj. Ky asociacion do të këtë edhe udhëheqës me afat të caktuar nga vet antarët. Bashkësia e formuar nga këta përfaqësuese duhet të përpilojë si hap fillestar urgjent draft rregulloren e punës së strategjive të reja të arsimit e aftësimin

profesional dhe marrjen e përgjithësive për zbatim e saj në përpikëmeri. Pastaj ky draft të shëndrohet në udhëzim administrativ apo statut.

- A do të kenë përfitime kandidatët dhe familjet e tyre me përfshirjen në procesin e edukimit profesional?

Normalisht që po. Kjo formë e përfitimeve mund të vijë nga komuna në formë të përfitimit të granteve kur ndonjë qytetar kualifikohet dhe certifikohet për ndonjë trajnim të veçantë dhe fillon vetpunësim apo hap edhe ndonjë vend të ri pune në kuadër të biznesit të tij. Ndihamat për kandidatët mund të vijin edhe në formë të bursave për nxënësit që ndjekin shkollimin profesional dhe kanë sukses shumë të mirë dhe tregojnë vlera pune dhe sjellje të kulturuar gjatë procesit mësimor dhe atij trajnues si në kabinetet shkollore apo edhe punëtoritë jashtë saj.

Benefitet mund të janë edhe të formave tekniko – teknologjike që mundësojnë vetpunësim. Vet pjesmarrja në këto trajnime bazuar në kërkesat e tregut dhe certifikuar sipas standarteve europiane, gratis apo me pagesë simbolike, është benefit për secilin do kandidat dhe familjet e tyre. Kjo nënkupton se këta individ të kualifikuar janë shumë potencial punësimi nesër. Qytetari duhet të vendos vet për fatin e tij dhe rrugën që e do ta ndjek, shteti duhet t'iu mundësoj kushtet ligjore dhe infrastrukturën që ata të aftësohen profesionalisht dhe të pajisen me një certifikatë të vlefshme për tregun e punës. Një punësuar më shumë, një barrë më pak për shtetin, një prosperitet zhvillimor më tepër.

Duhet të udhëtojmë të gjithë së bashku me mendje të shëndosh për të ndërtuar një vend ku mund ta shijojmë jetën dhe prekim zhvillim e tij përditë.

“Mos ma hiqni asnjë rrudhë. I kam paguar shtrenjtë ë gjitha “ (Magnani, 2019) .

Konkluzion final

Pavarësisht afateve procedurale dhe faktit se ka vështërsi tjera ekzistuese që dalin nga terreni dhe analiza e tij, duhet të vazhdohet në insistimn e ndryshimit të procesit të arsimit profesional. Brenda kornizës së aftësimin është mundësia për t`u indentifikuar edhe të metat që janë në shkollim dhe të gjendet zgjidhje e pranueshme për progres ekonomik.

Nëse dëshirojmë të arrijmë diçka që lenë gjurmë në efektin e cilësisë së edukimit në përgjithësi e arsimit profesional në veçanti duhet të punohet shumë në të gjitha sferat dhe të besojmë në rrugën dhe mënyrën që e kemi zgjedhur si sfidë.

Platforma reformuese e marrëveshjes mes grupeve të involvuara në proces dhe përgjegjëse për shkollim e aftësim profesional ofron mundësi të reja për t`u kualifikuar qytetari ynë dhe hap dyertë që sot pothuajse janë të mbyllura për tregun e punës.

Aplikacioni i modifikuar elektronik i komunës sonë, me përmbajtjen e të gjitha analizave dhe raporteve, do të ishte një katalizator shumë i madh i orientimit të të rinjëve drejt shkollimit dhe aftësimin profesional.

Etika e moralit më thotë se nuk duhet të jemi peng i antivlerave dhe humbjes së prespektivës. Prandaj, duhet ti ndryshojmë disa faktor të shoqërisë sonë komplese në dobi të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenjes sociale.

Në vazhdimësi mbetet që përmes IT pran KKGj dhe ekspertëve tjerë të teknologjisë informative të realizohet tërësisht dhe të funksionalizohet ky projekt elektronik për shërbim dhe informonim të qytetarit të Komunës së Gjakovës. Qyteti ynë e meriton një prespektiv digjitale të rifreskuar në vazhdimësi.

REFERNCAT

- Allison Cecilla L. & Berkowitz Neal A. (2005). *SQL for Microsoft Acces*. Texas, USA: Wordware Publiking Inc .
- Asimov, I. (2017, 11 26). *Filozofia*. Gjetur 06 22, 2019, nga Thenie:
<http://filozofia.al/index.php/2017/11/26/5971/>
- ASK. (Qershor, 2019). *Anketa e Fuqisë Punëtore*. Prishtinë: Agjensia e Statistikave të Kosovës.
- ASK. (2019, 6 23). Anketa e fuqisë punëtore. *Statistika sociale*, fv. 10-30.
- ASK. (2019). Statitiskat e Arsimit. *Vjetari Statistikor i Kosvës*, 67.
- autorësh, G. (2013). Youth Unemployment and Vocation Training. *Word Developent Report 2013*, fv. 2-44.
- B,Azemi & R,Bujari. (2013). *Bazat e kërkimit në edukim*. Prishtinë: Instituti ppedagogjik i Kosovës.
- B,Çolakoviç @E, Baraku. (1980). *Osnove informatike i metodologije naucnog rada*. Prishtinë: Libri universitar.

- Bank, W. (2012). *World Development Indicators*. Word Bank.
- Beqiri, E. (1998). *Bazat e informatikës*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Brada, R. (1995). *Pedagogjia familjare*. Pejë: Biblioteka pedagogjike.
- Brada, R. (2010). *Didaktika kiberntike. Teoria dhe praktika mësimore*. Prishtinë: Biblioteka pedagogjike.
- Brougham, H. P. (2017, 11 26). *Filozofia*. Gjetur 6 20, 2019, nga Thenie:
<http://filozofia.al/index.php/2017/11/26/5971/>
- Cassidy, A. (2005). *Planing for e - bussness success*. New York USA: St.Lucie Press.
- CEDEFOP. (2010). *Skills supply and demand in Europe Medium-term forecast up to 2020*. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
- CEDEFOP. (2012). From education to working life . *The labour market outcomes of vocational education and training*, fv. 11-63.
- CEDEFOP. (2020). *On the way to 2020 data for vocaional education and training policies*. Luxembourg: Office of the European Union.
- CISCO. (2004, July 31). *Annual Report*. Gjetur 6 25, 2019, nga 2004 Annual Report:
<https://www.cisco.com/c/en/us/about/annual-reports/annual-report-2004.html>
- Civici, A. (2011). *Iluzionet monetare- mashtrimet e mëdha*. Tiranë: OMBRA GVG.
- Confucius. (2017, 02 26). *Filozofia*. Gjetur 6 23, 2019, nga Thenie:
<http://filozofia.al/index.php/category/thenie/>
- Denis, H. (2010). *Historia e mendimit ekonomik*. Tiranë: Papirus.
- Dervishi, I. (2014, 04 23). *Libra*. Gjetur 03 1, 2018, nga 20 shprehjet më të bukura mbi librat:
<https://diaryoftirana.com/20-shprehjet-me-te-bukura-mbi-librat/>
- Dika, A. (2004). *Bazat e programimit n7 C++*. Prishtinë: Univeriteti i Prishtinës.
- Đordjevič, B. (2009). *Globalizacija i skola*. Beograd: Buduća škola.
- ECDLKosova, G. a. (2012). *Access 2010*. Prishtinë: ECDL Kosova.
- ECDLKosova, G. a. (2012). *Bazat e teknologjisë informative*. Prishtinë: EDDL.
- ECDLKosova, G. a. (2012). *Outlook 2010 Interneti dhe komunikim*. Prishtinë: ECDL Kosova.

- Europe, C. (2012). *Information service*. Gjetur 2016, nga VET in Europe:
<http://www.cedefop.europa.eu/en/information-services/vet-in-europe-country-reports.aspx>
- Eurostat. (2011, 07). Further Eurostat Information. *Main tables and database*.
- Eurostat. (2012). Key Data on Education 2012. ISBN 978-92-9201-242-7, fv. 27-165.
- Fink, D. (1998). Guidelines for the successful adaptation of information technology in SME. *International journal of information management Vol 18. N4, 243-253*.
- Fullan, M. (2001). *Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim*. Tiranë: Edualpa.
- Gashi, A., Halili, J., Duraku, N., & Jeffrey, A., Nowak. (2012). *Razvoj vještina 21 veka u predmetu nauke. Basic Education Program*. Prishtinë: MASHT.
- Georgy Mankiw, M. P. (2012). *Ekonomiksi - makroekonomia*. Tiranë: UET Press.
- GIZ. (2013). *Protfolio profesionalne orijentacije*. Beograd: GIZ.
- Gjiganti. (2016). *emigranti*. Gjetur 9 22, 2017, nga sistemi i edukimit ne zvicer:
<http://www.gjiganti.com/emigranti/zvicer/edukimi/sistemi.pdf>
- Hoxha, T. (2015). *PHP dhe My SQL për fillestar*. Leanpub.
- Kasapi, K. (2016). *Arsimimi dhe shkollimi. Zeri*.
- Kathrin Hoeckel, S. F. (2009). Learning for Jobs . *Switzerland*, fv. 7-37. Gjetur në Switzerland.
- Katrin Hockel, Simon Field, W. Norton Grubb. (2009). Learning for jobs OECD. *Switzerland*, fv. 7-37.
- Kocani, A. (2008). *Udhëzues për SPSS*. Tiranë: Eslebor.
- Kosoves, G. Z. (2008, 04 06). *Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës*. Gjetur 06 23, 2019, nga LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE: <https://gzk.rks-gov.net>
- Kosovës, K. i. (Dhjetor 2010). Ligji Nr 03/L-212 i punës . *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, 4.
- Kosovo, E. U. (2018). *Menaxhimi i Sistemeit ParaUniversitar në Kosovë*. Prishtinë: “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim” – KEEN” .
- Kume, V. (2002). *Marrja e vendime menaxheriale*. Tiranë: PEGI.
- Magnani, A. (2019, 4 23). *Filozofia*. Gjetur 6 24, 2019, nga Thenie:
<http://filozofia.al/index.php/category/thenie/>

- Mann, H. (2017, 11 26). *Filozofia*. Gjetur 06 20, 2019, nga Thenie:
<http://filozofia.al/index.php/2017/11/26/5971/>
- MAPL. (2013). *Organizimidhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë*. Prishtina: Qeveria e Kosovës.
- MASHT. (2007). *Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017*. Prishtinë: MASHT.
- MASHT. (2011, 10 16). Planis strategjik i arsimit në Kosovë 2011-2016. fv. 17-162.
- MASHT. (2012). *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë në Kosovë*. Prishtinë: MASHT.
- MASHT. (2014). *Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale 2013-2020*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.
- MASHT. (2018). *Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë 2017/18*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.
- MASHT. (2018). *Treguesit e arsimit në Kosovë*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.
- MASHT, A. (2019, 6). Sttistikat e Arsimit në Kosovë 2018-2019. *Sttistikat e Arsimit në Kosovë 2018-2019*, fv. 10-30.
- Mustafi, S. (2010, 11 30). *Fjala ime*. Gjetur 06 18, 2019, nga Thënie mbi internetin:
<https://fjalaime.ch/citate-mbi-internetin/>
- NEETs, E. 2. (2012). *Young people not in employment, education or training: Characteristics, costs and policy responses in Europe*. Luxembourg: Publication Office of the European Union.
- news, o. (2014, 17 9). *hapet shkolla profesionale austriake*. Gjetur 9 21, 2017, nga
<http://www.oranews.tv/vendi/tirane-hapet-shkolla-profesionale-austriake-herman-gmeiner/>
- Pavićević, M. (2015). *Razlike između formalnog, neformalnog i informalnog obrazovanja*. . Beograd: Zbornik rada Ucitejskog fakulteta.
- Pozhegu, D. (2016, 10 2016). *Zeri*. Gjetur 02 10, 2017, nga Arsimi profesional dhe nevojat e tregut: Shumë evidenca anekdotale tregojnë që në Kosovë kemi bollëk të kuadrove të shkolluar në nivelin universitar, por kemi pak quadro profesionale. Me fjalë tjera, Kosova ka relativisht shumë mjekë, ekonomistë dhe juristë, por ka relativisht pak teknikë, saldu
- Ramosaj, B. (2006). *Managment (Menaxhimi kreativ dhe Lidershipi)*. Prishtinë: Vatra.
- Riinvest. (2003). *Tregu i punës dhe papunësia.Raport Hulumtues*. prishtinë: Riinvest.

- RKS. (2015). *Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale në Kosovë 2013 – 2020*. Prishtinë: MASHT.
- Shala, A. (2012). *Sisteme e informimit dhe komunikimit*. Prishtinë: EGLA Company.
- Sopjani, V. (2009, 12 21). Etika e biznesit. Prishtinë, Kosovo.
- Stats, I. W. (2019, 03 31). *Internet Usage Statistics*. Gjetur 06 25, 2019, nga Word Stats: <https://internetworldstats.com/stats.htm>
- Sullivan. (2001). *Research Technologu*.
- Telegrafi. (2014, 11 12). *Statistika interesante nga përdorimi i internetit në Kosovë*. Gjetur 06 25, 2018, nga Teknologji/Interneti: <https://telegrafi.com/statistika-interesante-nga-perdorimi-i-internetit-ne-kosove/>
- Telegrafi. (2016, 01 07). *Ska trajnime kompjutersh per mesimdhenes*. Gjetur 02 10, 2017, nga lajme: (<http://www.telegrafi.com/lajme/s-ka-me-trajnime-kompjuteresh-per-mesimdhenes-2-78465.html>
- tema, g. (2014, 08 26). *Tema in Aktualitete*. Gjetur 9 22, 2017, nga shkollat profesionale sipas modelit austriak: <http://www.gazetatema.net/web/2014/08/26/veliaj-shkolla-profesionale-sipas-modelit-austriak/>
- Union, C. o. (2009). Council conclusions of 12 May 2009 on a strategic framework for European cooperation in education and training (ET 2020). *Official Journal of thr European Union C119*, 2-10.
- Union, C. o. (2011). Council conclusions on a benchmark for learning mobility. *Official Jurnal of the European Union,C372*, 31-35.
- Union, European Parlamet and Council of the European. (2009). *Recommendation of the European Parliament and of the Council of 18 June 2009 on the establishment of a European quality assurance reference framework for vocational education and training*. European Parlamet and Council of the European Union.
- Wikipedia. (2013, 10 5). *Wikipedia*. Gjetur 6 25, 2015, nga Gjakova: <https://en.wikipedia.org/wiki/Gjakova>